



Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë



2017 - 2036

Kuvendi i Republikës së Kosovës
Qeveria e Republikës së Kosovës

Zyra e Kryeministrit – Këshilli ndër-ministoror për ujëra
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Financave
Komunat e Kosovës



Detajet e Dokumentit

Titulli i dokumentit: Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë

Lëshuar nga: MMPH

Data e lëshimit: 5.05.2017



Përmbajtja

Detajet e Dokumentit.....	2
Përmbajtja	3
Fjalori i shkurtesave dhe Formulatat.....	5
Parathënie	7
1 Hyrje.....	8
1.1 Kronologjia e procesit të hartimit të Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës	8
1.2 Baza Ligjore	9
1.3 Mjedisi i Kosovës.....	11
1.4 Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë.....	15
1.5 Fushëveprimi i Strategjisë.....	15
1.6 Struktura logjike.....	18
2 Objektivat strategjike	19
2.1 Shfrytëzimi i ujërave	21
2.2 Mbrojtja e ujërave	21
2.3 Mbrojtja nga ujërat.....	22
2.4 Qeverisja	22
2.5 Objektivi Horizontal: Përafrimi i legjislacionit Kosovar me Direktivat e BE-së	23
2.6 Parimet.....	25
2.7 Treguesit objektivisht të verifikueshëm	25
3 Rrethanat e Kosovës	34
3.1 Demografia	34
3.2 Gjeografia.....	38
3.3 Ekonomia	45
3.4 Perspektivat dhe projeksionet e zhvillimit.....	47
3.5 Financimi institucional	49
3.6 Përmbledhje e treguesve ekonomik.....	52
4 Legjislacioni, institucionet dhe politikat.....	54
4.1 Legjislacioni ekzistues	54
4.2 Përafrimi me legjislacionin e ujit të BE-së.....	62
4.3 Institucionet e qeverisë qendrore	67
4.4 Institucionet lokale të qeverisjes	74
4.5 Institucionet e shërbimeve të ujit.....	74
4.6 Institucionet e shërbimit të ujitjes.....	75
4.7 Menaxhimi i të dhënave	76
4.8 Korniza e politikave.....	79
4.9 Sfidat Kyçe të Implementimit	94



5	Performanca Aktuale e Sektorit.....	99
5.1	Shfrytëzimi i Ujërave.....	99
5.2	Mbrojtja e Ujërave.....	110
5.3	Mbrojtja nga Uji.....	116
5.4	Qeverisja.....	122
5.5	Përformanca Financiare.....	123
5.6	Procesi i Investimeve.....	128
6	Nevojat Zhvillimore.....	131
6.1	Shfrytëzimi i Ujit.....	131
6.2	Mbrojtja e Ujërave.....	150
6.3	Nevojat për zhvillim – mbrojtja nga ujërat.....	162
6.4	Nevojat zhvillimore - qeverisja.....	168



Fjalori i shkurtesave dhe Formulat

Shkurtesat

Shkurtesa	Emri i Plotë
ADA	Agjencia Austriake e Zhvillimit
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare për Privatizim
AMSH	Analza Mjedisore e Shtetit
AMMK	Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
ARRU	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit
AT	Asistencë Teknike
ATShI	Asistencë Teknike dhe Shkëmbim Informacioni
BAR	Baza e Aseteve të Rregulluara
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BER	Burimet e Energjisë së Ripërtërishme
BK	Buxheti i Kosovës
CAPEX	Shpenzimet Kapitale
DEI	Direktiva për Emetimet Industriale(2010/75/EU)
DKU	Direktiva Kornizë për Ujëra (2000/60/EC)
DTUNU	Direktiva mbi Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC)
DU	Departamenti i Ujërave
DUP	Direktiva për Ujë të Pijshëm
EE	Efiçienca e Energjisë
b.e.	Banorë Ekuivalent
FIDIC	Federata Ndërkombëtare e Konsulentëve Inxhinier
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
HC	Hidrocentral
NJBU	Njësitë Biznesore për Ujitje
IHMK	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IMMK	Inspektorati Mjedisor i Kosovës
ITUZ	Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura
IPPC	Kontrolli i Integruar i Parandalimit dhe Mbrojtjes
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KBO ₅	Kërkesa biokimike për oksigjen për 5 ditë
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KIK	Kuvendi i Kosovës
KKK	Këshilli Konsultativ i Konsumatorëve
KNMU	Këshilli Ndër-ministror për Ujëra
KRU	Kompani Rajoonale e Uësjellësit
KShP	Ndërmarrje e Shërbimeve Publike
LPBD	Litra për kokë banori për ditë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MNS	Materiet e Ngurta të Suspenduara
MNTh	Materialet e ngurta të thata
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSh	Marrëveshja për Shërbime (në mes të Komunave dhe KRU)



Shkurtesa	Emri i Plotë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NCA N	Ndihma e Kishës Norvegjeze Azoti
NP	Ndërmarrje Publike
NPV	Vlera Aktuale Neto
NJOU	Njësia Operacionale e Ujërave
NJPMNP NVM	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (MZHE) Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OFWAT	Zyra për Rregullimin e Ujërave (Angli dhe Uells)
OPEX P	Shpenzimet Operative Fosfori
PMA	Plani i Menaxhimit të Aseteve
PMPL	Planifikimi për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
PSP	Participimi i Sektorit Privat
PVIU	Plani i Veprimit dhe i Investimeve për Ujëra
QeK	Qeveria e Kosovës
SIRU	Sistemi i Informacionit për Resurse Ujore KISTERS (softuer)
SSHUK	Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës
SVPU	Sistemi i Vlerësimit dhe Planifikimit të Ujërave
SHUKOS	Shoqata e Ujësjetësve të Kosovës
TFU	Task Forca e Ujërave
TUTM	Trupat Ujor Tepër të Modifikuar
TVSH UA	Taatimi në Vlerën e Shtuar Udhëzim Administrativ
UZ	Ujërat e Ndotura
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi për Mjedisin e Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USD	Dollari i Shteteve të Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VNT	Vlerësimi i Nevojave për Trajnime
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZZB	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim

Formulat

- Ndarja për një mijë , (presje)
- Ndarja për decimale . (pikë)
- Milion 10^6
- Miliard 10^9
- Trilion 10^{12}

Njësia monetare e përdorur në këtë strategji, përveç nëse ceket ndryshe, është: € Euro

Viti referues për çmimin nominal (përveç nëse ceket ndryshe): 2015

Përveç nëse ceket ndryshe, të gjitha vitet janë inkluzive, që d.m.th. periudha 2017 - 20 zgjatë 5 vjet duke përfshirë të dyja vitet 2017 dhe 2021.



Parathënie

Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës është hartuar në përputhje me Nenin 31 të Ligjit për Ujërat e Kosovës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.10, 29 prill 2013, Prishtinë). Strategjia Shtetërore për Ujëra është një dokument i planifikimit afatgjatë i cili përmban vizionin, misionin, objektivat, qëllimin, veprimet, aktivitetet dhe masat për zhvillimin e politikave ujore në Republikën e Kosovës. Ajo përcakton objektivat strategjike dhe drejtimet e zhvillimit të resurseve ujore duke filluar nga gjendja ekzistuese e sektorit të ujërave, shtjellimin e kërkesave, strukturat menaxhuese, detyrimet ndërkombëtare, kërkesat për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe cilësisë së ujërave, mbrojtjen nga ujërat dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore. Përmbajtja e Strategjisë është në përputhshmëri me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012 dhe direktivat relevante të BE-së, duke paraqitur kështu një bazë për diskutim dhe për përgatitjen e aplikacioneve për thithjen e fondeve nga Bashkimi Evropian. Strategjia Shtetërore për Ujëra po ashtu është një dokument në bazë të të cilit do të promovohen reforma në sektorin e ujërave me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore vendore dhe arritjes së standardeve të Bashkimit Evropian përkritazi me administrimin dhe menaxhimin e resurseve ujore. Strategjia për Ujëra, gjithashtu është një dokument i cili do të ndërlihd planifikime të shumë sektorëve, në veçanti ato të planifikimit hapësinor dhe urban të cilët lidhen direkt apo indirekt me sektorin e ujërave (furnizimi me ujë, shëndetësia, bujqësia, industria, energjetika, turizmi, peshkataria etj.). Strategjia ka një afat kohor prej 20 vitesh dhe do të vlejë për periudhën kohore të aprovuar. Strategjia planifikohet të implementohet në katër periudha kohore, periudha e parë do të përfshijë vitet 2017 deri më 2021, periudha e dytë 2022-2026, periudha e tretë 2027-2031 dhe periudha e katërt 2032-2036. Strategjia Shtetërore për Ujëra është hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Departamentit të Ujërave në bashkëpunim me institucionet e nivelit qendror, lokal, shoqërinë civile dhe me projektin e financuar nga BE “Mbështetje MMPH-së në menaxhim të burimeve ujore dhe monitorim të ujërave”, të menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBEK).

Partnerët kryesorë gjatë procesit të hartimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra kanë qenë Zyra e Kryeministrit (përmes Task Forcës së Ujërave, më vonë të transformuar në Këshillit ndër-ministror për ujëra), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si përgjegjëse për Ndërmarrjet Publike dhe Kompanitë Rajonale të Ujësjesve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, administratat komunale, sektori i biznesit dhe shoqëria civile.



1 Hyrje

Strategjia Shtetërore për Ujëra (SSHU) është një nga dokumentet kryesore të planifikimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Ky dokument është detyrim ligjor në përputhje me Ligjin Nr.04/L-147, Neni 31. Qeveria synon që përmes këtij dokumenti të adresojë dhe orientojë zhvillimet politike, operative dhe investive në sektorin e ujërave për periudhën 20 vjeçare. Qëllimi i Strategjisë është që të ofrojë një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të sektorit të ujërave duke përmbushur nevojat vijuese:

- Furnizimit me ujë të pijshëm,
- Ujë për prodhimin e ushqimit,
- Ujë për ujitjen e tokave bujqësore,
- Ujë për industrinë,
- Sport dhe rekreacion, dhe
- Gjenerimin e energjisë elektrike.

Qëllim tjetër i Strategjisë është përcaktimi i objektivave, veprimeve, aktiviteteve dhe masave për :

- Ruajtjen dhe mbrojtjen e resurseve ujore,
- Valorizimin ekonomik të resurseve ujore në kontesktin vijues:
 - “ta ruajmë këtë që kemi, duke e menaxhuar sa më mirë dhe duke përfituar nga kjo sa më shumë”),
- Menaxhimin e situatave që mund të ndodhin si thatësia dhe vërshimet dhe mbrojtjen prej tyre,
- Reagimin ndaj situatave emergjente dhe të jashtëzakonshme siç janë: ndotja e rastësishme dhe e qëllimshme e burimeve të ujit të pijshëm,
- Analiza dhe sigurimi i zgjidhjeve alternative për furnizim me ujë, ujitje dhe ujë industrial, përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare, zonave strategjike, lokacioneve në kuadër të NATURA 2000, ashtu siç parashihet në Kreun IX të Ligjit për ujëra Nr.04/L-147.

Strategjia Shtetërore për Ujëra synon të ofrojë zgjidhje edhe për trajtimin e ujërave të ndotura, objektiv ky i cili synohet të arrihet përmes zhvillimit të projekteve në ndërtimin e infrastrukturës për grumbullim dhe trajtim të këtyre ujërave. Objektivat strategjike synohet të arrihen përmes planit të veprimit dhe të investimeve për ujëra, i cili është pjesë përbërëse e këtij dokumenti strategjik. Plani për investime përmbledh projektet prioritare të përcaktuara nga MMPH në bashkëpunim dhe koordinim me sektorët tjerë të cilët direkt apo indirekt janë të lidhur me sektorin e ujërave ose shfrytëzojnë sasi të konsiderueshme të ujit në zhvillimin e veprimeve dhe aktiviteteve të tyre (furnizimi me ujë, ujitja, industria, energjetika, sporti dhe rekreacioni, ekologjia e lumenjve).

1.1 Kronologjia e procesit të hartimit të Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës

Edhe për këtë Strategji¹ vlen Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë për përgatitjen dhe aprovimin e dokumenteve strategjike dhe planeve për implementimin e tyre.

¹ Raporti i përputhshmërisë së kësaj strategjie me Udhëzimin Administrativ është dhënë në një dokument të veçantë



Nisma për hartimin e dokumentit aktual strategjik është marrë nga Zyra e Kryeministrit (përmes Task Forcës së Ujërave, e cila më vonë është transformuar në Këshillin Ndër-ministror për Ujëra) si dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i Ujërave (Neni 4, UA Nr. 02/2012).

Procesi i hartimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra ishte relativisht i gjatë dhe mjaft sfidues. Nismat për hartimin e këtij dokumenti burojnë nga Departamenti i Ujërave dhe nga Task Forca e Ujërave, i cili ka përgatitur koncept idenë (propozim projektin) në periudha të ndryshme planifikuese. Në periudhën 2006-2007, në kuadër të Planit dhe Strategjisë Zhvillimore të Kosovës (PSZHK) 2007-2013, Departamenti i ujërave kishte hartuar draftin e Strategjisë për sektorin e ujërave e cila planifikohej të ishte pjesë e PSZHK 2007-2013. Duke qenë se dokumenti PSZHK 2007-2013, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme dhe të mjaftueshme për zyrtarizim, draft strategjia e sektorit të ujërave 2007-20013 mbeti në nivelin e dokumentit intern të MMPH-së. Sektori i ujërave megjithatë vazhdoi t'i zhvillojë më tej konceptet, objektivat, qëllimet, veprimet, aktivitetet dhe masat e parapara me këtë dokument. Në këtë drejtim, në vitet pasuese, Departamenti i Ujërave me mbështetje të fortë të Këshillit Ndërministror për Ujëra në kuadër të Zyrës së Kryeministrit përsëri aktualizoi procesin e hartimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra duke e fuqizuar dhe avancuar edhe më tej rëndësinë e këtij dokumenti nëpërmjet:

- a) Ndryshimit dhe plotësimet të Ligjit për Ujëra për periudhën 2009 -2013,
- b) Integrimin e këtij koncept dokumenti në planet financiare në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, dhe
- c) Kërkimit të përkrahjes financiare nga Instrumenti Financiar për Para-aderim në Bashkimin Evropian (IPA).

Në periudhën 2010 -2012, MMPH dhe TFU në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Bashkimit Europian në Kosovë² arritën që të sigurojnë mbështetje financiare nga ZBEK për zhvillimin e një projekti i cili do të rezultonte me hartimin e SSHU.

Kështu që, në shtator të vitit 2012, ZBEK dhe MMPH u dakorduan për një kontratë konsulence (Kontraktues) që t'i ndihmojë Departamentit të ujit të MMPH-së në hartimin e Strategjisë për Ujërat e Kosovës. Nga viti 2012, e deri më tani DU i MMPH dhe Kontraktuesi janë angazhuar fuqishëm në grumbullimin e të dhënave, sistemimin, sintezën dhe analizën e tyre, organizimin e takimeve me të gjithë akterët e sektorit të ujërave, ballafaqimin e ideve të ndryshme nga sektor të ndryshëm, organizimin e takimeve debatuese e deri te finalizimi i draftit të versionit të katërt të SSHU-së në Gjuhët Angleze, Shqipe dhe Serbishte në prill 2017. Revidimi final i Strategjisë është bere nga eksperti i angazhuar nga Ambasada Zvicrane, Prof.Dr. Ibrahim Krasniqi. Përparimi i projektit është ndjekur dhe monitoruar nga Komiteti Drejtues i Projektit i përbërë nga institucionet kyçe të sektorit të ujërave. Në fund, por jo me më pak rëndësi, në procesin e hartimit të këtij dokumenti strategjik janë përfshirë pothuajse të gjithë aktorët e sektorit të ujërave .

1.2 Baza Ligjore

Sektori i ujërave në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës Nr.04/L-147. Në nenin 1 të këtij ligji theksohet se resurset ujore janë me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës, dhe se, për më tepër, qëllimi i ligjit është që të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të resurseve ujore, të përcaktojë procedura dhe parime udhëheqëse për distribuimin optimal të burimeve ujore dhe të themelojë struktura institucionale për administrimin e resurseve ujore.

² Dikur Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian në Kosovë (ECLO)



Baza ligjore për hartimin e SSHU është parashikuar në Kreun VI të Ligjit Nr.04/L-147, neni 31, në të cilin theksohet se Ministria harton Strategjinë Shtetërore për Ujëra për një periudhë kohore 20 vjeçare me mundësi rishikimi dhe plotësimi çdo pesë (5) vjet. Po ashtu në paragrafin 3, të neni 31, theksohet se ky dokument hartohet në bashkëpunim me organet tjera kompetente të administratës shtetërore në fushën e ekonomisë, financave, bujqësisë, pylltarisë, zhvillimit rural, industrisë, shëndetësisë, transportit, komunikacionit, energjisë, trashëgimisë kulturore, ndërmarrjeve publike dhe private, shoqërisë civile etj.

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 31, ky dokument propozohet nga Qeveria dhe miratohet nga Kuvendi e Republikës së Kosovës.

Kështu, Strategjia Shtetërore për Ujëra e Republikës së Kosovës është hartuar në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ujëra të Kosovës³.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 31 të Ligjit të ujërave kjo Strategji:

- Është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me autoritetet kompetente të administratës shtetërore (ashtu siç parashihet me paragrafin 3 të nenit 31):
 - Zyra e Kryeministrit – Këshilli Ndër-ministror për Ujëra)
 - Ministria e Zhvillimit Ekonomik
 - Ministria e Financave
 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
 - Ministria e Shëndetësisë
 - Ministria e Infrastrukturës
 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Ka qenë lëndë e konsultimeve me këto organe dhe me:
 - Asamblëtë dhe Autoritetet Komunale
 - Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit
 - Kompanitë publike dhe private,
 - Shoqërinë civile dhe
 - Organizata tjera nga fusha e mjedisit
- Është e vlefshme për një periudhë njëzet vjeçare: 2017 deri 2036
- Do t'i nënshtrohet rishikimit çdo pesë vjet
- Propozohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Zbatimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra do të arrihet përmes:

- Planit të Veprimit dhe Investimeve për Ujëra (PVIU), i cili mbulon periudhën e njëjtë njëzetvjeçare 2015 - 2034 dhe përbëhet prej katër planeve pesëvjeçare
 - Programi parë i PVIU-së: 2017 - 2021
 - Programi dytë i PVIU-së: 2022 – 2026
 - Programi tretë i PVIU-së: 2027 – 2031

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 29 PRIL 2013, PRISHTINË



- Programi katërt i PVIU-së: 2032 – 2036
- Planit për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve të hartuar në bazë të nenit 32 të Ligjit për Ujëra, versioni fillestar i të cilit do të bëhet në vitin 2017 për periudhën 2017-2021, dhe i cili rrjedhimisht do të azhurnohet sipas orarit vijues:
 - Plani për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve I: 2017 – 2021
 - Plani për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve II: 2022 – 2026
 - Plani për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve III: 2027 - 2032
 - Plani për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve III: 2033 - 2038

Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, në veçanti Programet e Masave të hartuar sipas nenit 24 të Ligjit për Ujëra, do të zhvillohen në pajtim me këtë strategji dhe në koordinim të plotë me Planin e veprimit dhe të investimeve në ujëra dhe me programet e implementimit, të përshkruara në këtë dokument.

1.3 Mjedi i Kosovës

1.3.1 Lokacioni

Republika e Kosovës shtrihet në Evropën jug-lindore, në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik (Ballkanin Perëndimor). Koordinatat gjeografike të Kosovës janë 41°50' 58" N - 42°15' 42" N në gjerësi gjeografike, dhe 20°01'02" E - 21°48'02" E në gjatësi gjeografike (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+). Kosova ka sipërfaqe totale prej 10,908 km², kufizohet me Shqipërinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë, dhe Malin e Zi. Republika e Kosovës ka 1,739,825 banorë (regjistrimi i Popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2011) dhe ka dendësi të lartë të popullsisë prej 159 banorë për km².

Që nga viti 2013 Kosova është ndarë në 37 njësi komunale (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal). Në aspektin e shërbimeve me ujë, Kosova ndahet në 7 regjione: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji dhe Gjlani.

1.3.2 Relievi

Republika e Kosovës karakterizohet me relief relativisht të butë, në periferi është e rrethuar nga vargmale të larta. Maja me e lartë është Gjeravica me lartësi mbidetare 2,656 m, dhe pika më e ulët është në Drinin e Bardhë, në Vërmicë, në kufi me Shqipërinë (Baza e Hidroekonomisë së Kosovës, 1983). Disa nga pjesët karakteristike të relievit të Kosovës janë: Gryka e Kaçanikut, gryka e Rugovës, Ujëvarat e Mirushës, Rrafshi i Dukagjinit, Rrafshi i Kosovës dhe rrafshnaltat e Drenicës dhe Kriva Reka.

1.3.3 Hidrografia

Republika e Kosovës është e ndarë në pesë sipërfaqe ujëmbledhëse që krijojnë pesë pellgje lumore, Drini i Bardhë, Sitnica, Morava e Binçës, Lepenci dhe Plava ("Jaroslav Çerni" Instituti i Hidroekonomisë, 1983-2000, Master Plani për Ujëra, Beograd):

- Uji i lumit Drini i Bardhë rrjedh në drejtim të jug-perëndimit dhe derdhet në Detin Adriatik,
- Uji i lumit të Plavës rrjedh në drejtim të jugut dhe derdhet në Detin Adriatik,
- Uji i lumit Ibër-Sitnicë rrjedh në drejtim të veriut dhe derdhet në Detin e Zi,
- Uji i lumit Morava e Binçës rrjedh në drejtim të jug-lindjes dhe shkarkohet në Detin e Zi, dhe
- Uji i lumit Lepenc rrjedh në drejtim të jugut dhe derdhet në Detin Egje.

Lumenjtë më të rëndësishëm janë:

- Drini i Bardhë,
- Lumbardhi i Pejës,



- Lumbardhi i Deçanit,
- Lumbardhi i Prizrenit,
- Ereniku, Toplluha,
- Mirusha,
- Klina,
- Sitnica,
- Llapi,
- Ibri,
- Lepenci,
- Morava e Binçës,
- Kriva Reka dhe
- Drenica

Brenda territorit të Kosovës gjinden gjashtë akumulime kryesore të ujërave sipërfaqësore (akumulacione):

- Ujmani,
- Batllava,
- Badovci,
- Përlepnica,
- Livoqi, dhe
- Radoniqi

Burimet e ujërave minerale dhe termo-minerale janë të shpërndara në tërë territorin e vendit. Disa nga burimet me të njohura janë:

- Kllokoti,
- Banja e Pejës,
- Velekinca,
- Mirashi dhe
- Runiku.

1.3.4 Resurset natyrore dhe biodiversiteti

Republika e Kosovës dallohet me diversitetin e resurseve të saj natyrore dhe biodiversitetit të saj të pasur. Ka depozita të mëdha të resurseve minerale metalike dhe jo-metalike, siç janë: plumbi, zinku, argjendi, nikeli, kromi, ligniti, agregatet dhe materialet ndërtimore, depozitat argjilore, shkëmbinjtë gëlqerorë. Përveç kësaj, Republika e Kosovës dallohet me biodiversitet të pasur, duke strehuar shumë specie të bimëve endemike dhe një numër të madh të vlerave të mbrojtura natyrore, parqe nacionale, siç janë, Parku Nacional i “Bjeshkëve të Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, monumente natyrore të rëndësisë së veçantë “Ujëvarat e Mirushës”, etj. Resurset tokësore – tokat bujqësore përbëjnë rreth 53% të sipërfaqes tokësore të territorit të Republikës së Kosovës, toka pyjore përbën 41.8% dhe sipërfaqja tjetër tokësore (zona të ndërtuara dhe ujëra) mbulon 5.2% (Instituti i Planifikimit Hapësinor, 2010, Plani Hapësinorë i Kosovës 2010-2020+, f. 41).

Infrastruktura e transportit (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore) – infrastruktura rrugore është mjaft e zhvilluar në të gjitha drejtimet. Rrugët më të rëndësishme janë:

- Rruga kryesore M9 Prishtinë- Pejë,
- Rruga kryesore M25 Prishtinë-Podujevë,
- Rruga kryesore M9 Prishtinë-Pejë



- Rruga kryesore M2 (Prishtinë-Kaçanik), dhe
- Autostrada “Ibrahim Rugova” Morinë-Merdarë e rëndësisë speciale.

Tri linjat hekurudhore janë:

- Kaçanik – Fushë Kosovë – Mitrovicë,
- Fushë Kosovë – Pejë dhe
- Fushë Kosovë – Podujevë.

Figura 1 Pozita gjeografike e Republikës së Kosovës në raport me vendet tjera të rajtonit





1.4 Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë

Strategjia Shtetërore për ujëra bazohet në qëllimet e përcaktuara në Nenin 1 të Ligjit për Ujërat e Kosovës Nr.04/L-147, të definuara si në vijim:

- të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio - ekonomik të Republikës së Kosovës;
- të përcaktojë procedura dhe parime udhëheqëse për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin;
- të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tejshfrytëzimi dhe keqpërdorimi;
- të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore.

1.5 Fushëveprimi i Strategjisë

Strategjia Shtetërore për Ujëra si njëri nga dokumentet kryesore të planifikimit dhe menaxhimit të resurseve ujore është konceptuar duke u bazuar në qasjen multi-sektoriale e cila orienton çështjet më të rëndësishme të ujërave duke përfshirë:

- Shfrytëzimin e ujërave
 - furnizimi me ujë të pijshëm
 - prodhimi i ushqimit
 - ujitja e tokave bujqësore
 - industria ekstraktive dhe përpunuese
 - gjenerimi i energjisë elektrike
 - peshkataria
 - turizmi, sporti dhe rekreacioni
- Mbrojtjen e ujërave
 - grumbullimi i ujërave të ndotura nga amvisëria (sistemi i kanalizimit publik)
 - grumbullimi i ujërave të ndotura nga industria ekstraktive dhe përpunuese (sisteme të veçanta)
 - grumbullimi i ujërave atmosferike (shiu, bora etj. - sisteme publike)
 - trajtimi i ujërave të ndotura (infrastruktura)
 - monitorimi i parametrave të shkarkimit të ujërave të ndotura në recipient
- Mbrojtjen nga ujërat
 - Vërshimet (rregullimi i segmenteve lumore, masat biologjike, muret mbrojtëse nga vërshimat, gabionet, argjinaturat etj.)
 - Kapërderdhjet (muret mbrojtëse, ngritje të terrenit me mbushje artificiale, etj.)
 - Erozioni (bankinat malore, pyllëzimi, mbrojtje të pyjeve etj.)
 - Kullimi (kanalet e drenazimit etj.)
 - Tharja (kanalet e drenazimit, mbushje, injektive etj.)
 - Thatësia (sistemet për paralajmërim të hershëm)
 - Ndryshimet klimatike

Pavarësisht nga përparimi i dukshëm që është bërë në vitet e fundit si rezultat i iniciativave të shumta dhe përmirësimeve në sektorin e ujërave, mbetet shumë për të bërë në të gjitha pjesët e këtij sektori,



duke përfshirë furnizimin me ujë, grumbullimin e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura, ujitjen, kullimin, menaxhimin e rrezikut nga vërshimet, parandalimin e erozionit dhe prodhimin e energjisë elektrike. Megjithatë, resurset ujore vlerësohen të pamjaftueshme (ky pohim bazohet në mungesë të studimeve dhe hulumtimeve hidrogeologjike). Zhvillimi i projekteve hulumtuese hidrogeologjike për të vlerësuar dhe saktësuar kapacitetet sasiore dhe cilësore të resurseve ujore deri më tani nuk është realizuar për shkak të mungesës financiare.

Pohimi bazohet në kërkesat e shumta të cilat reflektojnë dhe kërkojnë zgjidhje në sektorin e ujërave, kështu që deri më tani projektet e zhvilluara në këtë sektor kanë qenë më tepër të karakterit emergjent, pjesërisht zhvillimor dhe afatgjatë (nga buxheti i vendit), ndërsa projekte e financuara me buxhet të jashtëm (donacione etj.) në shumicën e rasteve kanë pasur karakter të ngritjes së kapaciteteve institucionale, humane dhe studime fizibiliteti për rajone, zona dhe segmente të caktuara.

Si të tilla, këto zhvillime gjithsesi konsiderohen si udhërrëfyes dhe lehtësues për zhvillimet e ardhshme të strategjisë Shtetërore për ujëra. Strategjia Shtetërore për Ujëra planifikohet të implementohet përmes planit të veprimit për investime brenda të cilit identifikohen projektet me prioritet dhe realizimi i tyre në periudha të caktuara kohore (afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata) përgjatë tërë kohëzgjatjes së Strategjisë Shtetërore për Ujëra.

Siç diskutohet më detajisht në Kapitullin 3, kapaciteti për investime kapitale është i kufizuar – dhe ka shumë kërkesa tjera konkurruese nga sektorët tjerë. Bruto produkti i brendshëm për kokë banori në paritetin e fuqisë blerëse vlerësohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar të jetë €7,766. Kjo është dukshëm më ulët se sa në shumë vende të BE-së (FMN 2013⁴):

- Kroacia: €18,191
- Republika Çeke: €27,200
- Gjermania: €40,007
- Spanja: €20,851

Të hyrat familjare janë rrjedhimisht më të ulëta sesa mesatarja e vendeve të BE-së. Në mënyrë që të mbrohen konsumatorët, Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) (më herët Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim) aktualisht aplikon politika tarifore që janë ekonomikisht të arsyeshme dhe të përballueshme për konsumatorët.

Strategjia e Shtetërore për ujëra të Kosovës është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me aktorët e tjerë në sektorin e ujërave, që të ofrojë këtë qasje për periudha afatgjata dhe afatshkurtra.

Strategjia Shtetërore e Ujërave, në pajtim me specifikimet e dakorduara, përcakton prioritetet sektoriale për fushën e ujërave, të cilat parashikohet të realizohen sipas periudhave kohore (afatshkurtra 5 vjet, afatmesme 10 vjet, dhe afatgjata 20 vjet) për të gjitha institucionet që kanë rol në menaxhimin e ujërave (duke përfshirë Qeverinë, MMPH, MBPZHR, MZHE, KRU-të, Komunat, NJBU). Kjo paraqet bazë racionale për planifikim dhe investim në projekte specifike të bazuar në kriteret të përcaktuara ndërsektoriale, konsideratat sektoriale e gjeografike, skenarë zhvillimorë, për të plotësuar dhe lehtësuar zbatimin e Ligjit të Ujërave dhe integrimin e Direktivave Kornizë të Ujit të BE-së.

Strategjia Shtetërore e Ujërave shoqërohet nga Plani i Veprimit dhe Investimeve në Ujëra (PVIU). PVIU identifikon projekte specifike të cilat planifikohen të realizohen në periudhën kohore afatshkurtesh, afatmesme dhe afatgjatë. Përderisa është e qartë se zhvillimi i infrastrukturës do të jetë komponenti

⁴ Baza e të dhënave mbi pasqyrën ekonomike të botës 2014:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/01/weodata/index.aspx>



me vlerë financiare më të lartë, PVIU përfshin gjithashtu masa për të trajtuar të gjithë gamën e nevojave të sektorit të ujërave, duke përfshirë:

- Legjislacionin
- Udhëzuesit
- Inspektimin dhe zbatimin
- Zhvillimin institucional
- Hulumtimet dhe kërkimet
- Monitorimin mjedisor
- Menaxhimin e informatave
- Rritjen e ndërgjegjësimit

PVIU përfshin planin financiar që tregon se si do të financohen projektet nga burime të ndryshme. Burimet financiare për implementimin e projekteve të planifikuara me Planin e Veprimit për Investime në Fushën e Ujërave planifikohet të sigurohen nga këto burime:

- Buxheti i Republikës së Kosovës
- Instrumenti i para-anëtarësimit (IPA) – mekanizmi financues i Bashkimit Evropian
- Donacione, grante dhe kredi
- Investimet e drejtpërdrejta private nga jashtë

Financimi i projekteve nga Buxheti i Republikës së Kosovës

- Financimi i projekteve të PVIU nga zëri buxhetor investime kapitale i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Financimi i projekteve të PVIU nga zëri buxhetor investime kapitale i komunave
- Financimi i projekteve të PVIU në kuadër të Ligjit për partneritet publiko -privat
- Financimi i projekteve të PVIU në kuadër të Ligjit për Koncesion dhe Ligjit Nr.04/L-147

Financimi nga Programi Instrumenti i BE-ës për ndihmë para-anëtarësimit (IPA)

- Financimi i projekteve të PVIU nga Komponentet I dhe II të Programit IPA (ngritje e kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimi ndërkufitar)

BE-ja është dakorduar për një numër të instrumenteve financuese që janë ose që do të vihen në dispozicion për Republikën e Kosovës. Në këtë aspekt, Bashkimi Evropian po luan rol të rëndësishëm në rindërtimin dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës, duke qenë financuesi më i madh i projekteve mjedisore përfshirë edhe sektorin e ujërave me qëllim të përafrimit me standardet e BE-së. Pritet që ndihmesa e BE-së të vazhdojë të ofrojë mbështetje financiare për Republikën e Kosovës, kështu që realizimi i PVIU do të lehtësonte implementimin e *Acquis* së BE-së për ujëra brenda periudhës kohore të Strategjisë Shtetërore për Ujërat (2017-2036).

Financimi nga donacione, grante dhe kredi

Parashihet që financimi i PVIU të bëhet nga donacione dhe grante pa kthim, dhe nga kredi të buta (me periudhë afatgjatë të kthimit të kredive) .

Një numër i donatorëve mbështesin në mënyrë aktive sektorin e ujërave në Republikën e Kosovës. Ndihtesa është ofruar kryesisht për sektorët mjedisor të rëndësishëm të lartë për Kosovën. Fillimisht kjo ndihmesë është përqendruar në përkrahjen e zhvillimit institucional dhe njerëzor, për të vazhduar me përgatitjen e legjislacionit primar, dokumenteve strategjike dhe planeve kryesore të veprimit për mjedisin dhe ujërat.



Përkrahja e vazhdueshme nga donatorët bilateral siç janë Zvicra dhe SHBA-të si dhe vendet anëtare të BE-së, do të jetë me dobi të madhe për Kosovën, posaçërisht në përkrahjen financiare të realizimit të PVIU dhe punëve shtesë për zhvillimin e strategjive, harmonizimin dhe përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me *Acquis* të BE-së.

Investimet e drejtpërdrejta private nga jashtë

Investimet e drejtpërdrejta private nga jashtë janë faktor kyç që garantojnë zhvillimin e suksesshëm të ekonomisë së Kosovës. Është e qartë se vendi ka nevojë për aksione të përbashkëta shtesë që të mbështesë zhvillimin ekonomik. Duke marrë parasysh shpenzimet e pritshme për përshtatjen e legjislacionit për mjedisin/ujërat në Kosovë me standardet e *Acquis* së BE-së për mjedisin, nevojitet një strategji më e hollësishme financiare për implementimin e strategjisë së tanishme për ujëra.

- Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës
- Financimi nga buxheti i Ministrisë (qendrore)
- Financimi nga komunat (lokal)
- Financimi nga të hyrat (të hyrat nga tarifatat e shërbimeve)
- Komponentet I, II dhe III të Programit IPA
- Burimet nga donatorët e jashtëm
- PPP

1.6 Struktura logjike

Strategjia Shtetërore për Ujëra ndjek një strukturë logjike:

- Miratimi i Objektivave Strategjike: këto objektiva janë mekanizma kryesorë të zërthyer në veprime, aktivitete dhe masa për zbatimin e Strategjisë Shtetërore të Ujërave.
- Definimi i Treguesve Objektivisht të Verifikueshëm në bazë të të cilëve monitorohet dhe raportohet përmbushja e objektivave të Strategjisë.
- Vlerësimi i situatës aktuale në aspektin e:
 - Përformancës momentale të sektorit të ujërave
 - Kufizimeve dhe mundësive: një vlerësim kritik i situatës momentale dhe gjasat për zhvillim në sektorin e ujërave, veçanërisht në aspektin e përmirësimit të Treguesve objektivisht të verifikueshëm.
- Vlerësimi i nevojave zhvillimore
- Analizat ekonomike dhe financiare
- Përgjigja strategjike përfshirë:
 - Definimin e objektivave strategjike – këto objektiva përshkruajnë në detaje arritjet e objektivave strategjike në hapa, së bashku me afatet kohore për arritjen e tyre të përcaktuar sipas secilës periudhës programore të Planit të veprimit dhe investimeve për ujëra
 - Politikat
- Plani i zbatimit
 - Programi i Masave që duhet ndërmarrë
 - Plani i financimit



2 Objektivat strategjike

Definimit të objektivave strategjike i ka paraprirë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Legjislacioni i Republikës së Kosovës, veçanërisht:
 - Ligji për Ujërat e Kosovës (Nr.04/L-174, 2013)
- Politikat dhe strategjitë ekzistuese të Republikës së Kosovës duke përfshirë ato që adresojnë zhvillimin ekonomik, planifikimin hapësinor, bujqësinë, shëndetësinë, mjedisin, energjinë.
- Politikat dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e ujërave

Objektivat strategjike janë:

Strategjia Shtetërore për Ujëra është e konceptuar që për periudhën 20 vjeçare të arrijë **katër qëllime kryesore të nivelit të lartë** siç janë:

Mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve ujore

- Ruajtja dhe mbrojtja e statusit të mirë të burimeve ujore dhe rrjedhave ujore (aty ku mundet)
- Minimizimi i ndotjes së burimeve ujore dhe rrjedhave ujore (ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore)
- Ruajtja dhe mbrojtja e ekosistemeve ujore (prurja e pranueshme ekologjike)
- Mbrojtja nga dukuritë natyrore (vërshimet, kapërderdhjet, thatësitat, erozioni, ndryshimet klimatike etj.).
- Zhvillimi i resurseve ujore (hulumtimi dhe kërkimi).

Menaxhimi i integruar i resurseve ujore

- Strukturat institucionale (ndarja e përgjegjësive, menaxhimi i ujit në nivel të pellgut lumor)
- Ndarja e barabartë e resurseve ujore (parimi i barazisë, Konventa Aarhus, Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit)
- Shfrytëzimi racional i ujërave (ofrimi i shërbimeve për të gjitha nevojat)

Strategjia Shtetërore për Ujërat (duhet të) reflektojë për kërkesat që dalin nga Konventa Aarhus, të drejtat dhe detyrimet që ajo përmban, të cilat grupohen në tri drejtime themelore, që jo pa qëllim janë quajtur edhe tri shtyllat e Konventës:

- E drejta e publikut për të pasur e për të kërkuar informacion mjedisor;
- E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje për çështje të mjedisit;
- E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit.

Valorizimi ekonomik i resurseve ujore

- Parimi ndotësi paguan
- Parimi shfrytëzuesi paguan

Përafrimi me direktivat dhe standardet e BE-së për fushën e ujërave

- Direktiva Kornizë për Ujëra 2000/60EC
- Shfrytëzimi eficient i ujërave
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja nga ujërat
- Qeverisje dhe menaxhim i qëndrueshme e ujërave



Arritja e objektivave të nivelit të lartë do të udhëhiqet nga **aplikimi i parimeve kryesore** të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga parimet e menaxhimit të qëndrueshëm, të përcaktuara në Nenin 6 të Ligjit për Ujëra:

- Koncepti ekologjik, social dhe ekonomik (arritja e ruajtjes së prurjes së pranueshme ekologjike, duke mos rrezikuar ekosistemet ujore, ujë cilësor për rastet sociale dhe ujë me shumicë për zhvillimin ekonomik).
- Kujdesi
- Parandalimi
- Minimizimi i shfrytëzimit të resurseve ujore
- Integrimi
- Ndotësi paguan
- Shfrytëzuesi paguan
- Parandalimi i ndotjes
- Perspektiva kohore
- Pjesëmarrja e publikut dhe qasja në informata
- Pjesëmarrja e palëve të interesuara
- Parimi universal i shërbimeve ujore
- Barazia
 - Uji është e mirë publike
 - Qasje për të gjithë
- Eficienca ekonomike
 - Parimi Shfrytëzuesi paguan
- Sundimi i Ligjit⁵
- Mbrojtja e Mjedisit⁶
 - Parimi i kujdesit
- Transparenca
 - Pjesëmarrja e publikut
 - Qasja në informata⁷
 - Konsultimi me palët e interesit

Qëllimet e Strategjisë Shtetërore të Ujërave të Kosovës janë mishëruar në **pesë Objektivat Strategjike** të përshkruara në detaje më poshtë.

⁵ Neni 3 i Kushtetutës

⁶ Neni 122 i Kushtetutës

⁷ Neni 41 i Kushtetutës



2.1 Shfrytëzimi i ujërave

Republika e Kosovës do të përpiqet që përmes kësaj strategjie të shfrytëzojë në mënyrë optimale burimet e saj ujore duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar.

◆ Objektivi Strategjik 1

“Të ndahet dhe mbikëqyret në mënyrë të qëndrueshme e drejta për shfrytëzimin e burimeve ujore të Kosovës tek të gjithë shfrytëzuesit e ujit për të garantuar ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin, për të maksimizuar përfitimet ekonomike nga përdorimet tjera të ujit, duke marrë në konsideratë ndryshimin e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesave të ujit dhe duke respektuar parimin e menaxhimit të qëndrueshëm.”

Elementet kyçe për arritjen e këtij objekti për shfrytëzimin e ujërave përfshijnë:

- Sigurimi i të drejtave elementare:
 - Qasje në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin për të gjithë
 - Qasje në kanalizim adekuat për të gjithë
- Maksimizimi i përfitimeve ekonomike nga shfrytëzimi i burimeve ujore për Republikën e Kosovës pa rrezikuar të drejtat themelore
 - Prodhimi bujqësor
 - Prodhimi industrial
 - Gjenerimi i energjisë
 - Peshkimi
 - Turizmi, rekreacioni dhe ujërat termo-minerale
- Qëndrueshmëria
 - Objektivat mjedisore
 - Nevojat mjedisore (siç është prurja minimale ekologjike e definuar në Nenin 1.29 të Ligjit për Ujëra)
 - Cilësia ekologjike: hidro-morfologjia
 - Qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike duke përfshirë ndryshimet e projektuara

Me shfrytëzimin e burimeve ujore në dobi të banorëve të Republikës së Kosovës, Strategjia i jep prioritet shfrytëzimit eficient të resurseve ujore dhe financiare.

2.2 Mbrojtja e ujërave

◆ Objektivi Strategjik 2

“Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që ndikojnë në ujëra në mënyrë proporcionale, eficiente dhe efektive, në mënyrë që të arrihen objektiva mjedisore të arsyetuara nga aspekti ekonomik për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke respektuar parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.”

Mbrojtja e ujërave përfshin:

- Balancimin ekonomik: përcakton objektivat mjedisore për trupat specifike ujorë në mënyrë eficiente ekonomike dhe proporcionale
- Përputhshmërinë me standardet evropiane (objektivat mjedisore dhe dispozitat e ndërlidhura të derogimit të parapara në Nenin 4 të Direktivës Kornizë të Ujërave të BE-së 2000/60/EC)



- Efektivitetin e kostos: masat e ndërmarra për të mbrojtur ujërat përdorin metoda dhe mjete që paraqesin kombinim më kosto-efektiv të masave për të arritur nivelin e dëshiruar të mbrojtjes.
- Barazia – ndotësi/shfrytëzuesi paguan: ngarkesa financiare dhe ekonomike e ndërmarrjes së masave mbrojtëse duhet të bartet nga pala përgjegjëse për ndotjen.

2.3 Mbrojtja nga ujërat

◆ Objektivi Strategjik 3

“Arritja e niveleve të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë vërshimet, rrëketë dhe erozionin në një mënyrë ekonomikisht të ekuilibruar dhe me kosto efektive.”

Ky objektivi përfshinë:

- Sigurimin e mbrojtjes nga vërshimet sipas standardeve të pranueshme duke përfshirë:
 - Paralajmërimin e rrezikut nga vërshimet
 - Parandalimin e vërshimeve
 - Zvogëlimin e efekteve të vërshimeve
 - Ndihmën emergjente
- Nevojën për koordinimin e planeve për shfrytëzimin e tokës duke përfshirë:
 - Planifikimin hapësinor
 - Planifikimin bujqësor
- Eficiencën ekonomike – arritja e përfitimevenga mbrojtja që janë shumë më të larta sesa kostoja
- Efektivitetin e kostos – përdorimi i mjeteve më efektive për arritjen e nivelit të dëshiruar të mbrojtjes

2.4 Qeverisja

◆ Objektivi Strategjik 4

“Të themelohet dhe të mirëmbahet një sistem i qeverisjes së ujit që është i drejtë, transparent, efikas, i koordinuar dhe me kapacitete të tillë profesional dhe teknik që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efektive arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat, duke përfshirë zbatimin e një sistemi të informacionit për ujërat për të monitoruar, vlerësuar, interpretuar dhe informuar palët e interesuara për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie.”

Parimet kryesore që duhet të merren në konsideratë për qeverisjen e sektorit (dhe në përgjithësi) përfshijnë:

- Efektiviteti – detyrat e “autoriteteve kompetente” ndërmerren në mënyrë efektive për të zbatuar dispozitat e politikave sektoriale dhe në veçanti të legjislacionit sektorial
- Efienca - detyrat ndërmerren në mënyrë eficiente ashtu që barra si në autoritetet kompetente ashtu edhe në ata që iu nënshtrohen procedurave të qeverisjes të minimizohet; efektivisht, kjo kërkon një qasje të koordinuar, profesionale dhe të strukturuar.



- Proporcionaliteti - niveli i burimeve që angazhohen për aspekte të veçanta të qeverisjes (dhënia e lejeve, monitorimi, zbatimi, raportimi etj.) është në proporcion me rëndësinë e aspektit në terma financiar dhe ekonomik.
- Qasja e drejtë - sistemi i qeverisjes operohet pa paragjykime.
- Transpareca – në pajtim me dispozitat e Kushtetutës (p.sh. Neni 41 i kushtetutës: E drejta për qasje në dokumente publike), Konventa e Arhus-it dhe instrumentet tjera ligjore (Ligji i Ujërave, p.sh. Neni 3 për qasjen në informata) procesi i qeverisjes është transparent dhe i hapur për shqyrtim publik nëpërmjet ofrimit të qasjes në informata dhe ku ka pjesëmarrje relevante të publikut në proceset e vendim-marrjes

Me rëndësi në këtë drejtim janë dispozitat indikative të BE-së “për rregullim me të mirë”⁸.

2.5 Objektivi Horizontal: Përafrimi i legjislacionit Kosovar me Direktivat e BE-së

Objektivi Horizontal

“Të arrihet përputhshmëri afatgjatë me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave, fillimisht nëpërmjet adoptimit të sistemeve kompatible të legjislacionit dhe planifikimit, dhe mëpastaj me zbatimin hap pas hapi të masave praktike të zbatimit.”

Në periudhën afatmesme Kosova do të kërkojë të futet në Bashkimin Evropian. Një nga kërkesat e hyrjes në BE është përfarimi me legjislacionin e BE-së (*acquis communautaire*). Një shpjegim i legjislacionit të tanishëm të BE-së në sektorin e ujërave është dhënë në shtojcë. Duhet theksuar që legjislacioni i BE-së me kohë ndryshohet dhe se gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë (20 vjet) i njëjti mund të pësojë ndryshime rrënjësore. Por, këto ndryshime nuk pritet të jenë të mëdha, duke u bazuar në rezultatin e Testit të Pështatshmërisë së këtij legjislacioni që është ndërmarrë para pak kohe. Megjithatë, ndryshimet mund të vijnë në mënyra të ndryshme duke përfshirë:

- Iniciativat që mund të vijnë nga procesi i rishikimit të politikave:
 - Komisioni Evropian ka kryer kohën e fundit një “Test të Pështatshmërisë” së legjislacionit të ujërave të BE-së. Rezultatet⁹ e tij tregojnë se:
 - Nuk ka nevojë për legjislacion të ri
 - Është i nevojshëm një ri-rregullim i paktë i legjislacionit aktual
 - Kërkohet zbatim më i mirë i ligjit
 - Kërkohet koordinim më i mirë me proceset tjera planifikuese (p.sh. planifikimin hapësinor)
 - Kërkohen udhëzime (dhe sqarime) më të mira
 - Plani për Ruajtjen e resurseve ujore të Evropës “e bënë të qartë se një opsion alternativ i furnizimit - ripërdorimi i ujërave të ricikluara për ujitje dhe për industri - është paraqitur si një çështje që kërkon vëmendjen e BE-së.”
- Përshtatja teknike, p.sh. aranzhime për standardet e reja apo të amandamentuara të cilësisë së mjedisit¹⁰

⁸ Shiko linkun për informata me të detajuara:

http://ec.europa.eu/governance/better_regulation/index_en.htm

⁹ [http://www.ecologic-events.eu/Fitness-Check-](http://www.ecologic-events.eu/Fitness-Check-Workshop/sites/default/files/Conclusions_FC_2nd_Stakeholder_WS.pdf)

[Workshop/sites/default/files/Conclusions_FC_2nd_Stakeholder_WS.pdf](http://www.ecologic-events.eu/Fitness-Check-Workshop/sites/default/files/Conclusions_FC_2nd_Stakeholder_WS.pdf)

¹⁰ Shikoni p.sh. propozimet aktuale të listuara në PRELEX për sektorin e ujërave



- Kanalizimi i dispozitave ekzistuese (shih mëposhtë Qeverisjen) që vijnë si rezultat i iniciativës për Rregullim më të mirë dhe përfundimit të testit të gjendjes së legjislacionit

Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndikim të theksuar në strukturën e përgjithshme dhe drejtimin e legjislacionit, prandaj *acquis* e tanishme paraqet një bazë të mirë për politikën e ujërave të Kosovës.

Në aspektin konceptual *acquis* përfshin:

- Përcaktimin e Qëllimeve
 - Objektivat mjedisore:
 - Direktiva Kornizë e Ujërave (Neni 4)
 - Standardet e cilësisë së mjedisit
 - Standardet e statusit të ujërave nëntokësore
 - Objektivat që kanë të bëjnë me Shëndetësinë
 - Direktiva për ujin e pijshëm
 - Direktiva për ujin për larje
- Kufizimet për shkarkim të ndotësve në mjedis
 - Direktiva për ujërat e ndotura urbane
 - Direktiva për emetimet industriale
 - Direktiva për llumin e ujërave të ndotura
- Krijimin e mekanizmave për arritjen e këtyre qëllimeve
 - Kërkesat për autorizim paraprak (lejet) – Direktiva të ndryshme
 - Planifikimi për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve – Direktiva Kornizë për Ujërat
 - Planifikimi për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet
- Kërkesat për monitorim dhe raportim

Kërkesat e tjera me rëndësi të BE-së përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm në):

- Dispozitat për kontrollin e ndotjes sipas Direktivës për emetime industriale (DEI 2010/75/EU)
- Caqet për energji të ripërtrishme (në kuadër të Pakos energjetike dhe klimatike)
- Caqet për efikasitet të energjisë dhe temetimin e gazrave serë (gjithashtu sipas Pakos energjetike dhe klimatike)
- Dispozitat për mbrojtjen e natyrës sipas Direktivës së Habitaveve (92/43/EC) dhe Direktivës së Zogjve (2009/147/EC)
- Dispozita për informim dhe pjesëmarrje të publikut (Direktivat 2003/4/EC dhe 2003/35/EC)
- Përgjegjësia mjedisore (Direktiva 2004/35/EC)
- Dispozitat e prokurimit publik¹¹

¹¹ Shih në veçanti Direktivën 2004/17/EC të 31 marsit 2004 që koordinon procedurat e prokurimit në sektorin e ujërave, energjisë, transportit dhe të shërbimeve postare, OJ L 134, 30.4.2004, p. 1.



2.6 Parimet

Parimet në vijim, të bazuara në Kushtetutë, Ligjin e Ujërave dhe zotimet e Qeverisë së Kosovës bërë qytetarëve të Kosovës, janë politikat e nivelit më të lartë dhe shërbejnë si udhërrëfyes për zbatimin e të gjitha masave dhe aktivitete tjera.

Qeveria e Kosovës mbështet parimet e mëposhtme:

- Uji është pasuri publike dhe Qeveria e Kosovës si gardian i interesave kombëtare do të menaxhojë me kujdes resurset ujore në mënyrë që të gjithë qytetarët të përfitojnë njësoj nga to.
- Qasja në ujë të pijshëm dhe kanalizim janë nevoja themelore njerëzore dhe ofrimi i tyre për të gjithë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë është funksion thelbësor i Qeverisë.
- Shfrytëzimi i ujërave, mbrojtja e ujërave dhe mbrojtja e qytetarëve dhe pronave të tyre nga efektet e dëmshme të ujërave janë të gjitha kushte bazë për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të Kosovës – dështimi për financim dhe menaxhim të duhur të këtij sektori nuk është opsion.
- Kosova ka perspektivë për anëtarësim në BE dhe për këtë arsye angazhohet për të zbatuar të gjitha dispozitat e *acquis communautaire* në kohën e duhur.

2.7 Treguesit objektivisht të verifikueshëm

Objektivat strategjike të përcaktuara më sipër janë të shprehura në terma narrative. Një përshkrim i tillë tekstual është i domosdoshëm për të kuptuar, por nuk siguron një monitorim dhe raportim lehtë të verifikueshëm. Prandaj, janë definuar një numër i treguesve objektivisht të verifikueshëm që kanë më shumë fokus numerik. Shumë nga këta shërbejnë për verifikimin e treguesve ekzistues, veçanërisht ata që janë definuar nga ARRU, kurse të tjerat janë të reja apo të adaptuara. Me treguesit e përdorura nga ARRU mund të ketë disa tregues për një çështje të vetme. Për shembull, për shkallën e lidhjeve në sistemin publik të furnizimit me ujë të pijshëm (Referenca e ARRU)

- Vlerat absolute: Numri i familjeve të kyçura në rrjet (W.2.A.01)
- Vlerat relative: përqindja e familjeve në zonën e shërbimit që janë të kyçura në rrjet (W.2.A.02)
- Treguesit e progresit: Numri i familjeve të kyçura në rrjet / numri i i planifikuar¹²

Treguesit janë gjithashtu të grupuar në dy nivele: "**kryesorë**" dhe "**të hollësishëm**", ku treguesi kryesor ofron "në një shikim të shpejtë" informacionin për çështjen që po konsiderohet. Informatat shtesë gjenden në treguesit e hollësishëm.

Treguesit janë nxjerrë drejtpërdrejt nga Objektivat Strategjike.

Treguesit do të raportohen çdo vit në të dy nivelet.

Përderisa shumë nga treguesit kanë për qëllim dhënien e informacionit "me një shikim të shpejtë" për gjendjen e sektorit të ujërave, disa janë në gjendje të përdoren për përcaktimin e "caqeve" apo qëllimeve. Për shembull, përcaktimi i caqeve në aspektin e numrit të familjeve të kyçura në rrjetin e shërbimit publik është i duhur dhe ofron motivim të drejtpërdrejtë. Megjithatë, në rastet e zbatimit të ligjit do të ishte e papërshtatshme të përcaktohen caqe pasi që indikatorit përfshinë si shkallën e shkeljes së ligjit ashtu edhe nivelin e efikasitetit të zbatimit të ligjit.

12 Një indikatorë i tillë është i krahasueshëm me treguesit e ndryshëm "real në raport me planin" që përdoren nga ARRU siç është vëllimi i shitjeve për familjet (i matur) krahasuar me atë të planifikuar (W.3.A.02) % të planit të vlerësuar



Caqet numerike përcaktohen në pjesën e Politikave të Strategjisë që pason vlerësimin e situatave aktuale dhe të potencialit për zhvillim në mënyrë që objektivat të jenë ambiciozë, por të arritshëm.

“Ofruesit e shërbimeve ujore” i përfshijnë subjektet vijuese:

- Kompanitë regjionale të ujit,
- Organizatat / Shoqatat e shërbimeve në komunitet

2.7.1 Treguesit e shfrytëzimit të ujit

Një listë e plotë e treguesve objektivisht të verifikueshëm për objektivat strategjike të përdorimit të ujit është dhënë në tabelën e mëposhtme. Treguesit kryesor janë dhënë në fund të nën-seksionit.

Tabela 1 Detajet e treguesve objektivisht të verifikueshëm: Objektivit Strategjik1 – përdorimi i ujërave

Ref	Indikatori	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
1.1	<u>Kapaciteti i shfrytëzueshëm i akumulimit të ujit për të përkrahur furnizimin e qëndrueshëm me ujë: Parandalimi i thatësirave</u>			
1.1a	Kapaciteti specifik i akumulimit – absolut	Vëllimi i akumulacionit (m ³ /banor)	Regjistri i akumulacioneve	MMPH
1.1b	Kapaciteti specifik i akumulimit – relativ	Vëllimi i akumulacionit si përqindje e vitit bazë: 2015 (% i 2015)	Regjistri i akumulacioneve	MMPH
1.1c	Sasia e ujërave sipërfaqësore	Proporcioni i trupave ujorë sipërfaqësor që i nënshtrohen mungesës së ujit (dështimi për të ruajtur prurjen minimale ekologjike)	IHMK	MMPH
1.1d	Sasia e ujërave nëntokësore	Proporcioni i trupave ujorë nëntokësore që arrijnë status të mirë sasior.	IHMK	MMPH
1.1e	Kufizimet në përdorim	Numri i kufizimeve të shkaktuara nga thatësira që iu imponohen bartësve të licencave për nxjerrjen e ujërave	Departamenti i ujërave	MMPH
1.2	<u>Mbulueshmëria me shërbime të ujit të pijshëm në përputhje me standardet</u>			
1.2a	Proporcioni i popullsisë urbane me qasje në sistemin publik ¹³ të furnizimit me ujë	Popullsia urbane me qasje në rrjet / popullsia urbane totale (%)	Ofruesit e shërbimeve të ujit	ARRU
1.2b	Proporcioni i popullsisë rurale me qasje në sistemin publik të furnizimit me ujë	Popullsia urbane me qasje në rrjet / Popullsia rurale totale (%)	Ofruesit e shërbimeve të ujit	ARRU

¹³ Publik në këtë kontekst i referohet furnizimeve që ofrojnë kompanitë regjionale të ujit, shërbimet komunale dhe organizatat/asociacionet e shërbimit në komunitet



Ref	Indikator	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
1.2c	Proporcioni i konsumatorëve që marrin furnizim 24 orësh	Konsumatorët që marrin furnizim 24 orësh / Totali i konsumatorëve (%)	Ofruesit e Shërbimeve të Ujit	ARRU
1.2d	Cilësia mikrobiologjike	Niveli i përputshmërisë së analizave të ujit me standarde të cilësisë së ujit të pijshëm (%)	IKSHPK	ARRU
1.2e	Cilësia kimike	Niveli i përputshmërisë së analizave të ujit me standarde të cilësisë së ujit të pijshëm (%)	IKSHPK	ARRU
1.3	Mbulueshmëria me shërbimin e ujitjes			
1.3a	Sipërfaqja e tokës nën ujitje	Hektar	Shënimet e kompanive të ujitjes	MBPZHR
1.3b	Përqindja e tokës ujitshme nën ujitje	Toka e ujitur / Toka e ujitshme (%)	Shënimet e kompanive të ujitjes	MBPZHR
1.4	<i>Energjia e ripërtëritshme nga Hidrocentralet (këta tregues kanë të bëjnë më shumë me sektorin e energjisë se sa me atë të ujërave)</i>			
1.4a	<i>Energjia e gjeneruar – absolute</i>	<i>GWh e energjisë së gjeneruar nga hidrocentralet</i>	<i>Shënimet e ndërmarrjeve gjeneruese</i>	<i>Rregullatori i Energjisë</i>
1.4b	<i>Energjia e gjeneruar – relative</i>	<i>% e totalit të energjisë së gjeneruar nga hidrocentralet</i>	<i>Shënimet e ndërmarrjeve gjeneruese</i>	<i>Rregullatori i Energjisë</i>
1.5	Aplikimi i parimit “ndotësi pagan”			
1.5a	Humbjet administrative të ujit	% e ujit të prodhuar që humb për shkak të lidhjeve ilegale, vjedhjes së ujit, konsumi i pamatur dhe regjistrimi më i ulët nga ujëmatësit	Ofruesit e shërbimeve të ujit	ARRU
1.5b	Shkalla e arkëtimit (mbledhja) – shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm	% e faturave të paguara me kohë (%)	Ofruesit e shërbimeve të ujit	ARRU
1.5c	NShkalla e arkëtimit (mbledhja) – furnizimi i ujit me shumicë duke përfshirë ujitjen	% e faturave të paguara me kohë (%)	Shënimet e kompanive të ujërave	MBPZHR
1.5d	Nxjerrjet pa licencë	Proporcioni i ujërave të nxjerra për të cilin nuk janë dhënë licencat (%)	Inspektorati i ujërave	MMPH



Ref	Indikatori	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
1.5e	Norma e arkëtimit (mbledhja) taksat e nxjerrjes	% e faturave të paguara me kohë (%)	Shënimet e Departamentit të Ujërave	MMPH
1.6	Eficienca e shfrytëzimit			
1.6a	Uji i pa-faturuar: Furnizimi me ujë të pijshëm	% ujit të pa – faturuar krahasuar me prodhimin total (%): Uji i pijshëm	Ofruesit e shërbimeve të ujit	ARRU
1.6b	Uji i pa-faturuar: Furnizimi i ujit me shumicë	% ujit të pa-faturuar krahasuar me prodhimin total (%): Uji me shumicë	Furnizuesit me shumicë të ujit	MZHE
1.6c	Uji i pa-faturuar: Ujitja	% ujit i pa-faturuar krahasuar me prodhimin total (%): Ujitja	Kompanitë e ujitjes	MBPZHR
1.6d	Vlera e shtuar nga ujitja e bimëve – absolute	Prodhimet bimore nga tokat e ujitura: Euro në vit (€)	Llogaritë ekonomike për bujqësi	MBPZHR ASK
1.6e	Vlera e shtuar nga ujitja e bimëve – relative	Prodhimet bimore nga tokat e ujitura: Euro në vit / vëllimi i ujit të përdorur për ujitje (€/m3)	Llogaritë ekonomike për bujqësi	MBPZHR ASK
1.6f	Kontributi i sektorit të ujërave në BPV	% e Bruto Produktit Vendor që vie si rezultat i sektorit të ujërave (duke përfshirë hidrocentralet)	Agjencia e Statistikave të Kosovës	MZHE

Indikatorët kryesor janë:

- I. Mbulueshmëria e përgjithshme (tërë popullsia) me furnizim publik me ujë
- II. Përformanca e përgjithshme e shërbimit të Kompanive të ujit në furnizim me ujë¹⁴
- III. Vlera e kulturave të ujitura si përqindje e BPV
- IV. Përqindja e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet

2.7.2 Indikatorët për mbrojtjen e ujërave

Një listë e plotë e treguesve objektivisht të verifikueshëm për objektivin strategjik të mbrojtjes së ujërave është dhënë në tabelën e mëposhtme. Indikatorët kryesorë janë dhënë në fund të nënseksionit.

Tabela 2 Detajet e treguesve objektivisht të verifikueshëm: Objektivi Strategjik2 – Mbrojtja e Ujërave

Ref	Indikatori	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
2.1	Cilësia e ujërave sipërfaqësore			

¹⁴ Ky indikator është dhënë në Raportin Vjetor të Përformancës, ARRU



Ref	Indikator	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
2.1a	Cilësia fiziko-kimike ¹⁵	Nr. i trupave ujore sipërfaqësore që plotësojnë objektivat fiziko-kimik/ Nr.total i trupave ujore sipërfaqësore (%)	IHMK	MMPH
2.1b	Cilësia biologjike ¹⁶	Nr. i trupave ujore sipërfaqësore që plotësojnë objektivat biologjike/ Nr. total i trupave ujore sipërfaqësore (%)	IHMK	MMPH
2.1c	Cilësia hidromorfologjike ¹⁷	Nr. i trupave ujore sipërfaqësore që plotësojnë objektivat hidromorfologjike/ Nr.. total i trupave ujore sipërfaqësore (%)	IHMK Komunat	MMPH
2.2	Cilësia e ujërave nëntokësore			
2.2a	Cilësia fiziko-kimike	Nr. i trupave ujore nëntokësore që plotësojnë objektivat fiziko-kimike/ Nr. total i trupave ujore nëntokësore (%)	IHMK	MMPH
2.2b	Cilësia mikrobiologjike	Nr. i trupave ujore nëntokësore që plotësojnë objektivat mikrobiologjike/ Nr. total i trupave ujore nëntokësore (%)	IHMK	MMPH
2.3	Menaxhimi i Ujërave të ndotura			
2.3a	Proporcioni popullsisë urbane të kyçur në kanalizim publik	Popullsia urbane e kyçur / totali i popullsisë urbane (%)	Ofruesit e Shërbimeve të Ujit	ARRU
2.3b	Proporcioni i popullsisë rurale të kyçur në kanalizim publik	Popullsia rurale e kyçur / totali i popullsisë rurale (%)	Ofruesit e Shërbimeve të Ujit	ARRU
2.3c	Vetëm trajtimi primar i ujërave të ndotura (1°)	Vetëm trajtimi primar i ujërave të ndotura / Ujërat e ndotura të gjeneruara (%)	Ofruesit e Shërbimeve të Ujit	ARRU MMPH
2.3d	Trajtimi sekondar i ujërave të ndotura (2°)	Trajtimi sekondar i ujërave të ndotura / Ujërat e Ndotura të gjeneruara (%)	Ofruesit e shërbimeve të ujit	ARRU MMPH

¹⁵ Cilësia e elementeve fiziko-kimike të gjendjes ekologjike në Shtojcën V të Direktivës Kornizë të Ujërave

¹⁶ Cilësia e elementeve biologjike të gjendjes ekologjike në Shtojcën V të Direktivës Kornizë të Ujërave

¹⁷ Cilësia e elementeve hidromorfologjike të gjendjes ekologjike në Shtojcën V të Direktivës Kornizë të Ujërave



Ref	Indikator	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
2.3e	Përputhshmëria e ujërave të ndotura urbane të shkarkuara me kushtet e licencës	Numri i mostrave të ujërave të ndotura që plotësojnë standardet / Numri i mostrave të ujërave të ndotura që janë matur (%)	Ofruesit e Shërbimeve të Ujit Inspektorati IHMK	MMPH
2.3f	Përputhshmëria shkarkimeve të tjera me kushtet e licencës	Numri i mostrave tjera të ujërave të ndotura që plotësojnë standardet / Numri i mostrave të ujërave të ndotura që janë matur (%)	Inspektorati IHMK	MMPH
2.3g	Shkarkimi i ujërave të ndotura pa licencë përkatëse	Numri i shkarkuesve pa licencë	Inspektorati	MMPH
2.4	Zonat e mbrojtura ujore (ZMU)			
2.4a	Mbulueshmëria e ZMU-ve	Sipërfaqja e mbuluar me vendime për ZMU (km ²)	Vendimet Ligjore	MMPH
2.4b	Përputhshmëria me ZMU	Inspektimet e ZMU-ve – Përputhshmëria / Inspektimet e ZMU-ve	Inspektorati	MMPH KRU-të
2.5	Zbatimi i parimit “ndotësi paguan”			
2.5a	Shkalla e arkëtimit – Ujërat e Ndotura urbane	% e faturave të paguara me kohë (%)	Ofruesit e Shërbimeve të Ujit	ARRU
2.5b	Shkalla e arkëtimit – pagesa ujore për shkarkim të ujërave	% e faturave të paguara me kohë (%)	Shënimet e Departamentit të Ujërave	MMPH

Indikatorët titullarë janë:

- V. Mbulueshmëria e përgjithshme (e tërë popullatës) me mbledhje të ujërave të ndotura
- VI. Përformanca e përgjithshme e shërbimeve të Kompanive të ujërave –shërbimet e kanalizimit¹⁸
- VII. Cilësia e ujërave sipërfaqësore: % që arrijnë objektivat mjedisore (duke përfshirë gjendjen e mirë ekologjike)

¹⁸ Ky indikator është dhënë në Raportin Vjetor të Performancës, ARRU



2.7.3 Indikatorët e mbrojtjes nga ujërat

Një listë e plotë e treguesve objektivist të verifikueshëm për objektivat strategjike të Mbrojtjes nga ujërat është dhënë në tabelën e mëposhtme. Indikatorët titullarë janë dhënë në fund të nënseksionit

Tabela 3 Detajet e treguesve objektivist të verifikueshëm: Objektivii Strategjik 3 – Mbrojtja nga ujërat

Ref	Indikatori	Definicioni	Mënyra e verifikimit	Autoriteti raportues
<u>3.1</u>	<u>Menaxhimi i Rrezikrrezikut nga vërshimet</u>			
3.1a	Planifikimi i Menaxhimit të Rrezikut nga vërshimet (PMRP)	Sipërfaqja e vendit që është mbuluar me plane për vlerësimin e rrezikut nga vërshimet / Sipërfaqja e vendit (%)	Shënimet e MMPH Shënimet e Komunave	MMPH
3.1b	Mbrojtja nga Rreziku i Vërshimeve - Urbane	Zona urbane me rrezik të lart për vërshime (km ²)	Zbatimi i PMRP	MMPH IHMK
3.1c	Mbrojtja nga Rreziku i Vërshimeve – Jo-Urbane	Zona jo-urbane me rrezik të lart për vërshime (km ²)	Zbatimi i PMRP	MMPH IHMK
3.1d	Dëmtimet nga Vërshimet	Parashikimi i dëmeve ekonomike nga vërshimet (€)	Parashikim i W.I.	MMPH
<u>3.2</u>	<u>Siguria e Digave</u>			
3.2a	Siguria e Digave - Inspektimi	Niveli i përputhjes me standardet (inspektimet) (%)	Shënimet e Inspektimeve nga MZHE	MMPH
<u>3.3</u>	<u>Erozioni</u>			
3.3a	Përputhshmëria e zonave të erozionit	Zbatimi i masave lehtësuese për Zonat e erozionit (sipërfaqja) / totali i zonave të përcaktuara erozive (%)	Inspektorati i MMPH	MMPH Komunat

Indikatori kryesor:

VIII. Popullsia e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë të vërshimeve (%)



2.7.4 Treguesit për qeverisje

Një listë e plotë e treguesve objektivisht të verifikueshëm për objektivat strategjike të Qeverisja është dhënë në tabelën e mëposhtme. Treguesit kryesor janë dhënë në fund të nënseksionit

Tabela 4 Detajet e treguesve objektivisht të verifikueshëm: Objektiv Strategjik 4 – Qeverisja

Ref	Indikatori	Definicioni	Mënyra e Verifikimit	Autoriteti Raportues
<u>4</u>	<u>Niveli i transponimit të legjislacionit të BE-së</u>			
4.1a	Niveli i transponimit	Tabelat e përputhshmërisë	MMPH	MMPH
<u>4.2</u>	<u>Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore</u>			
4.2a	Plani Menaxhues për Pellgjet lumore	Sipërfaqja e vendit e mbuluar plotësisht me Planin menaxhues për pellgjet lumore / Sipërfaqja e vendit (%)	Shënimet e MMPH	MMPH
4.2b	Programi i masave	Vlera e masave të ndërmarra / Vlera e masave në program (%)	MMPH	MMPH
<u>4.3</u>	<u>Intensiteti i monitorimit mjedisor</u>			
4.3a	Inspektimet	Numri i inspektimeve të ndërmarra	Inspektorati	MMPH
4.3b	Efiçienca e inspektimeve	Numri mesatar i inspektimeve për inspektor	Inspektorati	MMPH
4.3c	Monitorimi i ujërave sipërfaqësore	<ul style="list-style-type: none"> Nr. pikave të monitorimit Nr. mostrave të marra Nr. i parametrave të analizuar 	IHMK	MMPH
4.3d	Monitorimi i ujërave nëntokësore	<ul style="list-style-type: none"> Nr. pikave të monitorimit Nr. mostrave të marra Nr. i parametrave të analizuar 	IHMK IKSHPK	MMPH
4.3e	Monitorimi i shkarkimeve	Mostrat e marra dhe të analizuar	Inspektorati	MMPH
<u>4.4</u>	<u>Zbatimi</u>			
4.4a	Frekuenca e zbatimit	Numri i aksioneve të ndërmarra për zbatimin e ligjit	Inspektorati	MMPH
4.4b	Gjobat dhe dënimet	Vlera totale e dënimeve të shqiptuara dhe gjobave të vëna	Inspektorati	MMPH
<u>4.5</u>	<u>Qasja në informata</u>			
4.5a	Publikimi i të dhënave	Të dhënat e publikuara për prodhimin e ujit / Të dhënat për sektorin e ujërave	Shënimet e MMPH	MMPH



Ref	Indikator	Definicioni	Mënyra e Verifikimit	Autoriteti Raportues
4.5b	Qasja në të dhëna	Numri i klikimeve të regjistruara në KED faqen e ujërave		
4.6	<u>Investimet</u>			
4.6a	Investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve – absolute	Vlera Absolute (€)	Baza e të dhënave të Projektit	MZHE ARRU
4.6b	Investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve - relative	Në raport me planin (% e zbatimit)	Baza e të dhënave të Projektit	MZHE ARRU
4.6b	Investimet Kapitale në sektorët e ujërave dhe kanalizimeve – krahasimtare	Në raport me BPV (%)	Baza e të dhënave të projektit	MZHE ARRU

Treguesit kryesorë janë:

- i. Përparimi në zbatimin e programit të masave
- ii. Investimet Kapitale në sektorin e ujërave – krahasimore

2.7.5 Treguesit titullarë – të përmbledhur

Treguesit titullarë janë:

- I. Mbulueshmëria e përgjithshme me furnizimin publik me ujë (i tërë popullsisë)
- II. Përformanca e përgjithshme e kompanive të ujit - furnizimi me ujë¹⁹
- III. Vlera e kulturave bimore të ujitura si përqindje e BPV
- IV. Përqindja e energjisë elektrike të gjeneruar nga hidrocentralet
- V. Mbulueshmëria e përgjithshme me kanalizimin e ujërave të ndotura (i tërë popullsisë)
- VI. Përformanca e përgjithshme e kompanive të ujit - shërbimi i ujërave të ndotura²⁰
- VII. Cilësia e ujërave sipërfaqësore: % që arrijnë objektivat mjedisore
- VIII. Popullsia e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë nga vërshimet (%)
- IX. Progresi në zbatimin e programit të masave
- X. Investimet kapitale në sektorin e ujërave – krahasimore

¹⁹ Ky indikator është dhënë në Raportin Vjetor të Performancës, ARRU

²⁰ Ky indikator është dhënë në Raportin Vjetor të Performancës, ARRU

3 Rrethanat e Kosovës

3.1 Demografia

3.1.1 Popullsia e tanishme

Republika e Kosovës ka 1,739,825 banorë rezident (Regjistrimi i popullsisë nga ASK, 2011), ku 38 % apo 661,586 të banorëve jetojnë në zonat urbane dhe pjesa tjetër 62 % apo 1,078,239 e banorëve jetojnë në zonat rurale. Madhësia mesatare e familjeve e bazuar në numrin e anëtarëve të familjes është rreth 6 persona për familje. Përbërja etnike e popullsisë është dhënë më poshtë.




Figura 2 Përbërja etnike e popullsisë së Kosovës

Struktura e moshës së popullsisë është dhënë në figurën e mëposhtme:

Ndarja në bazë të moshës dhe gjinisë mund të përmblihet si:

- 0–14 vjeç: 27.7% (meshkuj 260,678/femra 239,779)
- 15–64 vjeç: 65.7% (meshkuj 617,890/femra 567,939)
- 65 vjeç e më shumë: 6.6% (meshkuj 50,463/femra 68,089) (vlerësimi i vitit 2010)²¹


Raporti gjinor

- në lindje: 1.086 meshkuj/femra
- nën 15 vjeç: 1.09 meshkuj/femra
- 15–64 vjeç: 1.09 meshkuj/femra
- 65 vjeç e më shumë: 0.74 meshkuj/femra
- Popullsia totale: 1.06 meshkuj/femra (vlerësimi i vitit 2010)

²¹ Libri i Fakteve Botërore i CIA-së, statistikat demografike



Figura 3 Piramida e popullsisë me 31 Mars 2011 në bazë të gjinisë dhe moshës²²



3.1.2 Projektionet e popullsisë

Pasi që Strategjia mbulon një periudhë prej 20 vitesh, është e rëndësishme që të merren parasysh ndryshimet në popullsi dhe ndryshimet në vendbanime gjatë kësaj periudhe.

Projektionet më të fundit të popullsisë të përgatitura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës përbëhen nga tre skenarë. Rezultatet e publikuara të këtyre skenarëve janë përmbledhur këtu:

Tabela 5 Projektionet e popullsisë deri në vitin 2061 – Skenari i mesëm

Viti	Gjithsej	Të rinj			Të rritur		
		0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
2011	1,780,021	495,101	1,162,044	122,876	27.8%	65.3%	6.9%
2021	1,883,805	406,059	1,301,556	176,190	21.6%	69.1%	9.4%
2031	1,931,957	371,065	1,308,534	252,358	19.2%	67.7%	13.1%
2041	1,923,175	313,466	1,262,015	347,693	16.3%	65.6%	18.1%
2051	1,859,447	256,760	1,177,814	424,872	13.8%	63.3%	22.8%
2061	1,743,470	215,907	1,022,265	505,299	12.4%	58.6%	29.0%

Tabela 6 Projektionet e popullsisë deri në vitin 2061 – Skenari i ulët

Viti	Gjithsej	Të rinj			Të rritur		
		0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
2011	1,780,021	495,101	1,162,044	122,876	27.8%	65.3%	6.9%
2021	1,837,371	383,338	1,280,187	173,846	20.9%	69.7%	9.5%
2031	1,789,962	303,970	1,239,396	246,597	17.0%	69.2%	13.8%
2041	1,635,681	206,993	1,092,849	335,839	12.7%	66.8%	20.5%
2051	1,398,626	124,900	876,887	396,838	8.9%	62.7%	28.4%

²² Projektionet për Popullsinë e Kosovës 2011 – 2061: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2013




2061	1,095,732	61,081	589,898	444,753	5.6%	53.8%	40.6%
------	-----------	--------	---------	---------	------	-------	-------

Tabela 7 Projektionet e popullsisë deri në vitin 2061 – Skenari i lartë

Viti	Gjithsej	Të rinj	Të rritur	Të moshuar	Të rinj	Të rritur	Të moshuar
		0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
2011	1,780,021	495,101	1,162,044	122,876	27.8%	65.3%	6.9%
2021	1,933,298	429,407	1,323,637	180,254	22.2%	68.5%	9.3%
2031	2,088,854	442,289	1,380,398	266,168	21.2%	66.1%	12.7%
2041	2,245,138	432,415	1,436,725	375,998	19.3%	64.0%	16.7%
2051	2,383,523	417,772	1,490,613	475,138	17.5%	62.5%	19.9%
2061	2,494,280	424,483	1,481,505	588,292	17.0%	59.4%	23.6%

Figura 4 Projektionet e popullsisë deri në vitin 2061– Agjencia e Statistikave të Kosovës



3.1.3 Dendësia e popullsisë

Republika e Kosovës vlerësohet si një ndër vendet më të populluara për kilometër katror. Ka rreth 165 banorë për kilometër katror (b/km^2). Dendësia më e madhe e popullsisë është në zonat urbane 1,000 b/km^2 , për faktin se në këto zona kemi përqendrimin më të madh të infrastrukturës ekonomike, shëndetësore, shkollore, tregtare, kulturore etj. Kjo mund të pasqyrohet me një hartë e cila pasqyron dendësinë e popullsisë sipas njësive administrative komunale dhe qendrave të mëdha siç janë Prishtina, Gjilani, Mitrovica, Gjakova, Prizreni, Ferizaji, Peja etj.



3.1.4 Vendbanimet

Në Republikën e Kosovës janë rreth 1500 vendbanime. Këto vendbanimet janë të shpërndara në modelin e vendbanimeve koncentrike, fshatrat janë të koncentruara përreth qendrave të mëdha urbane. Dhe vendbanimet janë të shpërndara kryesisht nëpër zonat fushore (Rrafshi i Dukagjinit dhe Rrafi i Kosovës), përgjatë luginave të lumenjëve (Rrafshi i Dukagjinit dhe Rrafshi i Kosovës).

Sipas legjislacionit të aplikueshëm vendbanimet ndahen në urbane dhe rurale:

Urbane

Një zonë gjeografike e urbanizuar – e definuar në nivelin e vendbanimit – karakterizohet me dendësi me të madhe të popullsisë në krahasim me zonat që e rrethojnë. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë një zonë definohet si urbane me vendim administrativ nga komuna.

Rurale

Zonë gjeografike e pa-urbanizuar - e definuar në nivelin e vendbanimit – karakterizohet me dendësi me të vogël të popullsisë, dhe ku shumica e tokës përdoret për bujqësi në krahasim me zonat që e rrethojnë. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë një zonë definohet si rurale me vendim administrativ nga komuna.

Po kështu regjistrimi i popullsisë (Tabela kryesore e raportit) konstanton se ndarja e popullsisë është si në vijim.

Tabela 8 Vlerësimi i vendndodhjes së popullsisë sipas regjistrimit

Vendi	Popullsia	Proporcioni
Urbane	661,586	38.0%
Rurale	1,078,239	62.0%
	1,739,825	

Përderisa ky vlerësim jep një indikator të përgjithshëm, ai është pashmangshmërisht i varur nga vendimet administrative, të cilat jo gjithmonë reflektojnë situatën “në terren”.

Dendësia mesatare e popullsisë në Kosovë është 165 banorë për kilometër katror. Megjithatë, kjo mesatare ka oscilime të mëdha në densitetin e popullsisë në zona të ndryshme, dhe nuk e përfshinë faktin që shumë zona të Kosovës janë të pabanuara kryesisht për shkak të terreneve sidomos atyre kodrinoro-malore.

Shënimet e regjistrimit të popullsisë në bazë të vendbanimeve (që referohen edhe si kadastra). Ekzistojnë 1,281 vendbanime të përcaktuara. Një klasifikim sipas madhësisë së vendbanimeve është dhënë në vijim.

Tabela 9 Klasifikimi sipas madhësisë – popullsia dhe vendbanimet

I ulët	I lartë	vendbanime	% vendbanimeve	Popullsia	Proporcioni
zero	0	35	2.7%		0.0%
>0	<100	151	11.8%	7,161	0.4%
>99	<200	102	8.0%	15,595	0.9%
>199	<500	252	19.7%	86,509	4.9%
>499	<1000	295	23.0%	213,973	12.0%
>999	<2000	288	22.5%	395,071	22.2%
>1999	<5000	124	9.7%	361,137	20.3%
>4999	<10000	20	1.6%	129,553	7.3%
>9999	<20000	4	0.3%	50,755	2.8%
>19999	<50000	7	0.5%	237,067	13.3%
>49999	<100000	2	0.2%	139,358	7.8%
>99999	<200000	1	0.1%	145,149	8.1%
		1,281	100.0%	1,781,328	100.0%



Kjo analizë tregon se ka një luhajtje shumë të madhe në madhësinë e vendbanimeve dhe se gati dy të tretat e popullsisë jetojnë në vendbanime me madhësi më të vogël se 10,000 banorë.

Dhjetë vendbanimet më të mëdha janë prezantuar më poshtë. Këto vendbanime përbëjnë gati 30% të popullsisë.

Tabela 10 Dhjetë vendbanimet me të mëdha

Rangu	Vendbanimi	Komuna	Popullsia e regjistruar	Sipërfaqja e vendbanimit km ²	Dendësia mesatare e popullsisë #/km ²
1	Prishtinë	Prishtinë	145,149	30.74	4,722
2	Prizren	Prizren	85,119	29.47	2,888
3	Gjilan	Gjilan	54,239	17.13	3,167
4	Pejë	Pejë	48,962	25.33	1,933
5	Ferizaj	Ferizaj	42,628	11.83	3,603
6	Gjakova	Gjakovë	40,827	28.51	1,432
7	Mitrovicë	Mitrovicë	33,904	9.84	3,446
8	Vushtrri	Vushtrri	27,272	18.59	1,467
9	Podujevë	Podujevë	23,453	9.20	2,549
10	Fushë Kosovë	Fushë Kosovë	20,021	13.27	1,509
			521,574	194	2,690

Siç po shihet, dendësia e popullsisë në Prishtinë është shumë e lartë dhe mund të krahasohet me qytetet me të dendura të Evropës.

Megjithatë, është me rëndësi të theksohet që zhvillimi nuk i përcjell kufijtë administrativ prandaj nevojiten analiza me të thella për të definuar zonat urbane.

3.2 Gjeografia


Terreni i Kosovës përbëhet nga pellgjet e rrafshëta fluviale me një lartësi mbidetare 400-700 m të rrethuara me disa vargmale të larta me lartësi mbidetare 2,000 deri në 2,500 m, dhe me një lartësi mesatare mbidetare 800 m, e rrethuar me bjeshkë mesatarisht të larta dhe përmban dy ultësira të mëdha.

Dy ultësirat e mëdha që mbulojnë 36% të territorit të vendit janë "Rrafshi i Kosovës" në veri-lindje dhe "Rrafshi i Dukagjinit" në jug-perëndim. Kufiri në mes të Rrafshit të Dukagjinit dhe Rrafshit të Kosovës formon ndarjen e ujërave sipërfaqësore në mes të Detit Adriatik në njërin anë dhe Detit të Zi dhe Detit Egje në anën tjetër.

Figura 5 Modeli i relievit



Figura 6 Rrjeti i lumenjve



Janë katër pellgje kryesore lumore ku dy më të mëdhatë mbulojnë 80% të sipërfaqes së vendit. Burimet e të gjitha këtyre lumenjve janë në territorin e Kosovës (vetëm lumi Sitnica, degë e lumit Ibër, buron jashtë Kosovës, në Mal të Zi).²³

Tabela 1 Pellgjet Lumore Kryesore në Kosovë

Pellgu Lumor	Sipërfaqja km ²	Gjatësia km	Prurja mesatare m ³ /s	Prurja vjetore milion m ³	Shkarkimi final
Drini i Bardhë	4,649	122	61.0	2,200	Detit Adriatik
Ibri	4,009	42	32.6	771	Deti i Zi
Morava e Binçës	1,564	60	6.1	330	Deti i Zi
Lepenci	685	53	8.7	307	Deti Egje
	10,907	277	108.4	3,608	

Ka shumë lumenj në Kosovë, që rrjedhin në drejtim të Detit Adriatik, Detit të Zi dhe Detit Egje. Lumenjtë kryesorë në Kosovë janë:

- Drini i Bardhë (në jug-perëndim të Kosovës – derdhet në Detin Adriatik),
- Lumi i Ibrit (në pjesën veriore, derdhet në lumenjtë Morava dhe Danub dhe me tutje në Detin e Zi) dhe
- Lepenci (në pjesën jug-lindore, derdhet në Lumin Vardar në drejtim të Detit Egje).


Ujëmbledhësi i ujërave sipërfaqësore që derdhet në Detin e Zi mbledhet nga një sipërfaqe prej 5,500 km², apo 51 % të territorit të Kosovës, Deti Adriatik mbledh ujërat nga një sipërfaqe prej 4,500 km², apo 43 %, dhe Deti Egje mbledh ujërat nga një sipërfaqe prej vetëm 900 km², apo 6 %.

Shumica e ujërave burojnë brenda territorit të Kosovës, me përjashtim të Lumit Ibër, që buron në Mal të Zi, ku ka një zonë ujëmbledhëse prej pak me shumë se 1,000 km². Ibri është burim i ujit për liqenin e Ujmanit.

²³ Në fakt, pellgu i 5st mund të konsiderohet: Plava, normalisht konsiderohet si pjese e Pellgut të Drinit të Bardhë.



Figura 7 Rrjeti i lumenjve të Kosovës






Kosova ka një numër të vogël të liqeneve natyrore. Megjithatë, janë ndërtuar disa akumulacione të mëdha, në mesin e tyre Ujmani, Prilepnica, Batllava, Badovci, Livoçi dhe Radoniqi. Këto akumulacione shërbejnë për qëllime të shumëfishta, për shembull përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm, për hidrocentrale, dhe për ujitje.

Territori i Kosovës është i pasur me burime të ujërave termale dhe minerale.

Kosova ka resurse të pamjaftueshme ujore, dhe në të ardhmen do të jetë faktorë kufizues për zhvillim ekonomik dhe social të vendit. Është vlerësuar se Kosova ka vetëm 1,600 m³ ujë/vit për banor. Rezervat e ujërave nëntokësore janë të kufizuara dhe gjinden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha në krahasim me pjesën lindore të vendit me rezerva të vogla dhe në pjesën jug-lindore, ku kërkesat për ujë janë shumë të mëdha.

Klima është kontinentale me dimra të ftoftë e me dëborë dhe vera të ngrohta e të thata. Mesatarja e të reshurave vjetore është 596 mm; temperaturat mund të sillen nga -27 °C në dimër deri në +39 °C në verë.

Figura 8 Treguesit historik të klimës dhe projeksionet deri në vitin 2039



Projeksionet e ndryshimeve klimatike tregojnë se ndryshimi do të rritet, me temperatura më të larta dhe çrregullime në reshje në regjion. Evropa Jugore do të ndikohet me ashpër sesa ajo Veriore. Ndryshimet klimatike veç janë duke ndodhur, dhe po sjellin thatësira më të shpeshta, vërshime, dhe zjarre në pyje. Edhe pse pritet që reshjet gjatë verës të zvogëlohen, intensiteti i tyre mund të rritet. Prandaj, ekziston rreziku i paraqitjes së valëve të nxehta të zgjatura, thatësirave dhe zjarreve në pyje, ashtu si edhe vërshimeve.

Bujqësia është sektor kyç i ekonomisë, menaxhimit të tokave dhe punësimit.




Tabela 2 Klasifikimi i tokave bujqësore sipas pellgjeve lumore

	Kosova		Drini i Bardhë		Ibri		Morava e Binçës		Lepenci	
	km ²	km ²	%	km ²	%	km ²	%	km ²	%	
Klasa I	1,098	349	32%	648	59%	96	9%	5	0.5%	
Klasa II	579	315	54%	132	23%	45	8%	86	15%	
Klasa III	325	129	40%	123	38%	51	16%	23	7%	
Klasa IV	661	474	72%	130	20%	37	6%	20	3%	
Klasa V	68	48	71%	15	22%	5	7%	0	0%	
Klasa VI	102	22	22%	67	66%	12	12%	0	0%	
Gjithsej	2,833	1,339	48%	1,114	38%	246	9.5%	134	4.2%	



Figura 9 Harta e tokave të Kosovës – CORINE (EEA)





3.3 Ekonomia

Nga viti 1999 deri në shkurt të vitit 2008, Kosova ka qenë nën administrimin e UNMIK-ut dhe ka pasur një rritje ekonomike si rezultat i rindërtimeve të pasluftës dhe donacioneve ndërkombëtare. Zhvillimi i lartë ekonomik që nga viti 1999 ka ndodhur në sektorin e tregtisë, ndërtimitarisë dhe shitjes me pakicë.

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 ekonomia e Kosovës është rritur për çdo vit, me efekt të vogël nga kriza financiare botërore. Ekonomia e Kosovës është rritur me një rritje 3 përqind në vitin 2009, kur shumica e vendeve të regjionit ishin në recesion, dhe për çdo vit ka arritur rritjen me të lartë ekonomike në Evropën Jug-lindore²⁴.

Një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës mbështetet në industrinë e minierave të varur nga eksporti dhe në remitancat e kosovarëve që punojnë jashtë vendit. Edhe pse vendi vuan nga një shkallë e lartë e papunësisë, supozohet se shumica e të papunëve janë të punësuar në ekonominë joformale. Gjatë disa viteve të fundit ekonomia e Kosovës ka treguar përparim të dukshëm në transformimin drejt një sistemi të ekonomisë së tregut dhe ka mbajtur stabilitetin makroekonomik, por ende është shumë e varur në komunitetin ndërkombëtar dhe diasporë për ndihmë financiare dhe teknike.

Aktiviteti i sektorit privat ka vazhduar të mbështetet me kredi nga sektori bankar, që është karakterizuar gjithashtu me shkallë të ulët të rritjes. Në anën tjetër, sektori publik përmes shpenzimeve publike vazhdon të jetë bartësi kryesor i aktivitetit ekonomik, veçanërisht përmes shpenzimeve kapitale, të cilat në mënyrë të vazhdueshme po tregojnë trend pozitiv të rritjes.

Megjithatë, treguesit tregojnë për një ngadalësim të rritjes së kërkesës si në sektorin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm.

Trendët historike zhvillimore, vlerat aktuale, dhe parashikimet (ku janë të disponueshme) e treguesve makroekonomik janë dhënë në nëntitujt e mëposhtëm.

3.3.1 Treguesit zhvillimor

Bruto Produkti Vendor (BPV) në Kosovë u rrit për 4.1% në vitin 2015. Historikisht, nga viti 2008 deri në vitin 2015, shkalla vjetore e rritjes së BPV të Kosovës arriti një mesatare prej 4.4% duke arritur nivelin me të lartë prej 6.9% në dhjetor 2008 dhe nivelin me të ultë të regjistruar prej 2.5% në dhjetor 2012.

²⁴ BERZh, Strategjia për Kosovën; maj 2013




Figura 11 Shkalla reale e rritjes së BPV 2006-2012²⁵

Në terma absolut, gjatë periudhës 2008-2014, BPV për banorë në vit është rritur nga 2,258 EUR në vitin 2008, në 3,277 EUR në vitin 2015. Kontributi i donatorëve në BPV ka pësuar rënie nga përafërsisht 34% në vitin 2014 krahasuar me vitin 2008.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), paga mesatare mujore në Kosovë në vitin 2015 ishte 466 euro. Nga viti 2012 deri në vitin 2015, paga mesatare u rrit për 25% apo për 94 Euro. Megjithatë, si në shumicën e vendeve, ka dallim të konsiderueshëm në mes të zonave urbane dhe atyre rurale. Në Kosovë, baza për krahasim të pagës mesatare është marrë sektorin publik, pasi që nuk ka të dhëna të sakta për nivelin e pagave në sektorin privat në Kosovë.

Tabela 14 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë në periudhën 2003 – 2011 (ASK – hulumtimi i buxheteve familjare)

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
€/capita	980	1,156	1,161	1,226	1,210	1,380	1,402	1,386	1,432

Inflacioni në Kosovë gjatë viteve të fundit ka pasur lëkundje të mëdha, kryesisht për shkak të reflektimit të çmimeve në tregjet e jashtme, korrelacion që vjen si rezultat i varshmërisë së madhe të ekonomisë së vendit nga importi. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), niveli i inflacionit në Kosovë mesatarisht për vitin 2016 ishte 0.3 %.

Papunësia në Kosovë paraqet sfidën kryesore për qeverinë. Me shkallën zyrtare të punësimit prej 32.9%, në vitin 2015, Kosova ka nivelin më të ulët të punësimit në Evropë. Shkalla e papunësisë, e definuar si raport në mes të numrit të të regjistruarve si të papunë dhe numri të përgjithshëm të popullsisë aktive, në Kosovë ka rënë gradualisht gjatë viteve të fundit (shih figurën e mëposhtme):

²⁵ ASK, Kosova në shifra në 2015




Figura 12 Trendi i rënies së nivelit të papunësisë 2006-2015

Megjithatë, duhet cekur së niveli i papunësisë mund të jetë me i ulët, pasi që një numër i madh i njerëzve janë në listat e të papunëve e punojnë në ekonominë joformale të Kosovës.

Sipas raportit të fundit të ASK për “Varfëria konsumuese në Republikën e Kosovës në vitin 2011” të publikuar në vitin 2013, është vlerësuar se:

- 29.7% e popullsisë së Kosovës jeton nën nivelin e varfërisë prej 1.72 Euro për ekuivalent të personit të rritur për ditë, nga të cilët 33 % jetojnë në zonat urbane dhe 67 % në zonat rurale
- 10.2% nën nivelin e varfërisë ekstreme prej 1.20 Euro për ekuivalent të personit të rritur për ditë, nga të cilët 34 % jetojnë në zonat urbane dhe 66 % në zonat rurale.

Në krahasim me vitet e kaluara, mund të vërehet së niveli i varfërisë nga viti 2009 në 2010 ka rënë për 5 % dhe u rrit pak nga viti 2010 në vitin 2011 për 0.5 %. Niveli i rritjes së fundit të varfërisë është brenda margjinës së gabimit të mostrës, që do të thotë se niveli i varfërisë nga viti 2010 në vitin 2011 nuk ka ndryshuar.

Remitancat vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, duke rritur rritjen ekonomike dhe duke ofruar të ardhura shtesë për ekonominë. Sipas Raportit: Kosova në shifra, të ASK afro 9% e të ardhurave familjare vijnë nga remitancat²⁶.

Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor, hartuar nga UNDP në 2016, Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IzhNj) në Kosovë është më i ulëti në regjion pas Shqipërisë dhe Bosnje dhe Herzegovinës që janë të ranguar të dyja në vendin e 85.

3.4 Perspektivat dhe projeksionet e zhvillimit

Në vitin 2010, Qeveria e Kosovës ka lansuar Strategjinë Afatgjatë (2010-2020+) të zhvillimit ekonomik të Kosovës²⁷. Për më shumë, Qeveria e Kosovës (QeK) ka miratuar planet afatmesme të Shpenzimeve (KASH), të cilat përditësohen në baza vjetore. Në nivelin lokal, secila komunë e Kosovës ka përgatitur planet e tyre të përgjithshme afatgjatë zhvillimore që përfshijnë të gjithë sektorët.

Plani Hapësinor i Kosovës, i hartuar nga MMPH, është dokumenti kyç në sektorin e planifikimit hapësinor, i cili është punuar në bashkëpunim me sektorë të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës duke përfshirë sektorin e gjerë ekonomik të vendit në përgjithësi. Objektivat e vendosura për ekonominë e Kosovës janë të lidhura me (i) krijimin e ambientit atraktiv për investitorët, (ii) avancimin e teknologjisë

²⁶ UNDP, 2012: Studimi i Remitancave të Kosovës

²⁷ Plani Hapësinor i Kosovës



së prodhimit, (iii) krijimin e prodhimit bujqësor dhe industrial, (iv) krijimin e vendeve të mjaftueshme të punës, (v) zvogëlimin e varfërisë, dhe (vi) dhënien prioritet të zhvillimit të territoreve më pak të zhvilluara.

Prioritetet e QeK që janë pjesë e KASH 2017-2019, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe zhvillimit institucional të Kosovës duke investuar në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e infrastrukturës. Prioritetet e Qeverisë janë përmbledhur në katër shtyllat vijuese:

- Rritje dhe zhvillim i qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisje e mirë dhe forcim i sundimit të ligjit;
- Zhvillim i burimeve njerëzore;
- Rritja e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët.

Për të arritur prioritetet e mësipërme qeveria planifikon ta mbajë nivelin e investimeve kapitale në kuotën 30 % të BPV. Të gjitha prioritetet e mësipërme do të financohen duke ruajtur stabilitetin makro-fiskal dhe qëndrueshmërinë.

Për të avancuar më tutje menaxhimin e financave publike, QeK fillimisht ka përcaktuar prioritetet e financimit. Këto prioritete do të zhvillohen më tutje në objektiva specifike dhe të matshme brenda sektorëve përmes procesit të KASH. Objektivat e përcaktuara në KASH zërthehen në projekte dhe aktivitete konkrete përmes proceseve buxhetore. Projektet dhe aktivitete konkrete në sektorin e ujërave tanimë janë marrë parasysh për qëllimet e SShUK.

Për të arritur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik (shtylla I), Qeveria e Republikës së Kosovës do të fokusohet në prioritetet sektoriale si në vijim:

- Krijimi i kushteve të favorshme për rritjen e investimeve të brendshme dhe të jashtme;
- Vazhdimi i investimeve në projekte të mëdha, përmes modernizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike;
- Mbështetje e vazhdueshme e zhvillimit rural dhe bujqësisë, në mënyrë që të rritet prodhimi vendor;
- Investime që kanë të bëjnë me menaxhimin e mjedisit dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Këto prioritete sektoriale do të financohen nga korniza buxhetore dhe potencialisht nga burimet tjera financiare (partneriteti publiko - privat, grantet, huatë, etj.)

Në veçanti, projektet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mjedisit dhe furnizimin me ujë të pijshëm, në bashkëpunim me donatorë do të vazhdojnë të hulumtojnë mundësitë për riparimin dhe zgjerimin e kapaciteteve për burime të ujit të pijshëm, përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave të ndotura, dhe zhvillimin e burimeve të reja ujore. Gjatë periudhës afatmesme, QeK do të fokusojë aktivitete e saj në forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Për sa i përket politikave të planifikuara për zhvillim të burimeve njerëzore (shtylla III), brenda këtij prioriteti strategjik, synimi është të rritet cilësia e kapitalit njerëzor që të adaptohet më mirë me kërkesat e tregut të punës. Fokusi i fazës së ardhshme do të jenë politikat me të cilat synohet përmirësimi në cilësinë e sistemit të edukimit, orientimi kah nevojat e tregut të punës dhe përmirësimi i kushteve për cilësinë e arsimit sidomos të atij universitarë.

Lëmitë tjera prioritare (shtylla IV) përmes të cilave QeK ka për qëllim të fuqizojë harmoninë sociale e kulturore dhe pjesëmarrjen e barabartë në jetën publike të vendit janë: politikat sociale dhe shërbimet shëndetësore.

Korniza afatmesme makro-fiskale paraqet bazën e llogaritjes së kornizës së shpenzimeve 2017-2019 dhe është përgatitur duke marrë parasysh të gjitha politikat që janë në vazhdim e sipër, dhe supozimet për politika të reja të bazuara në vitin bazë (2016).



Projeksionet nga QeK për rritje ekonomike gjatë periudhës 2017-2019 përpilohen në bazë të të dhënave historike për trendët ekonomike, dhe në zhvillimeve të fundit në eurozonë dhe në vendet e rajonit.

Rritja reale ekonomike e Kosovës parashihet të arrijë normën 4%. Megjithatë, kriza e borxheve në disa vende të eurozonës si dhe ndikimi i mundshëm i kësaj në tkurrjen e ekonomisë së tyre, pritet të ketë efekt në ekonominë e Kosovës përmes dy rrugëve: zvogëlimin e remitancave nga diaspora dhe investimeve të jashtme.

Pavarësisht faktit që konsumi pritet të jetë faktori kryesor që do të ndikojë në rritjen reale të BPV gjatë kësaj periudhe, ndikimi i tij pritet të bie ngadalë për t'i lënë vend kontributit të rritjes së investimeve private dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Bazat e modelit ekonomik në bazë të të cilit është modeluar drafti i KASH është i tillë që rreth 30% e konsumit të përgjithshëm, investimeve totale dhe eksportit të mallrave, janë mallra të importuara. Për pasojë, projeksionet për rritje të secilës pjesë të BPV kanë ndikim në rritjen ekonomike dhe në nivelin e importeve. Nuk janë dhënë detajet e pjesëmarrjes së "energjisë elektrike dhe ujërave" në BPV-në e projektuar. Gjatë periudhës së projeksionit, konsumi pritet të rritet me një normë mesatare reale prej 4.0%. Kontributi i investimeve në rritjen e BPV pritet të shënojë rritje graduale, ku investimet në këtë periudhë pritet të shënojë rritje reale mesatare prej 12%. Si rezultat i kësaj, pjesëmarrja totale e investimeve në BPV pritet të arrijë në 33% deri në fund të vitit 2019.

Parashikimet tjera për rritje ekonomike afatmesme në Kosovë janë kryer nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Për sa i përket shkallës së rritjes reale ekonomike Autoritetet Kosovare dhe FMN për periudhën 2014-2017 kanë paraparë parashikimet në vijim:

Tabela 15 Projeksionet e treguesve makro-ekonomik në Kosovë

Indikator	2017	2018	2019
Niveli i rritjes reale të BPV	3.9%	4.0%	4.0%
Niveli i rritjes së BPV për kokë banori	3.7%	3.8%	3.8%

3.5 Financimi institucional

3.5.1 Financimet e përgjithshme qeveritare

Institucionet qeveritare të Kosovës financohen nga të ardhurat e gjeneruara nga taksat, interesi dhe shitjet, dhe nga ndihma e donatorëve.

Sipas KFSH 2017-2019 të ardhurat totale të përgjithshme të Qeverisë (PQ) janë rritur gjatë viteve. I njëjti burim raporton se të ardhurat totale të PQ-së në vitin 2015 kanë qenë EUR 1,472 milion, nga të cilat ndihma e donatorëve ka kontribuar me EUR 14 milion, që paraqesin 1% të të ardhurave totale. Megjithatë, pjesëmarrja e kontributit të ndihmës së donatorëve në të ardhurat totale të PQ-së në vitin 2015 ka qenë më e ulët se sa në vitet paraprake.

3.5.2 Financimi i sektorit të ujërave

Infrastruktura e ujërave në Kosovë financohet nga tri burime kryesore:

- (i) konsumatorët e ujit, që paguajnë në mënyrë indirekte përmes kompanive të furnizimit të ujit;
- (ii) Buxheti i Republikës së Kosovës (BK); dhe



- (iii) Donacionet dhe grantet nga komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë prezent në Kosovë.
- (iv) PPP

Përveç kësaj, disa projekte infrastrukturore financohen përmes huave nga institucionet financiare ndërkombëtare. Këto hua, në rrethana ideale, do të paguhen nga përfituesit e drejtpërdrejtë (konsumuesit e ujit) apo në rastin me të keq nga Buxheti i Kosovës (BK).

3.5.2.1 Kontributi i konsumatorëve të ujit në financim

Furnizimi me ujë të pijshëm në Kosovë është i organizuar përmes shtatë kompanive rajonale të ujit (KRU-të), përderisa furnizimi me ujë për ujitje organizohet përmes tri kompanive për ujitje. KRU-të i paguajnë taksa MMPH-së për nxjerrjen e ujit dhe shfrytëzimin e ujit nga akumulacionet artificiale, dhe furnizojnë shtëpitë, bizneset dhe institucionet me ujë; i mbledhin ujërat e ndotura, dhe i transferojnë ato në impiantet për trajtimin e tyre, aty ku ato ekzistojnë. Banorët paguajnë për këto shërbime, të cilat do të duhej t'i mbulonin shpenzimet operative dhe disa kosto investive. I njëjti parim vlen edhe për kompanitë e ujitjes.

3.5.2.2 Buxheti i Kosovës

Zyrtarisht, buxheti i Kosovës, i menaxhuar nga Ministra e Financave, përbëhet nga dy komponente: buxheti i rregullt për aktivitetet rrjedhëse, dhe buxheti zhvillimor, i cili ka për qëllim investimet dhe avancimin e ekonomisë përmes programit të investimeve publike (PIP). PIP-i është miratuar nga qeveria e Kosovës në vitin 2005, si bazë për mobilizimin e fondeve vendore dhe atyre që vijnë nga donatorët (donacionet dhe huatë).

Kanali i parë i financimit përfshinë të gjitha kostot e operimit të trupave të administrimit të ujit (niveli i ministrisë) si dhe subvencionet dhe ndihmat financiare për ujë të pijshëm, dhe të kompanive të ujitjes në mënyrë që çmimet të mbesin të ulëta ose për shkaqe etike.

Kanali i dytë është për projekte kapitale që vjen nga departamente dhe agjenci të ndryshme të qeverisë që merren me çështjen e ujërave: departamenti i ujërave, departamenti i mjedisit, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik, në MMPH; Instituti Kosovar për Shëndetësinë Publike në MSh; Njësia për Monitorim dhe Politika e MZHE; dhe departamentet e shërbimeve publike të komunave.

Përveç kësaj, shumat e dhëna si hua regjistrohen si shpenzime në momentin që transferohen nga buxheti te pranuesi i fondeve.

Shuma totale e buxhetit të Kosovës që alokohet për investime në sektorin e ujërave për periudhën 1999-2014 ka qenë përafërsisht EUR 11.6 milionë²⁸.

3.5.2.3 Donacionet dhe grantet

Një komunitet i madh i donatorëve është prezent në sektorin e ujërave të Kosovës që nga viti 2000. Gjatë fazës së reformimit,²⁹ komuniteti kryesor i donatorëve për shërbimet me ujë e ka strukturuar veten duke u fokusuar në sektorë të ndryshëm dhe pjesë të ndryshme të Kosovës, gjegjësisht, ZZB-ja fokusohet kryesisht në jug-lindje (Gjilan dhe Ferizaj), BE-ja kryesisht në regjionin qendror dhe verior (Prishtinë dhe Mitrovicë), dhe KfW kryesisht në regjionin perëndimor (Prizren, Pejë dhe Gjakovë). Megjithatë, ZZB se fundmi ka vendosur që të zgjerojë fokusin e saj lokal dhe të mbështes projekte në pjesën perëndimore të Kosovës apo madje edhe në mbarë vendin.

²⁸ TFU, Trendet Historike të Investimeve në Sektorin e Ujërave në Kosovë, 2012

²⁹ Reformimi i sektorit të ujërave ka filluar në vitin 2000



Nga 1999 deri me 2014, komuniteti i donatorëve, përmes granteve dhe donacioneve, ka financuar rreth EUR 202.4 milionë në sektorin e ujërave të Kosovës³⁰. Ky është padyshim një burim vital i financimit.

3.5.3 Të ardhurat e sektorit të ujërave

Në pajtim me Ligjin për ujëra, burimi kryesor i të ardhurave nga sektori i resurseve ujore do të duhej të vinte nga pagesat ujore për shfrytëzimin e ujërave që duhet t'i mbledh MMPH nga shfrytëzuesit e ujërave për:

- (i) Shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- (ii) Shfrytëzimin e ujit për gjenerimin e rrymës elektrike;
- (iii) Mbrojtjen e ujërave;
- (iv) Nxjerrjen e inerteve nga rrjedhat ujore.

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 i MMPH rregullon çështjet e nxjerrjes së ujërave dhe shkarkimin e ujërave të ndotura si dhe kushtet e pagesën për to. Megjithatë ky udhëzim administrativ nuk zbatohet plotësisht. KRU-të ngarkohen nga MMPH me 0.001 – 0.003 EUR/m³ për nxjerrjen e ujit dhe EUR 0.001 EUR/m³ për shkarkimin e ujërave të ndotura. Këto ngarkesa nuk bazohen në asnjë llogaritje të kostove; ato bazohen në ngarkesat mesatare që praktikojnë vendet tjera të rajonit. Prandaj, ngarkesat për nxjerrjen dhe shkarkimin e ujërave për momentin janë shumë të ulëta që reflektojnë dobësinë e ekonomisë së Kosovës.

Në përputhje me këtë UA, MMPH duhet të ngarkojë përdoruesit dhe shkarkuesit e ujërave me një pagesë që do të bazohet në Parimin Përdoruesi Pagan, d.m.th. që përdoruesi i ujit do të duhej të paguajë një tarifë për ujin si një e mirë e përbashkët; dhe Parimi Ndotësi Pagan, që do të thotë ndotësi i ujit duhet të paguajë për trajtimin e tij apo të paguajë për dëmet që shkakton në mjedis uji i ndotur i patrajtuar. Deri me tani, MMPH ka ngarkuar KRU-të vetëm për nxjerrjen e ujit e jo për shkarkimin e ujërave të ndotura.

Që nga viti 2007 deri në fund të 2016, të ardhurat e përgjithshme të faturuara nga MMPH për përdoruesit e ujit kanë qenë EUR 1,724,866 nga të cilat vetëm 43% janë mbledhur. Janë tri probleme pse mbledhja e mjeteve nga MMPH është kaq e ulët:

- (i) Tarifat e ulëta;
- (ii) Konsumatorët ilegal të ujit (të pa-faturuar);
- (iii) Nivel i ulët i arkëtimit së të hyrave.

Besohet se një numër i konsiderueshëm i shfrytëzuesve të ndryshëm të ujit nuk janë licencuar dhe faturuar nga MMPH.

Tarifat për shërbimet e ujit të pijshëm dhe ujërat e ndotura³¹ caktohen nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Në vitin 2008, ARRU ka kaluar drejt rishikimit trevjeçar të tarifave për ujë që bazohet në procesin e parashikimeve të kostove operacionale, kostove kapitale të mirëmbajtjes dhe një shtesë për kthim në kapital, e mjaftueshme për të tërhequr investime nga donatorët, institucionet financiare, dhe mundësisht nga sektori privat në afate më të gjata.

ARRU ka krijuar një metodologji transparente për llogaritjen e tarifave për ujë dhe ujëra të ndotura të bazuar në rekuperim të kostos dhe tarifa të përbalueshme, që bazohet në parimet vijuese:

³⁰ IMWC, Trendet Historike të Investimeve në Sektorin e Ujërave në Kosovë, 2015

³¹ Furnizimi me ujë dhe shërbimet e kanalizimit bëhet nga shtatë KRU



- Për secilën kategori të konsumatorëve tarifrat janë uniforme për tërë territorin që një KRU mbulon me shërbime.
- Ndërsbvencionimi ekzistues i konsumatorëve shtëpiak nga ata jo-shtëpiak për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të ndotura do të zvogëlohet gradualisht me kalimin e kohës.
- Tarifrat janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet operacionale dhe ato kapitale për mirëmbajtje të pajisjeve si dhe të financojnë disa investime të përballueshme për konsumatorët.
- KRU-të kanë të drejtë të fitojnë një kthim në bazën rregullatore të aseteve të tyre sa për të financuar investimet kapitale në sektorin e tyre.

Informatat e siguruar nga ARRU-u tregojnë rritje graduale të tarifave të ujit dhe ujërave të ndotura gjatë viteve. Tarifrat janë dhënë pa llogaritjen e Tatimit në Vlerë të Shtuar (TVSh). Për momentin TVSh-ja për shërbimet me ujë dhe ujëra të ndotura është caktuar në 8% të shumës së faturuar.

Tabela 17 Ngarkesat mesatare për ujë dhe ujëra të ndotura gjatë viteve

Viti			2014	2015	2016	2017
Kategoria	Nën-kategoria	njësia				
Konsumatorët familjarë	Tarifat për ujë	EUR/m ³	0.34	0.35	0.35	0.36
	Tarifat për ujëra të ndotura	EUR/m ³	0.07	0.07	0.07	0.07
	Tarifat fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00
Konsumatorët jo-familjarë	Tarifat për ujë	EUR/m ³	0.73	0.75	0.75	0.76
	Tarifat për ujëra të ndotura	EUR/m ³	0.14	0.14	0.14	0.13
	Tarifat fikse	EUR/muaj	3.00	3.00	3.00	3.00

Për sa i përket shërbimeve të ujitjes, ngarkesat për ujë përcaktohen nga vetë kompanitë. Çmimet nuk bazohen në kostot e mbulimit të shpenzimeve, por në përfitimet marginale nga përdorimi i ujit për ujitje dhe nga parimi i “mundësisë për të paguar” të kapacitetit për të ri-paguar. Gjithashtu, nuk merret parasysh elementi i “kthimit të kapitalit”. Metoda e pagesës jo-volumetrike për ujitje përdor njësinë e sipërfaqes së tokës (hektar). Kjo metodë iu konvenon menaxherëve të kompanive të ujitjes pasi që është me lehtë të administrohet, pasi që nuk kërkon matje speciale të sasisë së ujit të furnizuar për ujitje. Sistemi i subvencioneve për infrastrukturën e ujitjes është prezent të Kosovë.

Ngarkesa për ujin e përdorur nga konsumatorët industrial që furnizohen nga kompanitë e furnizimit me shumicë dhe për bizneset e vogla përcaktohet nga ARRU bazuar në parimin e rekuperimit të kostove operacionale dhe të mirëmbajtjes, dhe të nevojave për investime kapitale që nevojiten për prodhimin dhe distribuimin e ujit.

Në përgjithësi, çmimi i ujit nuk përcaktohet në bazë të parimeve të Kornizës së Ujërave të BE-së të “çmimit ekonomik të ujit”, që do të mund të:

- Mundësonte furnizim të qëndrueshëm me ujë si në sasi ashtu edhe në cilësi;
- Dekurajonte konsumin e tepërt të ujit; dhe
- Siguronte fonde të mjaftueshme për zhvillimin e kompanive të ujit.

3.6 Përmbledhje e treguesve ekonomik

Statistikat kryesore ekonomike relevante të Kosovës janë përshkruar këtu për lehtësim të referimit:



- Bruto produkti vendor sipas qasjes së shpenzimeve, 2015: €5.8 miliard³² për vit
- Bruto produkti vendor për kokë banori, 2015: €3,277 për vit
- Pjesëmarrja e konsumit familjarë në BPV: ~85%
- Pjesëmarrja shpenzimeve qeveritare në BPV: ~15%
- Të ardhurat totale të qeverisë qendrore, 2015: €1.7 miliardë³³ për vit
- Shpenzimet totale qeveritare, 2015: €1.61 miliardë për vit
- Formimi i kapitalit fiks bruto, 2015:
 - €1.432 miliardë: të gjitha shpenzimet (~26% e BPV)

Treguesit e resurseve familjare janë dhënë në bazë të Hulumtimit të Buxhetit të Familjeve të ndërmarrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës:

- Konsumi për kokë banori 2015
 - Mesatarja: €1,432 për vit
 - Urbane: €1,641 për vit
 - Rurale: €1,299 për vit

Përballueshmëria e shërbimeve të ujit zakonisht gjykohet ne raport me përqindjen fikse të të ardhurave të familjes, ku pragu i përballueshmërisë zakonisht merret nga 3 deri 5% të të ardhurave mesatare. Duke marrë parasysh BPV-në relativisht të ulët për kokë banori në krahasim me BE-në (€25,700), vlera e ulët prej 3% është marr si e arsyeshme në këtë strategji.

³² Agjencia e Statistikave të Kosovës: BPV në 2015

³³ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Llogaritë Qeveritare në 2015



4 Legjislacioni, institucionet dhe politikat

4.1 Legjislacioni ekzistues³⁴

Ky seksion përshkruan legjislacionin ekzistues të rëndësishëm në sektorin e ujërave, duke përfshirë:

- Legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit
- Legjislacionin për menaxhimin e ujërave
- Legjislacionin tjetër relevant

4.1.1 Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përfshin dispozita të qarta mjedisore:

- Neni 7, §1, definon mbrojtjen e mjedisit si një nga parimet bazë të rregullimit kushtetues të Kosovës³⁵
- Neni 52 i parasheh të drejtat për qasje në informata, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe qasje në drejtësi; këto dispozita përbëjnë një pjesë të madhe të legjislacionit Mjedisor të BE-së
 - '[...] në mënyrë që të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave të secilit person të gjeneratës së tashme dhe të ardhme për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre'³⁶.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025 - Ligji për mbrojtjen e mjedisit përfaqëson bazën legjislative të mbrojtjes së mjedisit, e aprovuar me dekretin presidencial me 19.03.2009. Ai ofron kuadrin ligjor që synon të promovojë një mjedis të shëndetshëm në Kosovë përmes përvetësimit gradual të standardeve mjedisore të afirmuara nga Bashkimi Evropian dhe legjislacioni i tij. Për të arritur objektivat e cituara, ligji ka paraparë një numër instrumentesh ligjore për të siguruar kushtin e dyfishtë të zbatimit të ligjit dhe të mundësojë promovimin efektiv të një mjedisi të shëndoshë në Kosovë.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit prezanton përkufizimet dhe parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit duke i identifikuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente.

Sipas këtij Ligji, autoriteti kompetent për mbeturina, menaxhimin e ujërave, mbrojtjen dhe planifikimin (duke përfshirë planifikimin hapësinor) është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), e organizuar sipas departamenteve për sektorë specifike, ku secila prej tyre është përgjegjëse për ligjet dhe politikat e sektorit të saj.

Ligji rregullon, ndër të tjera, parimet e politikave të mbrojtjes së mjedisit, strategjinë e Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, programet e mbrojtjes së mjedisit, autorizimin që qeveria të përcaktojë kufijtë për emetim dhe shkarkim, masat për rihabilitim të mjedisit, pëlqimi për VNM, lejet dhe autorizimet, monitorimin dhe informimin rreth mjedisit. Ai gjithashtu përkufizon rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) dhe të Inspektoratit Shtetëror Mjedisor të Kosovës (ISHMK). Në shtator të 2011, është nënshkruar Udhëzimi Administrativ për

³⁴ I koordinuar me: Raporti i Legjislacionit Mjedisor, Maj 2013, Mbështetje Institucionale për Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) të Kosovës, Twinning Contract Number KS 10 IB EN 01.

³⁵ Neni 7, §1: Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

³⁶ Konventa për qasje në informata, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi për çështje mjedisore e nënshkruar në Aarhus, Danimarkë, me 25 Qershor 1998, Neni 1 – Objektivat.



organizimin dhe strukturën administrative të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), i cili në vete ngërthen Institutin Hidro Meteorologjik (IHMK) nën menaxhimin e AMMK.

Procesi i harmonizimit të ligjeve kombëtare mjedisore me direktivat relevante të BE-së po përparon dhe në 3 vitet e fundit janë miratuar ligje të reja në aspektin e legjislacionit horizontal (Vlerësimi Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis, raportimi), cilësinë e ajrit dhe kontrollin e ndotjeve industriale..

Harmonizimi i mëtutjeshëm në këto fusha duhet të përshpejtohet me miratimin e legjislacionit relevant sekondar - dhe vëmendje e veçantë t'i kushtohet fushave ku niveli i harmonizimit ka ngecje për momentin (p.sh.: menaxhimi i ujërave, menaxhimi i mbeturinave).

Kosova është duke zbatuar Strategjinë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2005-2015 dhe Planin e veprimit për mjedis 2006-2010. Strategjia është rishikuar në vitin 2011 dhe është zëvendësuar me draft strategjinë 2013-2022 dhe Planin e veprimit për periudhën 2013-2027. Strategjia e re parashikon kornizë të qartë për investime në infrastrukturën e mbrojtjes së mjedisit.

4.1.2 Baza ligjore e menaxhimit të ujërave

4.1.2.1 Legjislacioni primar

Baza ligjore për mbrojtjen e ujërave dhe menaxhimin e resurseve ujore është Ligji i Ujërave Nr.04/L-147, që është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës (KiK) me 19 Mars 2013, kurse është shpallur me Dekretin Presidential Nr.DL-011-2013, të datës 5 prill 2013 dhe e publikuar në Gazetën Zyrtare më 29 prill 2013.

Autoriteti kompetent për qeverisjen dhe menaxhimin e ujërave në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), dhe mbështetet nga ana e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila monitoron gjendjen e mjedisit. Ligji i Ujërave përcaktohet si ligj kornizë, dhe për të siguruar zbatimin e duhur të dispozitave të përcaktuara, përgatitja dhe zbatimi i legjislacionit sekondar - në formën e Udhëzimeve Administrative (UA) – konsiderohet prioritarë (shënim: Ligji i Ujërave kërkon që legjislacioni sekondar të miratohet në afatin prej 18 muajsh nga miratimi i tij).

Baza ligjore që për momentin rregullon sektorin për menaxhimin e ujërave dhe ujërave të ndotura në Kosovë përbëhet nga legjislacioni vijues primar dhe sekondar:

- Ligji Nr. 04/L-147 “**për ujërat e Kosovës**, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/29 Prill 2013, Prishtinë”, aprovuar nga KiK me 19.03.2013. Shpallur me dekretin presidencial Nr.DL-011-2013, të datës 05.04.2013 duke zëvendësuar Ligjin Nr. 2004/24 “për ujëra” aprovuar nga KiK me 08.07.2004 dhe shpallur nga SRSG me 14.10.2004.
- UA Nr. 2/99 “për testimin e zbatimit të **Standardëve Minimale për Cilësinë e Ujit të Pijshëm**”;
- UA Nr. 26/2013-MMPH “në Përcaktimin e mënyrës së evidencës dhe legjitimitetit të inspektorit të Ujit”;
- UA Nr. 63/05-MMPH “mbi përmbajtjen, formën, kushtet dhe procedura e lëshimit dhe mbajtjes së lejes ujore”;
- UA Nr.02/2016 “për **strukturën e pagesave të ujit**”;
- UA Nr. 05/2016-MMPH “për **përmbajtjen e Infrastrukturës (pasurisë) së ujërave**”;
- UA Nr. 28/2014-MMPH “për kriteret për **definimin e zonave për mbrojtjen e ujit** dhe masave të tyre mbrojtëse për resurset ujore që përdoren për ujë të Pijshëm”;
- UA Nr. 30/2014 “për **Vlerat Kufitare të Shkarkimit të Efluentëve** në trupat ujore dhe në rrjetin Publik të Kanalizimeve” i aprovuar nga Qeveria e Kosovës (QeK)
- UA Nr. 16/2012 “për **cilësinë e ujit që përdoret për qëllime të konsumit nga njerëzit**”



- UA Nr. 12/2013 “Sistemi i Informacionit për Ujëra”.

4.1.2.2 Legjislacioni sekondar

Sipas Ligjit të revokuar të Ujërave Nr.2004/41, 20 aktet nënligjore do të duhej të ishin aprovuar 24 muajsh pas hyrjes së tij në fuqi. Mirëpo, për momentin vetëm disa nga ato janë aprovuar. Sipas ligjit të sapo aprovuar të ujërave Nr. 04/L-147/2013, legjislacioni përkatës sekondar duhet të përgatitet në mënyrë që të mund të implementohet përmbajtja e Ligjit të Ujërave. Ligji i Ujërave Nr. 04/L-147/2013 fuqizon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në disa raste në bashkëpunim me ministrinë tjera relevante, për të përgatitur njëzet e dy (22) Udhëzime Administrative brenda tetëmbëdhjetë (18) muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

Table 3 Udhëzimet administrative të parapara me Ligjin e ujërave

N.	Udhëzimet e parapara administrative/ref. neni i ligjit të ujërave	Statusi
1.	Neni 8 “Pasurinë Ujore Artificiale”	Është nxjerrur.
2.	Neni 20 – themelimi i Institutit për ujëra të Kosovës	JO – Duhet të nxjerret më vonë
3.	Neni 22 – Detyrat dhe Përgjegjësit e Autoritetit të Pellgjeve Lumore	Është nxjerrur.
4.	Neni 31 – Dokumentet esenciale të planifikimit Strategjia Shtetërore e Ujërave, Plani për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore	JO – Duhet të nxjerret me vonë.
5.	Neni 34 – Programi i masave	JO - Duhet të lëshohet me vonë
6.	Neni 42 – Digat dhe Rezervarët	JO - Duhet të lëshohet me vonë. Është hartuar si draft, i cili pritet të aprovohet gjatë 2017.
7.	Neni 47 – Programi i mbrojtjes nga veprimet e dëmshme të ujërave	Është nxjerrur.
8.	Neni 48 - Mbrojtja e brigjeve të rrjedhave ujore dhe akumulimeve	Është nxjerrur.
9.	Neni 54 – Shpallja e zonave erozive	Është nxjerrur.
10.	Neni 58 – Klasifikimi i trupave ujqorë sipërfaqësorë	JO - Duhet të lëshohet me vonë. Është hartuar si draft, i cili pritet të aprovohet gjatë 2017.
11.	Neni 59 - Klasifikimi i trupave ujqorë nëntokësorë	JO - Duhet të lëshohet me vonë. Është hartuar si draft, i cili pritet të aprovohet gjatë 2017.
12.	Neni 60 – Lëshimi i ujërave të ndotura	Është nxjerrur.
13.	Neni 65 - Prurja e pranueshme ekologjike	Është nxjerrur.
14.	Neni 66 – Zonat e mbrojtura ujore	Është nxjerrur (UA nr. 28/2014). Do të rishikohet
15.	Neni 66 - Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike	Është nxjerrur.
16.	Neni 68 – Zona për larje	Është nxjerrur.
17.	Neni 71 – Procedurat për dhënien e lejeve ujore	Është nxjerrur (UA nr. 63/05), është në proces të rishikimit .
18.	Neni 72 - Lejet ujore	Është nxjerrur (UA nr. 63/05), është në proces të rishikimit .
19.	Neni 81 - Sistemi i Informacionit për Ujëra	Është nxjerrur
20.	Neni 92 – përcaktimi i pagesave për shfrytëzimin e ujërave	Është nxjerrur (UA nr. 02/2016), është në proces të rishikimit .



21.	Neni 95 – Inspektoriati për Ujëra	Është nxjerrur
-----	-----------------------------------	----------------

4.1.2.3 [Legjislacioni tjetër specifik për këtë sektor](#)

Pjesët tjera të legjislacionit specifik për sektorin që kanë rëndësi të madhe janë përshkruar këtu.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)

ARRU u themelua me 26 nëntor 2004 me Rregulloren UNMIK-ut Nr. 2004/49. Kjo Rregullore është amendamentuar/zëvendësuar me Ligjin që amendanton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 për aktivitetet e ofrimit të shërbimeve për ujëra, ujëra të ndotura, dhe mbeturinat e ngurta (Nr. 3/L-086) dhe më vonë me Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Nr. 05/L-42) i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në dhjetor 2015.

Struktura e pagesave për ujë

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 përcakton strukturën e pagesave për ujë. Pagesat bëhen si kompensim për:

- Nxjerrjen e ujit (Neni 4),
- Shkarkimin e ujërave të ndotura të patrajuara (Neni 5)
- Zvogëlimi i pagesës (Neni 7)
- Shkarkimin e ujërave të ndotura që i nënshtrohen trajtimit (Neni 8)
- Nxjerrja e materialeve inerte nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve (Neni 6)

Kompensimi për nxjerrjen e ujërave paguhet në bazë të vëllimit (për m³) ku ngarkesat luhaten varësisht prej përdorimit të ujit të nxjerrur, përveç në rastin e ujitjes ku pagesat bëhen në bazë të sipërfaqes së ujitur (hektarë).

Kompensimi që paguhet për hidrocentrale ngarkohet në bazë të energjisë elektrike të prodhuar (kWh). Kompensimi që paguhet për shkarkimin e ujërave të ndotura bëhet në bazë të vëllimit (për m³) dhe varion në bazë të:

- Burimit të ujërave të ndotura (industrial, urban),
- Nivelit të trajtimit para se të shkarkohen,
- Klasifikimit (cilësia e ujit) të ujërave në të cilat bëhet shkarkimi i ujërave të ndotura.

Faturimi dhe pagesat kryhen në baza mujore.

**Tabela 4 Sasia e kompensimit për shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe minerale**

Lloji i përdorimit të ujit	Sasia e kompensimit
Ujërat e pa-trajtuar, të marra nga ujërrjedhat	€ 0.003 / m ³
Ujërat e pa-trajtuar, të marra nga burimet nëntokësore	€ 0.001 / m ³
Ujërat e pa-trajtuar, të marra nga akumulimet artificiale	€ 0.002 / m ³
Ujërat termal	€ 0.01 / m ³
Prodhuesit që shesin ujë mineral dhe natyral në shishe	€0.001 për litër të ujit të shitur
Ujitja e tokave bujqësore më ujë nga burimet natyrore apo rrjedhës se ujërave	€5 / ha të ujitur
Ujitja e tokave bujqësore më ujë nga liqenet artificiale	€10 / ha të ujitur
Ujitja e tokave bujqësore më ujë nga burimet nëntokësore	€2.5 / ha të ujitur
Ujërat e përdorura për hurdhat e peshqive	€ 0.03 / m ³
Ujërat e përdorura për bazen sportiv (peshkim)	€2.5 / ha
Prodhuesit e elektricitetit	2.5% të çmimit të shitjes për secilin kWh të prodhuar, dhe 1.7 kWh prodhuar në impiant

Të dhënat për sasinë e kompensimit për shkarkimin e ujërave të ndotura janë dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 20 Sasia e kompensimit për ujin e shkarkuar

Lloji i ujit të shkarkuar	Sasia e kompensimit
Uji i shkarkuar nga proceset teknike e teknologjike për qarkullimin dhe procesimin e: naftës dhe derivateve të saj, metalurgjinë e zezë, industrinë e tekstit, industrinë e letrës, lëkurës, feramat, thertoret dhe industrinë e mishit, makinat dhe shërbimet për makina	€ 0.03 € / m ³
Uji nga industritë tjera që nuk janë përmendur më lartë	€ 0.02 € / m ³
Ujërat urbane që mblidhen nga sistemet e kanalizimeve	€ 0.001 / m ³
Llojet tjera të ujit të përdorur	€ 0.010 / m ³
Uji për ftohje në termocentrale me sistem të hapur të ftohjes	1.5% € / m ³

4.1.3 Legjislacioni tjetër relevant

Përveç legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe atë specifik për sektorin e ujërave, sektori i ujërave mbrohet në mënyrë indirekte nga ligjet e tjera që kanë të bëjnë me sektorët në vijim: shëndetësinë, bujqësinë, industrinë, transportin dhe me disa sektorë të tjerë.



4.1.3.1 Shëndetësia

Ligji i Shëndetësisë (Nr. 04/L-125) trajton një numër të aspekteve të mbrojtjes së shëndetit që kanë të bëjnë me ujërat. Në veçanti Neni 9 (Funksionet e kujdesit dhe rregullimit) përcakton shërbimet për mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së ujit dhe ushqimit për të mbrojtur konsumatorët, në koordinim me ministritë kompetente si funksion të Ministrisë së Shëndetësisë.

4.1.3.2 Ujitja

Në Kosovë legjislacioni i tashëm për ujitje është si rezultat i dy ligjeve të ndryshme:

- Ligji Nr.02/L-9 23 mars 2005, pjesërisht i amendamentuar me 25 nëntor 2005
- Ligji Nr. 03/L-198 8 korrik 2010, që e përditëson Ligjin e vitit 2005

Ligji rregullon dhe definon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me themelimin e trupave që ofrojnë shërbimet e ujitjes, duke përfshirë:

- Ministrinë e Bujqësisë
- Komunat
- Kompanitë e ujërave
- Asociacionet e shfrytëzuesve të ujit
- Federatën e asociacioneve të shfrytëzuesve të ujit

Sipas modelit të paraqitur në Ligj, roli i Ministrisë është që të krijojë dhe të zbatojë politikat për ujitje dhe kullim, përderisa nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në aktivitetet operacionale. Kompetencat specifike të Ministrisë janë:

- Të përcaktojë politikat për ujitje dhe kullim,
- Të përgatisë kriteret dhe kufizimet për pagesat për ujitje,
- Të jep pëlqimin në koordinim me AKP-në për transferimin e përgjegjësive të caktuara për menaxhimin me kanalet primare, sekondare dhe terciare dhe objektet përcjellëse, nga kompania në shoqatë, brenda territoreve përkatëse,
- Të definojë përgjegjësitë dhe kufijtë në mes të asociacioneve dhe kompanive, dhe vetëm në mes të asociacioneve
- Të përfaqësojë interesat e bujqësisë në fushën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në njësitë e monitorimit të ndërmarrjeve publike
- Të specifikojë përgjegjësitë e kufijve fizik në mes të kompanive të ujësjellësit dhe shoqatave të përdoruesve të ujit dhe midis shoqatave

Detyrat shtesë të MBPZHR janë:

- Të mbajë regjistrin e asociacioneve dhe federatave, dhe listën e kompanive
- Të merr pjesë në bordin e kompanive të ujërave me një anëtar
- Të monitorojë ujitjen dhe kullimin dhe cilësinë e ujit që përdoret për ujitje, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Të propozojë anëtarin(ët) e Bordit Mbikëqyrës të kompanive në pajtim me kriteret e përcaktuara në statutin e përgatitur nga Ministria, dhe të monitorojë zgjedhjen e trupave të asociacionit.
- Komunat kanë rol shumë më të paqartë dhe të dobët, pasi që ato mund vetëm të japin instruksione dhe të monitorojnë aktivitetet e asociacionit në territorin e tyre në pajtim me ligjin e aplikueshëm.



Roli i kompanive të ujitjes, në anën tjetër, është definuar në mënyrë shumë më të detajuar e precize. Ato duhet të:

- Ndërtojnë, operojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit sipas praktikave të mira biznesore dhe në pajtim me interesin e përgjithshëm.
- Sigurojnë me kohë ujin për ujitje, me sasi të mjaftueshme dhe cilësi të duhur, për nevojat e përdoruesve, dhe përmes MBPZHR dhe MMPH kërkon sasinë e nevojshme të ujit.
- Ofrojnë kontratat përkatëse përdoruesve të ujit për shërbimet e tilla dhe për të mbledhur pagesat për shërbimet e ofruara.
- Udhëzojnë dhe vlerësojnë kërkesat e reja për intervenime në infrastrukturën e ujit për ujitje, dhe të ofrojnë shërbime gjegjëse.
- Të jenë në përputhje me statutet dhe aktet nënligjore të miratuara nga autoritetet rregullatore.
- Mbajnë veç e veç llogaritë vjetore dhe planet vjetore të biznesit, të kontrolluar financiarisht dhe të pavarura, në dispozicion të Bordit Mbikëqyrës.
- Përcaktojnë çmimet e ujit për ujitje për shfrytëzuesit në pajtim me kapacitetet financiare të tyre.

Neni 8 specifikon se tarifat e ujit do të përcaktohen nga bordi mbikëqyrës i kompanive të ujërave dhe do të paguhet nga shoqatat dhe shfrytëzuesit.

Thelbi i Ligjit (nga Neni 9 deri të Neni 36) përshkruan asociacionet dhe federatat, trupat e tyre, rolin e tyre dhe raportet e tyre me MBPZHR.

4.1.3.3 [Ligji për vetëqeverisje lokale](#)

Pushteti lokal ka rëndësi të madhe për sektorin e ujërave. Në veçanti roli i komunave përfshin:

- Përgjegjësitë në sektorin e shërbimeve të ujit
- Përgjegjësitë për mbrojtje nga vërshimet

Në terma të përgjithshme, dispozitat kryesore legjislativë që kanë të bëjnë me pushtetin lokal janë:

- Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale
- Ligji Nr. 05/ L- 108 për financat e pushtetit lokal, që ka zëvendësuar Ligjin Nr. 03/L-049
- Ligji Nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ ndër-komunal

4.1.3.4 [Ligji për planifikim hapësinor](#)

Ligji për planifikim hapësinor Nr.2003/14 është nën përgjegjësinë e MMPH dhe gjithashtu adreson komunat. Kërkesat kyçe të Ligjit në këtë kontekst përfshijnë:

Kërkesa për plane:

- Planin Hapësinor të Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Neni 11)
- Plani Hapësinor për Zona të Veçanta - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Neni 12) – zonat e veçanta përcaktohen nga Plani Hapësinor i Kosovës dhe përfshijnë Parqet Kombëtare dhe zonat tjera që kanë veçori unike natyrore, ekonomike, bujqësore, kulturore apo historike
- Planet zhvillimore komunale – LSGUs (Neni 13) – plani multi-sektorial që përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor
- Planin zhvillimor urban – LSGUs (Neni 14) – plani strategjik, multi-sektorial që përcakton projektimet afatgjata për zhvillim dhe menaxhim të zonave urbane



- Planet rregullative urbane – LSGUs (Neni 15) – përcakton kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat për lokacionin e ndërtesave apo tokave urbane

Duhet cekur se Ligji iu referohet gjithashtu “planeve infrastrukturore”:

- Plani infrastrukturor është një plan i instalimeve dhe ndërtesave ekzistuese dhe instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore në fushën e:
 - Transportit
 - Instalimeve elektrike
 - Gypave për gaz
 - Gypave për naftë
 - Furnizimit me ujë dhe kanalizim
 - Telekomunikacionit
 - Instalimeve tjera

4.1.3.5 [Ligji për ndërmarrjet publike](#)

Ligji për ndërmarrjet publike (NP-të) ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008³⁷. Ligji përcakton kornizën rregullative për ndërmarrjet publike-të me pronësi qendrore apo lokale, duke i vendosur ato nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Qeverisë së Kosovës apo komunave respektive.

Ligji është plotësuar me Rregulloren për Kriteret për themelimin e kompanive publike lokale Nr. 02/2013. Duhet cekur se Ligji Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike që është në fuqi që nga qershori 2008, është amendamentuar në prill 2012 përmes Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrje publike. Ligji i amendamentuar ka marrë parasysh përfaqësimin më të madh të komunave në ndërmarrjet publike; gjithashtu ky Ligj ka lënë mundësinë e themelimit të ndërmarrjeve publike. Në pajtim me këto ndryshime dhe amendamenteve në Ligjin e ndërmarrjeve publike, Qeveria në vitin 2012, gjithashtu ka lëshuar 'Rregulloren Nr.02/2013 për kriteret për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në bordin e drejtorëve të kompanive regjionale të ujërave'. Sipas kësaj Rregulloreje, është paraparë që në Bordin e Drejtorëve të secilës KRU, të paktën gjysma e drejtorëve duhet të propozohen nga komunat të cilave iu ofrohen shërbimet nga KRU-të.. Komunat të cilat nuk kanë struktura të organizuara për menaxhimin e furnizimit me ujë, që për momentin kanë skema të ndërtuara për furnizim me ujë, dhe që janë nën mbikëqyrjen e drejtorive komunale (p.sh. Novobërda, Shtërpca, etj.), duhet të kalojnë procesin e konsolidimit dhe inkorporimit brenda KRU-ve ekzistuese, dhe kështu të licencohen dhe t'i nënshtrohen rregullimit që implementohet nga ARRU.

4.1.3.6 [Ligji për partneritetet publiko-private dhe koncesionet](#)

Partneriteti publiko-privat (PPP) dhe koncesionet në Kosovë rregullohen sipas Ligjit Nr. 03/L-090 për Partneritetin publiko-privat dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre.

Në vitin 2011, është aprovuar **Ligji i ri për PPP** (Nr.04/L-045), duke zëvendësuar Ligjin për procedurat e dhënies së koncesioneve Nr. 02/L-44 (Ligji i 2005-es), i cili ofron kornizë më të qartë ligjore, sqaron procedurat për implementimin e partneriteteve publiko-private dhe është në pajtim me Direktivën e BE-së dhe dispozitave të modelit UNCITRAL. Ligji i ri për PPP ka konvertuar PPP-ISC-në dhe Njësinë për

³⁷ Të ndryshuar me Ligjinnr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.



PPP në Komitetin e PPP-së dhe Departamentin Qendror të PPP brenda Ministrisë së ristrukturuar të financave.

Parimet sipas të cilave ky Ligj shtjellon PPP-të janë të gjëra:

- Trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminimi (mendohet në mes subjekteve publike dhe private)
- Transparenca (mendohet për proceset për PPP)
- Proporcionaliteti (mendohet në shpërndarjen e rrezikut dhe shpërblimit në mes të partnerëve publik dhe privat)
- Kost efektiviteti/efiçienca (supozohet këtu në kosto efektivitetin e ndonjë zgjidhjeje me PPP për dallim nga zgjidhja tërësisht publike)
- Mbrojtja e interesit publik, lirisë së konkurrencës, vlerës për para

Ligji për PPP mbështetet nga katër Direktiva:

- Direktiva Nr. 1/2011 për procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve PPP
- Direktiva Nr. 2/2011 për ekipet për menaxhim të projekteve
- Direktiva Nr. 3/2011 për shqyrtimin dhe miratimin e PPP komunale
- Direktiva Nr. 4/2011 për publikimin e njoftimeve për PPP

4.2 Përafrimi me legjislacionin e ujit të BE-së

Ky seksion shqyrton së pari proceset e përafrimit dhe pastaj vlerëson progresin në përafrimin e bërë në Kosovë.

4.2.1 Procesi i përafrimit

Republika e Kosovës i është qasur afrimit të standardeve mjedisore të BE-së dhe është bërë përparim substancial në zhvillimin e legjislacionit që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, duke përfshirë mbrojtjen e ujit, VNM, VSM, IPPC dhe mbrojtjen e natyrës. Përputhshmëria e legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së sigurohet përmes monitorimit të progresit të transponimit dhe implementimit të legjislacionit. Një numër i konsiderueshëm i ligjeve të mjedisit janë rishikuar dhe miratuar në vitet e fundit nga Kuvendi i Kosovës (<http://www.kuvendi-kosova.org>) dhe MMPH ka bërë progres të dukshëm në miratimin e legjislacionit sekondar (udhëzime administrative, urdhëra administrative dhe rregullore të ministrisë).

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e fushës së mjedisit në përgjithësi që nga viti 2002, në vijimësi është duke punuar në hartimin dhe përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE.

Përafrimi me legjislacionin mjedisor të BE-së është parakusht për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Vendet që synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian duhet të rreshtojnë legjislacionin, rregulloret dhe procedurat e tyre në mënyrë që të përputhen me gjithë trupin legjislativ të BE-së, i njohur si "*acquis communautaire*" ("*acquis*").

Në të njëjtën kohë, procesi i përafrimit para-anëtarësimi është një mundësi për vendet që synojnë të hyjnë në BE të organizojnë institucionet dhe procedurat e tyre dhe të trajtojnë stafin e tyre për proceset ditore dhe përgjegjësitë e zhvillimit, implementimit dhe zbatimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Përafrimi me legjislacionin mjedisor definohet në Kapitullin 27: Mjedisi i *acquis*³⁸.

³⁸ http://ec.europa.eu/enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis/index_en.htm



"Politikat mjedisore të BE-së kanë për qëllim të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mbrojnë mjedisin për gjeneratat e tashme dhe të ardhme. Bazohen në aksione parandaluese, parimin ndotësi paguan, luftimin e shkatërrimit mjedisor në burim, përgjegjësinë e përbashkët dhe integrimin e legjislacionit të BE-së në politikat tjera BE-së. 'Acquis' përbëhet nga mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës, kontrollin dhe menaxhimin e ndotjeve industriale, kimikateve dhe organizmave të modifikuar gjenetik (të njohura si GMO), zhurmën dhe pylltarinë. Përputhshmëria me 'acquis' kërkon investime të mëdha. Një administratë e fortë dhe e pajisur mirë në nivel qendror dhe lokal është imperativ për aplikimin dhe zbatimin e 'acquis' mjedisore".

Procesi i përafrimit është i strukturuar përgjatë tre hapave vijues:

Transponimi: miratimi apo ndryshimi i ligjeve, rregullave, dhe procedurave vendore në mënyrë që ligjet relevante të BE-së të jenë tërësisht të përfshira në rendin ligjor kombëtar. Edhe pse vendet kanë liri veprimi të konsiderueshme në zgjedhjen e mekanizmave më të përshtatshme për të reflektuar obligimet e legjislacionit mjedisor të BE-së, kjo liri është e kufizuar në disa aspekte nga parimet e përgjithshme të ligjeve të BE-së.

Implementimi: siguron institucionet dhe buxhetin e nevojshëm për të zbatuar ligjet dhe rregulloret, dhe të mbështesë personat përgjegjës për ndërmarrjen e masave të nevojshme praktike.

Zbatimi: ofrojnë kontrollet dhe dënimet e nevojshme për të siguruar që ligji po zbatohet në tërësi dhe në mënyrë të duhur.

Në parim, Kosova si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE duhet të adaptojë legjislacionin e saj me *acquis* mjedisore në mënyrë që të jenë në përputhshmëri të plotë me ligjet evropiane deri në datën e anëtarësimit. Megjithatë, BE-ja është e vetëdijshme se kjo kërkesë nuk do të jete reale duke marrë parasysh investimet e mëdha që nevojiten për infrastrukturën mjedisore. Prandaj mund të pritet që Kosova sipas të gjitha gjasave do të jetë në pozitë të negociojë 'periudhën transitore' për implementimin e direktivave që kërkojnë investime të mëdha siç është Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC), Direktiva për Emetimet Industriale (2010/75/EU) dhe Direktiva e Mbeturinave të Ngurta (1999/31/EC)

4.2.2 Legjislacioni i Ujërave – Niveli i Transpozimit

Për sa i përket përafrimit me legjislacionin mjedisor të BE-së – tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit të kornizës ligjore të ujërave në Kosovë (që është bërë nga Projekti i Binjakëzimit i BE-së në vitin 2013) dhe paraqet një përmbledhje të statusit momental të transpozimit të Direktivave të BE-së për ujërat në Kosovë.



Tabela 21 Statusi i Transpozimit

	Direktiva e BE-së	Statusi i Transpozimit në Kosovë
1	Direktiva e Këshillit Nr. 91/676/EEC e 12.12.1991 “që ka të bëjë me mbrojtjen e ujërave nga ndotja të shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore”, të amendamentuar nga rregulloret Nr. EC/1882/2003 dhe EC/1137/2008.	<p><u>E PATRANSPOZUAR</u>: Kapitulli IX – neni 61 për mbrojtjen e ujërave i Ligjit të Ujërave Nr. 04/L-147/2013 rregullon ndalimin e plehërimit dhe përdorimit të preparateve kimike. Ligji i tashëm i ujërave nuk transponon në tërësi këtë direktivë, por jo mund të bëhet me një UA që duhet të lëshohet për transpozimin e Direktivës.</p> <p>Ligji për Tokat Bujqësore, Neni 20 “mbrojtja e tokës nga ndotja” Neni 21 “monitorimi i tokave bujqësore”, Neni 22 “kontrolli i pllëshmërisë së tokave bujqësore”, përcakton që Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duhet të përcaktoj procedurat me një nënat për të mbrojtur, të ruajtur dhe për të përmirësuar karakteristikat kimike, fizike dhe biologjike të tokës bujqësore të punueshme dhe sigurimi i përdorimit të drejtë të plehrave minerale.</p> <p>Rekomandohet një koordinim në mes të dy ministrive për të arritur transponim të plotë të Direktivës.</p>
2	Direktiva e Këshillit Nr. 91/271/EEC e 21.05.1991 që ka të bëjë me “trajtimin e ujërave të ndotura” e amendamentuar nga Direktiva Nr. 98/15/EC dhe Rregulloret EC/1882/2003 dhe EC/1137/2008.	<p><u>PJESËRISHT E TRANSPOZUAR</u>: Ligji i Ujërave Nr. 04/L-147/2013, neni 60 përcakton se Ministria me akt nënligjor do të përcaktojë kushtet, metodat, parametrat dhe vlerat kufizuese të lëshimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe mjedisin pritës.</p> <p>Nenet 36 dhe 37 të Ligjit për Mjedisin parashohin që Qeveria, me akte të veçanta, do të përcaktojë normat e emetimit dhe cilësinë e mjedisit, respektivisht vlerat kufizuese të emetimeve dhe cilësisë së mjedisit të materieve ndotëse dhe energjisë duke përfshirë emetimet nga burimet statike dhe mobile në ujë, ajër, dhe tokë. Direktiva duhet të transpozohet plotësisht.</p> <p>Bazuar në Nenin 46 të Ligjit për Ujëra 2004 zëvendësuar nga Ligji i Ujërave Nr. 04/L-147/2013, është aprovuar UA Nr. 30/2014 për vlerat kufitare të efluentëve që shkarkohen në trupat ujorë dhe në sistemin e rrjetit publik të kanalizimeve. UA përmban shumë nga dispozitat e DTUZ dhe përcakton kufijtë e emetimit për disa parametra, përfshirë substanca të rrezikshme. Janë paraparë dispozitat për monitorim dhe vlerësim të përputhshmërisë por jo edhe kalendari i zbatimit. UA 30/2014 duhet të amendamentohet dhe harmonizohet me ligjin e ujërave të aprovuar rishtazi dhe legjisacionin relevant mjedisor, ELV duhet të merret parasysh si dhe objektivat afatgjate të DKU-së për arritjen e një statusi të mire të cilësisë së trupave të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.</p>



	Direktiva e BE-së	Statusi i Transpozimit në Kosovë
3	Direktiva e Këshillit Nr. 98/83/EC e 03.11.1998 “për cilësinë e ujit që përdoret për qëllime të konsumit nga njerëzit”, e amendamentuar nga Rregulloret Nr. EC/1882/2003 dhe EC/596/2009.	PJESËRISHT E TRANSPOZUAR: kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë. Për momentin e rregulluar sipas UA Nr. 16/2012 “për cilësinë e ujit që përdoret për qëllime të konsumit nga njerëzit” që zëvendëson Udhëzimin Administrativ Nr. 2/1999. Ky UA është hartuar me mbështetje konkrete nga projekti i TUAEX-it me ekspert nga Instituti Kombëtar Italian të Shëndetit. Implementimi i Udhëzimit të ri Administrativ për UP është paraparë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë së bashku me IKSHPK in në pajtim me kërkesat e Neneve 4 dhe 7 të Ligjit të Kosovës për Shëndet Publik 2007/02 L78.
4	Direktiva Nr. 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23.10.2000 “themelimin e një kornize për veprim të Komunitetit në fushën e politikës së ujit”, e amendamentuar nga Vendimi Nr. 2455/2001/EC dhe Direktivat Nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC dhe 2009/31/EC.	<u>PJESËRISHT E TRANSPOZUAR</u> me Ligjin e Ujërave Nr. 04/L-147/2013, transpozimi i plotë do të arrihet përmes UA-ve.
5	Direktiva Nr. 2009/90/EC e 31 Korrikut 2009 që përcakton, sipas Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për specifikimin teknik të analizave kimike dhe monitorimi i statusit të ujit (Tekst me relevancë për EEA).	<u>E PATRANSPOZUAR</u> : disa aktivitete relevante janë implementuar në projektin e Menaxhimit të Pellgjeve të Lumenjve të Kosovës (http://www.kosovo-water.eu/) por nuk është i rregulluar në mënyrë specifike.
6	Direktiva Nr. 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15.02.2006 “që ka të bëjë me menaxhimin e ujërave për larje” dhe zëvendësimin e Direktivës Nr. 76/160/EEC, e amendamentuar nga Rregullorja Nr. EC/596/2009.	<u>E PATRANSPOZUAR</u> : Ligji i Ujërave Nr. 04/L-147/2013, Neni 34 “Programi i masave” përcakton se programi i masave duhet të përfshijë Nr. 3.6. masat e dizajnuara për ujërat për rekreacion dhe larje.
7	Direktiva Nr. 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12.12.2006 “për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe shkatërrimi”.	<u>E PATRANSPOZUAR</u> : trupat e ujërave nëntokësore në Pellgun e Drinit të Bardhë janë identifikuar gjatë implementimit të projektit të Menaxhimit të Pellgjeve të Lumenjve të Kosovës. Asnjë rrjet i monitorimit në pajtim me Direktivën për ujërat nëntokësore nuk është dizajnuar dhe implementuar dhe vetëm 20 puse për ujë të pijshëm përdoren për monitorimin e ujërave nëntokësore. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i burimeve të ndotjes duhet të realizohet.
8	Direktiva Nr. 2006/11/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15.02.2006 “për ndotjet e shkaktuara nga disa substanca të rrezikshme në mjedise ujore” e Komunitetit (zëvendësuar nga 76/464/EEC) (versioni i kodifikuar) (për t’u zëvendësuar me 22.12.2013 me Direktivën 2000/60/EC).	<u>E PATRANSPOZUAR</u> : lista e substancave të rrezikshme është identifikuar kadastra e ndotësve mund të gjendet në faqen e internetit të AKMM-së. Kjo është bërë me ndihmën e Zyrës së Bashkëpunimit Norvegjez. Nuk ka udhëzim administrativ për ndotjen e ujërave.



	Direktiva e BE-së	Statusi i Transpozimit në Kosovë
9	Direktiva Nr. 2007/60/EC e 23 Tetor 2007 për vlerësimin e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet (Teksti me relevancë të EEA).	<u>E PATRANSPOZUAR</u> : Ligji “i Ujërave” Nr. 04/L-147/2013 Kapitulli VIII - Rregullimi dhe kontrolli i ujërave, nenet 45 – 57.
10	Direktiva Nr. 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16.12.2008 “standardet e cilësisë në lëmin e politikave të ujit, ndryshuar me direktivën 2013/39/BE, “për ndryshimin e Direktive 2000/60EC, dhe 2008/105/EC për Substanca prioritare në lëmine e politikave të ujit”.	<u>NUK ËSHTË TRANSPOZUAR</u> : Direktiva 2013/39/EU përcakton kriteret për “gjendje (të mirë) kimike” të ujërave sipërfaqësorë, duke ofruar si listën e “Substancave prioritare dhe ndotësve të tjerë të caktuar” ashtu edhe standardet e tyre të cilësisë mjedisore.

Tabela e mëposhtme prezanton nivelin e transponimit të Direktiveve të BE-së në Kosovë që kanë të bëjnë me ujërat bazuar në raportin e fundit të progresit të Rrjetit Rajonal të Mjedisit për Anëtarësim (RrRMA, mars 2012, Konzorciumi i udhëhequr nga Human Dynamics).

Tabela 22 Vlerësimi i nivelit të transpozimit të Direktiveve të BE-së në sektorin e ujërave (2012)

Direktiva e BE-së	Shkurtesa	Transponimi (2012)
Uji për larje	DUL	100%
Ujërat nëntokësorë	DUN	50%
Standardet e cilësisë së mjedisit	DSCM	100%
Menaxhimi i rrezikut nga vërshimet	DMRV	100%
Nitratet	DN	30%
Trajtimi i ujërave të ndotura urbane	DTUNU	31%
Korniza e ujërave	DKU	80%
Uji i pijshëm	DUP	80%

Implementimi i këtyre direktivave është nën përgjegjësinë e MMPH, përveç:

- Direktiva e Nitrateve (DN) nën përgjegjësinë e Ministrisë së Bujqësisë (Ligji për Bagëtinë 2004/33, ligji për plehrat 2003/10 dhe udhëzimi administrativ për cilësinë e plehrave 10/2006),
- Direktiva për Ujë të Pijshëm (DUP) nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Disa Direktiva janë ende në fazën fillestare të transponimit, progres i konsiderueshëm është arritur me aprovimin e Ligjit të Ujërave, por duhet progres i mëtutjeshëm për të kompletuar transponimin përmes rishikimit/hartimit të një numri të Udhëzimeve Administrative.

Ligji i Ujërave fuqizon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në disa raste në bashkëpunim me Ministrinë tjera relevante, për të aprovuar njëzet e dy (22) Udhëzime Administrative brenda tetëmbëdhjetë (18) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.



4.3 Institucionet e qeverisë qendrore

Ky seksion trajton përfshirjen e Institucioneve të qeverisë qendrore në menaxhimin e ujërave të Kosovës. Seksioni në vijim merret me organizatat lokale.

Ligji për Ujërat identifikon institucionet kryesore që merren me menaxhimin e ujërave në vendit.

Kapitulli II i Ligjit të Ujërave definojnë 'Kompetencat dhe Përgjegjësitë' dhe Kapitulli III definojnë 'Trupat dhe Njësitë e Themeluara sipas Ligjit të Ujërave' nën institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Komunat
- Këshilli Ndërmintor për Ujëra
- Instituti i Ujërave të Kosovës
- Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL)

MMPH është në proces të themelimit të Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore. Hapa të mëtutjeshëm janë të nevojshëm për përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe zonave në rrezik, dhe zbatimin e modaliteteve të implementimit dhe e programeve të monitorimit. Arsyet për këto vonesa janë të ndryshme por kanë të bëjnë me financimin e tyre, strukturën organizative, burimet njerëzore, etj.

Korniza e tanishme institucionale për menaxhimin e ujërave në Kosovë përfshinë një numër të madh të institucioneve qeveritare dhe të palëve tjera.

- Kuvendi: Kuvendi është organ legjislativ i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Ekzistojnë dy funksione të rëndësishme që kanë të bëjnë me mjedisin e ato janë:
 - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
 - Bordi Këshillëdhënës për Mjedis.
- Qeveria: Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron kompetenca ekzekutive në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Ajo propozon projektligje dhe amendamente të ligjeve ekzistuese dhe akteve tjera nënligjore dhe mund të jep mendimin e saj për projektligjet që propozohen nga subjektet tjera.

Mandati i Ministrive definohet me Rregulloren Nr. 02/2011 për përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive të tjera.

Përgjegjësinë kryesore për implementimin e legjislacionit mjedisor e ka MMPH, por edhe ministrinë tjera kanë gjithashtu përgjegjësi përkatëse mjedisore (p.sh: MBPZHR, MZHE, MSh, etj). Diferencimi i qartë ndërmjet përgjegjëseve është qenësor për të shmangur ndërhyrjen e kompetencave ndërmjet institucioneve qeveritare. Niveli lokal i qeverisjes (komunat) ka përgjegjësi specifike siç janë planifikimi lokal strategjik, monitorimi, inspektimi/zbatimi i ligjit, regjistrimi/licencimi, grumbullimi i të dhënave, raportimi, informimi publik dhe konsultimi.

Kapitulli III Organet dhe Njësitë e themeluara sipas Ligjit të Ujërave Nr. 04/L-147/2013 rregullon njësitë dhe organet e themeluara me Ligjin për Ujëra.

Neni 14 (Komunat) përcakton që Komunat janë përgjegjëse për lëshimin e lejeve, të përcaktuara me akte nënligjore për lejet ujore. Komuna është gjithashtu përgjegjëse sipas Neneve 40, 46, 47, 49, 51,



55, 57, 68, dhe 72³⁹ të Ligjit për Ujëra. Këto leje janë të ndryshme nga licencat që i lëshon ARRU, e cila gjithashtu administron një sistem të ndarë të lejeve në pajtim me legjislacionin dhe procedurat e tyre. Nenet 15 – 19 definojnë themelimin e trupave këshillëdhënëse, Këshillin Ndërmintor për Ujëra të Kosovës i cili koordinon dhe mbështet institucionet kompetente për menaxhimin e ujërave në procesin e vendimmarrjes, duke harmonizuar nevojat dhe interesat e ndryshme, dhe propozon masat për zhvillimin, përdorimin dhe mbrojtjen e menaxhimit të burimeve ujore të Kosovës. I jep mbështetje Qeverisë në hartimin e strategjisë së ujërave, legjislacionit për ujëra dhe në përgjithësi i udhëheqë reformat e përgjithshme të këtij sektori. Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë dhe udhëhiqet nga Kryeministri. Anëtarët aktual të Këshillit janë Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Ministri i Financave dhe Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe përfaqësuesi i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (aktualisht në rolin e koordinatorit udhëheqës të donatorëve të sektorit të ujit). Këshilli Ndërmintor për Ujëra mori përsipër rolin dhe shumicën e përgjegjësive nga ish Task Forca e Ujërave (TFU) që ka qenë themeluar si komitet i ministrive relevante të Qeverisë së Kosovës, udhëhequr nga Zëvendës-Kryeministri. KNMU ka Sekretariatit i cili mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim me këshilltarë afatgjatë, dhe me disa ekspertë afatshkurtër të financuar nga Qeveria dhe nga komuniteti i donatorëve.

Neni 20 parasheh themelimin e Institutit për Ujëra të Kosovës, një institut hulumtues për ujërat si një organ i pavarur me detyra specifike që do të definohen në akte nënligjore. Duke marrë parasysh rekomandimet e bëra nga projekte të ndryshme të mbështetjes institucionale të financuara nga donatorët ndërkombëtarë të implementuar në 8 vitet e fundit për MMPH, ka dyshime për domosdoshmërinë e themelimit të një instituti të tillë para se të forcohet korniza publike menaxhuese për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe mungesës së ekspertëve të mjaftueshme për sektorin e ujërave.

Nenet 21 – 22 parasheh formimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL).

Ligji për Ujëra definon një rajon të pellgjeve lumore për të gjitha pellgjet lumore. Autoriteti është me seli në Prishtinë dhe do t'i raportojë Ministrisë. MMPH aktualisht është në proces të shqyrtimit të organizimit të tij të brendshëm përbrenda të cilit do të themelohet ARPLre, fillimisht si departament i cili i raporton Ministrisë e më pastaj të avancohet në një autoritet të pavarur brenda MMPH. Neni 22, n. 1.16. përcakton që detyrat shtesë të Autoritetit do të përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë. Stafi i identifikuar duhet të jetë i vetëdijshëm për detyrat specifike dhe përgjegjësitë që derivojnë nga zbatimi i Ligjit për Ujërat, veçanërisht detyrat e reja që do të identifikohen nga Ministria me akte nënligjore të veçanta.

Ministrinë e paraqitura me poshtë kanë përgjegjësi të përbashkëta në sektorin Mjedisor në Kosovë.

4.3.1 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ligjërisht ka përgjegjësitë kryesore në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor duke përfshirë burimet ujore, mbeturinat, pyjet, cilësinë e ajrit, menaxhimin dhe planifikimin e zhvillimit. MMPH përbëhet nga Ministri me kabinetin e tij, Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Departamentet perkatese sipas rregullores për organizimin e brendshëm të aprovuar nga Qeveria me datë 4.05.2017.

³⁹ Neni 40 “- Financimi i ndërtimit të pajisjeve dhe objekteve ujore”; neni 46 “kompetencat për mbrojtjen nga efektet e dëmshme të përmbytjeve”; “Neni 47 - Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave; Neni 49- Kompetent për mbrojtjen rrjedhave ujore dhe objekteve ujore; Neni 51 - Mbrojtja nga erozioni dhe rregullimi i rrëkeve ; Neni 55 - Rrëketë -Rregullimi i rrëkeve; Neni 57 - Njoftimet dhe detyrimet; Neni 68 - Zona për larje; Neni 72 – Leja Ujore



Përgjegjësitë e MMPH janë:

- Përpilimi dhe përcjellja e implementimit të politikave dhe programeve që identifikojnë dhe zvogëlojnë ndotjen mjedisore; merr pjesë në zhvillimin e dokumenteve strategjike;
- Koordinimi i aktiviteteve për promovimin e politikave mjedisore;
- Vendosja e normave dhe standardeve mjedisore dhe nxjerrja e udhëzimeve që përputhen me standardet ndërkombëtare;
- Mbikëqyrja e implementimit të këtyre standardeve duke përfshirë inspektimin dhe shërbimeve tjera atëherë kur kjo është e nevojshme;
- Menaxhimi i shfrytëzimit dhe zhvillimit të infrastrukturës mjedisore (menaxhimi i vërshimeve);
- Promovimi i pjesëmarrjes së komunitetit, iniciativave dhe aktiviteteve zhvillimore;
- Zhvillimi i politikave, implementimi i ligjeve dhe mbikëqyrja e aktiviteteve për mbrojtjen mjedisore duke përfshirë burimet ujore, ajrore, tokës dhe biodiversitetit;
- Inkurajon dhe merr pjesë në zhvillimin si dhe implementimin e fushatave të informimit publik dhe aktiviteteve tjera promovuese për të ngritur vetëdijen publike dhe përputhjen me standardet e mbrojtjes mjedisore;
- Mbikëqyrë dhe vlerëson gjendjen e mjedisit, posaçërisht ndikimin e aktiviteteve industriale, të shërbimeve publike dhe aktivitetit ekonomik;
- Zhvillon politika për menaxhimin e burimeve ujore dhe mbikëqyrë implementimin e tyre.

Sa i përket përgjegjësisë menaxhuese të sektorit të ujërave në Kosovë, **Ligji i Ujërave Nr.04/L-147** qartëson se MMPH është autoritet kompetent për menaxhimin e ujërave në Kosovë, me përgjegjësi të veçanta si në vazhdim:

- Menaxhimi dhe planifikimi i resursve ujore në nivel të rajonit të pellgut të lumenjve;
- Vendosja e standardeve për mbrojtje mjedisore (duke përfshirë shkarkimin e ujërave të ndotura);
- Lëshimin e lejeve për shfrytëzim të ujit duke përfshirë nxjerrjen dhe shkarkimin edhe pse këto kompetenca mund të delegohen tek Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore.

Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AKMM) është në kuadër të MMPH dhe përfshinë Institutin Hidrometeorologjik (IHMK), Institutin për Mbrojtjen e Natyrës (IMN), dhe drejtoritë si dhe njësitë tjera.

MMPH nuk ka përgjegjësi për ofrimin apo promovimin e shërbimeve të shfrytëzimit të ujit, gjegjësisht furnizimin e ujit dhe/ose mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Dy departamentet kryesore të përfshira në menaxhimin e çështjeve përkatëse të sektorit të ujërave janë:

4.3.1.1 Departamenti i Ujërave (DU)

Aktualisht Departamenti i Ujërave (DU) në strukturën e vet ka 3 divizionet e mëposhtme:

Divizioni i përgjithshëm për politika ujore i cili kryen analizimin dhe planifikimin strategjik të shfrytëzimit, eksploatimit dhe mbrojtjes së ujërave dhe është i organizuar në tri njësi, që janë: Njësia e Analizës dhe Planifikimit Strategjik, Bashkëpunimi Ekonomik, Zhvillimi - projektet dhe investimet dhe Njësia e Buxhetore, Njësia e Sistemit Informativ dhe Libri i Regjistrimit të Ujërave.

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore që kryen detyra administrative- ligjore për aplikim direkt të dispozitave që kanë të bëjnë me ekonomizimin e ujërave në lidhje me shfrytëzimin dhe mbrojtjen e ujit nga ndikimet negative, mbrojtjen e ujit nga ndotja, mbrojtjen dhe kontrollimin e cilësisë së ujit,



rregullimin e ujërave dhe qarkullimi i ujërave, mbrojtjen nga erozioni dhe rregullimin e lumenjve. Divizioni punon në përcaktimin e prioriteteve për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e ujërave, licencat etj. Divizioni është i përbërë nga 4 njësi që janë: Njësia për Mbrojtjen e Ujërave nga Ndikimet Negative, Njësia për Mbrojtjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Ujërave, Njësia për Licenca dhe Njësia e Menaxhimit të Qarkullimit të Ujërave.

Divizioni për Koordinimin e Pellgjeve të Lumenjve, i cili mbledh të dhëna, vendos dhe organizon bazën e të dhënave për pellgjet lumore, mbledh informata për monitorimin, bashkëpunon me institucionet e tjera përkatëse të Kosovës, mban evidencë për pronën ujore, udhëheqë me burimet ujore në nivel të pellgut të lumit duke përfshirë planifikimin dhe kompensimin për shfrytëzimin dhe ndotjen e ujërave, kryen vlerësime të ndikimit mjedisor gjatë zhvillimit të planeve hapësinore dhe urbane, mbikëqyrë hulumtimet, mbrojtjen e interesit publik, kontrollin e lejeve të përkohshme hidro-ekonomike. Divizioni është i përbërë nga dy njësi që janë: Njësia për Pellgun e Lumit Drini i Bardhë dhe Njësia për Pellgun e Ibrit, Moravës së Binçës dhe Lepencit.

Domosdoshmëria dhe roli i DU do të shqyrtohet pas funksionalizimit të Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore.

4.3.1.2 Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit (DMM)

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit (DMM), përbëhet nga divizionet si në vazhdim: Divizioni për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor; Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale; Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate; Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës përfshinë Sektorin e Parqeve Kombëtare dhe 5 Zyra Regionale të vendosura në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan, që veprojnë si lidhje e komunikimit ndërmjet Ministrisë dhe Komunave. Zyrat Regionale kanë të punësuar 3 zyrtarë, një nga Departamenti i Planifikimit Hapësinor, një nga Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit dhe një nga DMM, që veprojnë si inspektorë. Sektori i Edukimit, Vetëdijesimit Publik dhe Bashkëpunimit me Komunitet dhe Shoqërinë Civile (SEVPBM) në kuadër të Divizionit të Zhvillimit të Politikës Mjedisore është i ngarkuar me implementimin e legjislacionit Mjedisor në nivel komunal.

4.3.1.3 Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AKMM)

Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës është themeluar në vitin 2003 në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit si institucion në kuadër të MMPH për të kryer detyra administrative, profesionale, mbështetje shkencore dhe hetuese në fushën e mbrojtjes së mjedisit. AKMM raporton në baza të rregullta për gjendjen e mjedisit sa i përket furnizimit me ujë, ndotjes së ujit, mbetjeve ujore të patrajuara, eutrofikimit dhe monitorimit të ujërave sipërfaqësore.

4.3.1.4 Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës (IHMK)

Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës (IHMK) është themeluar në vitin 2006 si pjesë e MMPH. Sipas ligjit për aktivitetet hidro-meteorologjike (Ligji Nr. 02/L-79 i 2006), IHMK është kompetent për ekzekutimin e të gjitha aktiviteteve hidro meteorologjike në Kosovë e që ndër të tjera përfshinë matjen dhe monitorimin e informacionit hidrometeorologjik e gjithashtu publikimin e informacionit në lidhje me cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore. Puna e Institutit përfshinë hidrologjinë, meteorologjinë e gjithashtu analizën fizike dhe kimike të mjedisit (uji, ajri dhe toka).

Në shtator 2011 është nënshkruar Udhëzimi Administrativ për organizimin dhe strukturën e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) që e inkorporon Institutin Hidro Meteorologjik (IHMK) në kuadër të AMMK.



Me themelimin e Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore, komponenta e IHMK do të duhet të bartet tek ky i fundit.

4.3.2 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Roli i MBPZHR, i definuar me Ligjin Nr. 02/L-9, është kryesisht në krijimin dhe implementimin e politikave për ujitje dhe kullim (drenazhim) përderisa nuk ka ndonjë aktivitet direkt në fushën operacionale. Në veçanti kompetencat e Ministrisë janë:

- Përcaktimi i politikave të ujitjes dhe kullimit,
- Zhvillimi i kriterëve dhe kufizimet e propozuara për pagesat e ujitjes,
- Dhënia e miratimit në koordinim me Agjencinë e Kosovës për Prona, për transferimin e disa përgjegjësive për menaxhimin me kanalet primare, dytësore dhe terciare dhe kushteve pasuese nga një ndërmarrje tek asociacioni në kuadër të territoreve të caktuara,
- Definimi i përgjegjësive dhe kufijve ndërmjet ndërmarrjeve dhe asociacioneve dhe ndërmjet vetë asociacioneve,
- Përfaqësimi i interesave të bujqësisë në fushën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në njësitë monitoruese të ndërmarrjeve publike,
- Specifikimi i përgjegjësive të kufijve fizik ndërmjet kompanive të furnizimit me ujë dhe asociacioneve të shfrytëzuesve të ujit dhe ndërmjet asociacioneve.

4.3.3 Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Nr. 03/L-087), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përmes Njesisë së saj për Politika dhe Monitorim (NjPM), mbikëqyrë punën e ndërmarrjeve publike (duke përfshirë Kompanitë Rajonale të Ujit) në Republikën e Kosovës dhe siguron operimin e tyre të përgjegjshëm dhe transparent. Ligji themelon kornizën ligjore për ushtrimin e të drejtës së pronës mbi ndërmarrjet publike dhe rregullon qeverisje korporative të këtyre ndërmarrjeve. KRU-të janë përgjegjëse për financimin e projekteve të infrastrukturës ujore duke përfshirë punët rehabilituese. Qeveria, përmes MZHE-së, mbështet financimin e projekteve të tilla të cilat zbatohen nga KRU-të.

4.3.4 Ministria e Financave (MF)

MF kërkon të sigurojë menaxhim të përgjegjshëm, të drejtë dhe transparent të fondeve publike dhe këshillon Qeverinë e Kosovës për politikën e saj ekonomike dhe fiskale. Zhvillimi dhe implementimi i politikave të shëndosha makro-ekonomike bëhet në bashkëpunim me Kuvendin, Ministrinë përkatëse, Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe Donatorët. Në këtë drejtim MF ndër të tjera përfshinë rolet dhe përgjegjësit në vazhdim:

- Koordinimi me Institucionet e Administratës Publike dhe kur është e duhur me donatorët multilateral dhe bilateral për çështjet që kanë të bëjnë me financimin e donatorëve dhe kontributet e granteve;
- Sigurimi i shfrytëzimi efektiv dhe transparent i fondeve të donatorëve të alokuara për qëllimet e pajtuara,
- Promovimi i ndryshimit të të gjitha projekteve në fushën e partneritetit publiko privat,
- Koordinimi i aktiviteteve të institucioneve ndërkombëtare financiare,
- Ofrimi i kornizës ligjore për zhvillimin e sektorit privat në Republikën e Kosovës.



4.3.5 Zyra e Kryeministrit

Kryeministri udhëheq Këshillin Ndërmintor për Ujërat (KNMU). KNMU (më parë TFW) vepron si komitet i Ministrave relevant të Qeverisë, nën kryesimin e Kryeministrit, me përgjegjësi për përmirësimin e situatës në sektorin e ujërave përmes zhvillimit të politikave sektoriale dhe planeve të veprimit bazuar në praktikën me të mira.

KNMU ofron platformën kryesore për zhvillimin e politikave për reformimin e sektorit të ujërave dhe në veçanti ka përgjegjësi për zhvillimin dhe miratimin e politikave të kërkuara për të siguruar Qëndrueshmëri të reformave dhe investimeve në sektorin e ujërave.

4.3.6 Këshilli Ndër-Mintor për Ujëra (KNMU)

Neni 15 i Ligjit të ri definon themelimin e Këshillit Ndërmintor për Ujëra (KNMU) si trup i pavarur që duhet të veprojë si organ koordinues dhe vendimmarrës në mënyrë që të promovojë më tutje zhvillimin e sektorit të ujërave të Kosovës. KNMU zëvendëson TFU dhe sipas nenit 17, ofron opinione dhe rekomandime për lëmitë në vazhdim:

- Implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që e rregullojnë sektorin e ujërave
- Implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me menaxhimin e ujërave
- Përpilimi dhe miratimi i Strategjisë Shtetërore të Ujërave;
- Zhvillimi i politikës në fushën e ujërave
- Politika e financimit për sektorin e ujërave

Sipas nenit 16 të Ligjit për Ujëra, KNMU kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga 4 Ministra të tjerë të linjës. Me rregullore të qeverisë anëtarë të KNMU janë emëruar:

- (i) Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- (ii) Ministri i Zhvillimit Ekonomik,
- (iii) Ministri i Financave, dhe
- (iv) Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal.

4.3.7 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është një trup i pavarur rregullator që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe është rregullator kyç për licencimin dhe rregullimin ekonomik të sektorit të shërbimeve me ujë (ujësjellës dhe kanalizime) - përderisa MMPH vepron si rregullator mjedisor. Që nga fillimi i vitit 2013, ARRU nuk është më përgjegjës për rregullimin e shërbimit të mbeturinave të ngurta pasi që përgjegjësia për menaxhimin e mbeturinave të ngurta iu kthye komunave. ARRU ka një numër të limituar të stafit: përveç Drejtorit dhe Zëvendësit të tij, janë të punësuar edhe nga tre analist që merren me modelimin / aprovimin e tarifave dhe numër i njëjtë për monitorimin e performancës, një inspektor, një zyrtar për mbrojtje të konsumatorëve ndërsa të tjerët janë staf administrativ. Dy zyrtar profesional kërkohen me qëllim të rritjes së eficiencës në ARRU.

ARRU është themeluar zyrtarisht në vitin 2004 përmes rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49. Në qershor të vitit 2008, me largimin e administratës ndërkombëtare nga Kosova, përmes Ligjit Nr. 03/L-086, llogaridhënia dhe përgjegjësia e ARRU është transferuar te institucionet vendore, përkatësisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Prandaj, roli kryesorë i ARRU është të menaxhojë një kornizë efektive rregullatore, që i stimulon ofruesit e shërbimeve me ujë në Kosovë që të ofrojnë shërbime cilësore të paguara nga konsumatorët.

Ligji Nr. 03/L-086 është zëvendësuar nga Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit Nr. 05/L-042.



4.3.8 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike (IKSHPK) është trup i Qeverisë së Kosovës me përgjegjësi për një numër të madh çështjesh që kanë të bëjnë me shëndetin publik duke përfshirë monitorimin dhe implementimin e standardeve për ujë të pijshëm në Kosovë në përputhje me kërkesat e nenit 7 të Ligjit për Shëndetin Publik Nr. 2007/02 L78.

4.3.9 Inspektorati Shtetëror Mjedisor i Kosovës (ISHMK)

Inspektorati Shtetëror Mjedisor i Kosovës (ISHMK) është themeluar me Udhëzimin Administrativ (UA) Nr. 02/2004-MMPH “për themelimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit” të datës 18.02.2004.

Detyrat e kontrollimit të ujit identifikohen me Ligjin e Ujërave 04/l-147, nga neni 94 deri në nenin 105. Pjesa që ka të bëjë me aktivitetet inspektuese është deleguar te Komunat.

Inspektorët e punësuar drejtpërdrejt nga MMPH (Inspektorët Shtetëror dhe ata Regjional) i raportojnë drejtpërdrejt Sekretarit Permanent të MMPH. Detyrat kryesore të tyre janë gjordat që duhet t'i shqiptojnë nëse ka nevojë por nuk kanë obligim të marrin ndonjë mostër. Ata shqiptojnë gjorda në përputhje me dënimet që parashihen nga Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014.

Ky organ është përgjegjës për mbikëqyrjen e implimentimit të 13 Ligjeve.

Sipas Analizës Mjedisore të Kosovës nga Banka Botërore:

- Legjislacioni mjedisor kërkon që instalimet që do të kishin ndikim në ndotje të dërgojnë raporte të monitorimit te MMPH, edhe pse cilësia e këtyre raporteve ndryshon në masë të madhe. Inspektorati mjedisor i MMPH-së është përgjegjës për inspektimin mjedisor të ajrit, ujit, dhe emetimin e ndotësve nga aktivitetet industriale. Megjithatë, ashtu siç ndodhë më agjencitë tjera qeveritare, ka mungesë të stafit dhe probleme me mbajtjen në punë të ekspertëve për shkak të pagesave më të mira në sektorin privat. Departamenti ka shumë pak inspektorë për numrin e problemeve mjedisore.
- Inspektimet kryhen në bazë të planit vjetor. Për objektet, planet për inspektime përgatiten në bazë të regjistrit të ndërmarrjeve dhe në bazë të prioritetit (d.m.th, vlerësimi i rrezikut). Inspektimi i objekteve fokusohet në verifikimin e statusit të lejeve, dukë përfshirë pasjen e lejeve mjedisore dhe autorizimet/lejet përkatëse, si dhe kushtet e lejes. Nuk merren mostra për analiza dhe Inspektorët nuk posedojnë pajisje mobile për matjen e parametrave ndotës. Procedurat e inspektimit kryhen duke u mbështetur në përvojën e Inspektorëve (shumica prej të cilëve u janë nënshtruar trajnimeve), pasi që manualet e inspektimit që përshkruajnë detajet e inspektimit ende nuk janë përgatitur.
- Të gjithë Inspektorët janë të vendosur në zyrën e Inspektoratit Mjedisor në Prishtinë, pas ndryshimit të vitit 2009 që kishte për qëllim rritjen e koordinimit dhe efijencës. Megjithatë, kjo lëvizje ka rritur kërkesat logjistike për inspektimet larg nga Prishtina. Në rastet e mospërmbushjes së kërkesave nga lejet, inspektorati mjedisor i referon rastet në Gjykata, duke shpënë në vonesa për shkak të ngarkesës së madhe të sektorit gjyqësor.

Raporti i Vlerësimit Institucional i bërë nga Task Forca për Ujëra në vitin 2011 rekomandon që:

- Kompetencat për inspektimin e ujërave duhet të kthehen tek DU në mënyrë që të kompletohet cikli i informacionit në administrimin e ujërave.



4.4 Institucionet lokale të qeverisjes

4.4.1 Komunat

Komunat zbatojnë planet lokale mjedisore të veprimit (PLMV) dhe programet për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me KES dhe NEAP dhe në përputhje me interesat e tyre specifike. Në projektimin e PLMV dhe të programeve, publiku, OJQ, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit inkurajohen vazhdimisht që të marrin pjesë. Komunat i raportojnë Ministrisë në lidhje me implementimin e këtyre planeve dhe programeve. Për të zvogëluar ndikimin negative në mjedis dhe në disa raste për të zvogëluar koston, dy apo me shume komuna mund të zhvillojnë dhe të miratojnë planet dhe programet e tyre së bashku.

Në përputhje me nenin 14 të Ligjit për Ujëra disa përgjegjësi për implementimin e politikës së ujërave janë deleguar të komunat. Këto përgjegjësi në veçanti kanë të bëjnë me lëshimin e licencave, të zbatojnë aktet nënligjore për licencat ujore. Komunat gjithashtu janë përgjegjëse për detyrat tjera specifike të identifikuar me Ligj, e në veçanti:

- Ndërtimi i objekteve ujore (neni 40)
- Mbrojtja nga vërshimet (neni 46)
- Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujit (neni 47)
- Mbrojtja e shtratit të ujërave (neni 49)
- Mbrojtja nga erozionit (neni 51)
- Rregullimi i rrëkeve dhe përrenjve (neni 55)
- Njoftimi Ministrisë në rast të rrezikut erozioni dhe rrëketë (neni 57)
- Përcaktimi i zonave për larje (neni 68), dhe
- Lëshim i lejeve ujore (neni 72)

Komunat gjithashtu kanë përgjegjësi për aktivitetet inspektuese nga inspektorët Mjedisor që zakonisht punësohen në kuadër të Departamentit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis (DPUKM) apo në kuadër të Departamentit për Inspektim (DI) në përputhje me organizimin e brendshëm të miratuar nga secila komunë.

4.5 Institucionet e shërbimeve të ujit

4.5.1 Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit

Shërbimet e ujit në formën e furnizimit me ujë dhe të kanalizimit të ujërave të ndotura janë gjerësisht (por jo plotësisht) në kuadër të përgjegjësisë së shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU). Këto KRU janë themeluar gjatë viteve 2002 – 2006. Para kësaj kohe shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura janë kryer nga Kompanitë komunale për furnizim me ujë që ishin diku 30 që janë konsoliduar nëpërmes të procesit të bashkimit ligjor dhe inkorporimit në shtatë ndërmarrje që operojnë tani.

KRU-të mbesin pronë e shtetit nën kontrollin e Qeverisë së Kosovës përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (me parë quhej Ministria e Ekonomisë dhe Financave). Secila KRU është e regjistruar si ndërmarrje me pronësi publike me kapitalin e tyre në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ato janë të licencuara për ofrimin e ujit të pijshëm nga ARRU. ARRU, përveç detyrave të tjera përcakton standardet dhe tarifrat optimale, monitoron performancën e KRU-ve; emëron, organizon dhe menaxhon Komitetet Këshilluese të Konsumatorëve në të shtatë rajonet; shqyrton ankesat e



konsumatorëve; këshillon KRU-të në çështje të ndryshme dhe merr përsipër detyrat e lidhura me fushën e menaxhimit të shërbimeve ujore.

Ekziston kushti për KRU-të për të pasur raporte kontraktuale me secilën komunë në kuadër të rajonit të tyre. Këto marrëveshje janë nënshkruar si “Marrëveshje të shërbimit” dhe iu japin KRU-ve rol të vetëm dhe ekskluziv për furnizim me ujë në kuadër të komunave të tyre dhe definimin e detyrave të secilës palë. Jo të gjitha komunat kanë nënshkruar marrëveshjet e shërbimit dhe disa të tjera që kanë nënshkruar këto marrëveshje kanë paraqitur brenga për afatet dhe kushtet.

Të shtatë KRU-të janë anëtare të SHUKOS-it, asociacioni i Kompanive të Ujësjetës të Kosovës.

4.5.2 Shërbimet komunale të ujit

Siç u përmend më lartë, shërbimet publike të ujit nuk ofrohen vetëm nga shtatë KRU por gjithashtu nga shërbimet komunale të ujit që janë nën mbikëqyrjen e komunave respektive. Në këtë moment ekzistojnë 11 shërbime lokale që operojnë vetëm në kuadër të një komune të vetme.

Këto shërbime përfshijnë edhe ato të krijuara pas procesit të rajonalizimit të kompanive të ujërave dhe atyre që u shërbejnë komunave në veri të Kosovës.

Këto shërbime nuk janë të licencuara nga ARRU për ofrimin e furnizimit me ujë. Vendosja e tarifave dhe monitorimi i cilësisë së shërbimit në teori bëhen nga komunat përkatëse. Megjithatë, nuk ka informacion publik në dispozicion në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar nga këto ndërmarrje përveç për cilësinë e ujit i cili monitorohet nga IKSHPK.

Strategjia e Qeverisë së Kosovës është integrimi i këtyre operatorëve në shtatë KRU-të në një afat të shkurtër kohor.

4.5.3 Operatorët lokal (“organizatat e komunitetit”)

Popullsia në zonat rurale kryesisht furnizohet nga operatorët e komunitetit. Ekzistojnë 670 sisteme të veçanta të ujësjetës të komunitetit (por jo të gjithë janë funksional) nga të cilët 490 menaxhohen nga shtatë KRU-të. Sistemet tjera zakonisht operohen nga komuniteti. Për këto të fundit nuk ekziston një monitorim i rregullt i cilësisë nga IKSHPK.

Strategjia e Qeverisë së Kosovës është integrimi i këtyre operatorëve në shtatë KRU-të në një afat të shkurtër kohor.

4.6 Institucionet e shërbimit të ujitjes

4.6.1 Kompanitë e ujitjes

Kosova përfaqëson dy lloje të ndryshme të skemave të ujitjes:

- Skemat e mëdha të menaxhuara nga Kompanitë e ujitjes (Ibër-Lepenc, Radoniqi-Dukagjini, Drini i Bardhë), me hapësirë totale të ujitjes në vit ndërmjet 5,000 dhe 10,000 hektarë;
- Skemat e vogla që menaxhohen nga komunitetet lokale të shpërndara në tërë vendin, me hapësirë totale të ujitjes në vit ndërmjet 1,000 dhe 2,000 hektarë.

Kjo ndarje është për shkak të zgjedhjes së bërë në të kaluarën e afërt dhe ka ndikim të rëndësishëm në bujqësi në Kosovë për investimet e reja infrastrukturore dhe përgjithësisht në menaxhimin e ujit.

Historikisht ujitja është menaxhuar nga ofruesit e ujitjes (gjithashtu identifikohen si Kompanitë e ujitjes). Pas luftës ishin gjashtë shërbime publike të ujitjes të cilat me vonë gjatë rajonalizimit dhe procesit të inkuorporimit janë fuzionuar në formimin e 3 kompanive rajonale të ujitjes e që janë Ibër-Lepenci, Radoniqi-Dukagjini dhe Drini i Bardhë.



Pagesat për ujë për shërbimet e ujitjes vendosen nga Kompanitë përkatëse që miratohen nga Bordi i Drejtorëve. Çmimet për shërbimet e ujitjes nuk bazohen në koston e rikuperimit por në përfitimin marginal për ujin e shfrytëzuar për ujitje dhe parimin e 'aftësisë për të paguar' të kapacitetit të ri-pagesës. Nuk merret parasysh elementi i 'kthimit të kapitalit' gjithashtu.

4.6.2 Asociacionet e shfrytëzimit të ujit

Numri i asociacioneve të aktiviteteve të shfrytëzimit të ujit është shumë i vogël në krahasim me rreth 50 të tilla sa janë krijuar në fillim. Ideja e këtyre asociacioneve, ashtu si parashihet në ligj, është bazuar në parimin e dhënies në menaxhim të rrjeteve sekondare dhe terciare aktorëve lokal.

Duhet gjithashtu të merret parasysh se MBPZHR nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për asociacione të qëndrueshme dhe zhvillimore të shfrytëzuesve duke i lënë ato në baza spontane dhe veprime vullnetare për secilin fermer në vend të promovimit të tyre dhe përcjelljes së tyre në rritjen e tyre. Mbështetja që do të mund t'u ofrohej do të ishte në aktivitetet si trajnimi, por gjithashtu edhe financimi për aktivitetet e mirëmbajtjes përmes ftesës për aplikim nga secili asociacion.

4.6.3 Aranzhimet Institucionale për mbrojtje nga vërshimet

Ligji për ujërat Nr. 04/L-147/2013 në Kapitullin VIII për Rregullativen dhe Kontrollimin e Ujërave thekson se autoritetet kompetente për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujit janë Komunitatet dhe Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore, ndërkaq Ministria ka vetëm rol të koordinimit dhe mbikëqyrjes. Programi i Mbrojtjes duhet të përpilohet nga autoritetet kompetente në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante dhe në përputhje me direktivat specifike që duhet të nxjerren nga Ministria përmes akteve nënligjore.

Për të garantuar implementim të plotë të mbrojtjes nga vërshimet do të jetë e domosdoshme zhvillimi dhe forcimi i:

- Informimit dhe konsultimit publik
- Koordinimit ndërmjet entiteteve kompetente në nivel kombëtar, të pellgut dhe lokale.
- Rrjetit të observimit (hidrologjia dhe klimatologjia)

Konceptet kryesore të mbrojtjes nga vërshimet kuptohen nga njësia përgjegjëse për "infrastrukturë dhe vërshime" në kuadër të Departamentit të Ujërave të MMPH, por kapaciteti i palëve të ndryshme duke përfshirë ekipin përgjegjës të Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore ka nevojë të përmirësohet.

4.7 Menaxhimi i të dhënave

4.7.1 Baza ligjore

Baza ligjore për monitorimin mjedisor është shtjelluar më sipër.

E drejta për qasje në dokumente publike është e drejtë e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Neni 41). Secili person ka të drejtë qasjeje në dokumentet publike, përveç në informata që janë të kufizuara me Ligj. Gjithashtu, e drejta për qasje në dokumente publike është e drejtë e garantuar nga një varg i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) është botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 88, me 25 Nëntor 2010. LQDP aplikohet për të gjitha dokumentet e mirëmbajtura, të hartuara apo të pranuar nga institucionet publike. LQDP bazohet në dhjetë parime të së drejtës për qasje në informacion:

- (i) E drejta për qasje në informacion i takon secilit person;



- (ii) Qasja është rregull, sekreti është përjashtim;
- (iii) E drejta iu takon të gjitha trupave publike;
- (iv) Kërkesa duhet të jetë e thjeshtë, e shpejtë dhe pa pagesë;
- (v) Zyrtarët janë të obliguar t'u ndihmojnë kërkuarëve të informacionit;
- (vi) Refuzimi duhet të arsyetohet;
- (vii) Interesi publik është me i rëndësishëm se sekreti;
- (viii) Secili ka të drejtën e ankimit të pafavorshëm;
- (ix) Trupat publike duhet të publikojnë informacionin bazë në mënyrë proaktive;
- (x) E drejta duhet të garantohet nga një trup i pavarur.

Ligji është plotësuar me legjislacionin sekondar duke përfshirë:

- Rregulloren Nr. 04/2012 për evidentimin zyrtar të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe paketave standarde të dokumenteve të kërkesave për qasje në dokumentet publike;
- Rregulloren Nr. 03/2011 për Shërbimet Qeveritare të komunikimit me Publikun;
- Rregulloren Nr. 1/2012 për kodin e etikës për zyrtarët për komunikim me publikun;
- Rregulloren Nr. 02/2012/MF për tarifën për qasje në dokumentet publike;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 për faqet e internetit të institucioneve publike;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2011 për Portalin e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/09 për transparencëtë komunave.

Në sektorin e ujërave ka legjislacion sekondar që rregullon Sistemin Informativ Ujor në formë të Udhëzimit Administrativ 12/2013. Udhëzimi definon Sistemin e Informatave për Sektorin e Ujërave.

Udhëzimi specifikon kërkesat për regjistrat vijues:

- Regjistri i Protokollit Ujor
- Regjistri i Dokumenteve Teknike
- Regjistri i Koncesioneve

Përmbajtja e Regjistrat të Protokollit të Ujërave përfshinë:

- Të dhënat për lejet ujore
- Të dhënat për lejet për përdorimin e zhavorit dhe rërës
- Të dhënat për substancat kimike dhe shkarkimi i tyre në ujëra nga mbajtësit e lejeve
- Regjistri i substancave të rrezikshme

Regjistri i Dokumentacionit Teknik përmban informata të ndërlidhura për dokumentacionin teknik siç kërkohet nga Regjistri i Protokollit Ujor.

Regjistri i Koncesioneve për Ujëra përmban detajet e koncesionit, kontratat dhe vendimet që kanë të bëjnë me to në sektorin e ujërave.

Kadastra e ujërave përmban:

- Kadastrën e Ujërave Sipërfaqësore
- Kadastrën e Ujërave Nëntokësore
- Kadastrën e Zonave të Rrezikuara
- Kadastrën e Objekteve dhe Infrastrukturës së Ujërave
- Kadastrën e Rrjedhjes së ujërave, rregullimi dhe mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave



- Kadastrën e Ujërave të Ndotura
- Kadastrën e Dokumenteve Teknike
- Kadastrën e Zonave të Ujërave të Mbrojtura

Përmbajtja e kërkuar për secilën nga këto Kadastra Specifike specifikohet në detaje në Udhëzim.

Udhëzimi përcakton:

- Të drejtën e përdoruesve të të dhënave dhe qasjes në informacion në Sistemin e Informacionit Ujor
- Financimi bëhet nga buxheti i institucionit që operon me Sistemin e Informacionit Ujor
- Mundësimin e qasjes në informacion

Udhëzimi parasheh që:

- Njësia për Sistemin e Informacionit Ujor – njësia e autorizuar nga Ministria për administrimin, menaxhimin dhe furnizimin me të dhëna, duke përfshirë përgjegjësinë (Neni 30) për futjen, ruajtjen dhe përditësimin e sistemit të bazës së të dhënave
- Ministria përgjegjëse për menaxhimin e ujërave e organizon bazën e të dhënave dhe e menaxhon atë në mënyrë elektronike në mënyrë që të krijojë Librin e Ujërave në format elektronik, dhe të printuar në letër
- Ministria do të nxjerrë procedurat e detajuara për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave për ujëra, brenda 6 muajsh.
- Ministria do të publikojë dizajnet e detajuara për sistemin e informacionit, dokumentacionin e nevojshëm, transferimin e autoritetit në hierarki, qasjen, kontrollin e të dhënave dhe informacionit brenda 10 muajsh
- Ministria do të publikojë brenda 12 muajsh katalogun e informacionit për ujërat

4.7.2 Monitorimi dhe mbledhja e të dhënave

Përgjegjësitë për monitorimin e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore janë paraqitur në nenin 35:

Programi i Monitorimit të Ujërave në Ligjin e Ujërave të Kosovës. Sipas këtij neni IHMK është kompetente për implementimin e monitorimit dhe për monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të rezervuarëve. IKSHP dhe ofruesit e furnizimit me ujë janë përgjegjës për monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave që shfrytëzohen për pije.

Sipas nenit 81: Sistemi Informativ Ujor, paragrafi 3, të gjithë personat apo institucionet janë të obliguara të ofrojnë të dhëna për ujin të MMPH dhe të autoritetet kompetente të ujërave. Neni 83: Kadastra e ujërave, paragrafi 3 thotë "të gjithë personat fizik dhe juridik, qeveritar apo jo qeveritar që kanë të dhëna që janë të regjistruara në kadastrën e ujërave paragrafi 2 i këtij neni duhet që pa kompensim të ofrojnë të dhënat tek Autoriteti për t'i regjistruar."⁴⁰ Neni 22: Detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit, paragrafi 1, përcakton detyra të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë të dhënat e nevojshme për përcaktimin e burimeve, për sasinë dhe vetitë e ujërave, vrojtimin e ujërave, dhe për regjistrin e objekteve dhe pajisjeve ujore.

Tani për tani AKMM pranon dhe mbledh të dhëna mjedisore për tërë Kosovën duke përfshirë ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore.

40 Në Ligjin për Ujërat e Kosovës, Autoriteti për Pellgjet e Lumenjeve adresohet si 'Autoriteti'.



4.7.3 Menaxhimi i Informacionit

Kapitulli XI: SISTEMI INFORMATIV DHE PJESËMARRJA PUBLIKE i ligjit për ujërat në Kosovës përmban disa nene që kanë të bëjnë me të dhënat dhe menaxhimin e informacionit. Neni 81.1 thotë se Sistemi Informativ Ujor përfshinë masat dhe aktivitetet në lidhje me regjistrimin, transferimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e të dhënave dhe çështjet e tjera të rëndësishme për menaxhimin e ujërave. Neni 81.2 përmban çështje të ndryshme relevante për Sistemin Informativ Ujor përveç tjerash Kadastrën Ujor. Përbërja e vetë kadastrës së ujërave është e detajuar në nenin 83.

4.7.4 Shpërndarja dhe përdorimi i Informacionit

Neni 81.4 thotë *“Të dhënat e Sistemit Informativ Ujor janë publike dhe secili mund të ketë qasje në to përveç të dhënave që konsiderohen si sekret shtetëror”*.

Në kuadër të MMPH, të dhënat në lidhje me shfrytëzimin e ujit shfrytëzohen për raportim e gjithashtu për qëllime planifikimi ndërmjet tjerash nga AKMM, DU dhe IHMK.

IHKM është prodhuesi me i madh i të dhënave dhe AKMM konsumuesi me i madh i këtyre të dhënave. AKMM gjithashtu prodhon material që shpërhap informacion mjedisor për publikun. Lëshimi i lejeve për shkarkime ujore dhe nxjerrje të ujit në DU mbështetet, deri në njëfarë mase, nga të dhënat për sasinë e ujit dhe cilësinë për disa vite të kaluara edhe duke shfrytëzuar modelet hidraulike (SVPU). Ky model megjithatë ka përfunduar së shfrytëzuar por është rekomanduar për tu ripërtërirë. Stafi i DU merr pjesë aktive në përmbushjen e obligimeve raportuese për Agjencinë Evropiane të Mjedisit (AEM).

4.8 Korniza e politikave

Në prill 2014, TFU (tash KNMU) ka miratuar një dokument politike për Qeverinë. Ky punim ka shërbyer si bazë dhe udhërrëfyes për zhvillimin e Strategjisë shtetërore të ujit. Qeveria ka miratuar punimin mbi Politikën e ujit. Para pak kohe, më 3 qershor 2015, Qeveria ka aprovuar politikën e vetë të ujit, e cila cek parimet kyçe për veprim, aranzhimet për qeverisje në sektorin e ujërave, rekomandimi i politikës për burimet e ujit dhe për shërbimet e ujit dhe definon hapat e ardhshme jetike.

Ky Dokument, së bashku me Strategjinë Shtetërore të Ujërave, dhe Programin e Veprimit dhe Investimeve do të jenë dokumente primare të politikës për sektorin e ujërave. Megjithatë, këto politika të Republikës së Kosovës duhet të vendosen në kontekstin e strategjive zhvillimore ndërsektoriale të vendit dhe të harmonizohen me strategjitë e sektorëve specifik relevant me rëndësi për sektorin e ujërave.

4.8.1 Shërbimet e ujit

Nuk ka një politikë specifike të qeverisë për nënsektorin e shërbimeve të ujit. Megjithatë, është me rëndësi të dihet se:

- Korniza e ofruar nga mbikëqyrja e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit e drejton këtë nënsektor në mënyrë të mirë monitoruar dhe moderne.
- Elementet e politikave ekzistuese ndërsektoriale kanë rëndësi direkte për sektorin ashtu sikur është theksuar me poshtë.

4.8.1.1 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit – Roli në politika

ARRU ofron udhëzim të politikave dhe mbikëqyrje përmes:

- Politikës tarifore për furnizim me ujë
- Politikës tarifore për ujin me shumicë
- Procedurave rregullatore



- Planeve të veprimit
- Manualit të Sigurimit të Cilësisë për Implementim të Politikave të ARRU dhe Procedurave Administrative
- Mbikëqyrjes së Kompanive Rajonale të Ujit, Planeve të Biznesit

Drejtimi i Politikës së ARRU pasqyrohet në vizionin e saj, misionin dhe parimet e punës së saj:

- Vizioni
 - Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.
- Misioni
 - Rregullimi i kompanive publike të ujësjellësit dhe kanalizimit në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikat më të mirat të Europës, me fokus të veçantë në promovimin e efikasitetit, transparencës dhe shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorëve, me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara, duke marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.
- Qëllimet strategjike
 - Zhvillimi dhe implementimi i kornizës rregullative e cila siguron ofrimin e shërbimeve cilësore me çmime të arsyeshme për konsumatorët e shërbimeve të ujit;
 - Mbrojtja afatshkurtër dhe afatgjatë e interesave të konsumatorëve duke siguruar se Ofruesit e Shërbimeve të Ujit nuk do të abuzojnë me monopolin e tyre dhe të ofrojnë shërbime në përputhje me standardet e vendosura dhe të duhura të shërbimit;
 - Vendosja e tarifave të ujit që ekuilibrojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të arsyeshme në njërën anë dhe mbrojtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimit;
 - Stimulimi i konkurrencës ndërmjet Ofruesve të Shërbimeve të Ujit duke krahasuar performancën e tyre;
 - Ngritja e transparencës dhe përgjegjësisë në sektorin e ujërave përmes monitorimit të performancës dhe raportimeve publike për performancën e demonstruar.
- Parimet udhëheqëse në kryerjen e misionit të vet dhe objektivat strategjike janë:
 - Balancimi: Përcaktim i tarifave të shërbimit të balancuar që:
 - Mundëson kompanitë e licencuara të ujit të ofrojnë shërbime në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante të shërbimit;
 - Marrja parasysh e mundësisë së konsumatorëve për të paguar.
 - Objektiviteti: Monitorim efektiv dhe vlerësim objektiv e gjithashtu punë transparente e kompanive të licencuara duke ofruar krahasime të performancës së duhur në baza vjetore.
 - Mbrojtja e interesave të konsumatorëve: Trajtimi efektiv dhe i drejt i ankesave dhe mosmarrëveshjeve të konsumatorëve duke i përfshirë Kompanitë e licencuara në këtë proces;
 - Konsultimi:
 - Konsultimi me palët në mbledhjen e informacionit në lidhje me pikëpamjet e tyre dhe prioritetet përmes shkëmbimit të informacionit, memorandumeve



të mirëkuptimit, organizimit të punëtorive të hapura, publikimit të raporteve relevante në ueb faqen e tyre, dhe përmes shtatë Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve;

- Ofrimi i këshillave në përpilimin dhe shqyrtimin e politikës
- Transparenca: Publikimi i informacionit në mënyrë të hapur dhe transparente që mundëson të gjitha palët që të kuptojnë dhe marrin pjesë në vendim-marrjen rregullative nga ARRU;
- Bashkëpunimi:
 - Bashkëpunimi me rregullatorët e tjerë në sektorin e ujërave në Kosovë (siç është MMPH dhe IKSHPK), në mënyrë që të sigurojë se përgjegjësitë e palëve të janë të definuara qartësisht;
 - Bashkëpunim i afërt me rregullatorët e tjerë ekonomik për shërbimet e ujit në regjion dhe Evropë, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe implementim të praktikave me të mira.
- Jo-diskriminimi:
 - Sigurimi se tarifat e shërbimit që u ngarkohen konsumatorëve janë të drejta dhe nuk imponohet ndonjë diskriminim apo demonstrojnë preferenca për ndonjë kategori të konsumatorëve.
 - Sigurimi që shërbimet e ofruara për ujë dhe ujëra të ndotura kryhen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese e gjithashtu çështjet gjinore dhe minoritare adresohen në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës.

4.8.2 Mjedisi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është autoritet kompetent kryesor për sektorin e mjedisit dhe mbështetet nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës.

Dokumentet kryesore të politikës në sektor janë:

- Strategjia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit: 2013 – 2022
- Plani Kombëtar I Veprimit për Mjedis: 2013 - 2017
- Strategjia dhe Plan i Veprimit për Biodiversitet 2011 – 2020

Përveç kësaj ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i Planeve Hapësinore për Interesat e Veçanta, duke përfshirë:

- Planet Hapësinore për Zonat me Interes të Veçantë: “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”, Instituti për Planifikim Hapësinorë, Prishtinë, shkurt 2012.
- Planet Hapësinore për Zonat me Interes të Veçantë Ekonomik: “Fusha e Re e Minerës”, Instituti për Planifikim Hapësinorë, Prishtinë, mars, 2011
- Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, Instituti për Planifikim Hapësinor, Prishtinë, shkurt, 2013

4.8.2.1 [Strategjia e Kosovës për Mjedis](#)

Strategjia e Kosovës për Mjedis (e azhurnuar në gjendje aktuale) identifikon objektivat për sektorin e ujërave si në vazhdim:

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit me *acquis* të BE-së;



- Administrimi i strategjive dhe planeve për pellgjet lumore;
- Ndërtimi i Impianteve për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUZ) dhe kanalizimeve përkatëse;
- Riparimi dhe ndërtimet e reja të rrjeteve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Menaxhimi për mbrojtjen dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve;
- Modernizimi i rrjeteve për monitorimin e ujërave sipërfaqësore;
- Krijimi i rrjetit për monitorimin e ujërave nëntokësore.

SKM me tutje identifikon prioritetet për sektorin e ujërave si në vazhdim:

- Hartimi i akteve nënligjore;
- Hartimi i strategjisë dhe planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore;
- Përmirësimi i sistemit të informacionit për ujin;
- Parandalimi i degradimit të ekosistemeve të lumit nga nxjerrja e zhavorrit dhe të rërës;
- Sigurimi i ujit nëpërmjet një strategjie të përshtatshme, duke përfshirë sigurimin e digave dhe rrjeteve të furnizimit me ujë, në mënyrë të tillë që aspekte të biodiversitetit janë të përfshira;
- Rritja e bashkëpunimit midis inspektorateve të ujit dhe të natyrës në zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së natyrës;
- Zbatimin e VSM dhe procedurave të VNM, sidomos kur janë planifikuar aktivitete që duhen ndërmarrë në ligatinat dhe zonat e mbrojtura ujore;

Ndërtimi urbane dhe rurale të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe ku është e mundur, duke përfshirë edhe vendbanimet joformale në rrjetet publike të kanalizimit dhe të furnizimit me ujë.

4.8.2.2 [Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedis](#)

Versioni i tanishëm i PKVM tregon se:

- “Në përgjithësi objektivat e përgjithshme janë për të zvogëluar ndotjen në nivele që përputhen me *acquis* e BE-së dhe standardet ndërkombëtare”

Në arritjen e këtij objektivi të përgjithshëm janë vendosur tri objektiva specifike:

- Objektivi 1. Fuqizimi i Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit
- Objektivi 2. Investimi në zonat kritike problematike
- Objektivi 3. Fuqizimi i informimit dhe vetëdijesimit

Sa i përket investimit në sektorin e ujit është theksuar se është mjaft kritike për t’u investuar në zonat urbane në ndërtimin e rrjeteve për ujë të pijshëm të sigurt dhe ITUZ.

Në periudhën afat shkurtër PKVM specifikon projektet e prioritetit të lartë në tri nivele: me kosto të lartë, të mesme dhe të ulët. Elementet me kosto të lartë janë paraqitur këtu.



Tabela 5 Investimet me prioritet të lartë dhe kosto të lartë për sektorin e ujërave: PKVM

1. Kanalizimi	Ndërtimi i infrastrukturës për impiante të mëdha të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUZ) në 7 qendra kryesore: përafërsisht 900 000 p.e.	MMPH MZHE PSP Komunat	€136 mln	60% donatorët 40% BK
2. Furnizimi me ujë	Riparimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në 7 qendrat kryesore për përafërsisht 600 000 persona	MMPH MZHE Komunat	€60 mln	60% donatorët 40% BK, PSP

Duhet cekur se është llogaritur përballshmëria e kostove të larta të këtyre investimeve në terma kapitale në raport me financat publike. Megjithatë, siç duket nuk është marrë në konsideratë përballshmëria e kostonë së operimit (tarifat e shpagimit të kostove) për konsumatorët.

4.8.2.3 Plani i Veprimit për Biodiversitet

Plani i veprimit për biodiversitet adreson një gamë të gjerë të sektorëve, duke përfshirë peshkatarinë dhe ujërat.

Për peshkatarin Plani i Veprimit specifikon prioritetet në vijim:

- Përcaktimi i kushteve të ruajtjes për biodiversitet në ligjet dhe dokumentet e peshkimit;
- Përmirësimi i kontrollit dhe ndërprerjes së peshkimit ilegal përmes bashkëpunimit të afërt ndërmjet MBPZHR dhe MMPH, Asociacioneve të peshkimit dhe OJQ;
- Data baza e stokut të peshqve; dhe
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve të ujit me shfrytëzim me të mirë të ushqimit natyral dhe ruajtjes së llojeve të peshqve.

Më tej, Plani i Veprimit i Strategjisë së Mjedisit specifikon prioritetet në vazhdim:

- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave dhe kontrollimin e qarkullimit të lumenjve duke shfrytëzuar treguesit për përtëritjen e biodiversitetit.
- Ndërprerja e shkatërrimit të ekosistemeve të lumenjve nga shfrytëzimi i rërës dhe degradimi i shtretërve të lumenjve dhe gjithashtu përmirësimi i menaxhimit të pellgjeve të lumenjve;
- Sigurimi i ujit përmes strategjisë së përshtatshme duke përfshirë sigurinë e digave dhe rrjetit të furnizimit me ujë në mënyrë që përfitimet të jenë më të mëdha nga biodiversiteti;
- Ngritja e bashkëpunimit ndërmjet Inspektorateve të ujit dhe të natyrës në implementimin e kushteve për mbrojtjen e natyrës;
- Implementimi i procedurave mjedisore për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit dhe Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe veçmas kur aktivitetet janë planifikuar dhe ndërmarrë në hapësirat ujore dhe në tokat e lagështa.

4.8.2.4 Agro-Mjedi

Edhe pse jo në mënyrë primare e lidhur me mjedisin, duhet të thuhet se Programi i Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (PZhBR), versioni i fundit i hartuar nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural–, specifikon “mjedisin” si objekt kryesor.

Ky program përfshinë masat në lidhje me një numër të çështjeve mjedisore duke përfshirë edhe ato të identifikuara për tu përputhur:

- Masa 2 – Ristrukturimi i potencialit fizik



- Investimi në: izolimin e ndërtesave; pajisje më e mirë për nxehe dhe zvogëlim i shfrytëzimit të drurit dhe koston për nxehe; gropave septike, trajtimit të ujërave të ndotura, mbajtja e hapësirave dhe cisternave për pleh; kompostimi në ferma
- Masa 3 – Burimet e ujit
 - Ruajtja e ligatinave dhe zonës vërshyese si pjesë e mbrojtjes nga vërshimet
- Masa 4 – Përpunimi i ushqimit
 - Kërkesa për menaxhimin mjedisor në fabrikat e përpunimit, energjia nga biomasa, ndarja e mbeturinave
- Masa 6 – Diversifikimi
 - Menaxhimi i turizmit rural, marketingu direkt i produkteve, përpunimi i drurit dhe leshit
- Masa 7 – Infrastruktura rurale dhe trashëgimia
 - Furnizimi me ujë, rrugët e mirëndërtuara, ujërat e ndotura, grumbullimi i mbetjeve, qendrat e komunitetit, objekte brezgjëra rurale

Në lidhje me tokat e lagështa duhet të identifikohen veprimet në vazhdim:

- Vendosja në hartë, mbrojtja e përrrenjve dhe ligatinave, mbrojtja nga kullimi, mirëmbajtja e rezervuarëve artificiale dhe pellgjeve të peshqve për zogjtë.

4.8.3 Politikat Shtetërore Ndërsektorale

4.8.3.1 Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015 – 2018

Seksioni 1.15 i Programit ka të bëjë me përmirësimin e mjedisit jetësor. Në lidhje me ujërat është përfshirë teksti në vazhdim:

- **Sa i përket shërbimeve adekuate të furnizimit me ujë ku të gjithë shfrytëzuesit do të kenë sasi të mjaftueshme të ujit cilësorë, Qeveria do të fokusohet në:**
 - Rritja e kapaciteteve të akumulimit dhe trajtimit të ujit
 - Stimulimi i përmirësimit të menaxhmentit të kompanive regjionale dhe lokale me qëllim të sigurimit të financimit direkt nga bankat zhvillimore që operojnë në Republikën e Kosovës.
 - Zgjerimi i mëtejshëm si dhe rehabilitimi i rrjetit në zonat rurale.
- **Mbrojtja e ujërave**
 - Në qendrat e mëdha urbane, që paraqiten si ndotës të mëdhenj të ujërave dhe lumenjve, do të fillojë implementimi i impianteve. Do të investohet edhe në liqenin e Batllavës dhe të Badovcit, me qëllim të evitimit të ujërave të zeza dhe ujërave të tjera ndotës. Fondet do të sigurohen nga buxheti, duke bërë riorientimin e investimeve, si dhe nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Qeveria, me ndihmën e donatorëve, ka
 - Gjatë katër viteve të ardhshme Qeveria do të sigurojë marrëveshje financimi për Prishtinën, Ferizajn, Gjilanin dhe Mitrovicën.
- **Rregullimi i përrrenjve dhe masat kundër erozionit:**
 - Mbrojtja e akumulacioneve ekzistuese,
 - Masat kundër erozionit në brigjet e ujërrjedhave,



- Rregullimi i rrjedhave ujore në zonat bujqësore.
- **Sigurimi i ujit për shfrytëzim:**
 - Do të bëhet zgjerimi i dy sistemeve kryesore, Ibër-Lepencit dhe Radoniqit, si dhe projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes, duke shfrytëzuar edhe një pjesë të madhe të lumenjve të Kosovës, siç janë: Drini, Lepenci, Ereniku, Lumbardhi, Sitnica, Drenica, Llapi dhe Morava.
 - Investime madhore për ndërtimin e akumulacioneve, të cilat do të kenë destinim ujitjen e tokave bujqësore, por edhe destinime të tjera. Do të fillojë rregullimi i lumenjve kryesorë, si dhe ndërtimi i akumulimeve mbi këta lumenj. Kjo do të mundësojë shfrytëzimin më të madh të tyre dhe do t'i parandalojë vërshimet. Gjithashtu, do të identifikohen të gjitha lokacionet e mundshme, në mënyrë që potenciali ujqor të shfrytëzohet edhe për prodhimin e energjisë elektrike, duke i plotësuar kriteret mjedisore dhe ato të BE-së.

Seksioni 1.2 trajton Sektorin e Energjisë dhe thekson si në vazhdim:

- Në mënyrë që të garantohet furnizim i sigurtë dhe i besueshëm i rrymës, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë mandatit të tanishëm qeverisës synon të vazhdojë me reformat në sektorin e energjisë si në vazhdim:
 - Zhvillimi i procedurave të tenderimit për ndërtimin dhe funksionalizimin e Hidrocentralit të Zhurit me kapacitet instalues prej 305 MW deri më 2019, me qëllim të ndërtimit dhe funksionalizimit në periudhën 2020-2024

4.8.3.2 [Deklarimi i politikave afatmesme prioritare 2017-2019](#)

Prioritetet e sektorit kanë rëndësi të drejtpërdrejtë në sektorin e ujërave ashtu si thuhet në deklaratën e cila është risjellë këtu:

1. Rritja Ekonomike

1.2 Zhvillimi i sektorit të bujqësisë

Ngritja e kapaciteteve konkurruese të bujqve

Ky prioritet do të arrihet me shtimin e prodhimeve bujqësore dhe kur bujqit plotësojnë standardet të cilësisë me të lartë të ushqimit. Për këtë qëllim, mbështetja për këtë prioritet është planifikuar të vazhdojë me:

- Intensifikimin e masave për rehabilitimin e sistemit të ujitjes

1.5 Energjia, minierat, telekomunikacioni dhe ndërmarrjet publike

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji.

... Politikat ekzistuese sipas kornizës strategjike dhe të planifikimit për sektorin e energjisë përfshijnë aktivitete të ndryshme siç janë:

- Implementimi i projektit të termocentralit Kosova e Re
- Vazhdimi i aktiviteteve për ndërtimin e HC "Zhur";
- Vazhdimi i aktiviteteve për dekomisionimin e termocentralit "Kosova A"

Reformimi dhe ristrukturimi i NP dhe ngritja e standardeve të shërbimit publik për qytetarët

- Gjatë kësaj periudhe është planifikuar puna për monitorimin e funksionalizimit të plotë të ndërmarrjes së re të Postës së Kosovës dhe implementimin të kontratës për privatizimin e PTK-së. Me rëndësi të veçantë është përmirësimi i furnizimit me ujë,



shtimi i kapaciteteve akumuluese dhe të prodhimit për furnizim me ujë përmes investimesh në sistemin rajonal të ujit të mbështetur nga partneret zhvillimor dhe Qeveria, duke mbështetur Kompanitë publike rajonale për të ndërtuar kapacitetet teknike që ofrojnë shërbime përmes investimeve direkte të MZHE. Qëllimi i Qeverisë është që vazhdimisht të zvogëlohen subvencionet për ndërmarrjet publike përderisa në të njëjtën kohë të përmirësohet performanca e tyre.

6. Shëndeti dhe Mirëqenia Sociale

6.3 Mbrojtja e mjedisit jetësor

Cilësia e mjedisit në Kosovë është shumë larg nga standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Ka probleme serioze në lidhje me cilësinë e ujit, menaxhimin e mbeturinave, ndotjen e ajrit, ndotjen e tokës dhe humbjet në biodiversitet, menaxhim i dobët i mbetjeve industriale dhe shfrytëzim jo i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

4.8.3.3 Plani Hapësinor për Kosovën 2010 – 2020+

Plani Hapësinor paraqet analizë të detajuar dhe të gjerë dhe një program të masave. Në veçanti:

Kapitulli 4 Strategjia dhe Veprimet e Zbatimit:

Shkoqitjet në vazhdim nga Plani Hapësinor janë paraqitur në formatin në vazhdim:

- Çështja
 - Qasja apo elementi
 - Veprimi
 - Veprimi Specifik
- Shkalla e lartë e ndotjes dhe degradimit të mjedisit
 - Aktivitetet për të arritur cakun për ujin janë:
 - Ndalimi me ligj i eksploatimit të inerteve nga shtretërit e lumenjve nga operatorët e pa-licencuar.
 - Ndalimi i shkarkimit të mbetjeve në shtretërit e lumenjve.
 - Standardizimi i deponive të mbeturinave.
 - Shfrytëzimi i plehrave kimike dhe pesticideve duhet të përputhet me standardet për minimizimin e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.
 - Sigurimi i mbrojtjes me efikase të groposjes së mbetjeve të rrezikshme që mund të shkaktojnë katastrofa në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore.
 - Secila ndërtesë apo aktivitet industrial, minierë, minierë e hapur duhet të ndërtojë impiant industrial duke u bazuar në aktivitetin ekonomik dhe të ndërmarrë pastrim të mbetjeve kimike dhe biologjike për ujërat dhe të shkarkoj ujërat e pastra në përrrenj.
 - Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura ndërtohen për të pastruar ujërat nga sistemet e kanalizimit të vendbanimeve.
 - Zonat ku ka nevojë për eksploatim të depozitave të materieve inerte trajtohen profesionalisht.
 - Ndalimi i ndonjë aktiviteti mekanik në shtratin e lumit nga makineria e operimit.



- Ndalimi i mjeteve të motorizuara dhe pajisjeve të tjera larëse në ujërat sipërfaqësore.
 - Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja nga të gjitha nivelet qeverisëse.
 - Ndalimi i shkarkimit të elementeve dhe mbeturinave që mund të rrezikojnë shëndetin e florës dhe faunës në lumenj.
 - Zbatimi i dënimeve rigoroze për ndotësit.
 - Monitorimi i deponive ilegale dhe vlerësimi i situatës aktuale.
 - Eliminimi i të gjitha deponive ilegale që mund të shkaktojnë ndotjen e ujërave.
 - Riparimi dhe gjithashtu ndërtimi shtresave agile dhe kanaleve kulluese për deponitë me qëllim për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.
 - Pastrimi i parkut industrial në Mitrovicë që është kërkesë urgjente pasi ky park është duke ndotur lumenjtë dhe ujërat nëntokësore me metale të rënda.
 - Kontrollimi strikt i shfrytëzimit të plehrave kimike dhe pesticideve në tokat bujqësore.
 - Ndalimi i shfrytëzimit të materieve kimike përgjatë brigjeve të lumenjve siç përcaktohet me ligj.
 - Ndalimi i shkarkimit në ujëra të çfarëdo substance kimike dhe biologjike e përdorur në bujqësi.
 - Ofrimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e rregullt e deponive me mbetje të rrezikshme veçmas të atyre në kompleksin e Trepçës, KEK-ut dhe Hanit të Elezit.
 - Trajtim i decentralizuar i ujërave të ndotura me të cilën të gjitha vendbanimet kanë impiant për trajtimin e ujërave të ndotura apo në rast të trajtimit të centralizuar të gjitha shtatë qendrat rajonale duhet të ndërtojnë impiantet e tyre⁴¹
- Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
 - Me qëllim të vendosjes së kontrollit në zonat e rrezikuara nga vërshimet, MMPH/Departamenti i ujërave në bashkëpunim me autoritetet kompetente për ekonomi, financa, bujqësi, pylltari, tregti, industri, shërbime publike, komunikime, transport, energji, zhvillim rural, banim, ndërtim dhe mbrojtje të mjedisit duhet të përpilojnë Planin për menaxhimin e vërshimeve me të vetmin qëllim për të minimizuar pasojat apo edhe për të minimizuar vërshimet. Plani duhet të përmbajë:
 - Bazën e të dhënave për vëllimet e prurjeve në lumenj.
 - Paraqitjen në hartë të zonave të rrezikuara përgjatë brigjeve të lumenjve dhe valës vërshuese të lumenjve me qëllim të monitorimit të përhershëm.
 - Sistemi i paralajmërimit dhe alarmimit për vërshimet

41 Plani Hapësinor gjithashtu riprodhon informacion nga studimi 2004 për ujërat e ndotura që tregon se 7 WWTP të mëdha duhet të ndërtohen dhe tregon se ekziston presion i 'madh' ndërkombëtar për impiantet në Prishtinë, Mitrovicë dhe Ferizaj.

- Caktimin i stafit në nivel qendror për paralajmërim të hershem, monitorim dhe alarmim.
- Përpilimi i planeve emergjente për vërshimet nga institucionet përkatëse për menaxhimin e krizave. Parandalimi i efekteve negative nga vërshimet përmes masave paraprake teknike.
- Ndërmarrja e masave teknike në brigjet e lumenjve apo në vetë shtretërit e lumenjve për të shmangur barrierat natyrore dhe barrierat e vendosura nga njeriu.
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zonat ku shtretërit e lumenjve nuk mund të përballojnë gjithë prurjet, me intervenime teknike (argjinatura me material natyror por edhe materiale të ngurta gjithashtu).
- Urbanizimi i brigjeve të lumenjve, bonifikimi dhe pyllëzimi si masa mbrojtëse.
- Mirëmbajtja e grykëderdhjeve përmes intervenimit natyror.
- Ndalimi me ligj i shfrytëzimit të tokës bujqësore përgjatë brigjeve të lumenjve që mund të shkaktojë ndikime rreziku për vërshime
- Ndalimi i të gjitha aktiviteteve ndërtimore në afërsi të brigjeve të lumenjve përveç atyre objekteve me karakter ekonomik (urat, digat, kanalet e kullimit etj) që nuk e rrezikojnë rrjedhën e lumit me vërshime. Parandalimin e shkatërrimit të florës përgjatë brigjeve të lumenjve përveç atyre që kanë ndikim negativ.
- Parandalimi i shkatërrimit të florës përgjatë shtretërve të lumenjve
 - Mbjellja e drunjve përgjatë shtretërve të lumenjve me qëllim të parandalimit të erozionit, vërshimeve dhe gjithashtu ofrimit të pamjeve natyrore sipas studimeve të mëhershme.
 - Parandalimi i eksploatimit të inerteve në brigjet e lumenjve.
 - Restaurimi i brigjeve të lumenjve sipas studimeve të mëhershme.
 - Parandalimi i ndryshimit të rrjedhës në shtratin e lumit.
- Erozioni
 - Zonat në të cilat erozioni ka intensitet të lartë dhe shkakton pasoja të rrezikshme për rrjedhjen e ujit, tokën, pyjet, objektet dhe gjërat tjera të palëvizshme, duhet të paraqiten si zona erozive që duhet të bëhen nga komunat sipas ligjit për Ujërat të Kosovës. Qeveria e Kosovës shpall zonat erozive vetëm kur ka të bëjë me një interes të madh nacional që ndikohet nga erozioni dhe përpilon masa mbrojtëse.
 - Parandalimi i erozionit është objektiv dhe detyrë e të gjithë shfrytëzuesve, shfrytëzuesve të tokës bujqësore, tokave malore, pyjeve, ujërave dhe aseteve tjera natyrore me qëllim të mbrojtjes së rrugës, vendbanimit, tokës bujqësore dhe të mirave tjera materiale. Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv, duhet të ndërmerren hapa të menjëhershëm dhe konkrete si në vazhdim:
 - Parandalimi i prerjes së pyjeve dhe degradimit të tyre,
 - Parandalimi i mbikullotjes,
 - Parandalimi i shfrytëzimit të mjeteve materiale që shkaktojnë erozion.
- Veprimet kundër erozive: për të ndaluar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të ndërmerren veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike.



- Masat Hidroteknike
 - Ndërtimi i terrasave, argjinaturave dhe digave në shtratërit e ujërrjedhave si masa mbrojtëse hidroteknike për të minimizuar fuqinë erozive.
 - Ndërtimi i argjinaturave përgjatë brigjeve të lumenjve.
 - Mbjellja e drunjve përgjatë shtretërve të lumenjve.
 - Parandalimi i eksploatimit të inerteve në brigjet e lumenjve.
- Masat bujqësore
 - Mirëmbajtja e tokës bujqësore,
 - Aplikimi i praktikave të duhura bujqësore,
 - Përdorimi i sistemit të ujitjes kullimit të bëhet sipas udhëzimeve të ekspertit,
 - Shtimi i investimeve për mbrojtjen e tokës përgjatë brigjeve të lumenjve.
- Masat biologjike
 - Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerja dhe zjarri pakontrolluar,
 - Parandalimi i kullotjes në zonat e zhveshura dhe me mungesë flore,
 - Pyllëzimi i djerrinave dhe hapësirave të degraduara,
 - Krijimi i brezave të gjelbëruara në regjionet ku ka mundësi me të lartë të erozionit,
 - Mbjellja përgjatë brigjeve të lumenjve, përrenjve dhe rrjedhjeve ku erozioni është aktiv.
- Lokacionet prioritare ku masat kundër erozionit duhet të ndërmerren:
 - Në pellgun e lumit Ibër, diku 947 km² apo 23% e pellgut janë me shkallën 1 ose 2 të incidencës.
 - Në pellgun e lumit Morava e Binçës diku 700 km² apo përafërsisht 41% janë të rrezikuar nga rreziku prej ishkalës 1 ose 2.
 - Në pellgun e Drinit të Bardhë diku 800 km² apo 24% e pellgut është i rrezikuar nga rreziku i shkallës 1 ose 2, dhe
 - Në pellgun e lumit Lepenc diku 230 km² apo 35% të pellgut është i rrezikuar me rrezikun e shkallës 1 ose 2.
 - Intervenimet hapësinore nga të dhënat e paraqitura në harta duhet të ndërmerren në një sipërfaqe prej 2620 km² që është e rrezikuar nga erozioni ekstrem dhe i fuqishëm.
 - Qeveritë komunale duhet të shpallin hapësirat e rrezikuara dhe të ndërmarrin masa konkrete kundër erozionit në bashkëpunim me MMPH, MBPZHR, Agjencinë e Pyjeve, MPS, MF, etj.
- Ruajtja, mbrojtja dhe eksploatimi racional i burimeve natyrore
 - Problemet që duhet të adresohen me urgjencë
 - Ndotja e ujit shkaktohet nga mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura nga industria
- Zhvillimi dhe integriteti i infrastrukturës dhe komunikimit (4.1.4)



- Zhvillimi i rezervave akumuluese të ujit në
 - Dragaçina - Komuna e Suharekës,
 - Kremenata – Komuna e Kamenicës,
 - Ponoshec dhe Ripaja – Komuna e Gjakovës,
 - Bistrica dhe Vaganica – Komuna e Mitrovicës,
 - Pollata dhe Majanci – Komuna e Podujevës,
 - Cecelia dhe Miroqi – Komuna e Vushtrrisë,
 - Drelaj dhe Kërstovci – Komuna e Pejës,
 - Mova – Komuna e Skenderajt,
 - Dobroshec – Komuna e Glllogvcit,
 - Makoc – Komuna e Prishtinës, Shtimes,
 - Reçan – Komuna e Prizrenit,
 - Firaja – Komuna e Shtërpçës, dhe
 - Binaq – Komuna e Vitisë
- Dispozitat implementuese
 - Kushtet për alokimin e hapësirave të objekteve të rëndësishme për Kosovën.
 - Ndërtesat e rëndësishme së veçantë lejohet të ndërtohen në rastin kur lejohet nga faktorët natyror ekzistues. Prioritet kanë hapësirat (lokacionet) ku ka infrastrukturë siç është: qasja e lehtë në rrugë, rryma elektrike, telekomunikacioni, furnizimi me ujë, kanalizimi etj.
 - Kushtet për vendosjen e aktiviteteve ekonomike në një hapësirë
 - Realizimi i parqeve të biznesit duhet të bazohet në kriteret e dhëna në vazhdim:
 - Potenciali për zhvillim, toka, infrastruktura e duhur (kanalizimi, uji, rryma elektrike, telekomunikacioni, nxemja),
 - Kushtet për caktimin e zonave të ndërtimit
 - Në mënyrë që të caktohen zonat për ndërtim, zonat prioritare ku infrastruktura e domosdoshme teknike ekziston si: qasja e lehtë në rrugë, rryma elektrike, telekomunikimi, uji dhe kanalizimi. Nëse nuk ekziston infrastruktura në afërsi, është e domosdoshme që para se të caktohet zona për ndërtime të ndërtohet së pari infrastruktura.
 - Kushtet (funktionale, hapësinore, ekologjike) të definimit të sistemeve të komunikimit dhe infrastrukturës tjetër në zonë.
 - Për të ndërtuar sisteme publike të furnizimit me ujë dhe kanalizime për ujëra të ndotura duhet të merret leje nga autoriteti i rajonit të pellgjeve lumore;
 - Për të ndërtuar impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura dhe kolektorëve për këto ujëra, leja duhet të merret nga autoriteti i rajonit të pellgjeve lumore;
 - Masat e mbrojtjes së vlerave natyrore dhe trashëgimisë historike
 - Planet hapësinore, planet rregullative dhe planet menaxhuese përmbajnë masa gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe kulturore si dhe



trashëgimisë historike në Kosovë. Për zonat e veçanta të deklaruara si zona të mbrojtura, planifikimi hapësinor dhe menaxhimi, MMPH zhvillon dhe përpilon plane rregullative në territorin e komunave që janë të vendosura në ato hapësira. Masat e parashikuara në planet e mësipërme janë në formën e përgjithësuar:

- Mbrojtja e lumenjve nga eksploatimi ilegal i zhavorit;
- Shfrytëzimi racional i ujërave nëntokësore;
- Masat për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis.
 - Lejet për ndërtimin dhe operimin e kapaciteteve industriale lëshohen vetëm me aplikimin e teknologjisë moderne për të mos ndotur ajrin, ujin dhe tokën;
 - Kapacitetet industriale që lëshojnë ujëra të ndotura industriale e të cilat mund të ndërtohen në të ardhmen duhet të kenë impiante për pastrimin e këtyre ujërave;
 - Ndalimi i shkarkimit të ujërave të ndotura në lumenj dhe liqene;
 - Në mënyrë që të mbrohen ujërat nëntokësore nga kontaminimi i mundshëm:
 - Duhet të ndërtohen sistemet për kanalizimin të ujërave të ndotura;
 - Uji duhet të kanalizohet në sistemin e veçantë të kanalizimit atmosferik;
 - Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet kullimit të ujërave atmosferike në varreza;
 - Deponitë ekzistuese ilegale duhet të eliminohen (shih dispozitën 5.9.), përderisa të rejat duhet të ndërtohen sipas standardeve evropiane në mënyrë që të parandalohet ndotja e tokës dhe ujit nëntokësor nga mbeturinat.

4.8.4 Politikat Tjera Sektoriale Specifike të Rëndësisë së Madhe

4.8.4.1 Energjia

Strategjia e Energjisë për Kosovën ofron informacion për gjendjen e përgjithshme të hidroenergjisë:

- Prodhimi i hidroenergjisë vjen kryesisht nga Hidrocentrali (HC) i Ujmanit me kapacitet prodhimi 35 MW dhe HC i Lumbardhit me kapacitet prodhimi prej 8.3 MW.
- Prodhimi i energjisë elektrike nga Hidrocentralet e Kosovës ka pësuar rënie nga 9.71 ktoe⁴² në vitin 2004 në 5.40 ktoe në vitin 2007, me ulje mesatare vjetore prej 23.7%

Strategjia nënvizon veprimet që tashmë janë ndërmarrë në lidhje me hidroenergjinë:

- Gjatë vitit 2006 është përgatitur një studim para-fizibiliteti në lidhje me potencialin hidrik, dhe në vitin 2008 është bërë vlerësimi i potencialeve të energjisë diellore si dhe të potencialeve të erës, biomasës dhe ujërave gjeotermale. Gjithashtu janë kompletuar projektet në vijim. Hartimi i procedurave tenderuese për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla (2008).

Ajo gjithashtu përcakton një sërë objektivash, duke përfshirë:

- Optimizimi i eksploatimit të të gjitha burimeve energjetike në dispozicion, duke përfshirë burimet vendore dhe të importuara; Kosova duhet të shfrytëzojë burimet e saj të bollshme të linjitet dhe të planifikojë shfrytëzimin racional të tyre për gjenerimin e rrymës elektrike .. Për

⁴² Kilo-tonë të ekuivalentit të naftës



me tepër, ajo gjithashtu duhet të shfrytëzojë racionalisht të gjitha burimet tjera energjetike në dispozicion, duke përfshirë hidroenergjinë dhe burimet tjera të energjisë së ripërtëritshme.

- Promovimi i vetëdijesimit për mbrojtjen e mjedisit në aktivitetet energjetike: Në përputhje me EnCT, Kosova zotohet të implementojë Acquis Communautaire për Mjedisin në lidhje me eksploatimin e burimeve të energjisë dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës energjetike.
- Sigurimi i përdorimit efikas të energjisë dhe nxitja e shfrytëzimit të burimeve të energjisë së ripërtëritshme: Kosova planifikon të promovojë eficiencën e energjisë dhe përdorimin e energjisë së ripërtëritshme si dy opsione të ndërlidhura të zhvillimit të qëndrueshëm që kontribuojnë në sigurinë e përgjithshme të furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit
- Plotësimi i kërkesës për energji është paraparë si në vijim:
 - (iii) Gjenerimi i energjisë nga Hidrocentrali (HC) i Ujmanit, i cili me mirëmbajtje dhe rehabilitim, mund të vazhdojë operimin e tij komercial për një kohë të gjatë;
 - (iv) Gjenerimi i energjisë nga HC i vogël (HCV) i Lumbardhit;
 - (v) Gjenerimi i energjisë nga Hidrocentrali i Zhurit, i cili pritet të ndërtohet;
 - (vii) Gjatë periudhës 2010-2018, mbi 16 HCV do të ndërtohen, ndërsa hidrocentralet e vogla ekzistuese do të rehabilitohen dhe do të kthehen në operim me kapacitet të përgjithshëm prej mbi 60 MW. Ndërkohë hidrocentralet e vogla ekzistuese do të rehabilitohen dhe do të kthehen në operim;
- Zhvillimi i kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë
 - Ndërtimi i HC të Zhurit me koncesion përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues;
 - Rritja e kapacitetit/ konvertimi në HC të kthyeshëm të Ujmanit;
 - Zhvillimi përmes koncesionit të HC-ve të vogla të reja përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues;
- Politika e implementimit (të Ripërtëritshmet)
 - Përgatitja e një programi mbështetës dhe stimulues për joshjen e investimeve të sektorit privat në zhvillimin e projekteve të EE (Eficiencës së Energjisë) dhe BER (Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme), në përputhje me qasjet Evropiane, është një burim tjetër i rëndësishëm i energjisë së ripërtëritshme (kryesisht hidrocentralet e vogla), si dhe krijimi i një fondi garantues për kreditë që investitorët do të merrnin nga bankat vendore për implementimin e EE dhe BER.
- Masat që duhet të ndërmerren
 - Implementimi i politikës së mësipërme dhe masave nga Qeveria;
 - Ndërtimi me koncesion i HC të Zhurit në përputhje me studimet e fizibilitetit, masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale dhe konsultimin me opinionin publik;
 - Identifikimi dhe para-vlerësimi i të gjitha hidrocentraleve me potencial të madh në Kosovë bazuar në strategjinë aktuale të energjisë;
 - Koncesionimi për ndërtim me investim të sektorit privat, përmes procedurave tenderuese transparente dhe konkurruese, të hidrocentraleve të vogla tashmë të identifikuara;
 - Zhvillimi dhe zbatimi i stimujve fiskalë për të promovuar eficiencën e energjisë dhe teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme.
- Masat Mbrojtëse Mjedisore



- Kosova është zotuar për të miratuar dhe implementuar standardet mjedisore të BE-së për të gjitha investimet e reja në sektorin e energjisë. Qeveria do të:
 - Forcojë menaxhimin e burimeve të ujit në përputhje me Ligjin për Ujëra të Kosovës dhe Direktivën e Kornizës për Ujëra të BE-së në mënyrë që të sigurohet furnizim i besueshëm me ujë për sektorët e banimit, industrisë, energjisë dhe bujqësisë.

4.8.4.2 Minierat dhe Mineralet

Minierat dhe nxjerrja e mineraleve janë në kuadër të kompetencave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Dokumentet kryesore të politikave në këtë fushë janë:

- Strategjia për Miniera e Republikës së Kosovës 2012 - 2025
- Programi Implementues për Strategjinë e Minierave 2015-2017

Strategjia e Minierave (f.32) merr në konsideratë burimet e rërës dhe zhavorrit, dhe thotë:

Ekzistojnë diku 110 prani dhe burime të rërës dhe zhavorrit. Nga ky numër, vetëm disa nga pranitë dhe burimet me të mëdha kanë përbërje të mjaftueshme minerale dhe granulare, që i bën ato të përshtatshme si lëndë e parë për prodhimin e betonit.

Rezervat e rërës dhe zhavorrit në Republikën e Kosovës janë të koncentruara në shtretërit e lumenjve kryesorë, dhe për shkak të aktiviteteve intensive të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit, një pjesë e peisazheve të këtyre lumenjve janë mjaft të dëmtuara.

Vlerësohet se sasia e përgjithshme e rërës dhe zhavorrit arrin në 331 Mm³. Pasi që ndikimet mjedisore të përpunimit të rërës dhe zhavorrit janë të rënda dhe për shkak të destinimeve të ndryshme të tokës ku janë të lokalizuara këto burime, ky aktivitet rezulton si pa perspektivë, dhe veprimet e tilla duhet të zëvendësohen me aktivitete me të favorshme në shfrytëzimin e silikateve të forta dhe gurëve karbonikë.

Megjithatë, duke qenë se shtresat dhe depozitat e rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve janë të ripërtëritshme (prurjet vjetore të lumit), lejimi i shfrytëzimit të tillë duhet të kufizohet dhe kushtëzohet me elaborime të detajuara dhe profesionale.

Vendimi Nr. 02/46 i datës 02.11.2011, i lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, ndalon shfrytëzimin e materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve, brigjet e lumenjve dhe zonat në afërsi të tyre në tërë Republikën e Kosovës. Ky vendim gjithashtu ka paraparë ndalimin e përkohshëm (3 vite) të të gjitha aktiviteteve të shfrytëzimit në lumenjtë dhe përreth tyre. Ky vendim konsiderohet si i domosdoshëm për ndalimin përfundimtar të degradimit të mëtejshëm të lumenjve.

Si përmbledhje, situata aktuale përfshin:

- Dëmtimin e lumenjve si pasojë e nxjerrjes së zhavorrit në të kaluarën
- Ndalimin e përkohshëm të nxjerrjes së mëtejshme të zhavorrit
- Zhvillimin e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të rërës dhe zhavorrit të lumenjve

Në lidhje me pikën e fundit, Strategjia për Minierat përfshin nën Objektivin IV.2. Mbrotjen e mjedisit nga aktivitetet e gërmimit, një masë e rëndësishme së veçantë:

- IV.2.4 Kryerja e një studimi mbi prurjet vjetore të materialeve inerte në lumenjtë kryesorë dhe përpilimi i një plani të përgjithshëm mbi mundësitë e shfrytëzimit të inerteve, nga këndvështrimi i mbrojtjes së mjedisit;



Programi Zbatues i Strategjisë së Minierave përfshin një numër të projekteve të rëndësishme, duke përfshirë:

- Rehabilitimin e zonave të degraduara të lumit Drini i Bardhë
- Rehabilitimi i parkut industrial në Mitrovicë: Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica

Megjithatë, duket sikur Programi Zbatues nuk përfshin studimin e përmendur më lartë (IV.2.4.).

4.8.4.3 Ujitja

MBPZHR aktualisht është duke zhvilluar Strategjinë e Ujitjes, e cila është akoma në draft version dhe prandaj nuk është shqyrtuar detajisht këtu.

4.8.4.4 Pylltaria

Dokumentet strategjike për sektorin e pylltarisë në Kosovë janë Ligji për Pyjet i vitit 2003, i amendamentuar në vitin 2004, dhe Politika dhe Strategjia për Pylltarinë, e pasuar nga Plani i Veprimit, që e mbulon periudhën 2010-2020, publikuar nga MBPZHR në vitin 2009.

Plani i Veprimit nënvizon aktivitetet kryesore gjatë një periudhë prej 10 viteve të ardhshme, me një përditësim të vazhdueshëm për të pasqyruar ndryshimet në shoqëri. Aktivitetet e Planit të Veprimit përfshijnë aspektet teknike, çështjet edukative, mjedisore, socio-ekonomike, industriale, etj. Duke marrë parasysh këtë kompleksitet, është e qartë se MBPZHR punon ngushtë me ministrinë tjera, duke përfshirë MMPH, gjatë implementimit të veprimeve të planifikuara.

Nuk ekzistojnë masa konkrete që janë paraparë në dokumentin ekzistues të Politikës dhe Strategjisë në lidhje me kapacitetet absorbuese ujëmbledhëse në mbrojtjen nga rreziku i vërshimeve, dhe zvogëlimi i erozionit. Prandaj, rekomandohet fuqishëm që këto masa të merren parasysh gjatë rishikimit të dokumentit të Politikës dhe Strategjisë nga MBPZHR. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me MMPH dhe komunat përkatëse, të cilët janë aktorët kryesorë gjatë implementimit të këtyre masave.

4.9 Sfidat Kyçe të Implementimit

Janë një numër i çështjeve kyçe për implementim që duhet të adresohen:

- **Transpozimi** i legjislacionit të BE-së nuk është i plotë,
- **Kapaciteti** për të zbatuar legjislacionin në nivelin qendror dhe lokal mbetet i dobët,
- **Buxheti** i alokuar për këtë sektor është i kufizuar, dhe
- Institucionet relevante për menaxhimin e ujërave kanë mungesë të **resurseve** të duhura njerëzore, administrative dhe kapitale për të implementuar dhe zbatuar kërkesat në mënyrë efektive, siç parashihet në Ligjin për Ujëra të Kosovës.
- Ka një mungesë të përgjithshme të resurseve njerëzore dhe financiare dhe **struktura institucionale** në nivelin lokal duhet të forcohet.

4.9.1 Lidhja e Legjislacionit me Procesin e Zhvillimit Institucional

Kërkesa për përgatitjen e Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës (SSHUK) është definuar në Nenin 31 të Ligjit për Ujërat dhe specifikon një horizont implementimi prej 20-vjetësh (2017 - 2036). I lidhur ngushtë me përgatitjen e SSHUK është zhvillimi i Planit të Veprimit dhe Investimeve për Ujëra (PVIU) për periudhën e njëjtë kohore.



Në mënyrë që objektivat e përcaktuara në SSHUK të arrihen dhe të sigurohet implementim efektiv i masave investuese siç janë paraqitur në PVIU, duhet të sigurohet një pajtim kombëtar për strukturën institucionale dhe procesin e ndërlidhur të zhvillimit të legjislacionit.

Në mbështetje të përafrimit të Kosovës me Bashkimin Evropian (BE) këshillohet përgatitja e një **strategjie realiste dhe afatgjatë** (një “udhërrëfyes”) për implementimin e legjislacionit të BE-së dhe kjo do të ndërlidhet veçanërisht me **përgatitjen e planeve menaxhuese për pellgjet lumore** (PMPL-ve) dhe **implementimin e kërkesave të BE-së për DKU-të**. Në mënyrë ideale, ky proces duhet të kryhet në lidhje me afatin kohor të Strategjisë për Ujërat e Kosovës (SUK) dhe kërkesat për planifikim të menaxhimit të pellgjeve lumore, siç është specifikuar në Ligjin për Ujëra të Kosovës në Nenet 31 dhe 32.

Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës do të kërkojë më tej zhvillimin e kushteve të përshtatshme të kornizës për implementimin e legjislacionit të BE-së për ujëra dhe mjedis **në nivel të pellgjeve lumore**: të gjitha këto në mbështetje të kërkesave për implementimin e DKU dhe DUP / DTUNU dhe në këtë mënyrë të krijohet baza për zhvillimin efektiv të Planeve Implementuese sipas Specifikave të Direktivave (PISD) në sektorët relevantë.

Lidhjet ndërmjet dispozitave të direktivave të ndryshme të BE-së duhet të merren në konsideratë sa më shumë të jetë e mundur gjatë procesit të zhvillimit të legjislacionit kombëtar.

Ka disa çështje ndërsektoriale në sektorët e ndryshëm të mjedisit (p.sh. laboratorët e monitorimit, pjesëmarrja e publikut, informimi mjedisor etj.) që duhet të merren në konsideratë së bashku, në mënyrë që të shfrytëzohet sa më mirë sinergjia në mes të burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare që karakterizojnë situatën aktuale të sektorit të ujërave në Kosovë - në veçanti një qasje e implementimit të përbashkët mund të jetë relevante për fushat e mëposhtme:

- **Monitorimi dhe Raportimi për Statusin e Mjedisit dhe Emetimet:** cikli i monitorimit përfshin aktivitetet nga mbikëqyrja në terren dhe marrja e mostrave, analizat laboratorike, sigurimi i cilësisë dhe kontrolli i cilësisë, ruajtja e të dhënave dhe përpunimi, vlerësimi dhe raportimi i të dhënave
Saktësia e secilit prej të gjitha këtyre aktiviteteve ndikon në rezultatin përfundimtar, dhe besueshmërinë e informacionit dhe të dhënave të shpërndara dhe të përdorura për përcaktimin e politikave sektoriale përkatëse.
- **Dhënia e Lejeve, Inspektimi dhe Zbatimi:** duhet të hartohen procedurat për dhënie e licencave me kërkesa të definuara qartë dhe kërkesa operative për inspektim dhe zbatim. Inspektoratet mjedisore duhet të pajisen me burime të mjaftueshme njerëzore dhe pajisje; duhet të sigurohet trajnimi në baza të rregullta për inspektorët, duke përfshirë informacionin e përditësuar për obligimet e reja që dalin nga procesi i transpozimit/implementimit të Direktivave Mjedisore të BE-së. Aktivitetet e inspektimit përfshijnë mbikëqyrjen në vendin e ngjarjes dhe kontrollin administrativ për përputhshmërinë me kushtet e lejeve, licencave dhe urdhërave të lëshuara nga Autoriteti/et Kompetente. Duhet të krijohet një sistem adekuat dhe proporcional i gjobave, dënimeve dhe përgjegjësisë penale për shkeljet e rënda.
- **Pjesëmarrja e Publikut dhe Përfshirja e Hisedarëve:** Në procesin e transpozimit dhe implementimit të *acquis* të BE-së – është e domosdoshme që të përfshihet publiku, dhe autoritetet relevante të niveleve qendrore dhe lokale.
- **Menaxhimi i të Dhënave dhe Informimi Mjedisor:** Promovimi i transparencës duke ofruar qasje në të dhënat mjedisore është një parim i rëndësishëm për tërë legjislacionin mjedisor; në mënyrë që të promovohet Ndërgjegjësimi Mjedisor, qasja në të dhënat mjedisore duhet të jetë e garantuar për hisedarët, autoritetet tjera dhe publikun e gjerë.

[Hartimi i Planit për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore të Kosovës](#)

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës- i publikuar me 29 prill 2013 - specifikon

- në Nenin 31 – përgatitjen e "Strategjisë Shtetërore për Ujëra": Strategjia Shtetërore për Ujërat duhet të hartohet për një periudhë kohore njëzet (20) vjeçare, me mundësi rishikimi dhe plotësimi në çdo pesë (5) vjet.
- në Nenin 32 – përgatitjen e një "Plani për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve". Plani për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve duhet të hartohet për periudhë gjashtë (6) vjeçare.
- Neni 110 më tutje specifikon: "Planet për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve duhet të nxirren në afat prej njëzetekatër (24) muajsh."

Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore të Kosovës në përputhje me DKU

Në pajtim me kërkesat e sipërpërmendura të Ligjit për Ujëra të vitit 2013 – është propozuar që të harmonizohen horizontet e planifikimit për përgatitjen e PMPL të parë të Kosovës 'në përputhshmëri me DKU' me Ciklin Planifikues të DKU të BE-së 2015 / 2021 / 2027 / 2033 / .

Afati 24 muajsh i përcaktuar në Nenin 110 për 'nxjerrjen' e PMPL konsiderohet shumë i shkurtër – pasi që shumë nga parakushtet (institucionale / administrative / teknike / financiare) për përgatitjen e një PMPL kuptimplotë ende nuk janë efektive.

Në anën tjetër Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës është përgatitur për një afat implementimi 20-vjeçar (2017 - 2036), dhe mund të pritët që Qeveria e Kosovës do ta aprovojë SSHUK-un (dhe Planin e Veprimit dhe Investimeve për Ujëra - PVIU) në vitin 2017.

Një objektivi specifik për përgatitjen e Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës ka qenë:

- "Të përkrahet Qeveria e Kosovës, në veçanti MMPH dhe Departamenti i saj për Ujërat, në hartimin e një Strategjie të unifikuar për Ujërat e Kosovës, një Plani të Veprimit dhe Investimeve në Ujëra për tërë Kosovën për të drejtuar planifikimin, identifikimin, priorizimin, dhe implementimin e investimeve në sektorin e resurseve ujore në dobi të popullatës duke ruajtur ndërkohë resurset dhe ekosistemet e ndërlidhura me to. "
- "Të zgjerohet dhe thellohet përafrimi i praktikave dhe standardeve të Kosovës në sektorin e resurseve ujore me ato të Direktivës së Kornizës për Ujëra të BE-së, dhe duke e bërë këtë të kontribuojë në progresin e Kosovës drejt procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE".

Në këtë kuptim, SSHUK ofron një elaborim të mëtutjeshëm të kushteve të kërkuara në kornizë për implementimin e legjislacionit të BE-së për ujëra dhe mjedis në nivel të pellgjeve të lumenjve (e gjithë kjo në mbështetje të kërkesave për implementimin e DKU dhe DUP / DTUNU dhe potencialisht në mbështetje të hartimit të Planeve të Implementimit Specifike për Direktivat (PISD) për sektorët përkatës).

- Direktiva Kornizë për Ujëra (DKU) e BE-së specifikon në Shtojcën e saj VII kërkesat për implementimin e PMPL për vendet anëtare të BE-së.
- Logjika e procesit të zhvillimit dhe planifikimit të SSHUK (dhe mbështetjes së monitorimit të cilësisë së ujërave – me rekomandime për rishikimin e programeve monitoruese) bazohet në strukturën dhe logjikën e kritereve të implementimit të DKU-së.
- SSHUK priorizon problemet dhe rekomandon zgjidhje teknike të përcjella me një vlerësim ekonomik për ato më të rëndësishmet.

4.9.1.1 [Drafti i parë i Planit për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore për Kosovën të përgatitet për vitin 2017](#)

(3) Drafti i parë i PMPL-të për Kosovën do të përgatitet për vitin 2017 / me përditësim dhe përgatitje të PMPL në përputhje me DKU të BE-së për vitet 2021 / 2027 / 2033 / 2039



Për implementimin e SSHUK, rekomandohet që të merret qasja e DKU; dhe sugjerohet që të harmonizohet cikli i PMPL të Kosovës sa më parë që të jetë e mundur me Ciklin e përgjithshëm të PLANIFIKIMIT të menaxhimit të pellgjeve lumoretë vendeve anëtare të BE-së në pajtim me DKU të BE-së). Kjo ndërlidhje e qartë dhe e fortë do të lehtësojë integrimin pasues të çështjeve tjera të menaxhimit të ujërave në PMPL të Kosovës; d.m.th. çështjet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave që (për shkak të mungesës së të dhënave dhe informatave jo të plota p.sh. për deponi të egra, nxjerrjen e zhavorit, ndotjen difuze nga bujqësia, industria, mbi-shfrytëzimin e pyjeve) nuk mund të shqyrtohen në mënyrë adekuate në kohën e përgatitjes së draftit të parë të PMPL, do të përditësohen/adresohen në PMPL-et e ardhshme.

Ndërvarësia në mes të SSHUK 2017 - 2036 me afatin kohor të mundshëm për përgatitjen PMPL të Kosovës është prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 28 Krahasimi i Orarit të Planifikimit për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve të Kosovës me Afatet Kohore të DKU-së.

Neni 31	Viti	Neni 32	DKU E BE-së
Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës SSHUK e parë (dhe PVIU përkatëse) të përgatitet për periudhën implementuese 2017 – 2036 / me rishikim dhe përditësim të SSHUK / PVIU në çdo pesë (5) vite		Planet e Kosovës për MPL (PMPL) PMPL Drafti i parë të përgatitet për 2017 / me përditësimin dhe përgatitjen e PMPL planeve të plota çdo gjashtë (6) vite Përgatitja e PMPL në përputhshmëri me DKU të BE-së për vitet 2021 / 2027 / 2033 / 2039	Cikli i Planifikimit për MPL sipas DKU të BE-së PMPL i parë i përgatitur nga Vendet Anëtare të BE-së për periudhën 2000 deri 2009 / me përditësime çdo gjashtë (6) vite
SSHUK 2017 – 2036 e përgatitur	2017		
	2017	Drafti i parë i PMPL-së për Kosovën	2015
Rishikimi / përditësimi i SSHUK	2021		
	2022	PMPL i parë i plotë për Kosovën	2021
Rishikimi / përditësimi i SSHUK	2026		
	2027	PMPL i dytë i Kosovës (i përditësuar)	2027
Rishikimi / përditësimi i SSHUK	2031		
	2033	PMPL i tretë i Kosovës (i përditësuar)	2033
Rishikimi / përditësimi i SSHUK	2036		
	2039	PMPL i katërt i Kosovës (i përditësuar)	2039

Pjesëmarrja e Publikut

Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara si dhe publikut të gjerë të prekur në procesin e përgatitjes, rishikimit dhe përditësimit të Planeve për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve (PMPL) duhet të inkurajohet. Secili PMPL duhet të publikohet dhe të jetë në dispozicion të publikut për komente. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligji për Qasje i mundëson publikut qasje në informata për dokumentet



publike. Në ligjin e ri për ujërat është mundësuar pjesëmarrja e publikut. Neni 84 parasheh pjesëmarrjen e publikut në hartimin e Strategjisë Shtetërore për Ujërat dhe Planit për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore, të cilat do të vihen në debat publik para finalizimit të tyre.

4.9.2 Legjislacioni për Ujëra - Zbatimi

Mbikëqyrja inspektuese e ligjit për ujëra kryhet nga ana e Ministrisë përmes Inspektoratit të Ujërave (e rregulluar nga ligji i shfuqizuar për ujërat me Nenet 78 – 91, Ligji Nr. 04/L-147, “për ujërat” Kapitulli XIII 93 – 108). Ligji themelon një Inspektorat i cili është i autorizuar të inspektojë objektet dhe pajisjet, të marrë mostrat, dhe të ndërmer masa zbatuese.

Instituti Hidro-meteorologjik është përgjegjës për marrjen e mostrave dhe analizimin e ujërave dhe efluentëve sipas metodave të përkruara të definuara me Nenin 51 të Ligjit të Mjedisit, i cili parasheh që Qeveria duhet të përcaktojë llojin e emetimeve, parametrat për cilësinë e mjedisit, metodologjinë e matjeve, marrjes së mostrave, etj.

Sipas nenit 50 të Ligjit për Mjedisin, Ministria duhet të sigurojë monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit. Kjo është kompetencë specifike e AKMM-së;

- Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.22/03 “për themelimin e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit”, AKMM është përgjegjëse për marrjen e të dhënave monitoruese nga IHMK, dhe nga KRU (Neni 5, paragrafi 2 “Përgjegjësitë e AKMM”, ndërsa IHMK është përgjegjës për analizën: rrjeti i monitorimit është në përputhje me kriteret e identifikuar në Direktivën Kornizëpër Ujëra (DKU) që kanë të bëjnë me ujërat sipërfaqësore por jo edhe me ato nëntokësore.

Të dhënat e mbledhura nga monitorimi do të përfshihen në Sistemin Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit (Neni 50 i Ligjit për Mjedisin);

- Lëshimi i autorizimeve apo lejeve për nxjerrjen e ujit nga një masë ujore apo për shkarkimin e ujërave të ndotura: Neni 110 i ligjit për ujëra parasheh në paragrafin 1 që secili person që kryen aktivitete në resurset ujore, më hyrjen në fuqi të këtij Ligji, brenda afatit prej gjashtë muajsh, duhet të parashtrojë një kërkesë në Ministri, për të marrë leje ujore;
- Aktivitetet monitoruese dhe inspektuese për t’u siguruar që kushtet e autorizimit apo lejes janë duke u respektuar, janë të parapara me Ligj;
- Marrja parasysh se kur dhe si të ndryshohen kushtet e lejes si pasojë e zhvillimeve të reja, informacionit shtesë dhe/apo efekteve negative mbi masat ujore në fjalë.

Dispozita për dhe aplikimi i gjobave dhe dënimeve të përshtatshme dekurajuese janë paraparë në Ligjin për Ujërat dhe në Ligjin për Mjedisin.

4.9.3 Aplikimi i Parimit të Shpagimit të Kostove

Neni 34 i Ligjit për Ujërat “Programi i masave” dhe Shtojca 1, A) “Planet për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve (PMPL) Nr. 9 dhe 11.2” dhe Nenet 85-92 “Burimet financiare” theksojnë së PMPL duhet të përmbajnë analizat ekonomike dhe një raport të hapave dhe masave praktike që duhet të ndërmerren për aplikimin e parimit për shpagimin e kostove të përdorimit të ujit në pajtim me Direktivën Kornizë për Ujëra (DKU) të BE-së 2000/60.

Duhet theksuar se parimi që ndotësit paguajnë është definuar në nenin 6 “Parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të Ligjit të Ujërave që është aktualisht në fuqi.



5 Performanca Aktuale e Sektorit

5.1 Shfrytëzimi i Ujërave

5.1.1 Furnizimi me Ujë

Republika e Kosovës është duke vazhduar të zhvillojë dhe zgjerojë sistemet e furnizimit me ujë. Sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë, mbi 97.8% e popullsisë ka qasje në sistem të ujësjellësit (ujë me gypa) brenda banesave të tyre.

Tabela 29 Mbulueshmëria me Sistem të Ujësjellësit (Regjistrimi i Popullsisë 2011)

Natyra e furnizimit	Njësi Banimi	Proporcioni
Uji me gypa nga sistemet publike	204,365	69.6%
Uji me gypa nga burimet tjera	82,609	28.2%
Uji me gypa brenda ndërtesës, jashtë njësisë banesore	899	0.3%
Uji me gypa jashtë ndërtesës	3,413	1.2%
Nuk ka ujë me gypa	2,157	0.7%
Gjithsej	293,443	100.0%


Shumica dërmuese e këtyre pronave furnizohen nëpërmjet sistemeve publike të menaxhuara nga Kompanitë Rajonale të Ujit (afër 70%), ndërsa pothuaj 10% furnizohen nga sistemet furnizuese të ujit që nuk menaxhohen nga KRU-të. Rreth 18% kanë furnizimet e tyre individuale. Ekziston dallim i madh i nivelit të lidhjes në sistemin publik të furnizimit në zonat urbane (pothuaj 99%) dhe zonat rurale (61%). Shumë nga pronat që nuk janë të lidhura në sistemet e furnizimit publik janë relativisht të largëta.

Standardi i operimit për shumicën e sistemeve të furnizimit me ujë është mjaft i mirë, edhe pse akoma nuk i plotëson objektivat e caktuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i sistemeve të vogla rurale, që mbulojnë pothuaj 3.8% të popullsisë, aktualisht nuk funksionojnë, siç edhe është theksuar në Studimin e Mbulueshmerisë, të financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, gjatë vitit 2014.

Për ato sisteme që operohen nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, respektimi i kërkesave për cilësinë e ujit të pijshëm, si për parametrat mikrobiologjikë ashtu edhe për ata fiziko-kimikë, në përgjithësi është i lartë (mbi 95%), por disa zona akoma ballafaqohen me probleme të vogla. Pothuajse të gjitha lidhjet në furnizimin me ujë janë duke u matur (mbi 89% dhe kjo është në rritje).


Disa sisteme publike të furnizimit me ujë që operohen nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit akoma nuk kanë arritur furnizimin 24 orësh në të gjitha rastet.

Figura 13 Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit – Vazhdueshmëria e Furnizimit në 2015



Kjo është për shkak të faktit se pjesë të mëdha të rrjeteve të furnizimit me ujë përbëhen nga gypat që janë instaluar më shumë se 30 vite më parë dhe të cilët kanë nevojë për zëvendësim. Ashtu sikur është cekur në Raportet për Performancën Vjetore për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, nevoja për zëvendësimin e gypave është ende mjaft e madhe. Ky problem evidentohet me tutje nga nivele të larta të ujit të pa-faturuar (rrjedhjet dhe humbjet) nga sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm.

Figura 14 Uji i Pa-pafaturuar që humb nga Sistemet e Furnizimit me Ujë të Pijshëm



Siç u tha me lartë, shumica dërmuese e ujit të furnizuar nga sistemet publike të furnizimit janë në përputhje me kërkesat e Direktivës për Ujë të Pijshëm (98/83/EC) të Bashkimit Evropian. Megjithatë një numër i masave janë të nevojshme për të përmirësuar monitorimin e cilësisë së ujit të furnizuar dhe, me e rëndësishmja, duhen investime për të siguruar kapacitete të vazhdueshme për ti plotësuar këto standarde.

Mesazhi Kryesor

Ekziston një mbulueshmëri e lartë me sisteme të furnizimit publik me ujë në zonat urbane, por kjo është shumë më e ulët në zonat rurale. Edhe pse uji i furnizuar është përgjithësisht i cilësisë së mirë, ende ka zona që nuk kanë furnizim 24 orësh dhe nivelet e humbjeve të ujit mbesin të larta (rreth



56%). Pjesët me të vjetra të rrjetit furnizues kanë nevojë për zëvendësim të vazhdueshëm në mënyrë që të zvogëlohen humbjet dhe të rritet efikasiteti financiar dhe i resurseve.

Tabela 30 Prodhimi i Ujit i Raportuar nga ana e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (Raporti i Performanës për 2015): 000 m3 për vit

000m3	2015	MIT	FE	GJA	GJI	PE	PR	PZ	KRU-të
Prodhimi		23,154	7,481	13,721	8,535	25,559	41,282	17,308	137,044

Konsumi total nga ana e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit vlerësohet përafërsisht 140 milion metra kub për vit.

5.1.2 Ujitja-gjendja aktuale

Që nga viti 1999, kushtet ekonomike për prodhimin bujqësor dhe për operimin e sistemeve të ujitjes institucionale dhe jo-institucionale (jo ligjore) kanë ndryshuar rrënjësisht. Produktiviteti bujqësor është i ulët; cilësia e prodhimeve varion shumë, qasja në treg është kryesisht e kufizuar brenda kufijve të Kosovës, dhe shumë njerëz kanë zgjedhur të braktisin bujqësinë në favor të punësimit më të levërdishëm kryesisht në ndërtimtari dhe tregti. Kështu një pjesë e madhe e tokës e cila me parë është punuar dhe ujitur është lënë anash, si djerrinë, dhe kështu ka mbetur joproduktive. Një politikë dhe strategji bujqësore që promovon ndryshimin dhe që ka për synim zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural është duke u zhvilluar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Për më tepër, në vitet e fundit është parë një shtrirje e gjerë dhe kryesisht jo e kontrolluar e aktiviteteve ndërtimore në tërë Kosovën dhe në tokën bujqësore. Intensitetet e ndërtimit janë më të mëdha përreth qendrave urbane dhe pak më të vogla në zonat rurale. Shtëpitë e banimit dhe ndërtesat tjera shpesh janë ndërtuar në tokën bujqësore, duke përfshirë edhe atë me infrastrukturë të ujitjes dhe të menaxhuar nga ofruesit institucionalë të ujitjes.

Sistemet e ujitjes në Kosovë janë duke u ballafaquar me problemin e infrastrukturës së vjetëruar dhe me rënie të të ardhurave për mirëmbajtje dhe riparim të objekteve të ujitjes. Të hyrat e përgjithshme të mbledhura nga biznesi i ujitjes nuk mund të mbulojnë as kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes e as kostot e investimeve kapitale. Përgjithësisht shërbimi i ujitjes subvencionohet.

Një problem tjetër serioz me të cilin ballafaqohen kompanitë e ujitjes është numri i madh i sistemeve të vogla ilegale të ujitjes. Ka pak informacion nga kompanitë e ujitjes për skemat e tilla, përveç kur bujqit individualë apo grupet e tyre marrin iniciativë dhe paraqiten. Këto sisteme janë ndërtuar me iniciativë të një individi apo grupi të bujqëve lokalë.

Ujëmatësit kryesorë janë instaluar në dalje të burimit të ujit, por jo gjithmonë.

Nuk ka ujëmatësa të veçantë të instaluar në pronën (tokën) e shfrytëzuesve të ujit. Në këtë rast uji i përdorur për ujitje bazohet në kalkulimin që përdor parametrat teknikë të vlerësimit të ujit të nevojshëm për një hektar, varësisht nga kultura e mbjellur.

Megjithatë, bujqësia mbetet një element kyç i ekonomisë (13% e BPV) dhe punësimit (së paku 4.6%)⁴³. Mirëpo, Kosova mbetet një neto importues i ushqimit dhe kafshëve të gjalla⁴⁴. Siç theksohet në Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitet 2014 – 2020, konkurrenca e shtuar është një

⁴³ Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të Kosovës 2012 – Agjencia e Statistikave të Kosovës, shtator 2013, Tabela 1.6B. Megjithatë është e njohur se një pjesë e madhe e punësimit në bujqësi është “joformale”, ashtu si thuhet në seksionin 5 të Studimit.

⁴⁴ Statistikat e Tregtisë së Jashtme nga SITC – Agjencia e Statistikave të Kosovës



objektiv kyç. Një nga mangësitë e identifikuar për zhvillimin e bujqësisë është sistemi i dobët i ujitjes, i kufizuar në shtrirje dhe në teknologji. Prandaj, rehabilitimi i ujitjes duhet të mbështetet nga Qeveria e Kosovës.

Tabela 31 Klasifikimi i Tokave Bujqësore sipas Pellgjeve të Lumenjve

	Kosova		Drini i Bardhë		Ibri		Morava e Binçës		Lepenci	
	km ²	km ²	%	km ²	%	km ²	%	km ²	%	
Klasa I	1,098	349	32%	648	59%	96	9%	5	0.5%	
Klasa II	579	315	54%	132	23%	45	8%	86	15%	
Klasa III	325	129	40%	123	38%	51	16%	23	7%	
Klasa IV	661	474	72%	130	20%	37	6%	20	3%	
Klasa V	68	48	71%	15	22%	5	7%	0	0%	
Klasa VI	102	22	22%	67	66%	12	12%	0	0%	
Gjithsej	2,833	1,339	48%	1,114	38%	246	9.5%	134	4.2%	

Niveli i mbulueshmërisë me ujtitje është tani shumë më i ulët se në të kaluarën, dhe ekziston potencial i konsiderueshëm për shfrytëzim të shtuar të ujitjes për të mbështetur prodhimin e kulturave me vlerë të lartë.

Tabela 32 Skema e Ujitjes, Mbulueshmëria sipas Skemës

Skema	Sipërfaqja e pajisur (ha)	Sipërfaqja e ujitur 2004-2016 (ha)	Sipërfaqja e ujitshme (ha)
Ibër Lepenc	20,000	2,500	14,500
Radoniqi	8,600	4,700	5,000
Dukagjini	5,000	800	2,500
Drini Bardhë Peja	6,500	1,300	2,500
Istog	8,500	1,350	2,000
Lumi Bardhë	8,500	1,650	3,000
Gjithsej	57,100	12,300	29,500

Tabela 33 Sipërfaqet e Raportuara që ujitën nga tri Kompani Publike⁴⁵

Kompanitë e Ujitjes	2012	2011	2010
KU "Radoniqi – Dukagjini" SHA	5,176	5,216	5,012
KU "Drini i Bardhë"	955	918	750
HS Ibër – Lepenci	1,860	1,647	1,271
Gjithsej	7,991	7,781	7,033

Raportet e ofruesve kryesorë të ujitjes tregojnë se në vitin 2014 sipërfaqet e ujitura nga skemat e tyre kanë qenë rreth 7,200 hektarë. Ujitja shtesë që bëhet përmes ofruesve të tjerë të skemave më të vogla vlerësohet se ofron ujtitje për rreth 4,000 hektarë.

Konsumi i ujitit i raportuar nga tri Kompanitë Publike kap kufijtë prej 1.7 – 33 milion metra kub për vit.

Tabela 34 Furnizimi i Raportuar i Ujit nga Kompanitë Publike⁴⁶

Kompania e Ujitjes	2014
KU "Radoniqi – Dukagjini" SHA	5,134
KU "Drini i Bardhë"	631
HS Ibër - Lepenci	1,490
Gjithsej	7,255

⁴⁵ Raportet e Performancës Vjetore të Ndërmarrjeve në Pronësi Publike-të Institucioneve Qendrore, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

⁴⁶ Raporti Vjetor i Performancës së Ndërmarrjeve Qendrore Publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik



Duke supozuar nivelin e njëjtë të konsumit të ujit për njësi të sipërfaqes për skemat tjera (që nuk operohen nga kompanitë e mëdha), mund të vlerësohet një nivel i përafërt i konsumit të ujit prej 150 milion metra kub.


Janë identifikuar disa çështje që kanë të bëjnë me ujitjen⁴⁷, duke përfshirë:

- Potencial i madh për zgjerim të ujitjes dhe rritje të vlerës së shtuar
- Eficiencë e ulët e përdorimit
- Ndotja e ujërave sipërfaqësore⁴⁸

⁴⁷ Drafti I Strategjisë për Ujitje

⁴⁸ Ju lutëm referojuni seksionit të mëposhtëm për Mbrojtjen e Ujërave

Figura 15 Sipërfaqet nën Ujitje



5.1.3 Hidroenergjia

Kosova gjeneron mbi 5,000 GWh energji elektrike, kryesisht nga termocentralet me thëngjill. Megjithatë, një pjesë e vogël e kësaj energjie është e ripërtëritshme dhe ende ka probleme për mbulimin e kërkesës në kohën e pikut.

Siç është cekur në **Strategjinë e Kosovës për Energji** hidroenergjia vjen kryesisht nga Hidrocentrali (HC) i Ujmanit me kapacitet të instaluar prej (2 x 17.5) 35 MW dhe HC i Lumëbardhit me kapacitet të



instaluar prej 8.8 MW. Tri skemat tjera të vogla të hidroenergjisë kanë kapacitet prej rreth 2 MW në total⁴⁹.

Tabela 35 Kapaciteti i Gjenerimit Hidro-elektrik të Energjisë⁵⁰

Njësitë gjeneruese	Kapaciteti i njësive të HC-ve (MW)		Viti i ndërtimit
	Instaluar	Neto	
Ujmani	35.00	32.00	1983
Lumëbardhi	8.80	8.00	1957 (2006)
Dikanci	1.34	1.32	1957 (2010)
Radavci	0.28	0.28	1934 (2010)
Burimi	0.48	0.47	1948 (2011)
Total hidrocentralet	45.90	42.07	

HC i Ujmanit operohet nga NPH Ibër-Lepenc.

HC i Lumëbardhit operohet nga Kelag International⁵¹.

Kelag po ashtu merr pjesë në zhvillimin e kapaciteteve të reja të impianteve hidrikoenergjetike përmes KelKos:

- Kaskada e Pejës (5 HC-të) për €120 Milion (60 MW)
- Kaskada e Deçanit (3 HC-të) për €55 Milion (23 MW)

Tabela 36 Gjenerimi i Elektricitetit nga Hidrocentralet (HC-të)⁵²

GWh	2007	2008	2009	2010	2011
HC	93.2	75.7	88.7	115.5	75.4
Gjithsej	4,309.5	4,505.8	5,260	5,481	5,696.4
HC/Gjithsej	2.2%	1.7%	1.7%	2.1%	1.3%

Ekziston potencial i konsiderueshëm për zgjerimin e gjenerimit të hidroenergjisë, ku mundësitë kryesore janë paraqitur në Strategjinë për Energji:

- Hidrocentrali i Zhurit (300 MW)
- 16 hidrocentrale të tjera të vogla me kapacitet total të instaluar prej 60 MW

Potencialet për akumulimet (rezervuaret) që do të ndërtoeshin për qëllimin (përdorimin) e dyfishtë të ofrimit të potencialit për hidroenergji dhe ofrimit të ujit për përdorime tjera (sidomos për ujitje) është një mundësi e mirë.

5.1.4 Shfrytëzimi i Ujit për Nevojat e Industrisë

Siç është raportuar në Raportin e Gjendjes së Ujërave 2015

- Industria konsiderohet si sektori më i madh i konsumit të ujit. Konsumatorët me të mëdhenj industrialë të ujit në Kosovë janë ndërmarrjet si KEK, New Co Feronikeli, Sharrcem etj.

Shumica e ndërmarrjeve industriale furnizohen nga ujërat sipërfaqësore nga liqenet akumuluese. Të dhënat tregojnë së ndërmarrjet e mëdha industriale (për nevojat teknologjike, të proceseve, ftohjes, atyre sanitare, etj.) konsumojnë me shume se 30% të sasisë së konsumit total të ujit në Kosovë.

49 Skema e katërt e vogël e hidroenergjisë është Prizreni

50 Deklarata për Sigurinë e furnizimit për Kosovën, Zyra Rregullatore për Energji, korrik 2011

⁵¹ http://www.kelag-international.com/content/page_eng_224_ENG_HTML.jsp

52 Bilanci i Energjisë së Kosovës (Q4 – 2011), Agjencia e Statistikave të Kosovës



Tabela 37 Konsumi i ujit për vitet 2007/2008 nga ndërmarrjet e mëdha industriale

Konsumatorët	Vitet	Konsumi i ujit			
		TCA		TCB	
KEK ⁵³		Konsumi (m ³)	Konsumi specifik (m ³ /MWh)	Konsumi (m ³)	Konsumi specifik (m ³ /MWh)
	2007	6,955,000	5.23	871,300	2.987
	2008	8,274,000	mes=6.12	9,330,057	mes=2.60
Sharrcem	Vjetor (m ³)	Kondicionimi i gazrave të furrës (m ³)	Ftohja e pajisjeve (m ³)	Nevojat sanitare (m ³)	Rastet speciale (m ³)
	113,661	29,565	43,800	18,396	21,900
New CO Feronikeli		Të dhënat sipas sistemit të faturimit nga hidro sistemi (HS) i Ibër- Lepencit (m ³)			
	2007	1,232,466			
	2008	3,604,560			

Këto industri kryesore shpenzojnë rreth 20 milion metra kub për vit.

Shumica e ndërmarrjeve të vogla industriale e përdorin ujin nga rrjetet publike të furnizimit me ujë, ndërsa vetëm një numër i vogël i tyre kanë sistemin e vet të furnizimit me ujë (puset). Tabela në vijim paraqet të dhënat për konsumin industrial të ujit në disa nga komunat e Kosovës.

Tabela 38 Sasia e ujit të konsumuar nga ndërmarrjet industriale në disa komuna dhe burimet e furnizimit të tyre

Komuna	Sasia e ujit të konsumuar m ³ / vit	
	Burimet vetanake të ujërave nëntokësore (puset) dhe nga sistemi i furnizimit me ujë	Sistemi publik i furnizimit me ujë
Deçan	-	1,000
Gjakovë	-	158,000
Istog	190,000	-
Klinë	22,000	-
Rahovec	-	54,000
Pejë	10,000	122,000
Prizren	4,000	163,000
Suharekë	-	809,000
Gjithsej:	226,000	1,307,000

⁵³ Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., Energetska Korporacija Kosova D.D., Kosovo Energy Corporation J.S.C.



5.1.5 Konsumi i Burimeve Ujore – Treguesit Përmbledhës

Vlerat e dhëna më lartë tregojnë vlerat e përafërta të konsumit të ujit, siç janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 39 Konsumi i Vlerësuar i Burimeve Ujore nga Sektorët Kryesorë

000 m3 për vit	Vëllimi	Proporcioni
Furnizimi Urban dhe Rural me Ujë	178,118	52%
Ujitja	140,193	41%
Industria	25,916	8%
Gjithsej	344,227	100%

Në përgjithësi kjo paraqet një shpenzim prej rreth 200 m³ për banor për vit.

Vlerat krahasuese të nxjerra nga Studimi i Bankës Botërore⁵⁴ janë dhënë më poshtë. Mund të shihet se ka një ndryshim të madh në konsumin specifik, që variron nga nivelet e gjetura në Kosovë në kufirin e ulët, deri të nivelet shumë më të larta (4 herë më shumë në rastin e Maqedonisë dhe Greqisë) ku industria apo bujqësia dominojnë konsumin e ujit. Mesatarja e përgjithshme për rajonin është dukshëm më e lartë se ajo në Kosovë, që sugjeron se kërkesa do të mund të rritej dukshëm në të ardhmen.

Tabela 40 Vlerat Krahasuese të Përdorimit Specifik të Ujit në Rajon

	Viti	Shfrytëzimi i Ujit	Popullsia	Shfrytëzimi Specifik	Shfrytëzimi Mbizotërues
		Miliard m3	Milion	m3/p/a	
Shqipëria	1995	0.93	3.20	291	Bujqësia
B&H	1990	0.80	4.00	200	Balancuar
Bullgaria	1997	3.10	8.00	388	Industria
Kroacia	1996	1.82	4.65	391	Industria
Maqedonia	1996	1.75	2.03	862	Ujitje
Greqia	2000	8.84	10.56	837	Bujqësia
Hungaria	1995	6.70	9.97	672	Industria
Moldavia	1996	1.77	4.30	412	Industria - Energjia
Rumania	1990	8.57	22.44	382	Bujqësia dhe Industria
Serbia dhe Mali i Zi	1997	8.40	10.55	796	Industria
Slovenia	1997	0.33	1.90	174	Amvisëritë
Gjithsej		43.01	81.60	527	

Disponueshmëria e burimeve është e ndryshme në territorin e Kosovës. Siç është paraqitur në tabelën në vijim, zonat në perëndim të vendit kanë me shumë ujë, por kanë dendësi me të vogël të popullsisë. Niveli i mungesës së ujit në këto zona është më i ulët. Në lindje të vendit reshjet atmosferike janë më të ulëta dhe dendësia e popullsisë është më e lartë, që rezulton në nivele më të larta të mungesës së ujit.

Kalkulimet e paraqitura më poshtë nuk marrin parasysh rezervat nëntokësore të ujit dhe ndikimin e rezervave të tilla në disponueshmërinë e resurseve. Siç është rasti edhe me burimet tjera të ujit, ujërat nëntokësore janë më të bollshme në pjesën perëndimore se në atë lindore të vendit.

⁵⁴ Menaxhimi i Burimeve të Ujit në Evropën Jug-lindore, IBRD, 2003,



Tabela 41 Bilanci i Ujërave dhe Vlerat e Treguesve të Mungesës së Ujit

Pellgu i Lumit		Drini i Bardhë	Plava	Lepenci	Morava e Binçës	Ibri
Spërfaqja	(km ²)	4,519	252	582	1,546	4,009
Popullsia ⁵⁵	Nr.	670,000	35,000	160,000	190,000	725,000
Dendësia i Popullsisë	/km ²	148	139	275	123	181
Qarkullimi i Ujërave						
Reshjet Vjetore	(mm/v)	839	1,076	842	677	693
Reshjet vjetore, P	(Mio m ³ /v)	3,791	271	490	1,046	2,778
Prurja mesatare vjetore ⁵⁶	(m ³ /s)	61.01	4.71	8.70	10.80	32.60
Rrjedhja Q	(Mio m ³ /v)	1,924	149	274	341	1,028
Rrjedhja, Q	(mm/v)	426	589	471	220	256
Rrjedhja/Reshjet Q/P	%	51%	55%	56%	33%	37%
Kërkesa e Prurjes Minimale ⁵⁷	(Mio m ³ /v)	443	34	63	78	236
Resurset për një person	m ³ /p/v	2,211	3,268	1,320	1,380	1,092
Vlerat e Treguesit Falkenmark⁵⁸						
Pa Mungesë, > 1700	m ³ /c/y					
Mungesë, > 1000 - 1700 <	m ³ /c/y					
Mungesë e theksuar, < 1000	m ³ /c/y					
Mungesë absolute, <500	m ³ /c/y					
Vlerat e Indeksit të Shfrytëzimit të Ujit						
Shfrytëzimi për person	m ³ /c/y	237	-	185	154	177
Indeksi i Shfrytëzimit të Ujit	%	11%	0%	14%	11%	16%

Sipas Treguesit Falkenmark, pellgu i Ibrit është identifikuar të ketë mungesë më të madhe të ujit. Duke marrë parasysh së në pellgun e Ibrit ka një koncentrim të madh të industrisë (duke përfshirë KEK-un dhe FerroNikelin), niveli i mungesës së ujit është dukshëm më i madh se sa që tregohet nga treguesi Falkenmark, i cili supozon se kërkesa për ujë është e shpërndarë në mënyrë të barabartë për tërë popullatën.

Agjencia Evropiane e Mjedisit e përdor Indeksin e Shfrytëzimit të Ujit⁵⁹ (IShU), i cili shprehet si përqindje e burimeve të nxjerra krahasuar me burimet në dispozicion. Sipas shkallës për kokë banori për territorin e Kosovës si tërësi, IShU mund të vlerësohet si:

- Konsumi: 200 m³ për person / Resurset për person 1,600 m³ për person = 13%

Kjo është nën nivelin e standardit prej 20%, dhe prandaj nxjerrja aktuale e ujërave nuk është, në nivel të vendit, duke shkaktuar *stres ujqor*. Megjithatë, siç u tha më lartë, ka dallime të mëdha ndërmjet pellgjeve të ndryshme të lumenjve, ku vlerat e shfrytëzimit të ujit tregojnë mungesë shumë më të madhe për pellgun e Ibrit në krahasim me pellgjet tjera.

Janë vlerësuar faktorët kyç që mund të ndikojnë në disponueshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve në të ardhmen.

⁵⁵ Vlerat e përafërta bazuar në Rezultatet e Regjistrimit të vitit 2011

⁵⁶ Vlerat nga stacionet e monitorimit në kufirin e poshtem të pellgut: IHMK dhe Raporti i Gjendjes së Ujërave 2010

⁵⁷ E kalibruar për të bërë korelacionin me vlerësimin kombëtar të resurseve ujore të disponueshme prej 1,600 metra kub për person për vit

⁵⁸ Shihni për shëmbull [Brown and Matlock](#), Një Shqyrtim i Indekseve dhe Metodologjive të Pamjaftueshmërisë së Ujit, prill 2011, Konsorciumi për Qëndrueshmëri

⁵⁹ EEA Raport Nr 2/2009, Burimet e ujit në Evropë — përballjs me mungesën e ujit dhe thatësinë



Parashikimet për klimën deri në vitin 2050⁶⁰ tregojnë së në vitin 2050:

- Temperatura mesatare vjetore do të rritet për përafërsisht 2 gradë celsius
- Rreshjet mesatare vjetore do të ulën për përafërsisht 15%

Ndikimi i përgjithshëm në burimet e disponueshme të ujit nga këto ndryshime do të jetë i madh dhe negativ. Zvogëlimi i burimeve të disponueshme mund të pritet të jetë për rreth 20%.

Parashikimet për popullsinë e Kosovës⁶¹ tregojnë që popullsia në të ardhmen deri në vitin 2051 do të jetë në nivelet e mëposhtme:

- Varianti i Lartë: 2,383,523
- Varianti i Mesëm: 1,859,447
- Varianti i Ulët: 1,398,626

Mesatarja e këtyre parashikimeve tregon për një rritje të mundshme të popullsisë prej +6% deri në mes të këtij shekulli.

Këto parashikime mund të përdoren për të dhënë një vlerësim të përgjithësuar për disponueshmërinë e mundshme të burimeve ujore duke supozuar që ndryshimet do të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjitha pellgjet e lumenjve (p.sh. ulja e përqindjes së rreshjeve, rritja e temperaturës dhe ndryshimi i përqindjes së popullsisë, janë të njëjta në secilin pellg).

Tabela 42 Vlerat e Burimeve Ujore në të Ardhmen (2050) sipas Pellgjeve

Pellgu i Lumit		Drini I Bardhë	Plava	Lepenci	Morava e Binçës	Ibri
Sipërfaqja	(km ²)	4,519	252	582	1,546	4,009
Popullsia ⁶²	Nr.	707,841	36,977	169,037	200,731	765,947
Dendësia i Popullsisë	/km ²	157	147	290	130	191
Qarkullimi i Ujërave						
Reshjet Vjetore	(mm/v)	713	914	716	575	589
Reshjet vjetore, P	(Mio m ³ /v)	3,222	230	417	889	2,362
Prurja mesatare vjetore ⁶³	(m ³ /s)	48.81	3.77	6.96	8.64	26.08
Rrjedhja, Q	(Mio m ³ /v)	1,539	119	219	272	822
Rrjedhja, Q	(mm/v)	341	472	377	176	205
Rrjedhja/Reshjet Q/P	%	48%	52%	53%	31%	35%
Kërkesa e Prurjes Minimale ⁶⁴	(Mio m ³ /v)	354	27	50	63	189
Resurset për një person	m ³ /p/v	1,674	2,474	1,000	1,045	827
Vlerat e Treguesit Falkenmark⁶⁵						
Pa Stres, > 1700	m ³ /p/v					
Stres, > 1000 - 1700 <	m ³ /p/v					
Mungesë e theksuar, < 1000	m ³ /p/v					

⁶⁰ www.climatewizard.org

⁶¹ Projektionet e Popullsisë së Kosovës 2011 – 2060, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Pristinë, dhjetor 2013

⁶² Vlerë e përafërt bayuar në regjistrimin e popullsisë me 2011

⁶³ nga stacionet e monitorimit në kufirin e poshtem të pellgut: IHMK dhe Raporti i Gjendjes së Ujërave 2010

⁶⁴ E kalibruar për të bërë korelacion me vlerësimin kombëtar të resurseve ujore të shfrytëzueshme në 1,600 metra kub për person për vit

⁶⁵ Shihni për shëmbull [Brown and Matlock](#), Një Shqyrtim i Indekseve dhe Metodologjive të Pamjaftueshmërisë së Ujit, prill 2011, Konsorciumi për Qëndrueshmëri



Mungesë absolute, <500	m ³ /p/v					
----------------------------------	---------------------	--	--	--	--	--

Siç është treguar më lartë, implikimet e vlerësuara të ndryshimeve klimatike dhe në popullsi ka të ngjarë se do të rezultojnë në nivele të mungesës së dukshme të ujit, ku si pellgu i Ibrit ashtu edhe ai i Lepencit do të bien në kategorinë “mungesë e theksuar e ujit” sipas treguesit Falkenmark.

Ndikimi i kësaj ulje teorike të burimeve ujore të disponueshme në disponueshmërinë aktuale të burimeve do të varet nga:

- Kërkesa specifike për ujë nga amvisëritë, institucionet dhe industria
- Efiçienca e shfrytëzimit të ujit
- Niveli i akumulimit të burimeve të ujit

Masat për adresimin e secilit nga këta faktorë konsiderohen si pjesë e reagimit strategjik të ndërlidhur me Kornizën Strategjike për Ndryshimet Klimatike të aprovuar në vitin 2014 nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor⁶⁶.

5.2 Mbrojtja e Ujërave

Mbrojtja e ujërave në masë të madhe përfshin marrjen parasysh të parandalimit të ndotjes nga tri burime: urbane, industriale dhe difuze. Një pjesë e legjislacionit të Bashkimit Evropian për mjedisin adreson çështjen e ndotjes së ujit duke përfshirë, në mes tjerash:

- **Direktiva Kornizë për Ujëra** (2000/60/EC) – vendos *objektivat mjedisore dhe proceset e planifikimit*
- **Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane** (1991/271/EEC) – kërkon *grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në aglomerate (zonat urbane me ekuivalentin e popullsisë prej më shumë se 2000 banorë)*
- **Direktiva e Azotit** (1991/676/EEC) – imponon *kufizimin e përdorimit në bujqësi të substancave që përmbajnë azot, ashtu që të kufizohet ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore me nitrate.*

5.2.1 Ujërat e Ndotura Urbane

5.2.1.1 Aglomeracionet Urbane

Duke reflektuar mbi shqyrtimet e mësipërme lidhur me kufizimet që e shoqërojnë analizën e shpërndarjes së popullsisë në bazë të kufijve administrativë, është realizuar një analizë gjeografike. Analiza, bazuar në të dhënat për përdorimin e tokës, ka përdorur të dhënat dhe imazhet satelitore për të identifikuar “aglomeracionet” (siç është përcaktuar me Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura).

Përderisa analiza nuk mund të jetë zëvendësim për një ekzaminim të detajuar të ndërmarrë në nivel të një projekti studimor, vlerësimi jep një përafrim të arsyeshëm që mund të përdoret për qëllime strategjike në nivel vendi. Rezultatet e kësaj analize janë përmbledhur këtu:

- 76 aglomeracione
- 440 vendbanime
- Popullsia e përgjithshme e përfshirë: 1.35 milion

⁶⁶ http://mmph-rks.org/repository/docs/Climate_Change_Framework_Strategy_19022014_FINAL_717626.pdf



Nga perspektiva strikte e Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (DTUZU) 26 nga aglomeracionet janë shume të vogla për tu marr parasysh për qëllime të përputhshmërisë (p.sh. me pak së 2,000 e.p.), që gjithsej na japin 50 aglomeracione për qëllime të DTUZU, me popullsi totale prej 1.32 dhe madhësi mesatare prej 26,366 banorësh.

Në shqyrtimin e kësaj analize, referencë i është bërë përputhshmërisë së të dhënave për DTUZU bazuar në raportet e Shteteve Anëtare të BE-së (shih WaterBase). Duke marrë parasysh popullsinë dhe madhësinë e Kosovës dhe duke aplikuar mesataret e BE-së, numri i aglomeracioneve që do të duhej “pritur” është vlerësuar si në vijim.

- Baza e popullsisë (1.78 milion / 25,715): 69 aglomeracione
- Baza e sipërfaqes (10,900 km² / 182): 60 aglomeracione

Megjithatë, siç u cek më lartë, Kosova ka dendësi relativisht të lartë të popullsisë dhe sipërfaqe të mëdha që janë “të pabanueshme”. Prandaj, do të pritej një numër më i vogël i aglomeracioneve me popullsi më të madhe se mesatarja. Draft vlerësimi i dhënë me lartë (50 aglomeracione me madhësi mesatare prej 26,366) duket së konsiston në mënyrë të arsyeshme me të dhënat e implementimit të dhëna me sipër.

Përshkrimet e aglomeracioneve janë përdorur si për qëllime të vlerësimit të rritjes së popullsisë në të ardhmen në nivel lokal (këtu më poshtë) ashtu edhe për vlerësimin e kostos së përputhshmërisë me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (Nevojat Zhvillimore).

5.2.1.2 Kanalizimet Shtëpiake

Kanalizimi i ujërave të ndotura urbane është, si në rastin e furnizimit me ujë, një shërbim publik i menaxhuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit dhe një numër i operatorëve tjerë shumë më të vegjël.

Tabela 43 Prezenca e tualeteve – Regjistrimi i Popullsisë në 2011

Ofrimi	Gjithsej	Proporcioni
Tualetet brenda njësisë banesore	257,428	87.7%
Tualetet jashtë njësisë banesore por brenda ndërtesës	6,327	2.2%
Tualetet jashtë ndërtesës	15,147	5.2%
Pa tualete	14,541	5.0%
Gjithsej	293,443	100.0%

Siç është prezantuar me lartë, shumica dërrmuese e shtëpive kanë tualete të një forme apo tjetër. Vetëm 5% e popullsisë nuk ka tualete standarde.

5.2.1.3 Grumbullimi i Ujërave të Ndotura

Megjithatë, niveli i lidhjes në shërbimet publike të grumbullimit të ujërave të ndotura është shumë më i ulët. Ashtu sikur është treguar në Raportet e Performancës Vjetore për Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit, vetëm 65% e amvisërive në zonën e shërbimit të KRU-ve janë të lidhura në sistemin publik të ujërave të ndotura (kanalizim).



Tabela 44 Vlerësimi i Mbulueshmërisë me Rrjetin e Kanalizimit – Raporti i Performancës 2015

KRU	Shtepi në zonën e shërbimit	Shtepi të lidhura	Mbulueshmeria
Ferizaj	21,659	17,327	80%
Gjakove	28,452	17,356	61%
Gjilan	32,386	16,517	51%
Mitrovica	33,937	17,308	51%
Pejë	38,855	14,765	38%
Prishtinë	92,888	82,670	89%
Prizren	53,952	31,292	58%
Gjithsej	303,438	197,235	65%

Ashtu si në rastin e furnizimit me ujë të pijshëm, edhe këtu ka një numër të sistemeve që ofrojnë shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura që nuk operohen nga KRU-të. Studimi i Mbulueshmërisë (ZZB, 2014) vlerëson se këto sisteme ofrojnë shërbime për rreth 16.2% të popullsisë, duke dhënë një total të mbulueshmërisë me sisteme të grumbullimit të ujërave të ndotura prej rreth 73%.

Përsëri, si në rastin e furnizimit me ujë të pijshëm, situata në zonat urbane dhe zonat rurale është mjaft e ndryshme:

- Mbulueshmëria e zonave urbane me grumbullim të ujërave të ndotura: 100%
- Mbulueshmeria e zonave rurale me grumbullim të ujërave të ndotura: 57%

Kërkesat e Direktivës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane janë specifikuar në termat e “aglomeracioneve” ashtu si përcaktohet në Nenin 2.4 të Direktivës:

- ‘aglomeracioni’ nënkupton një zonë ku popullsia dhe/ose aktivitetet ekonomike janë mjaftueshëm të koncentruara që ujërat e ndotura urbane të grumbullohen dhe të barten tek impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane apo në pikën e shkarkimit përfundimtar;

Në terma me të gjerë, kërkesat kryesore të Direktivës janë të aplikueshme për aglomeracionet që gjenerojnë një ngarkesë të ujërave të ndotura prej së paku 2,000 banorëve ekuivalent (b.e..). Ligji i ri për Ujërat në kuadër të Nenit 60 parasheh rregullimin e shkarkimit të ujërave të ndotura. Megjithatë, ende nuk janë përcaktuar aglomeracionet në përputhje me Ligjin. Për qëllimet e kësaj Strategjie, është bërë një përkufizim indikativ fillestar i aglomeracioneve.

Duke pasur parasysh kërkesat e Direktivës, është vlerësuar që aktualisht janë 50 zona urbane që do të konsideroheshin “aglomeracione të më shumë se 2000,00 b.p.,” sipas kësaj Direktive, me madhësi të shpërndarjes si në vijim.

Tabela 45 Numri dhe Madhësia e Vlerësuar e Aglomeracioneve sipas DTUZU

Klasa e madhësisë	Numri 2035	Popullsia 2011	Popullsia 2035	Popullsia 2050
>1,999 <10,000	32	120,719	136,484	121,171
>9,999 <50,000	12	379,720	365,826	353,782
>49,999 <10,0000	7	433,715	533,363	614,100
>99,999	3	384,166	589,330	624,662
	54	1,318,320	1,625,003	1,713,715

Sipas kësaj analize, të paktën 80% të popullsisë do të duhej t’i sigurohej një shërbim i centralizuar i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Duhet theksuar se:



- Këto vlera janë të krahasueshme me numrin dhe madhësinë e shpërndarjes së aglomeracioneve në zona të ngjashme me Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.
- Jo të gjitha sistemet aktuale të grumbullimit rural të ujërave të ndotura do të futeshin në kuadër të përkufizimit të aglomeracionit, por sipas kërkesave të Direktivës (Neni 7 dhe Neni 2.9) ujërave të ndotura të grumbulluara nga këto sisteme do të duhej t'u sigurohej "trajtim i përshtatshëm".
- Mund të ketë nevojë për grumbullim dhe trajtim shtesë të ujërave të ndotura në mënyrë që të plotësohen objektivat mjedisore të Direktivës së Kornizës për Ujëra apo për të mbrojtur shfrytëzimin e ujit nën pikat e shkarkimit të kanalizimit, sidomos nxjerrjen e ujit të pijshëm dhe ujitjen e kulturave me vlerë të lartë.

5.2.1.4 Trajtimi i Ujërave të Ndotura

Aktualisht ekziston vetëm një impiant për trajtimin e ujërave të ndotura urbane që operon në Kosovë, ai në Skenderaj, me një kapacitet prej rreth 8,000 b.e. Një numër i vogël i objekteve të vogla të trajtimit në zonat rurale janë gjithashtu duke operuar.

Megjithatë, janë ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për t'u përgatitur për implementimin e trajtimit të ujërave të ndotura në të gjitha qytetet kryesore, ku studimet e fizibilitetit janë kryer për Prishtinë, Gjakovë, Gjilan, Pejë dhe Prizren, Ferizaj dhe Mitrovicë. Punimet kanë filluar tashmë për ITUZ (Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura) të Prizrenit. ITUZ-ët e Gjakovës dhe Pejës janë gjithashtu në proces të inicimit.

Është gjithashtu me rëndësi të ceket se kostot e investimeve të ndërlidhura me implementimin e Direktivës dihet se janë të mëdha. Kostot e vlerësuara të investimeve në 12 vendet anëtare që i janë bashkuar BE-së në mes viteve 2004 dhe 2007 është €35 miliardë⁶⁷. Kjo përfaqëson një kosto investuese që është përafërsisht €340 për një banor. Një nivel i krahasueshëm i nevojës për investime mund të pritet në mënyrë të arsyeshme edhe në Kosovë.

5.2.2 Kanalizimi i Ujërave Atmosferike

Situata aktuale lidhur me grumbullimin, transferimin dhe shkarkimin e ujërave atmosferike nuk është mirë e dokumentuar. Në shume raste sistemet e grumbullimit të ujërave të ndotura në zonat urbane shërbejnë gjithashtu për kanalizimin e ujërave atmosferike (drenimi i ujërave urbane) d.m.th. sistemet e kanalizimit janë të kombinuara.

Sistemet e kombinuara të kanalizimit mund të paraqesin një numër problemesh, në veçanti për trajtimin e ujërave të ndotura. Për shkak të efikasitetit, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dizajnohen për të trajtuar vëllimin e "rregullt" (në kohën pa shi) të prurjeve të ujërave të ndotura. Megjithatë, gjatë kohës kur ka të reshura të mëdha të shiut, vëllimet e ujit që hyjnë në sistemin e kanalizimit mund të jenë më të mëdha se që sistemi mund ta përballojë. Në mënyrë që të shmangen përmbytjet, sistemet e grumbullimit pajisen me gypa shtesë për qarkullim të ujërave atmosferike që mundësojnë që prurja e tepërt të transportohet jashtë zonës urbane dhe të shkarkohet në një recipient. Ngjashëm, vëllimi i ujërave të ndotura që arrin në impiantet e trajtimit mund të jetë shumë më i madh se sa që është kapaciteti i projektuar, dhe kur arrihet kapaciteti i impiantit, atëherë uji i tepërt duhet të shkarkohet pa u trajtuar.

Zgjidhja alternative, ku ekzistojnë sisteme të ndara për ujërat e ndotura dhe për ujërat atmosferike, do ta shmangte këtë problem, por kjo bartë me vete kosto investuese dhe të mirëmbajtjes më të madhe për shkak të infrastrukturës shtesë. Për shkak të ndotjes që mund të ndodhë nga ujërat

⁶⁷ http://ec.europa.eu/environment/water/water-urbanwaste/implementation/factsfigures_en.htm



atmosferike urbane, ka një tendencë në rritje në Evropë që autoritetet rregullative të kërkojnë të paktën trajtimin bazik për së paku “vrullin e parë” të ujërave urbane.

Përcaktimi se cili lloj i sistemit është optimal në një zonë urbane varet nga rrethanat lokale, duke përfshirë madhësinë e zonës urbane, ujërat e recipientit lokal dhe potencialin investues. Në këtë moment vendimi në Kosovë dominohet nga kufizimet e fondeve në dispozicion. Me rastin e zhvillimit të projekteve investuese për kanalizimin atmosferik urban duhet të merret parasysh:

- Qasja për ndërtimin e sistemeve të reja të grumbullimit: të kombinuara, të ndara, hibride.
- Qasja për renovimin dhe riparimin e kanalizimeve ekzistuese.

Në rastin e zonave të reja zhvillimore, duhet të merret parasysh aplikimi i “sistemeve të qëndrueshme të kanalizimi urban”. Sistemet e qëndrueshme të kanalizimit atmosferik urban⁶⁸ projektohen për të zvogëluar masat e ujit të tepërt që krijohen shpejt nga pjesët e shtruara të papërshkueshme në hapësirat urbane dhe e bëjnë këtë duke lejuar infiltrimin e shiut përmes trotuareve të përshkueshme dhe kështu imitohet procesi i drenimit natyror dhe zvogëlohet vëllimi i ujit të shkarkuar në kanalizimin e ujërave sipërfaqësore.

5.2.3 Ujërat e Ndotura industriale

Shumë uzina të vogla industriale shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura në sistemet publike të kanalizimit të ujërave të ndotura. Disa industri më të mëdha po ashtu shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura në kanalizim, por shumë prej tyre i shkarkojnë ato drejtpërdrejt në mjedis.

Sipas dispozitave të Direktivës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane, shkarkimet në kanalizim nga industritë janë subjekt i rregullimit dhe kur është e domosdoshme i nënshtrohen para-trajtimit ashtu që të mos rrezikohet arritja e standardeve të përcaktuara të shkarkimit nga impianti për trajtimin e ujërave të ndotura.

Impiantet më të mëdha industriale rregullohen sipas ligjit të BE-së me Direktivën e Emetimeve Industriale (2010/75/EU). Kjo kërkon nga këto impiante që të aplikojnë teknologjinë më të mirë në dispozicion gjatë operimit të tyre, duke përfshirë konsumimin e ujit si dhe gjenerimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

5.2.4 Ndotja Difuze

Termi ndotja difuze i referohet pranisë së kontaminimit që rrjedh nga burimet e shpërndara (që janë e kundërta nga “burimet pikore”). Burimet më të shpeshta të ndotjes difuze të ujit janë:

- Bujqësia, duke përfshirë plehun nga kafshët, plehrat artificiale, pesticidet, baltën (nga erozioni)
- Kullimi i zonave urbane
- Depozitimi i ndotësve nga ajri
- Aktivitetet industriale, duke përfshirë hedhjen e produkteve të minierave dhe mbeturinave (të dyja po ashtu mund të shfaqen si burime pikore).
- Tokat tjera të kontaminuara (zonat e braktisura industriale, objektet ushtarake)

Informacioni i detajuar lidhur me nivelin e ndotjes difuze aktualisht nuk është në dispozicion. Megjithatë, duhet theksuar se Plani Zhvillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në kontekstin e marrjes parasysh të masave Agro-Mjedisore, thotë:

⁶⁸ Shih për shembull: www.susdrain.org



Ndikimi mjedisor i nivelit aktual të aktivitetit bujqësor në Kosovë vlerësohet se është më i ulët se sa në vendet fqinje. Përdorimi i plehrave dhe kimikateve bujqësore është i ulët (për shkak të çmimit të lartë të plehrave dhe mungesës së subvencioneve nga qeveria), dhe kështu nuk ndotin shumë tokën dhe ujërat nëntokësore.

Tabela 46 Përdorimi i Plehrave Minerale, 2008 – Anketimi i Ekonomive Familjare Bujqësore (Agjencia e Statistikave)

Kultura bimore	Sipërfaqe (ha)	Ton për vit	Kg/ha/vit
Drithërat	98,543	53,335	541
Perimet	11,613	7,748	667
Pemë (Drunj)	5,096	1,767	347
Bimë forrajere	104,763	13,262	127
Të tjera	319	84	265
Gjithsej	220,334	76,197	346

Sasia mesatare e plehrave të përdorur është 346 kg / ha. Kjo është pesha e “përgjithshme” e plehut të përdorur. Përbërja e lëndëve ushqyese në plehra nuk është cekur.

Tabela 47 Përdorimi i Plehrave Organike në Bujqësi, 2008 – Anketimi i Ekonomive Familjare Bujqësore (Agjencia e Statistikave)

Grupi i kulturës bimore	Sipërfaqja (ha)	Tonë Pleh Organik	kg/ha
Drithëra	98,543	284,281	2,885
Perime	11,613	98,686	8,498
Fruta	5,096	21,367	4,193
Bimë forrajere	104,763	221,203	2,111
Të tjera	319,	1,346	4,219
Gjithsej	220,334	626,883	2,845

Sasia mesatare e plehut organik të përdorur është 2,845 kg / ha, që është dukshëm më e ulët sesa nivelet e aplikimit në shumë Vende Anëtare të BE-së⁶⁹.

Duke supozuar se 20% e plehut artificial është Azot (ekuivalent me 70 kg për hektar), dhe 7 kg /T Azot (20 kg Azot për hektar) në pleh organik, kjo është e barabartë me shkallën e kombinuar të aplikimit prej rreth 90 kg për hektar, shumë më e ulët se pragu prej 170 kg i caktuar në Direktivën për Nitrate.

5.2.5 Ngarkesat e Ndotjes së Përgjithshme

Ngarkesa vjetore e ndotjes nga ujërat e ndotura urbane nga banorët dhe ndërmarrjet komerciale nga e tërë Kosova vlerësohet të jetë:

- 52,000 Tonë për Vit BOD₅
- 73,850 Tonë për Vit COD
- 52,000 Tonë për Vit TSS
- 10,400 Tonë për Vit N
- 2,100 Tonë për Vit P

⁶⁹ Shikoni p.sh.: <http://www.ramiran.net/doc98/FIN-POST/MENZI2.pdf>



5.3 Mbrotja nga Uji

5.3.1 Menaxhimi i Rrezikut nga Vërshimet

Vërshimet katastrofike rrezikojnë jetëra dhe shkaktojnë tragjedi njerëzore e gjithashtu edhe humbje të mëdha ekonomike. Vërshimet janë fenomene natyrore, por me masa të duhura është e mundur të zvogëlohet mundësia që ato të ndodhin dhe të kufizohet ndikimi i tyre. Përveç dëmeve ekonomike dhe sociale, vërshimet mund të kenë pasoja të rënda mjedisore, për shembull kur përmythen instalimet që mbajnë sasi të madhe të materieve kimike toksike apo shkatërrohen sipërfaqet e ligatinave. Në dekadat që vijnë ka të ngjarë të paraqiten rreziqe me të mëdha nga vërshimet në Evropë dhe dëme më të mëdha ekonomike⁷⁰.

Sipas vlerësimit të bërë në Master Planin për Ujëra të vitit 1983, një ngjarje e vërshimit në 100 vjet mund të kishte ndikim të dukshëm:

- Pellgu i Lumit të Drinit të Bardhë 50%
- Pellgu i Lumit Ibër 24%
- Pellgu i Lumit Lepenc 20%
- Pellgu i Lumit Morava e Binçës 6%

Ky vlerësim i mëhershëm vjen në përfundim së gjatësia e lumenjve në rrezik nga vërshimet në Kosovë është rreth 491 km. Përafërsisht 140 km është e rregulluar (28%).

Janë bërë një numër i vlerësimeve më të fundit specifike dhe të lokalizuara të rrezikut nga vërshimet, si në vijim:


- Analiza dhe Përgatitja e Hartave të Cenueshmërisë nga Rreziku (AHCRr), Vlerësimi i Rrezikut nga Vërshimet e Shpejta për Kosovën, nëntor 2012, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Fondet e Qeverisë së Luksemburgut
- Raporti i vlerësimit të shpejtë, identifikimi i komunave në nevojë të mbështetjes për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet dhe menaxhimin e rrezikut nga thatësitat në Shqipëri dhe Kosovë, REC, GIZ, gusht 2013
- Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike në Ballkanin Perëndimor, Krijimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershem për Vërshimet në Pellgun e Drini-Buna (DEWS), Studimi Vlerësues për Të Metat dhe Nevojat në Krjimin e DEWS, maj 2013, GIZ
- Vlerësimi i Nevojave të Përfituesve UNDP WMO 2011 (mbështetur nga BE-ja)
- Menaxhimi i Pellgjeve të Lumenjve – MMPH, BE
 - Raport për rrezikun nga vërshimet për zonën e vërshimit të Skenderajt
 - Plani indikativ i menaxhimit të rrezikut nga Vërshimet për Pellgun e Lumit Drin

Ashtu si është paraqitur në shifrat më poshtë, janë një numër zonash që janë identifikuar tashmë se janë në rrezik të lartë nga vërshimet.

⁷⁰ Komisioni Evropian, DG Mjedisi




Figura 16 Harta e Shpërndarjes së Nivelit të Rrezikut nga Vërshimet e Shpejta në Kosovë⁷¹



⁷¹ AHCRr Vlerësimi i Rrezikut nga Vërshimet e Shpejta – Figura 22

Figura 17 Vlerësimi preliminar i rrezikut nga vërshimet – Pellgu i Lumit Drini i Bardhë



Bazuar në punën e bërë deri më tani, vlerësimi paraprak i rrezikut nga vërshimet, siç parashihet nga Neni 4 i Direktivës për Menaxhimin e Rreziqeve nga Vërshimet (2007/60/EC), është pothuajse i përfunduar. Megjithatë, nevojitet një analizë e konsiderueshme e mëtejme në mënyrë që të përpilohen hartat plotësisht të përputhshme të kërcënimit nga vërshimet, hartat e rrezikut nga vërshimet dhe në fund fare planet për menaxhimin e rreziqeve nga vërshimet (Neni 7) për implementimin e masave të duhura për parandalimin e vërshimeve dhe për kufizimin e pasojave negative.



Janë të nevojshme zhvillime të mëtejme në këtë fushë, siç edhe ceket në Kornizën Kosovare për Menaxhim të Rrezikut nga Vërshimet, Një Plan Veprimi për Politika, Procedura dhe Koordinim, Task Forca për Ujëra, shkurt 2011.

5.3.2 Siguria e Digave

Siç u theksua me lartë, shembja e digave është një shkaktar potencial i vërshimeve në Kosovë. Mirëpo, çështja e Sigurisë së Digave është adresuar këtu ndarazi duke i marrë parasysh çështjet specifike që shfaqen. Task Forca për Ujëra ka publikuar një vlerësim të Sigurisë së Digave në tetor të vitit 2012⁷².

Në Kosovë ekzistojnë pesë diga të mëdha. Ato paraqesin shtyllën e furnizimit me ujë në Kosovë. Monitorimi dhe mirëmbajtja e digave janë pezulluar pjesërisht në vitet e fundit. Inspektimi vizual i digave ekzistuese dhe shqyrtimi i shkurtër i vizatimeve dhe dokumentacionit ekzistues (vizatimet, dokumentet për vetitë e materialeve dhe analizat) të bëra gjatë shqyrtimit nga TFU, tregon se digat tani për tani janë në kushte stabile. Megjithatë, mungojnë informata të rëndësishme për sigurinë e digave:

- Nuk ka kornizë ligjore që definojnë përgjegjësitë, mbikëqyrjen, sanksionimin në rast neglizhence për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, etj.
- Nuk ka monitorim të digave që nga viti 1997 dhe vrojtim dhe vlerësim të vazhdueshëm të gjendjes së digave;
- Databaza e dizajnit është diku 40 apo 50 vite e vjetër. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime të mëdha në metodat dhe kriteret e vlerësimit;
- Disa diga kanë mangësi individuale të sigurisë që duhet të korrigjohen.

Tabela 48 Digat e Mëdha në Kosovë – Karakteristikat Kryesore⁷³

Emri	Pronari	Viti i Ndërtimit	Lartësia në metra	Akumulimi në Milion m ³	Madhësia eUjëmbledhësit km ²
Batllava	KEK	1960	46	40	226
Badovci		1963	45	32	
Radoniqi		1982	61	113	180
Ujmani	NPH Ibër- Lepenci	1979	101	370	1,100
Përlepnica		1982	40	4.2	55

Përpjekje të mëtejme, ashtu siç është specifikuar në raportin e TFU, janë të nevojshme për të plotësuar kërkesat e monitorimit të sigurisë dhe standardeve të sigurisë të pasqyruara në rekomandimet e Komisionit Ndërkombëtar për Operimin e Digave të Mëdha (KNODM).

5.3.3 Erozioni

Siç është cekur në raportin e Gjendjes së Ujërave, erozioni është një çështje e rëndësishme. Erozioni shkakton degradimin e tokave bujqësore dhe pyjore, rrjeteve të rrugëve dhe hekurudhave, si dhe të objekteve ndërtimore dhe të banimit.

Plani Zhvillimor Rural dhe Bujqësor (2009 – 13) gjithashtu identifikon erozionin si një shqetësim dhe parasheh disa masa që janë të nevojshme:

- Përmirësimi i mbrojtjes nga erozioni në tokat pyjore

⁷² http://www.kryeministri-ks.net/tfu/repository/docs/Kosova_Dam_Safety_Review_Oct_2012.pdf

⁷³ E nxjerrë nga të dhënat e prezantuara në WTF Shqyrtimin e Sigurisë së Digave



- Ulja e erozionit në zonat ku kultivohen frutat/vreshtat
- Krijimi i hartave të zonave në rrezik nga erozioni: vlerësimi i sasisë së humbjes së dheut sipërfaqësor, dhe lokacioni.

Tabela 49 Sipërfaqja e Tokës së Kosovës – Kategorizimi i Erozionit⁷⁴

Kategoria	Sipërfaqe km ²	%
Kategoria I, II dhe III	5,973	55.6 %
Kategoria IV (erozion i ulët)	3,680	34.2 %
Kategoria V (erozion shumë i ulët)	1,970	10.2 %
Gjithsej	10,750	100 %


Shqetësimet shtesë që kanë të bëjnë me erozionin janë shprehur në Studimin e Fizibilitetit të vitit 2009 për Ujin e Pijshëm:

- Kanali i Ibër-Lepencit
 - Gjendja: Në kohën e reshjeve të mëdha sasi e madhe e baltës futet në kanal dhe shkakton turbullirë të madhe
 - Ndikimi: Turbullira e madhe shkakton nivel të lartë të bllokimeve të impiantit të trajtimit të ujit të pijes, që zgjasin një apo dy ditë.
 - Reagimi: Të kryhen punët ndërtimore për të eliminuar apo ulur erozionin e dheut në kanalin e hapur
- Rezervuari i Radoniqit
 - Gjendja: Erozioni i tokës në hyrje të rezervuarit shkakton nganjëherë turbullirë të madhe.
 - Ndikimi: Turbullira e madhe shkakton probleme në impiantin e trajtimit të ujit dhe ngarkesa të mëdha të materieve organike që rezultojnë në para-klorim të shtuar.
 - Reagimi: Të ndërtohet kanali hyrës me beton të armuar prej rreth 2 km deri te rezervuari.

⁷⁴ Gjendja e Ujërave të Kosovës, 2015, MMPH, AKMM



Figura 18 Harta e Rrezikut nga Erozioni – (Raporti i Gjendjes së Ujërave 2010)





5.4 Qeverisja

5.4.1 Monitorimi

Sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës, IHMK është përgjegjëse për sasinë dhe cilësinë e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe akumulacioneve. Situata në vitin 2016 mund të përmbledhet si në vazhdim:

- Sasia dhe cilësia e ujërave sipërfaqësore
 - Cilësia e ujërave të lumenjve është duke u monitoruar sistematikisht që nga viti 2003. Numri i mostrave të marra nga disa vende dallon nëpër vite nga 33 deri në 57 për shkak të kombinimit të ridizajnit të rrjetit dhe burimeve në dispozicion për tu monitoruar në disa vite. Programi synon marrjen e mostrave në baza mujore përveç për disa lokacione ku kjo bëhet në baza sezonale dy herë në vit. Kryesisht analizohen parametrat klasik të cilësisë (siç është temperatura, pH, jonet kryesore, pjesët ushqyese, KOD₅, COD, etj), të cilëve në vitet e fundit i'u janë shtuar disa metale të rënda. Laboratori i IHMK ka kromatografin e gazit me spektrometrin e masës (GC-MS) që mund të shfrytëzohet për analizimin e mikrondotësve organik siç janë pesticidet e gjithashtu edhe plazma të induktuar me Spektrometrin e Masës (ICP-MS) që mund të shfrytëzohet për analizimin e një spektri të gjerë të metaleve (të rënda). Megjithatë stafi i tanishëm nuk është në gjendje t'i shfrytëzojë këto pajisje; për me tepër, reagensat kimik dhe materialet tjera që kërkohen për analizat me këto aparatura mungojnë.
 - Monitorimi hidrologjik nuk është rivendosur si duhet gjatë dekadës së kaluar, kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe të burimeve njerëzore. Si rezultat i kësaj, një numër i kufizuar i të dhënave të përditësuara janë në dispozicion për nivelet e ujërave të lumenjve sidomos të prurjeve.
- Sasia dhe cilësia e ujërave nëntokësore
 - Këtu situata është shumë e krahasueshme me monitorimin hidrologjik dhe prandaj shume pak të dhëna janë mbledhur që nga viti 1990.
- Sasia dhe cilësia e akumulacioneve
 - Tani për tani, IHMK nuk është duke kryer asnjë matje të akumulacioneve.

Sipas Ligjit për Ujëra, IKSHPK dhe ofruesit e furnizimit me ujë (KRU-të) janë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujërave që shfrytëzohen për pije. Kjo përfshinë cilësinë e ujit që nxirret nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore për prodhimin e ujit të Pijshëm. KRU-të janë përgjegjëse për monitorimin e sasisë së ujërave që shfrytëzojnë për pije.

- IKSHPK përbëhet nga zyra kryesore në Prishtinë së bashku me zyrat rajonale në gjashtë qytete të Kosovës (Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan). Të gjithë laboratorët mund të analizojnë parametrat mikrobiologjik dhe parametrat e cilësisë fiziko-kimike. Laboratori në Prishtinë është shumë modern për të analizuar një spektër të gjerë të mikrondotësve (duke përfshirë pesticidet, metalet e rënda etj).
- Laboratorët e shumicës së KRU-ve nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm dhe prandaj analizimin e kanë kontratuar tek IKSHPK. Pak kohë më parë është licensuar laboratorit i KRU Radoniqi për të bërë analizat biologjike-kimike të testeve të ujit për ujin që furnizohet nga kjo Kompani tek konsumatorët e saj.



5.4.2 Menaxhimi i informacioneve

Ligji për Ujërat e Kosovës në Kapitullin XI për Sistemin Informativ dhe Pjesëmarrjen e Publikut definon disa obligime në kuptimin e bazës së të dhënave dhe dhënies së informacionit. Sistemi Kombëtar i Informacionit Ujor duhet që përveç tjerash të ruajë dhe përpunojë të dhënat për sasinë dhe cilësinë e ujit, për lejet, për shkarkimet e substancave të rrezikshme, dhe për burimet e ujit.

Sa i përket mbledhjes së të dhënave dhe dhënies së tyre, Ligji thotë se *“Të gjithë personat dhe institucionet janë të obliguar të ofrojnë të dhëna për ujërat për Ministrinë dhe autoritetin kompetent për ujërat”* dhe *“të dhënat e Sistemit Informativ Ujor janë publike dhe secili mund të ketë qasje në to, përveç në të dhënat që konsiderohen si sekret zyrtar”*.

Situata e tanishme mund të përshkruhet si në vazhdim:

- Ruajtja e të dhënave
 - Forma tipike e ruajtjes së të dhënave cilësore, veçmas në lidhje me cilësinë e ujit dhe lejet, është në programin Excel dhe Word. Më parë, ka ekzistuar një bazë qendrore e të dhënave e cila nuk është më operationale. Të dhënat për lejet ujore gjithashtu ruhen në mënyrë joformale në MS Office, që mund të arsyetohet nga një numër relativisht i vogël i lejeve që janë duke u lëshuar. Disa licenca të softuerit ArcGIS ekzistojnë në kuadër të Ministrisë dhe shfrytëzohen për të ruajtur dhe përpunuar hartat në lidhje me pellgjet lumore, nën-pellgjet dhe për monitorimin e ujërave.
- Qarkullimi i të dhënave
 - Të dhënat për monitorimin e cilësisë së ujit rrjedhin nga IHMK ku ato janë të ruajtura në formatin Excel që nga viti 2003. Me formatin e tanishëm, secili dokument përmban vlerën e mostrave për një stacion dhe për një datë të caktuar. Për pasojë, është pothuajse e pamundur të sigurohen informacione si trendet ndër vite apo krahasime të cilësisë së ujit ndërmjet pellgjeve të lumenjve. Informacionet në këtë format analizohen, cilësia e tyre sigurohet dhe shfrytëzohen për raportim nga AKMM dhe deri diku nga DU. Një shembull i kësaj të fundit është shfrytëzimi i të dhënave të lumenjëve për lëshimin e lejeve të shkarkimit.
- Shpërndarja e të dhënave
 - AKMM prodhon raporte për Gjendjen e Mjedisit që përfshinë të dhënat për ujin. Të dhënat e papërpunuara për programet e monitorimit akoma nuk bëhen publike.

5.5 Përformanca Financiare

5.5.1 Shërbimet me ujë

Për gjashtë vite që ARRU bën matjen e performancës së kompanive rajonale të ujësjellësit, përformanca ka treguar përmirësim të përgjithshëm nga një vit në tjetrin, duke përfshirë performancën financiare, dhe kjo ngritje ka qenë e ngadalshme.

Në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014, përformanca financiare e KRU-ve për të dy shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura është përmirësuar, në veçanti sa i përket profitit. Megjithatë, mbetet brengë niveli i ulët i tanishëm i efikasitetit komercial (shkalla e arkëtimit) që ka shënuar përmirësim më të vogël. Në këtë drejtim sfidë e madhe mbetet rritja shumë e vogël e efikasitetit të faturimit, arkëtimit të borxheve të vjetra, ndërmarrjes së ndërprerjes së lidhjeve dhe e zbatimit të masave tjera të aplikueshme ndaj konsumatorëve që nuk paguajnë.

Niveli i tanishëm prej 74% i shkallës së arkëtimit është jo i kënaqshëm dhe paraqet problem për qëndrueshmërinë financiare dhe operacionale të KRU-ve në ruajtjen e nivelit të tanishëm të shërbimit. Për periudhën e tanishme 2015 – 2017, shqyrtimi i tarior i'u ka dhënë mundësinë KRU-ve për të korrigjuar shume probleme duke përgatitur mirë planet rregullaore të biznesit që janë konsideruar si sfiduese, dhe ende konsiderohen si të tilla, duke pasur parasysh rrethanat nëpër të cilat KRU-të po kalojnë, sa i përket arritjes së objektivave dhe përmirësimit e efijencës së përgjithshme. Megjithatë, niveli i arritjeve drejt planifikimit për vitin 2015 për të gjithë treguesit financiar ka qenë i pakënaqshëm. Një fushë tjetër e performancës së dobët financiare të KRU-ve janë investimet kapitale. Gjatë periudhës 2012-2015, sa i përket shërbimeve të ujit (ujë dhe ujëra të ndotura), KRU-të kanë investuar vetëm 33.3% të investimeve kapitale totale të planifikuara, të aprovuara nga ARRU, ndërsa vetëm 9.8% nga donatorët.

Në figurën në vazhdim janë dhënë nivelet e tanishme ndaj projekteve të arritjeve për treguesit kryesor të performancës financiare në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014⁷⁵.

Figura 19 Kosto totale për njësi të prodhimit të ujit





Figura 20 Shitjet totale në krahasim me planet (Uji)



75 ARRU, Raporti i performances 2015



Figura 211 Shitjet totale në krahasim me planet (Ujëra të ndotura)




Figura 22 Arkëtimi i të ardhurave në krahasim me ato të faturuara (Uji dhe Ujëra të Ndotura)





Figura 23 Shpenzimet Kapitale për shërbimet me ujë – krahasuar me planin



5.5.2 Ujitja

Në ofrimin e shërbimeve të ujit me shumicë, secili entitet në Kosovë ballafaqohet me një numër sfidash unike për madhësinë e tyre, historinë dhe lokacionin. Sidoqoftë, këto ndërmarrje ballafaqohen me një numër presionesh që së bashku dhe për disa vite mund të rrisin kostot dhe rrezikojnë qëndrueshmërinë e tyre.

Në klimën e tregut ekziston kapacitet i ndërmarrjeve private për tu përfshirë në kontratat e sektorit të shërbimit të furnizimit të ujit me shumicë. Fushat me interes mund të jenë instalimi i ujëmatësve, leximi, faturimi dhe arkëtimi, kontabiliteti, auditimi financiar apo ndonjë operim tjetër dhe mirëmbajtja e sistemeve të vogla.

Deri tani, përveç kontraktimit të disa shërbimeve të vogla nuk ka ndonjë shembull të PSP në sektorin e ujitjes në Kosovë.

Pagesat për ujë për shërbimet e ujitjes vendosen nga vet ndërmarrja dhe miratohen nga Bordi i Drejtorëve. Çmimet nuk bazohen me në rikuperimin e kostove por në një përfitim marginal për ujin e shfrytëzuar për ujitje dhe “aftësinë për të paguar”. Nuk merret parasysh elementi “kthimi në kapital”. Faturimi nuk bëhet mbi parimin volumetrik. Pagesa për metodën jo-volumetrike për ujin për ujitje bazohet në njësi të tokës (hektarë). Kjo metodë ju konvenon menaxherëve të kompanive të ujitjes sepse është e lehtë për tu administruar dhe nuk kërkon masa të veçanta për furnizimin me ujë për ujitje.

Në Kosovë është i pranishëm një sistem i ndërsubvencionimit të infrastruktura e ujitjes.. Një ndërsubvencionim i zakonshëm ndodhë ndërmjet blerësve të rrymës dhe atyre atyre që shfrytëzojnë shërbimet e ujitjes (NPH “Ibër-Lepenci”) të cilët shfrytëzojnë ujin nga i njëjti akumulacion dhe digë. Menaxherët e një projekti akumulacion-digë, që gjenerojnë energji elektrike dhe ofrojnë ujë për ujitje, ballafaqohen me vendimet se si të alokojnë koston e përbashkët për të dy aktivitetet. Këto kosto alokohen ndërmjet konsumatorëve të ujitjes dhe atyre të energjisë elektrike, duke përfshirë koston për mirëmbajtjen e digës dhe akumulacionit.

Shumica e investimeve në këtë sektor janë financuar nga donatorët apo nga Qeveria e Kosovës. Këto investime janë të bazuara në shumë kritere duke përfshirë efikasitetin ekonomik, barazinë,



qëndrueshmërinë dhe sigurinë e ushqimit. Kur dëshirohet eficienta ekonomike, atëherë vlera ekonomike e infrastrukturës tejkalon kostot e saj në termat e vlerave të tanishme.

Në përgjithësi qëndrueshmëria e kompanive të ujitjes nuk është e siguruar, pasi që ekspansioni i madh i zonave urbane që bëhet duke uzurpuar tokën bujqësore, po i ndryshon shpejt prioritetet e popullsisë.

Për më tepër rrjeti i vjetruar i gypave dhe burimet e kufizuara të ujit rezultojnë me kosto të lartë operacionale dhe mund të vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e ofruesve pasi që arkëtimi nuk mbulon koston e operimit.

Bazuar në informacionin që përmban Raporti Vjetor 2011 - Përformanca e Ndërmarrjeve Publike Qendrore, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, NJPMNP, 2012, teksti në vazhdim e përshkruan performancën financiare të dy ndërmarrjeve të ujitjes.

Tabela 50 Performanca financiare e Kompanisë Rajonale të Ujitjes Radoniqi-Dukagjin

Përshkrimi	2014 (000€)
Të hyrat	742
Shpenzimet	-416
Fitimi/Humbja operacionale	326
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-196
Borxhet e këqija	-127
Fitimi/Humbja financiare	3
Parat në fund të vitit	111

KRU Radoniqi-Dukagjin ka përfunduar vitin 2014 me një përparim modest për shkak të rritjes së të hyrave duke kthyer humbjet në fitim financiar në krahasim me vitin paraprak për shkak të rritjes së të hyrave që është një tregues premtues për të ardhmen.

Në mënyrë të ngjashme performanca e KRU Drini i Bardhë është përmbledhur këtu.

Tabela 51 Performanca financiare e Kompanisë Rajonale të Ujitjes Drini i Bardhë

Përshkrimi	2014 (000€)
Të hyrat	313
Shpenzimet	-149
Fitimi/Humbja operacionale	164
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-151
Borxhet e këqija	0
Fitimi/Humbja financiare	-13
Parat në fund të vitit	0.15

Edhe pse kompania ka zvogëluar humbjet financiare me përqindje modeste, akoma është në krizë financiare pasi shkalla e arkëtitimit është vetëm 70% dhe kompania mund të mbulojë vetëm kostot e veta operacionale.

5.5.3 Hidrocentralet

Tabela 52 Performanca financiare e NPH Ibër- Lepenci

Përshkrimi	2014 (000€)
Të hyrat	4,184
Shpenzimet	-3,667
Fitimi/Humbja operacionale	517
Zhvlerësimi dhe amortizimi	-4,624
Borxhet e këqija	0



Fitimi/Humbja financiare	-4,107
Parat në fund të vitit	966

Përkundër faktit që kjo kompani është financiarisht stabile, nuk mbahet me subvencione nga shteti dhe ka fitim operacional, që është një indikator i cili tregon stabilitet në operim dhe në ofrimin e shërbimeve publike.

5.6 Procesi i Investimeve

5.6.1 Trendet Historike

Trendet historike të investimeve në sektorin e ujërave janë analizuar në detaje nga KNMU në raportin e tyre të 2015. Në formë të përmbledhur raporti konstaton:

Investimet në sektorin e ujërave nga donatorët ndërkombëtarë dhe Qeveria e Kosovës nga viti 1999 deri 2014 vlerësohet se janë të paktën €315 milion në total. Nga kjo shumë, përafërsisht tri të katërtat janë donacione nga komuniteti ndërkombëtar dhe një e katërta është nga buxheti i Kosovës (BK).

Investimet nga donatorët datojnë që nga viti 1999 dhe ende vazhdojnë, me një trend të butë të rënies përderisa investimet nga BK kanë filluar më vonë dhe janë të regjistruara nga viti 2000 por janë në rritje të vazhdueshme nga një vit në tjetrin.

Tre donatorët ndërkombëtarë veçohen nga të tjerët me kontributet e tyre substanciale në sektorin e ujit. BE, KfW dhe ZZB kanë pasur qasje më përcaktuese dhe fundamentale për përmirësimin e sektorit dhe kanë mbuluar 53% të investimeve totale përderisa donatorët e tjerë përbëjnë 11% të investimeve. Donatorët kanë zhvilluar programet për mbështetje financiare të KRU-ve dhe institucioneve si MMPH, komunat, ARRU, NjPMNP, etj. Mbështetja e donatorëve përfshinë investimet kapitale dhe asistencën teknike.

Asistenca financiare nga BK dhe agjencitë lokale mbulon 36% të investimeve. Kontributi i BK manifestohet nëpërmes institucioneve të ndryshme. Fillimisht që nga viti 2000 përmes Departamentit të Shërbimeve Publike dhe me vonë, ndërmjet viteve 2002 dhe 2008, përmes pasuesit të këtij departamenti (Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit - AKM), ka mbështetur KRU-të kryesisht me subvencione për të mbuluar kostot operative.

Bazuar në të dhënat e disponueshme, përgjatë periudhës 1999 – 2011 nga mjetet e zotuar janë implementuar projekte në vlerë prej €215.26 milionë nga te cilat €149,41 milionë janë nga donatorët e huaj, ndërsa vlera e investimeve vendore ka qenë €65.85 milion. Për periudhën 2012 – 2014 kanë qenë €46.7 milionë investime vendore në implementimin e projekteve në sektor, si dhe afro €53.0 milionë donacione nga investitorët e huaj përfshirë edhe kredinë e KfW-së, vlera e së cilës për këtë periudhë është rreth €9 milionë.



Figura 24 Investimet në sektorin e ujërave të Kosovës – Nga raporti i trendëve historike (KNMU)





Tabela 53 Investimet në sektorin e ujërave - Kosova dhe Donatorët: 1999 – 2014

Përshkrimi	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kosova (€m)	5.62	1.0	1.6	2.2	0.6	1.0	3.1	4.5	4.2	6.1	14.6	14.2	12.7	12.9	16.1	17.7
Donacion (€m)	10.2	12.8	19.9	17.9	17.5	10.6	7.7	7.9	8.5	19.3	9.8	12.6	11.0	12.2	18.3	22.0
Total (€m)	10.2	13.8	21.5	20.2	18.2	11.6	10.8	12.3	12.7	25.4	24.5	26.7	23.8	25.1	34.4	39.7
Kumulativ	10.2	24.0	45.6	65.7	83.9	95.5	106.3	118.6	131.3	156.7	181.2	207.9	231.7	259.8	291.2	330.9

5.6.3 Investimet në Mbrojtjen e Mjedisit – Bashkimi Evropian

Në përcaktimin e potencialit për investime në të ardhmen në sektorin e ujërave, është marrë parasysh niveli i shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit në Bashkimin Evropian.


Figura 25 Shpenzimet e sektorit publik për mbrojtjen e mjedisit për vitin 2011 (% e BPV) – Eurostat



Siç shihet në figurën e mësipërme, ka një dallim të madh në nivelin e shpenzimeve.


Duke marrë parasysh mesataren e BE (diku 0.65%), kjo do të përkthehej në vlerën për Kosovës (duke supozuar BPV diku €5 miliard) diku €32.5 milion për vit.

Figura 26 Proporcioni i shpenzimeve për mjedis - Aktuale dhe Investimet



Përsëri, ka një dallim të madh në proporcionin e shpenzimeve që është për investime. Megjithatë, duhet të thuhet se vendet me proporcion më të lartë të investimeve janë shtetet që i janë bashkangjitur së fundmi BE-së, sidomos Sllovenia dhe Kroacia të dyja shpenzojnë në investime më shumë se 75% të totalit të shpenzimeve.

Figura 27 Shpenzimet publike për mjedis sipas nën-sektorëve: Eurostat 2011



Sikurse me treguesit e tjerë të diskutuar këtu, mund të shihet dallim i madh në shpërndarjen e shpenzimeve ndërmjet nënsektorëve por duhet të thuhet se menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe ujërave të ndotura është zënë një vend të dalluar.

Nga ky shqyrtim i shkurtër i statistikave për një vit të vetëm, nuk mund të arrijmë në përfundime të detajuara. Megjithatë mund të nxjerret një vlerësimi “i rendit të madhësisë”. Duke supozuar se 80% e shpenzimeve për mjedisin janë për investime dhe diku 50% e kësaj është për sektorin e ujërave, fitohet një vlerë statike indikative prej rreth €13 milion si kufi+ i sipërm i potencialit për shpenzime kapitale nga burimet publike për sektorin e ujërave.



6 Nevojtat Zhvillimore

6.1 Shfrytëzimi i Ujit

6.1.1 Akumulimi i ujit

6.1.1.1 Thatësira

Një vlerësim i plotë dhe i detajuar i rrezikut nga thatësira për Kosovën nuk është kryer akoma edhe pse janë publikuar⁷⁶ një numër dokumentesh. Një draft i parë i këtij vlerësimi është në proces si pjesë e procesit të Karakterizimit të Pellgjeve të Lumenjve. Vlerësimi më i detajuar i bërë deri me tani, është raporti i sigurimit të Ujit për Kosovën Qendrore 2011/12. Konstatimet kryesore që përmban ky raport janë nënvizuar më poshtë:

Ibër-Lepenci

Edhe pse kanali i Ibër-Lepencit mund të bartë sasi të madhe të ujit në baza ditore, ende mund të paraqiten probleme të mungesës së ujit për periudha të shkurta kohore për arsye të ndryshme të dhëna në vijim:

- Parashikimi jo i duhur i kërkesës ditore dhe operimi jo i duhur i portave që lëshojnë ujin.
- Dëmtimet e kanalit veçmas kur nivelet e ujit janë të larta në kanal.
- Kapërderdhja edhe futja në sifonin e kanalit pengohet nga mbetjet e ngurta.
- Problemet me cilësinë e ujit me shumicë, etj.

Këto janë çështje të sigurisë së ujit që mund të quhen si të cenueshme dhe janë pak më të ndryshme se sa ruajtja e ujit me shumicë. Ato duhet të adresohen gjithashtu në programin e masave.

Liqeni i i Batllavës

Përveç problemit të sasisë së ujit, ekzistojnë çështje të sigurisë së ujit, për shembull për shkak të mbrojtjes së pamjaftueshme të akumulacionit nga ndotjet nga ekonomitë familjare, turizmi dhe aktivitetet e fermave. Në fund sezonit të vitit 2010, Konsulenti ka vënë re në lokacione të ndryshme shtimin e mikrofitëve që reflekton tejkalimin e nutrientëve që hyjnë të liqe. Ekziston gjithashtu rreziku i ndotjes aksidentale nga rruga.

Liqeni i Badovcit

Sistemi i Badovcit nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme: Kërkesa kumulative është më e madhe se sa mbushja për një vit të zakonshëm. Duke marrë parasysh ndryshimin e klimës (një vit tipik shumë i thatë me vetëm 50% të prurjes së zakonshme) prurjet hyrëse kumulative për një sezon shumë të thatë nuk mund të mbulojë kërkesën e përgjithshme që do të thotë do të ketë mungesa të përkohshme.

Ka edhe çështje tjera të sigurisë së ujit si rezultat i mbrojtjes së pamjaftueshme të liqenit nga ndotjet e ekonomive familjare, turizmit dhe aktivitetëve të fermave. Ujërat e ndotura nga ekonomitë familjare shkarkohen në liqe si dhe ka rrezik të madh nga ndotja prej rrugës.

Përmbledhje – Gjendja Aktuale

Gjendja aktuale tregon se në vitin 2010 kan pasur mungesë të ujit në liqe dhe furnizim i pamjaftueshëm për një pjesë të qytetit të furnizuar nga sistemi i Badovcit.

76 Shih shembullin: Burimet e ujit, Sfidat në Kosovë në ndikime e tyre pëtej kufirit, BALWOIS, 2010

Kjo don të thotë se uji nga liqeni i Batllavës duhet të plotësojë mungesën e liqenit të Badovcit. Kufizimet në furnizimin me ujë janë gjithashtu për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të prodhimit dhe sistemit të shpërndarjes së ujit. Në rrjetin e ujësjellësit ka humbje të konsiderueshme të ujit.. Për përmirësimin e situatës janë dy projekte që po zbatohen:.

- Njëri projekt synon shtimin e prodhimit për 700l/s përmes impiantit në Shkabaj duke e marrë ujin nga kanali i Ibër-Lepencit.

- Projekti i dytë synon përmirësimin e efikasitetit të rrjetit dhe përmirësimin e menaxhimit të përgjithshëm të kompanisë. Këto masa kanë pasur një sukses në zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e rikuperimit të kostos.

Përfundimet

Këto rezultate tregojnë dy probleme kryesore të kufizimit me ujë. Badovci: mungesat e ujit në liqe mund të ndodhin nga viti 2011 e tutje dhe mungesat do të shtohen veçmas nën supozimet e ndryshimeve klimatike. Batllava: Në vitin 2035 ekziston rrezik i madh i mungesës së ujit që kërkon kapacitet shtesë ose të ri dhe kjo mungesë është edhe me e madhe nën supozimin e ndryshimeve klimatike. Ujman:i nën supozimin e ndryshimeve klimatike dhe duke marrë parasysh shtimin e madh të ujitjes prej 10 000 ha, ekziston rreziku i mungesës strukturore të ujit pas vitit 2020 veçmas nën supozimin e ndryshimeve klimatike. Sistemi i ujërave nëntokësore: besimi në rezultate është modest pasi supozimi duhet të bëhet mbi kapacitetin e ujërave nëntokësore. Në afat të shkurtër kohor, janë planifikuar investimet në furnizimin urban me ujë që do të sigurojnë ujë të mjaftueshëm deri në vitin 2020. Supozohet se rrjeti shpërndarës i ujësjellësit ka kapacitet për shpërndarje të ujit të trajtuar nga liqenet e Batllavës dhe Ujmanit në zonën e shërbimit të KRU Prishtina.

Në planin afatgjatë 2020-2035, veçmas në rastin e klimës e cila po bëhet më e thatë, ka gjasë të madhe që do të paraqiten mungesa të strukturuar të ujit gjatë verës.

E dyta, mbajtja e cilësisë së burimeve të ujit dhe ujit në kanal është një sfidë në afat të gjatë kohor pasi presioni për ndotjen e burimeve është në rritje.

Nga viti 2020 do të jenë të nevojshme burime e ujit të pastër shtesë për shkak të shtimit relativ dhe absolut të kërkesës për ujë dhe për shkak se është e vështirë të mbahet një kualitet i mjaftueshëm i ujit me shumicë.

Duke marrë gjithashtu parasysh përgjegjësitë e kompanisë për furnizim me ujë, është afër mendsh që KRU-të të mbështesin opsione të rrezikut më të vogël të kontaminimit të ujit, si diversitetet e burimeve të ujit dhe të korridoreve të furnizimit. Kjo do të jetë esenciale në rastin e emergjencave, katastrofave natyrore, ndotjes, gabimeve njerëzore apo aksidenteve që çojnë në shkëputjen e furnizimit me ujë.

Përpos shqetësimeve lidhur me pellgun e ujëmbledhësit të Ibër-Lepencit, në seksionet furnizimi me ujë, ujitja dhe akumulimi, janë vlerësuar edhe një varg i nevojave tjera për zhvillimin e burimeve të ujit. Këto vlerësime nuk po përsëriten këtu por duhet të kihen parasysh kur të analizohet situata e përgjithshme.

Për me tepër menaxhimi i rrezikut të thatësirave ka nevojë të adresohet në mënyrë të ngjashme me menaxhimin e rrezikut të vërshimeve.

Nevojat e zhvillimit në këtë drejtim janë adresuar në Raportin TFU për Menaxhimin e Rrezikut të Thatësirës. Implementimi i kornizës së tillë është esenciale. Në veçanti duhet të adresohet monitorimi, shkëmbimi i informacionit dhe nevoja planifikuese. Sikurse menaxhimi i rrezikut nga vërshimet kjo ka nevojë të integrohet në procesin planifikues të menaxhimit të pellgut të lumit.



6.1.1.2 Akumulacionet

Ashtu sikur u theksua me lartë, ekzistojnë pesë akumulacione të mëdha që janë në shfrytëzim në Kosovë në këtë moment.

Tabela 55 Akumulacionet ekzistuese (Raporti i Gjendjes së Ujërave 2015)

Rezervari	Rrjedhja e ujit (Lumi)	Ujëmbledhësi km ²	Rrjedhja mesatare m ³ /sekondë	Vëllimi Milion m ³	
				E lartë	E ulët
Ujmani	Ibër	1,060.0	13.5	350.0	390.0
Batlava	Batlavë	226.0	1.1	25.1	30.0
Badovci	Graçankë	103.0	1.1	20.0	26.4
Prilepnica	Prilepnica	62	-	-	-
Radoniqi	Lumëbardhi i Deçanit	130.0	0.2	102.0	113.0
		1,581	15.9	497.1	559.4

Çështjet që ngriten për këto akumulacione janë:

- Inspektimi i sigurisë së digave, procedurat dhe përgjegjësitë kanë nevojë urgjente të qartësohen dhe të vendoset një sistem apo inspektim i rregullt dhe mirëmbajtja për të siguruar një operim të sigurtë dhe pa ndërprerje.
- Diga e Perlepticës ballafaqohet me problem serioze me lymin dhe sedimentimin (kjo është arsyeja pse janë planifikuar dy akumulime të reja për furnizimin e Gjilanit).

Këto çështje kanë nevojë të zgjidhen me urgjencë. Në veçanti problemi i digës së Perlepticës ku përpos problemit me lymin dhe sedimentimin paraqiten edhe shenja të dukshme të rrjedhjes në një vend (ashtu sikur konstatohet në Raportin e Sigurisë së Digave, TFU 2012).


Pavarësisht çështjeve me të cilat ballafaqohen digat ekzistuese, duhet të merret parasysh zhvillimi i akumulacioneve të reja shtesë.

Ndërtimi i digave dhe akumulacioneve për akumulimin (mbajtjen) e ujit për një numër qëllimesh siç janë hidrocentralet, furnizimi me ujë për pije, ujitje dhe mbrojtje nga vërshimet, ka një të kaluar të gjatë dhe është një qasje konvencionale që praktikohet gjerësisht për menaxhimin e ujërave në Evropë.

Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit:

- Gjatë dy shekujve të kaluar është shënuar rritje e konsiderueshme e madhësisë dhe numrit të akumulacioneve me kapacitet të madh të akumulimit, veçmas me zhvillimin e hidrocentraleve dhe menaxhimin e pellgjeve. Tani për tani në Evropë ka diku 7000 diga të mëdha. Përveç kësaj ka me mijëra diga të vogla... Shtetet e BE-së me numrin më të madh të liqeneve akumulues janë Spanja (rreth 1200), Anglia (rreth 570), Italia (rreth 570) Franca (rreth 550) dhe Suedia (rreth 190).

Figura 28 Kapaciteti specifik i digave - Evropë (EEA 1999)



Nëse aplikohen vlerat e mësipërme për Kosovën dhe për popullsinë prej 1.8 milion, fitohet një vlerë prej përafërsisht 290 m³ për banorë. Kjo e vendos Kosovën në nivele të krahasueshme (për kokë banori) për Francën, Irlandën dhe Italinë. Kur të krahasohet me shtetet tjera të Europës Jugore që kanë kapacitet specifik të akumulimit prej rreth 1,000 m³ për kokë banori (Greqia, Portugalia Spanja), del që niveli i akumulimit është i ulët. Kur të merret parasysh Gadishullin Ballkanik në veçanti, gjithashtu shihet se Kosova ka rezerva relativisht të vogla.

Tabela 56 Kapaciteti specifik i akumulimit – regjioni i Ballkanit⁷⁷

Vendi	m ³ për banor (viti 2000)
Shqipëria	1,455
Bosnja dhe Hercegovina	968
Bullgaria	629
Kroacia	329
Greqia	1,184
Hungaria	175
Moldavia	419
Rumania	624
Sllovenia	101
Serbia dhe Mali i Zi	737
Turqia	1,965

Ndërtimi i akumulacioneve dhe digave është kritikuar për një numër arsyesh, veçmas për çështje mjedisore. Për shembull EEA tregon si në vazhdim:

Ndërtimi i akumulacioneve shpie në një numër të çështjeve mjedisore si gjatë ndërtimit edhe pas përfundimit. Pas mbylljes së digës niveli i ujit rritet në liqe. Si rezultat, shpesh ndodhin ndryshime të mëdha në zonat me prani të ujit. Për shembull toka punuese mund të humbet,

⁷⁷ [Water Resources Management in South-Eastern Europe, World Bank 2003](#)



vendbanimet të përmythen dhe niveli i ujërave nëntokësore të rritet. Pasi të jetë mbushur akumulacioni, dy lloje të problemeve mjedisore shfaqen, të cilat:

- E bëjnë akumulacionin të papërshtatshëm për destinimin që ka, për shembull paraqitja e algave dhe substancave toksike në akumulacionin që përdoret për ujë të pijshëm.
- Shkaktojnë përkeqësim ekologjik në sistemin e lumit veçmas në pjesën e tij nën akumulacion.

Meqenëse digat ndalojnë rrjedhen natyrore të lumit dhe akumulacioni ndryshon ciklin hidrologjik, pasojat ekologjike mund të jenë të shumëfishta. Për shembull, pengohet që peshqit migrues të lëvizin për në vendet ku i lëshojnë vezët e tyre. Ky është problem veçmas për peshkun siç është sallmoni, trofta, ngjala dhe bliri. Madje

edhe digat e vogla shkaktojnë problem pasi ato paraqesin barrierë të pakalueshme për shumicën e llojeve të peshqve. Kështu digat e vogla (me të ulëta se 10-15 metra të lartë) që janë 10 deri në 100 herë më të shpeshta se digat e mëdha kanë pasur efekt të dëmshëm në llojlojshmërinë e peshqve. Për më tepër, akumulacionet e ndalin qarkullimin e materieve të suspenduara (kryesisht rërës) në të. Kjo zvogëlon sasinë e masës në rrjedhat e poshtme dhe në det, ku mungesa e rërës shkakton erozionin e bregdetit.

Për më tepër EEA ka shprehur brengën se akumulacionet dhe masat tjera “konvencionale” apo “strukturat e rënda” janë favorizuar në krahasim me veprimet e ndjeshme mjedisore siç është menaxhimi i kërkesës, përmirësimet e efiçencës dhe kullimi i qëndrueshëm urban⁷⁸. Duke pasur parasyshçështjet me të cilat ballafaqohet Kosova nr menaxhimin e ujërave, aplikimi i një kombinimi optimal kosto-efektiv i të gjitha masave do të jetë i nevojshëm. Në një rrafsh më praktik, ka gjithashtu brenga në kuadër të asistencës së donatoreve sa i përket financimit të digave të reja si rezultat i perceptimit negativ që është shfaqur nga një numër i problemeve që janë publikuar mjaft shpesh⁷⁹.

Pavarësisht këtyre brengave, ka argumente të shumëta në favor të shfrytëzimit të digave dhe akumulacioneve si mjete për menaxhimin e ujërave, veçmas kur ato projektohen dhe operohen për të qenë të adaptueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe multifunktionale (zbutja e thatësirave, menaxhimi i rrezikut të vërshimeve, energjia e ripërtërishme)⁸⁰, dhe kur aplikohet si njëra prej masave në qasjen e menaxhimit të integruar të ujërave që është në përputhje me qasjen e menaxhimit të pellgjeve lumor ashtu sikur është përcaktuar në Direktivë Kornizë të Ujërave.

Sikur edhe është raportuar në Raportin e Ujërave 2015, Masterplani i vitit 1983 për menaxhimin e ujërave ka përmbajtur planet për një numër të akumulacioneve të reja siç është paraqitur në tabelën më poshtë.

- Akumulacionet e Shipashnicës dhe Hogoshtit janë në përputhje me Kërkesën e komunës së Kamenicës Nr.1158/14, të datës 11.03.2014, në teritorin e të cilës komunë janë paraparë këto dy akumulacione.

⁷⁸ Burimet e ujit në tërë Evropën — përballja me pamjaftueshmerinë e ujit dhe thatësirat, EEA Reporti No 2/2009

⁷⁹ <http://www.internationalrivers.org/files/attached-files/030309.irnjbic.pdf>

⁸⁰ Shi për shembull Grupin Punues Evropian për Pendat dhe Vërshimet në Evropë. Roli i pendave në lehtësimin e vërshimeve, dhjetor 2010



Tabela 57 Planifikimi i ndërtimit të akumulimeve ujore (Tabela 4 – Raporti i Gjendjes së Ujërave 2015)

Nr	Akumulimi	Lumi/rrjedha e ujit	Ujëmbledhësi	Rrjedhja mesatare	Rrjedhja vjetore	Vëllimi
			km ²	m ³ / sekondë	milion m ³	milion m ³
1	Drelaj	Pejë-Bistrica e Pejës	173.0	4.65	146.6	84.5
2	Kërstovc	Lumi i Binçës	118.0	3.20	101.0	40.0
3	Movë	Lumi i Klinës	239.0	1.20	37.8	34.0
4	Morinë	Llabenica	26.0	2.25	70.8	38.0
5	Ripaj	Lumi Trava	59.0	2.38	74.9	36.0
6	Reçan	Lumi Bistrica e Prizrenit	155.0	4.55	143.3	68.0
7	Dragaçin	Lumi Dragaçin	36.0	0.25	7.9	6.8
8	Kremenata	Lumi Kremenatë	56.0	0	15.9	8.8
9	Binçë	Lumi i Madhë	72.0	0.63	19.5	1.0
10	Shipashnice	Desivojce	77.6	0.63	19.9	14.9
11	Hogosht	Hogosht	48.5	0.42	13.2	9.9
12	Firajë	Lumi Lepenc	229.0	5.34	168.3	16.5
13	Shtime	Lumi Topillë	102.0	0.66	20.9	113.0
14	Cecelija	Lumi i Zi	47.0	0.41	12.9	21.0
15	Makovc	Lumi Prishtevka	26.0	0.19	6.0	10.0
16	Majanc	Lumi i Kançandollit	88.0	0.68	21.4	30.0
17	Vaganic	Lumi Lushta	46.0	0.23	7.2	8.0
18	Miraçë	Lumi Tërstena	31.0	0.20	6.3	6.0
19	Dobroshevcë	Lumi Drenica	35.0	1.38	43.4	23.2
20	Pollata	Lumi Llap	111.0	1.23	38.6	37.5
21	Bistrica	Lumi Bistricë e Prizrenit	159.0	1.40	44.2	25.0
Gjithsej	(e nxjerrë këtu)		1934.1	31.88	1020	632.1

Përveç kësaj, kohën e fundit ka pasur propozime nga ana e Komunes së Kamenicës që të përfshihet në projektet me prioritet. Kërkesa me numër të protokollit: 1405/14, i datës 24.03.2014:

- Diga e Desivojçës – S= 154 ha, h=50 m dhe Q=1.22 m³/s
- Diga e Kremenatës - S= 229 ha, h=80m
- Diga e Gjyrishevcit- S= 11.0 ha, h=50m dhe Q=1.0 m³/s

Implementimi i të gjitha akumulacioneve të planifikuara do të sillte akumulim total (duke përfshirë kapacitetin aktual prej rreth 525 milion m³) në përafërsisht 1,150 milion m³. Duke supozuar shtimin e popullsisë gjatë periudhës të cilës i referohet kjo Strategji (deri më 2033) në diku 2.2 milio,n kjo do të rezultonte **në kapacitetin specifik akumulues prej rreth 500 m³ për kokë banori**. Kjo do ta vendoste Kosovën me afër, por akoma nën, kapacitetin mesatar të vendeve fqinje dhe vendeve të Evropës Jugore.

Është e qartë se ndërtimi i këtyre akumulacioneve do të ishte ndërmarrje e madhe, do të ishte e shtrenjtë dhe do të kërkonte përpjekje të konsiderueshme për të implementuar mjedisin e sigurt dhe sigurinë operationale. Për më tepër, dimensionin ndërkombëtar gjithashtu duhet të adresohet ashtu siç është dëshmuar në rastin e skemës së propozuar për HC e Zhurit.

Megjithatë ekzistojnë argumente të qarta në dobi të marrjes parasysh të implementimit të këtyre skemave. Vlerësimi i kostos për një program të tillë të ndërtimit të digave dhe të akumulacioneve është i vështirë dhe pengohet nga mungesa e informacionit të projekteve specifike. Megjithatë, “një



vlerësim indikativ” mund të bëhet duke aplikuar koston për njësi⁸¹. Me këtë rast është aplikuar dhe përshtatur kostoja mesatare prej €1 për metër kub të akumulacionit të planifikuar për të kryer një përlllogaritj të ekonomisë shkallës potenciale. Kjo është bërë me “rregullën e gishtit të madh” duke llogariturqë kostoja e pranueshme për ujitje është diku \$1/m³ (Lempérière). Nuk është marrë parasysh fare lokacioni për këto objekte, terreni apo natyra e akumulacionit.

Tabela 58 Vlerësimi në nivel vendi i koston së ndërtimit për akumulacionet e reja.

	Akumulimi	Lumi	Vëllimi m ³	Kosto për njësi €/m ³	Kosto totale € Milion
1	Drelaj	Pejë-Bistrica e Pejës	84.5	1.75	147.5
2	Kërstovc	Lumi i Binçës	40.0	0.93	37.3
3	Movë	Lumi i Klinës	34.0	0.98	33.3
4	Morinë	Llabenica	38.0	0.95	36.0
5	Ripaj	Lumi Trava	36.0	0.96	34.6
6	Reçan	Lumi Bistrica e Prizrenit	68.0	0.80	54.1
7	Dragaçin	Lumi Dragaçin	6.8	1.59	10.7
8	Kremenata	Lumi Kremenatë	8.8	1.47	12.9
9	Binçë	Lumi i Madhë	1.0	2.82	2.8
10	Shipashnice	Desivojce	14.9	1.20	17.9
11	Hogosht	Hogosht	9.9	1.42	14.1
12	Firajë	Lumi Lepenc	16.5	1.22	20.1
13	Shtime	Lumi Topillë	113.0	0.68	77.2
14	Cecelija	Lumi i Zi	21.0	1.13	23.8
15	Makovc	Lumi Prishtevka	10.0	1.41	14.1
16	Majanc	Lumi i Kançandollit	30.0	1.02	30.5
17	Vaganic	Lumi Lushta	8.0	1.51	12.1
18	Miraçë	Lumi Tërstena	6.0	1.65	9.9
19	Dobroshevcë	Lumi Drenica	23.2	1.10	25.5
20	Pollata	Lumi Llap	37.5	0.95	35.7
21	Bistrica	Lumi Bistricë e Prizrenit	25.0	1.07	26.8
			632.1	1.07	676.9

Duhet marr parasysh së ky është një vlerësim “i përafërt” dhe mund të konsiderohet si indikativ. Kostoja e projekteve individuale do të mund të ketë ndryshime të konsiderueshme nga këto që janë dhënë në tabelën e mësipërme bazuar në rrethanat e çmimeve për projektet në fjalë.

Duke marrë parasysh kufizimet e vlerësimit të kostove të bëra këtu, mund të shihet së ndërtimi i të gjitha këtyre akumulacioneve do të paraqiste një ndërmarrje masive dhe do të kërkonte investime të mëdha.

6.1.2 Furnizimi me Ujë

6.1.2.1 Vlerësimi global nga lartë poshtë

Këto vlerësime bazohen në konsiderimin e zbrazëtirave për përputhshmëri në nivel kombëtar, regional apo komunal dhe aplikimi i faktorit të koston apo funksionit në formë të përgjithësuar. Ky

⁸¹ Për shembull: <http://www.ecy.wa.gov/programs/wr/wstf/images/pdf/dam-doug.pdf> or F. Lempérière, HydroCoop, Paris, France “Roli i pendave në shekullin XXI”



proces na jep indikacionet e nevojave totale të mundshme, por nuk na jep informacione në nivel të projekteve (shikoni më poshtë vlerësimin “Poshtë-Lartë”).

Analiza Mjedisore e Vendeve Anëtare të Bankës Botërore

Analiza Mjedisore e Vendeve Anëtare të Bankës Botërore⁸² (AMVA) na jep një vlerësim lartë-poshtë për nën-sektorët e ujit të pijshëm dhe të ujërave të ndotura siç janë prezantuar në kornizën e mëposhtme.

AMVA të Bankës Botërore – Nevojat për Investime për Ujin e Pijshëm

Për furnizimin me ujë (përgatitjen e ujit të pijshëm plus rrjetin), një vlerësim i përafërt për njësi prej €350 për banor mund të aplikohet për vlerësimin e kostos së furnizimit me ujë të pijshëm të sigurt në zonat me shërbim të ulët (OECD 2005). Me cakun për mbulueshmërinë prej 90 përqind të popullsisë me furnizim me sistem të ujësjellësit (duke marrë parasysh që tani 40 përqind te popullsisë nuk janë të lidhur në rrjet ose ku shërbimet janë të dobëta), rreth 600,000 njerëz do të kërkonin këto investime, që do të kushtonin rreth **€210 milion**.

Metoda e Vlerësimit të Kostos

Gjatë përgatitjes së kësaj strategjie është përdorur modeli i ngjashëm me FEASIBLE për vlerësimin të kostove për të bërë një vlerësim pak më të detajuar të përputhshmërisë së kostove për të dyja, furnizimin me ujë dhe ujërat e ndotura:

- Sistemi i furnizimit me ujë
 - I ri – zgjerim
 - Ekzistues - riparimet
- Trajtimi i ujit të pijshëm (i kombinuar, i ri dhe i riparuar)

Për vlerësimin e përafërt të investimeve (kostove kapitale) dhe implikimeve në të hyrat (kostot operative) për objektivat e përcaktuara, janë vlerësuar kushtet e infrastrukturës ekzistuese në kombinim me parashikimin e thjeshtë të rritjes së popullsisë..

Vlerësimet e dhëna më poshtë janë bazuar në objektivin për të arritur mbulueshmëri me rrjetin publik të furnizimit me ujë prej 100% në të gjitha vendbanimet me më shumë se 500 banorë (duke përdorur të dhënat nga regjistrimi i popullsisë nga viti 2011). Kjo rezulton në një shkallë të përgjithshme të lidhjes prej 93%.

Tabela 59 Vlerësimi i Kostos së Përputhshmërisë – Furnizimi me Ujë të Pijshëm dhe Trajtimi (Milion Euro)

€ Milion	Sistem i ri	Sistem i rinovuar	Gjithsej
Rrjeti i ujit të pijshëm	127.6	143.5	271.1
Trajtimi i ujit të pijshëm			93.8
Gjithsej	127.59	143.47	364.82

Këto vlerësime mund të krahasohen me ato të dhëna në Studimin e Fizibilitetit për Ujë të Pijshëm të vitit 2009, nga i cili është përgatitur tabela përmbledhëse më poshtë⁸³. Vlerësimet e dhëna aty tregojnë nevojën për investimin e përafërsisht €500 milion.

⁸² Vlerësimi i kostos së degradimit të mjedisit, Shqyrtimi institucional, dhe Shqyrtimi i Shpenzimeve Publike Mjedisit, Banka Botërore, janar 2013

⁸³ Duhet të ceket se Studimi për Ujë të Pijshëm ka marrë në konsideratë një numër të konsiderueshëm të nevojave për investime për të plotësuar standardet, në detaje dhe si i tillë nuk ka qenë vlerësim “nga lartë



Tabela 60 Përmbledhja e nevojës për investime – e adaptuar nga Studimi i Fizibilitetit për Ujë të Pijshëm i vitit 2009 (Milion EURO)

Nevojat për investime për adresimin e çështjeve të cilësisë	
Investimet për modernizimin dhe renovimin e Impianteve për Trajtimin e Ujërave (ITU), të reja dhe ekzistuese	€26.4
Përmirësimet e kërkuara për sistemet e klorinimit.	€1.9
Përmirësimet e kërkuara për përditësimin e laboratorëve të KRU-ve	€0.5
Zëvendësimi dhe rinim i seksioneve me të vjetra të sistemit të gypave.	€100.0
Vazhdimësia dhe mbulueshmëria me furnizim me ujë	
Ulja e humbjes së ujit nga gypat	€45.7
Investimet për rritjen e kapaciteteve të ITU-ve	€80.0
Zgjerimi i furnizimit me ujë për të mbuluar tërë popullsinë e Kosovës	€244.0
TOTAL	Përafërsisht €500

6.1.2.2 Vlerësimi nga Poshtë-lartë

Vlerësimi nga poshtë-lartë merr parasysh identifikimin e projekteve dhe grumbullimi i tyre në një program investimi afatgjatë. Programet e detajuara për investimet afatgjata janë të rënda dhe kërkojnë kohë të gjatë për përgatitje. Për momentin programet që janë pjesë e Biznes Planeve të Kompanive Regjionale të Ujit dhe në Planet Zhvillimore Komunale janë krahasimisht afatshkurta (zakonisht 5 vite apo me pak, rrallëherë 10 vite). Prandaj të dhënat janë marrë nga Planet Investive për Infrastrukturën e Furnizimit me Ujë dhe për Ujëra të Ndotura në nivel Komunal, të përgatitura nga KRU-të dhe komunat në 2008 – 2009 me ndihmën e bashkëpunimit nga ana e USAID, IRD, CDF, SHUKOS dhe UNDP. Gjithashtu është marrë në konsideratë Plani Afatgjatë i Investimeve për Ujësjellës dhe Kanalizim për qytetin e Prishtinës.

Plani Afatgjatë i Investimeve për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizime për Qytetin e Prishtinës

Plani i investimeve afatgjata për qytetin e Prishtinës është përgatitur në vitin 2010 nën financimin e KfW. Kërkesat e përgjithshme për investime për furnizimin me ujë (Shtojca 4.3) të qytetit dhe zonës së saj industriale është dhënë më poshtë.

Tabela 61 Qyteti i Prishtinës - Plani afatgjatë i investimeve – Furnizimi me ujë

	2010	2020	2030	2040	Gjithsej
Riparimet e furnizimit me ujë	116,550,000				116,550,000
Zgjerimi i furnizimit me ujë		89,774,300	31,410,000	7,343,500	128,527,800
Ujëra - Gjithsej	116,550,000	89,774,300	31,410,000	7,343,500	245,077,800

Vlerësimet për nevojat për investime në sistemin e furnizimit me ujë duken shumë të larta në krahasim me vlerësimet tjera të ngjashme.

Planet e Investimeve Komunale

Planet e investimeve për 23 komuna ekzistojnë në kohën e përgatitjes së kësaj Strategjie. Planet e veçanta nuk janë përgatitur për komunat që kanë filluar punën në bazë të reformave të vitit 2008*:

- Graçanicë*
- Junik*
- Kamenicë*

poshtë” sa për të thënë. Megjithatë, vlerësimet e kostove të renovimit afatmesëm të rrjetit dhe zgjerimit të sistemit janë bazuar në qasjen lartë-poshtë.



- Mamushë*
- Novobërdë
- Partesh*
- Ranillug*

Investimet për këto komuna kanë qenë të përfshira në planet komunale por jo si të veçanta.

Planet për investime nuk janë përgatitur për komunat në vijim:

- Lepasaviq
- Novobërdë
- Rahovec
- Shtërpcë
- Skenderaj
- Zubin Potok
- Zveçan

Aplikimi i të dhënave ekzistuese për popullsinë tregon se këto komuna përbëjnë 8% të popullsisë totale. Një fond shtesë për investime në këto zona duhet të përgatitet – vlera prej 10% është e arsyeshme.

Për me tepër, është vërejtur se ekziston një numër mospërputhjesh në mes të planeve dhe mungojnë disa informata kyçe për kostot:

- Periudha investive e planeve është paraparë të jetë maksimum 25 vjet, por jo të gjitha planet përfshijnë të gjitha nevojat afatgjata për përputhshmëri të plotë dhe perspektivën e zgjerimit të rrjetit;
- Disa investime janë identifikuar por jo edhe kostot e tyre;
- Kostot e rrjeteve të furnizimit me ujë dhe rrjeteve të kanalizimit janë bazuar në të dhëna të besueshme;
- Kosto e trajtimit të ujërave të ndotura janë të përafërta dhe këto kosto nuk janë përfshirë në të gjitha planet;
- Vetëm një numër i vogël i planeve i konsiderojnë planet për mbrojtje nga vërshimet;
- Vetëm një numër i vogël i planeve i konsiderojnë planet për drenazhimin e ujërave nga reshjet;
- Ka një spektër të gjërë të kostove që janë identifikuar në këto plane, qoftë sa i përket nevojave të përgjithshme për investime dhe kostove specifike (për person apo për lidhje).

Shumë nga këto plane janë të standardeve të larta dhe mund të vazhdojnë të jenë bazë për planifikimin afatgjatë për komunat dhe për KRU-të. Megjithatë, disa prej tyre kanë nevojë për rishikim për të reflektuar ndryshimet në kufijtë e komunave dhe për të adresuar mungesat e cekura me lartë. Investimet e identifikuara për secilën komunë janë përmbledhur më poshtë.



Tabela 62 kërkesat për investime për Komuna – Planet e vitit 2009

Komuna	Popullsia	Investimet në ujëra	Investimet për person
Deçan	40,019	€28,000	€0.70
Dragash	33,490	€4,150,568	€123.93
Ferizaj	108,610	€6,484,000	€59.70
Fushë Kosovë	34,827	€2,740,000	€78.67
Gjakovë	94,556	€25,250,000	€267.04
Gjilan ⁸⁴	90,178	€60,240,000	€668.01
Drenas	58,531	€3,265,000	€55.78
Hani i Elezit	9,403	€1,300,000	€138.25
Istog	39,170	€2,200,000	€56.17
Kaçanik	33,409	€4,400,000	€131.70
Klinë	38,396	€-	€-
Lipjan	57,605	€8,515,000	€147.82
Malishevë	54,613	€3,131,413	€57.34
Mitrovicë	71,909	€20,669,042	€287.43
Obiliq	21,554	€5,400,000	€250.53
Pejë	96,450	€7,414,365	€76.87
Podujevë	88,589	€6,380,000	€72.02
Prishtinë	199,635	€46,412,000	€232.48
Prizren	177,781	€34,118,654	€191.91
Shtime	27,324	€800,000	€29.28
Suharekë	59,713	€16,780,606	€281.02
Viti	46,987	€-	€-
Vushtrri	77,246	€16,860,465	€218.27
	1,559,995	€276,539,113	€177.27

Siç është treguar këtu, kostot e investimeve dallojnë shumë nëse shikohen në bazë të kostove për person. Në disa zona ka nënvlerësim serioz të nevojave për investime.

Investimet për furnizim me ujë të identifikuar në plane janë kategorizuar dhe janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 63 Përmbledhje e nevojave për investime për furnizimin me ujë të identifikuar në planin për investime të vitit 2009.

Nën-Sektori	Funksioni	Lloji	Kostoja Totale	Proporcioni
I Ujërave	Furnizimi	I ri	€101,065,483	36.5%
I Ujërave	Furnizimi	Riparim	€82,461,630	29.8%
I Ujërave	Furnizimi	Të gjithë	€183,527,113	66.4%
I Ujërave	Burimi	I ri	€84,360,000	30.5%
I Ujërave	Burimi	Riparim	€7,472,000	2.7%
I Ujërave	Burimi	Të gjithë	€91,832,000	33.2%
I Ujërave	Matje		€1,180,000	0.4%
I Ujërave	Të gjithë	Të gjithë	€276,539,113	100.0%

⁸⁴ Vlera relativisht e lartë e dhënë për Gjilanin vjen si rezultat i përfshirjes në planin e investimeve të €55 milion për zhvillimin e një burimi të ri për Gjilan dhe Viti



Dragashi

Masterplani për ujësjellës dhe për ujëra të ndotura për komunën e Dragashit është përgatitur nga projekti i UND-së: Konservimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Përdorimit të Tokave në Dragash: *Masterplani, Strategjia komunale për implementimin e zhvillimit hap pas hapi të shërbimeve me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve*, Dragash, Kosovë. Kostoja e përgjithshme e furnizimit me ujë është përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 64 Masterplani i Dragashit – përmbledhja e investimeve për ujë të pijshëm

000 Euro	Faza 1a	Faza 1b	Faza 2	Faza 3	Të gjitha Fazat
	2013-2016	2017-2020	2020-2023	2023-2033	2013-2033
Ujëra	3,507	2,611	2,474	2,322	10,914

Siç shihet, nevoja e përgjithshme për investime për nën-sektorin e furnizimit me ujë për komunën e Dragashit në periudhën deri në vitin 2033 është vlerësuar të jetë rreth €11 Milion. Kjo paraqet një shumë bruto prej rreth €330 për kokë banori.

6.1.2.3 Vlerësimi i Nevojave të Përgjithshme për Investime – Uji i Pijshëm

Përderisa tri vlerësimet lartë-poshtë të konsideruara këtu mund të duket së po tregojnë vlera të ndryshme, në fakt ka përputhje të madhe:

- Rinovimi i rrjetit ekzistues për ujë të pijshëm: €120 - €150 milion
- Investimet për trajtimin e ujit të pijshëm: €90 – 100 milion
- Investimet për zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë (veçanërisht në zonat rurale):
 - Mbulueshmëria e plotë (100%): €210 - €250 milion
 - Duke përjashtuar vendbanimet e vogla (93%): €125 milion

Vlerësimet poshtë-lartë arrijnë një vlerë rreth €276 milion. Megjithatë, siç është thënë këtu, ky vlerësim nuk mbulon tërë territorin dhe për disa komuna vlerësimi duket të jetë i ulët. Përgjithësisht një vlerë rreth €330 milion vlerësohet të jetë e arsyeshme .

Si përfundim, nevojat e përgjithshme për investime janë vlerësuar të jenë nga €330 milion deri në €500 milion, varësisht nga objektivat e përcaktuara për rinovimin e rrjetit, objektivit të përcaktuar për mbulueshmërinë me rrjet dhe parametrat që kanë të bëjnë me popullsinë dhe trendët e zhvillimit urban.

6.1.3 Ujitja

Bujqësia është pjesë kyçe e ekonomisë (13% e BPV-së) dhe e punësimit (së paku 4.6%)⁸⁵. Megjithatë, Kosova mbetet neto importues i ushqimit dhe shtazëve⁸⁶. Siç është cekur në *Programin për Zhvillim të Bujqësisë dhe Zonave Rurale*, përmirësimi i konkurrencës është objektivi kyç. **Një nga fytyrat e ngushta që janë identifikuar për zhvillimin e bujqësisë është sistemi i dobët i ujitjes, i kufizuar në mbulueshmëri dhe teknologji.**

Raportet e ofruesve kryesorë të ujitjes tregojnë së në vitet e fundit sipërfaqja e ujitur nëpërmjet skemave të tyre arrin rreth 7,000 deri në 9,700 hektarë.

⁸⁵ Rezultatet e Sondazhit të Fuqisë Punëtore në Kosovë 2012 – Agjencia e Statistikave të Kosovës, shtator 2013, Tabela 1.6B. Megjithatë, dihet që shumica e punësimit në bujqësi është “joformale” siç është cekur në seksionin 5 të Sondazhit.

⁸⁶ Statistikat e Tregtisë së Jashtme sipas SITC – Agjencia e Statistikave të Kosovës



Tabela 65 Zonat e raportuara të ujitura nga kompanitë publike⁸⁷ (hektarë)

Kompania e ujitjes	2012	2013	2014
KU "Radoniqi – Dukagjini" Sh.a.	5,176	5,243	5,134
KU "Drini i Bardhë" Sh.a.	2,610	2,460	631.5
NPH Ibër – Lepenci Sh.a.	1,860	1,703	1,490
Gjithsej	9,646	9,406	7,256

Ujitja shtesë përmes skemave tjera të ujitjes vlerësohet të sigurojë rreth 4,000 hektarë shtesë, duke e dhënë një sipërfaqe totale të ujitjes prej rreth 12,000 hektarë.

Niveli i përdorimit të ujitjes është shumë më i ulët se që ka qenë në të kaluarën, dhe prandaj ekziston potencial i konsiderueshëm për rritjen e nivelit të ujitjes së tokave për të mbështetur prodhimin e kulturave bujqësore me vlerë të lartë, në mënyrë që sipërfaqja e ujitshme e dobishme të jetë më shumë se dyfishi i sipërfaqes aktualisht të ujitur, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 66 Mbulueshmëria e skemës së ujitjes sipas skemës⁸⁸

Sistemi	Sipërfaqja e ujitur me 2004-2012 (ha)	Sipërfaqja e ujitshme (ha)
Ibër –Lepenci	2,500	14,500
Radoniqi	4,700	5,000
Dukagjini	800	2,500
Drini i Bardhë - Pejë	1,300	2,500
Istog	1,350	2,000
Lumbardhë	1,650	3,000
Gjithsej	12,300	29,500

Treguesit e ujitjes për vendet me ujitje më intensive në jug të Evropës⁸⁹ tregojnë se rreth 7% e sipërfaqes totale të tokës së tyre është e pajisur për ujitje. Gjashtë vendet e dhëna në tabelën e mëposhtme përbëjnë rreth 84% të tokës së ujitur në Bashkimin Evropian. Për Kosovën, me një sipërfaqe prej gati 11,000 km², 7% do të përfaqësonte një sipërfaqe prej rreth 80,000 hektarë; kjo është shumë më tepër se sipërfaqja e ujitshme e vlerësuar. Në baza për kokë banori, ujitja e 29,500 hektarëve në Kosovë do të përfaqësonte rreth 0.017 hektarë për banor, që është shumë më pak se ajo e vlerësuar më poshtë për vendet me mbulueshmëri më të lartë të ujitjes në Evropën Jugore.

Intensiteti i ujitjes shprehet gjithashtu në terme të proporcionit të tokës bujqësore që është e përshtatshme për ujitje. Proporcioni mesatar i tokave të punueshme (duke përfshirë pyjet) që mbulohet me ujitje nga përdoruesit kryesor të ujitjes në BE ishte rreth 20%. Toka e punueshme në Kosovë raportohet⁹⁰ të jetë përafërsisht 250,000 hektarë. Mbulimi me ujitje i 25,000 hektarëve do të përfaqësonte 10%, që është shumë më ulët se vlera mesatare për vendet që janë konsideruar këtu.

⁸⁷ Raportet vjetore të performancës të ndërmarrjeve publike qendrore, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

⁸⁸ Këto të dhëna janë të fundit të disponueshme

⁸⁹ Raporti EEA Nr 2/2009 Burimet ujore nëpër Evropë — duke u përballur me mungesën dhe thatësira të ujit, fq.40

⁹⁰ Sondazhi i Familjeve Bujqësore 2008, Agjencia e Statistikave të Kosovës



Si përfundim, renovimi dhe zgjerimi i sistemeve të ujitjes në Kosovë për të gjitha sipërfaqet e ujitshme (29,000 hektarë), do të rezultonte në një intensitet të ujitjes në Kosovë që është ende shumë më i ultë se në shumicën e vendeve që përdorin ujitjen në Evropë, dhe kështu mund të konsiderohet si objektivi real.

Tabela 67 Sipërfaqet e ujitura - EEA 2009

Vendi	Popullsia milionë	Sipërfaqja km ²	E ujitur hektarë	Proporcioni % e ujitur	Intensiteti ha / person
Franca	63.7	543,965	2,710,000	5%	0.0425
Greqia	11.2	131,957	1,590,000	12%	0.1420
Italia	59.6	301,338	3,970,000	13%	0.0666
Portugalia	10.6	92,345	620,000	7%	0.0585
Spanja	45.2	505,988	3,770,000	7%	0.0834
Rumania	21.5	237,500	810,000	3%	0.0377
Gjithsej	212	1,813,093	13,470,000	7%	0.0636

Aktualisht raportohet se 140 milionë m³ përdoren për të ujitur 12,000 hektarë përmes kompanive të mëdha për ujitje. Kjo paraqet një normë të aplikimit prej rreth 11,500 m³/hektar. Normat e aplikimit në vendet anëtare të BE-së kryesisht janë në kufijtë prej 5,000 – 7,000 m³/hektar⁹¹.

Nëse Kosova është në gjendje të rris eficiencën e ujitjes dhe kështu të zvogëlojë normën bruto të aplikimit në një vlerë të përafërt me ato të treguara për vendet anëtare të BE-së, kjo në masë të madhe do ta kompensonte rritjen e konsumit si rezultat i mbulueshmërisë së rritur në sipërfaqen e ujitur. Reduktimi i normës së aplikimit në rreth 7,000 m³/hektar derisa në të njëjtën kohë bëhet rritja e mbulueshmërisë prej 12,300 hektarë në 29,000 hektarë do të rezultonte në rritje të konsumit prej rreth 45%. Kjo paraqet një sasi shtesë të ujit prej 60 milionë m³ për vit. Ky vëllim paraqet rreth një të tretën e konsumit aktual për shërbimet e furnizimit urban. Me fjalë tjera, ky vëllim paraqet rreth gjysmën e ujit të humbur të raportuar për sistemet e furnizimit me ujë në vende urbane. Ky vlerësim në nivel vendi nuk i merr parasysh situatat specifike në pellgje të veçanta, dhe është e qartë që kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet rritjet e ujitjes në pellgjet me *stres ujor* më të theksuar, sidomos Ibri dhe Lepenci.

Efienca e shfrytëzimit të ujit për ujitje në aspektin e vlerës së shtuar për njësi të konsumit nuk është vlerësuar formalisht për shkak të mungesës së të dhënave. Megjithatë, duke marrë parasysh vjetërsinë dhe natyrën e pajisjeve të përdorura, dhe normave të vlerësuara të aplikimit, duket se ka potencial të dukshëm për përmirësime në këtë plan.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017 – 2019 specifikon “zgjerimin e sistemeve të ujitjes” si një objektivi.

Nevojat për investimet e mëtejme për renovimin e sistemeve ekzistuese të ujitjes, për zgjerimin e sistemeve me qëllim të arritjes së niveleve më të larta të mbulueshmërisë dhe për përmirësimet e efikasitetit të sistemeve të aplikimit ende nuk janë bërë në detaje. Megjithatë mund të nxjerret një vlerësim i epërm tregues duke zbatuar normën e kostos së investimit për hektar⁹² prej €15,000 për ujitje efikase pikë pikë, duke përjashtuar investimet në rezervuare të cekura më lartë, dhe duke supozuar dyfishimin e sipërfaqes aktualisht të ujitur në një total prej rreth 25,000 hektarë. Ky vlerësim i përafërt parasheh një vlerë investive prej rreth €150 milionë. Megjithatë, ky vlerësim nuk e merr

⁹¹ <http://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/use-of-freshwater-resources/use-of-freshwater-resources-assessment-2>

⁹² Shiqoni shëmbullin: <http://www.fao.org/docrep/W7314E/w7314e0h.htm>



parasysh infrastrukturën ekzistuese apo investimet që po bëhen në afat të shkurtër. Një vlerë dukshëm më e ulët e më pak se gjysma e vlerësimit të sipërm do të mund të parashihej në mënyrë të arsyeshme, dhe prandaj për qëllime të planifikimit strategjik financiar nevojitet investimi prej €70 milionë.

Figura 29 Toka bujqësore e përshtatshme për ujtje – sipas klasifikimit (Raporti mbi GjeU , 2010)





Figura 30 Sipërfaqet e përshtatshme për ujitje -Pellgu i Ibri





6.1.4 Hidroenergja

Kosova është në gjendje të gjenerojë energji të mjaftueshme për të mbuluar ngarkesën bazë, por është e angazhuar që të plotësojë kërkesën maksimale (pikun). Kostoja e importit të energjisë elektrike për të plotësuar kërkesën maksimale është e lartë (krahasuar me koston e gjenerimit të ngarkesës bazë) siç është treguar me lartë. Prandaj ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të hidroenergjisë është prioritet për të siguruar plotësimin e kërkesës maksimale dhe për të ulur koston e mbulimit të kësaj kërkesë.

Zyra Rregullatore e Energjisë⁹³ konstaton :

- Kontributi i gjenerimit të KEK-ut në sistem: €29.75 për MWh
- Kontributi i gjenerimit të Ujmanit: €27.50 për MWh
- Importet: €70.00 për MWh
- Eksportet: €30.00 për MWh

Në përgjithësi tarifa e shitjes me shumicë e energjisë elektrike është €0.0335/kWh dhe tarifa mesatare për shfrytëzuesit është rreth €0.058/kWh⁹⁴.

Potenciali për gjenerim të energjisë së ripërtëritshme⁹⁵ dhe ndikimet⁹⁶ e skemave të tilla janë shqyrtuar në disa studime.

Për momentin po përgatiten dy skema kryesore për implementim nga Kelkos:

- Kaskada e Pejës:
 - Drelaj 1: 4.3 MW
 - Drelaj 2: 11.6 MW
 - Shtupeq: 11.6 MW
 - Rugova: 31.8 MW
 - Kuqishte: 4.7 MW
 - Gjithsej: 57.8 MW
 - Kosto e vlerësuar: €120 Milionë
- Kaskada e Deçanit:
 - Lumbardhi 2: ~10 MW
 - Belleja: 5.2 MW
 - Deçani: 8.3 MW
 - Gjithsej: 23 MW
 - Kosto e vlerësuar: €55 Milionë

Përveç kësaj janë identifikuar një skemë tjetër e madhe dhe një numër i skemave tjera të vogla:

⁹³ <http://ero->

[ks.org/Tarifat/2012/January/english/Tariff_Application_2012_Part_III_Wholesale_Electricity_Price.pdf](http://ero-ks.org/Tarifat/2012/January/english/Tariff_Application_2012_Part_III_Wholesale_Electricity_Price.pdf)

⁹⁴ Projekti për efikasitet energjetike dhe energji të ripërtrishme në Kosovë, (P143055), PID, Banka Botërore

⁹⁵ Opsionet për energji të qëndrueshme për Kosovën. Analiza e disponueshmërisë së burimeve dhe koston, Grupi për Energji dhe Resurse, Universiteti I Kalifornisë, Berkeley, Janar 2012

⁹⁶ Shikoni p.sh.: Analiza e Energjisë së ripërtrishme dhe Ndikimi I saj në Zhvillimin Rural në Kosovë, Rrjeti I Zgjerimit për Politika Bujqësore, Nëntor 2009



- Skema e madhe – Hidrocentralet e Zhurit (HC I dhe II e Zhurit): studimi origjinal i fizibilitetit i vitit 1983, i rishikuar në vitin 2001, dhe propozimi tjetër i zhvilluar, rishikuar dhe reviduar në vitin 2009
- Sa i përket potencialit hidroenergjetik nga skemat më të vogla, studimi më i detajuar deri më tani është bërë në vitin 2006⁹⁷

6.1.4.1 Skema e madhe - Zhuri

Duke marrë parasysh skemën e madhe të hidrocentralit në Zhur, vlerësimi origjinal i kostos për këtë central tregohet më poshtë: €287 milion.

Tabela 68 Vlerësimi i Kostos së Ndërtimit – Skema e Hct të Zhurit: Vlerësimi Original

Ref	Zëri i Kostos	Kosto e ndërtimit (pa TVSh) Euro
PUNËT NDËRTIMORE		
1	Ndërtimi	€126,890,000
2	Pajisjet	€33,442,000
3	Pajisjet elektromekanike	€76,267,000
SHPENZIMET FILLESTARE		
1	Studimet dhe punët hulumtuese	€7,695,000
2	Projekti dhe mbikëqyrja inxhinierike	€4,217,000
3	Mbikëqyrja në terren dhe shpenzimet e pronarit	€8,681,000
4	Shpronësimi i tokave dhe shtëpive (me taksat e shitjes)	€29,824,000
INVESTIMET TOTALE		287,016,000

Gjatë revidimit të Studimit të Fizibilitetit për HC e Zhurit⁹⁸, është përgatitur një vlerësim i rishikuar i kostove totale, që tregon një rritje të dukshme të kostove të vlerësuara në €329 Milionë (një rritje prej 15%), siç tregohet më poshtë.

Tabela 69 Vlerësimi i rishikuar i Kostos - HC i Zhurit

Zëri	Kosto Totale €
Shpronësimi i tokave	€29,824,000
Punët ndërtimore	€126,890,000
Pajisjet	€109,708,000
Të tjera	€20,593,000
Asetet (kapitale) totale afatgjata	€287,017,000
Asetet e tanishme	€3,110,000
Monitorimi	€175,000
Kamatat gjatë ndërtimit (7%)	€39,030
Totali i asetëve kapitale dhe të tanishme, monitorimi	€329,332,000

Projekti i rishikuar i Zhurit (2009) thekson:

- Për arritjen e profitit nga projekti nga ana e koncesionarit prej 7% gjatë një periudhe prej 50 vitesh, duke përfshirë të ardhurat nga ulja e emetimit të CO₂, çmimi i shitjes së energjisë elektrike do të ishte 84.65 €/MWh.

⁹⁷ Studimi I parafizibilitetit për identifikimin e resurseve ujore dhe shfrytëzimit të tyre përmes hidrocentraleve të vogla në Kosovë, Ministria e Energjisë dhe Minerave, Asociacioni Shqipëtar i Energjisë dhe Mjedisit për Zhvillim të Qëndrueshëm, DANIDA, maj 2006

⁹⁸ Rishikimi I studimit të fizibilitetit për HC-në e Zhurit, Grant nr. H2540, Banka Botërore, ELEKTROPROJEKT, maj 2009



- Pasi që, duke marrë parasysh aspektet energjetike, është e domosdoshme që HC i Zhurit të jetë i liruar nga rreziku i tregut, ka vetëm rrezik që gjenerimi i elektricitetit të varet nga disponueshmëria e mjaftueshme e ujit. Për atë arsye, pronari i kapitalit do të mund të ulte profitabilitetin marginal nën 7%. Nëse profitabiliteti marginal është 5%, çmimi i shitjes së energjisë elektrike së bashku me të ardhurat nga ulja e emetimit të CO₂ do të duhej të ishte 69.15 €/MWh nga ana e koncesionarit, do të thotë 66.63 €/MWh nga ana e KEK-ut (si dhënës i koncesionit).

6.1.4.2 Skemat e vogla

Siç u tha më lartë, skemat më të vogla janë gjithashtu pjesë e politikave qeveritare të pranuar.

Tabela 70 Skemat e hidrocentraleve të vogla (të dhënat me ngjyrë hiri janë përfshirë në kaskada të Pejës dhe Deçanit)

Emri	Fuqia [kW]	Energji Milion ë kWh	Ndërtimore Milionë Euro	Mekanike Milionë Euro	Energji Milionë Euro	Dizajn Milion ë Euro	Gjithsej Milionë Euro
Hidrocentralet e reja që do të ndërtohen							
1: HC Kuqishtë	3,900	17	2.20	1.20	0.10	0.12	3.62
2: HC Drelaj	6,200	27	2.90	2.10	0.10	0.18	5.28
3: HC Shtupeq	7,600	35	3.55	2.60	0.15	0.22	6.52
4: HC Bellajë	5,200	25	2.80	1.90	0.10	0.17	4.97
5: HC Deçan	8,300	39	2.95	3.00	0.15	0.21	6.31
6: HC Lloçan	3,100	14	1.50	1.50	0.10	0.11	3.21
7: HC Mal	4,000	18	2.15	1.70	0.15	0.14	4.14
8: HC Erenik	2,000	9	1.40	0.70	0.10	0.12	2.32
9: HC Jasiq	1,900	10	1.05	0.70	0.10	0.10	1.95
10: HC Dragash	2,200	10	1.50	0.65	0.10	0.10	2.35
11: HC Orçush	5,600	26	2.15	1.90	0.15	0.15	4.35
12: HC Reçan	1,500	7	1.15	0.50	0.10	0.11	1.86
13: HC Brezovicë	2,100	10	1.80	0.70	0.10	0.12	2.72
14: HC Lepenc	3,500	16	2.65	1.00	0.15	0.13	3.93
15: HC Bajskë	300	1	0.85	0.15	0.10	0.05	1.15
16: HC Batare	1,100	6	1.66	0.39	0.15	0.10	2.30
17: HC Majanc	600	3	0.87	0.20	0.03	0.08	1.18
18: HC Mirusha	4,600	22	9.20	5.00	0.10	0.36	14.66
Totali i hidrocentraleve të reja	63,700	294	42.33	25.89	2.03	2.58	72.83
Hidrocentralet ekzistuese që do të rehabilitohen/modernizohen							
19: HC Dikancit	1,900	10	0.20	0.53	0.10	0.03	0.86
20: HC Radavcit	350	2	0.04	0.12	0.10	0.01	0.26
21: HC Burimit	800	5	0.09	0.31	0.10	0.02	0.51
22: HC Prizrenit	330	1	0.04	0.15	0.10	0.01	0.30
23: HC Shtimes	140	1	0.02	0.07	0.10	0.01	0.19
Totali i hidrocentraleve ekzistuese	3,520	18	0.38	1.18	0.50	0.07	2.13
TOTALI i të dy grupeve	67,220	313	42.71	27.07	2.53	2.66	74.96



6.2 Mbrojtja e Ujërave

6.2.1 Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura

6.2.1.1 Vlerësimi lartë-poshtë

Ashtu si në rastin e furnizimit me ujë vlerësimet lartë-poshtë mund të gjenden nga Banka Botërore dhe puna e ndërmarrë në përgatitjen e kësaj strategjie.

Analiza Mjedisore e Shtetit (AMSH) nga Banka Botërore

AMSH nga Banka Botërore – Nevojat zhvillimore për grumbullimin dhe trajtimin të ujërave të ndotura *Për vlerësimin nevojave për investime në sektorin e ujërave të ndotura analiza e Bankës Botërore supozon që 50% të popullsisë momentalisht iu ofrohet shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura, dhe që caku është të arrihet niveli prej 90%. Vlerësimi më tutje supozon që:*

- *Vendbanimet e mëdha – trajtimi terciar i ujërave të ndotura duke përfshirë largimin e nutrientëve*
- *Vendbanimet e mesme – trajtimi sekondar biologjik*
- *Vendbanimet e vogla – trajtimi ekstensiv i ujërave të ndotura*

Për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura/kanalizimeve, vlerësimi i thjeshtë në vijim i investimeve bazohet në krahasimin ndërkombëtar për kostot për njësi në mënyrë që të jetë në pajtim me standardet e BE-së. Rreth 50 përqind e popullsisë kanë qasje në sistemet e kanalizimit, kundrejt normës së dëshiruar prej 90 përqind. Rreth 0.7 milionë banorë do të duhej të kyçen në rrjetin e kanalizimit. Më tutje, disa kanalizime mbliidhen dhe shkarkohen pa trajtim, prandaj me lidhje shtesë në rrjetin e kanalizimit, do të nevojitet trajtimi i ujërave të ndotura të 1.6 milionë banorëve të Kosovës. Supozohet një periudhë 10-vjeçare për kostot e pajtueshmërisë me rregulloret e BE-së ... Për sistemet e kanalizimeve investimet e njësisë për banor variojnë nga €670 deri €770, për trajtimin e ujërave të ndotura nga €70 deri €120 (kallamishtet kushtojnë rreth €35 për banorë).

Siç u pa më sipër, nevojat investive totale të vlerësuara për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura vlerësohet të jenë €424 milion. Kostot vjetore operative pas këtyre investimeve vlerësohet të jenë rreth €80 milionë për vit.

Tabela 71 Banka Botërore – Vlerësimi i kostos për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura

	Investimet totale € milion		Kostoja vjetore për operacione € milion		
	2010-15	2015-20	2010	2015	2020
Grumbullimi	122	250	21	31	42
Trajtimi	64	174	0	12	38
Gjithsej	185	424	21	43	80

Për t'iu përmbajtur standardeve të BE-së duhet të investohen rreth €425 milionë në grumbullimin (kryesisht në zonat periferike dhe rurale) dhe trajtimin (në mbarë vendin) e ujërave të ndotura/kanalizimit. Në vitin 2010 kostot vjetore të operimit të sistemit të ujërave të ndotura ishin rreth €20 milionë. Kur të jetë arritur përputhshmëria e plotë, kostoja vjetore e operacioneve vlerësohet të jetë €80 milion.

6.2.1.2 Modeli i kostos së përputhshmërisë

Është bërë një vlerësim i kostos totale të përputhshmërisë që ka të bëjë me grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura bazuar në një plan paraprak të aglomeracioneve pas definimit dhe kërkesave të



përcaktuara në Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC) të Bashkimit Evropian dhe në udhëzimet që shoqërojnë atë. Zbatimi i planit ka identifikuar 76 aglomeracione kandidatë. Prej këtyre 50 janë mbi pragun kryesor prej 2,000 b.e. të përcaktuar në DTUNU. Janë përgatitur vlerësimet e kostove të përputhshmërisë të asociuara me këto 50 aglomerate.

Tabela 72 Statistikat preliminare të aglomeracioneve të përkufizuara

Më e ulët	Më e lartë	Popullsia	Numri
>0	<1,000	6,622	10
>999	<2,000	24,079	16
>1,999	<10,000	120,719	29
>9.999	<50,000	379,720	13
>49.999	<100,000	433,715	6
>99.999	<1,000,000	384,166	2
		1,349,021	76

Vlerësimet marrin parasysh:

- Nevojën për riparimin e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit
- Nevojën për zgjerimin e rrjeteve për të ofruar mbulim të plotë në të gjitha aglomeracionet që kanë mbi 2,000 b.e.
- Nevojën për trajtimin e ujërave të ndotura:
 - Ekstensive⁹⁹ në aglomeracionet e vogla
 - Sekondare në shumicën e aglomeracioneve
 - Terciare në aglomeracionet e mëdha (qytete)

Bazat për vlerësime janë:

- Aglomeracioni si njësi për përputhshmëri¹⁰⁰
- Mbulueshmëria e përgjithshme prej rreth 73% të popullsisë totale
- Vlerësimet për mbulueshmëri momentale me shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura
- Gjendja momentale e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit
- Funksionet e standardizuara të kostos.

Rezultatet e vlerësimeve janë përmbledhur këtu:

Nevojat për investime në sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura (kanalizim) janë rreth €580 milionë duke përfshirë ato për ndërrimin e një pjese të madhe të rrjeteve ekzistuese (rreth 40% të totalit, duke përfshirë një shumë të caktuar për përmirësimin e menaxhimit të ujërave atmosferike).

Nevojat për investime për trajtimin e ujërave të ndotura janë vlerësuar në rreth €220 milionë.

Vlerësimi për shpenzimet kapitale në total është rreth €800 milionë.

Kostot operative vjetore pas këtij investimi llogariten në rreth €70 milionë për vit.

⁹⁹ Shiko p.sh.: http://ec.europa.eu/environment/water/water-urbanwaste/info/pdf/watguide_en.pdf

¹⁰⁰ Aglomeracionet kanë qenë të definuara “përafërsisht” sipas Raportit të regjistrimit të popullsisë



6.2.1.3 Vlerësimi Poshtë-Lartë

Planet e Investimeve për Komuna - 2009

Tabela 73 Kërkesat për Investime për Komunë – Planet e vitit 2009

Komuna	Popullsia	Investimet për ujëra të ndotura	Investimet për person
Deçan	40,019	€-	€-
Dragash ¹⁰¹	33,490	€28,884,950	€862.49
Ferizaj	108,610	€8,599,336	€79.18
Fushë Kosovë	34,827	€14,173,000	€406.95
Gjakovë	94,556	€15,491,085	€163.83
Gjilan	90,178	€40,757,000	€451.96
Drenas	58,531	€14,034,900	€239.79
Hani i Elezit	9,403	€2,013,000	€214.08
Istog	39,170	€27,691,000	€706.94
Kaçanik	33,409	€13,715,000	€410.52
Klinë	38,396	€-	€-
Lipjan ¹⁰²	57,605	€47,353,900	€822.04
Malishevë	54,613	€7,810,000	€143.01
Mitrovicë ¹⁰³	71,909	€75,529,000	€1,050.34
Obiliq	21,554	€9,874,000	€458.11
Pejë	96,450	€58,792,500	€609.56
Podujevë	88,589	€36,365,167	€410.49
Prishtinë	199,635	€5,660,000	€28.35
Prizren	177,781	€60,582,279	€340.77
Shtime	27,324	€12,032,180	€440.35
Suharekë	59,713	€22,695,000	€380.07
Viti	46,987	€-	€-
Vushtrri	77,246	€22,941,100	€296.99
	1,559,995	€524,994,397	€336.54

Një gamë e gjerë e kostove investive të identifikuar vijnë si rezultat i dallimeve në qasjen e ndërmarrë në planet për nivelin e mbulueshmërisë (që variojnë nga urban, urban me rrethinë, deri te mbulimi i plotë) dhe vlerësimi i nevojave për investime për trajtimin e ujërave të ndotura (në disa raste nuk është bërë asnjë vlerësim).

Nevojat për investime të kategorizuara për të gjitha komunat janë përmbledhur këtu.

¹⁰¹ Vlera shumë e lartë për investime vjen si rezultat i përfshirjes së €16 milionëve për trajtimin e ujërave të ndotura. Kjo vlerë është rivlerësuar dhe është zvogëluar dukshëm në Planin Kryesor të fundit nga UNDP.

¹⁰² Vlera relativisht e lartë e dhënë këtu vjen si rezultat i përfshirjes së shumës prej €25 milionëve për trajtimin e ujërave të ndotura

¹⁰³ Vlera shumë e lartë e investimeve vjen si rezultat i përfshirjes së një vlerësimi të "thjeshtë" të kërkesave të kolektorit dhe impiantit të trajtimit prej €50 milionë.



Tabela 74 Vlerësimet e kostos së investimeve për përputhshmëri: ujërat e ndotura – planet investive të vitit 2009

Nën-Sektori	Funksioni	Lloji	Investimet	Proporcioni
Ujërat e Ndotura	Mbledhja	I ri	€261,351,345	49.8%
Ujërat e Ndotura	Mbledhja	Riparim	€14,820,152	2.8%
Ujërat e Ndotura	Mbledhja	Të gjitha	€276,171,497	52.6%
Ujërat e Ndotura	Trajtim	I ri	€248,822,900	47.4%
Ujërat e Ndotura	Trajtim	Riparim	€-	0.0%
Ujërat e Ndotura	Trajtimet	Të gjitha	€248,822,900	47.4%
Ujërat e Ndotura	Të gjitha	Të gjitha	€524,994,397	100.0%

Vlerësimi i përgjithshëm i nevojave për investime është rreth €525 milionë. Megjithatë, duhet cekur së kjo duhet të konsiderohet si nënvlerësim. Siç u tha me lartë, disa nga komunat nuk janë përfshirë (~8% e popullsisë), disa nga komunat për të cilat kostoja për person e investimeve për ujëra të ndotura nuk është vlerësuar plotësisht (sidomos për Prishtinën dhe Ferizajin). Përshtatja e saktë e vlerësimeve për të marr parasysh këto çështje është problematike. Megjithatë, është e arsyeshme të supozojmë kërkesa shtesë prej:

- 10% për të mbuluar ato komuna që nuk janë përfshirë këtu
- 15% për të mbuluar kërkesat shtesë për Prishtinën
- 5% për të mbuluar kërkesat shtesë për Ferizajin

Një përshtatje e tillë do të jepte një kosto totale të përputhshmërisë prej përafërsisht €675 milionë.

Masterplani për ujërat e ndotura të pellgut të lumit Ibër dhe lumit Moravë

I përgatitur në vitin 2011 masterplani i ujërave të ndotura mbulon pellgun e lumit Ibër dhe përfshin popullsinë në vazhdim.

Tabela 75 Pellgu Ibër - Morava perëndimore – Plani kryesor i ujërave të ndotura mbi mbulueshmërinë e popullsisë

Komuna	Proporcioni në Pellg	2012	2022	2032
Ferizaj	22%	24,287	27,295	29,615
Fushë Kosovë	100%	36,717	52,464	66,080
Gjilan	4%	3,552	3,710	3,836
Drenas	92%	53,307	45,150	41,516
Graçanicë	100%	11,850	19,570	27,200
Lipjan	100%	57,132	48,475	44,596
Mitrovicë ¹⁰⁴	100%	90,286	71,739	62,088
Novobërdë	8%	542	599	651
Obiliq	100%	21,224	15,961	13,665
Podujevë	100%	83,911	45,402	32,386
Prishtinë	97%	202,810	275,702	334,599
Shtime	99%	27,186	25,341	24,637
Skenderaj	25%	12,388	9,223	7,880
Vushtrri	100%	69,678	61,092	56,974
Popullsia totale në MPPL		694,870	701,723	745,723

¹⁰⁴ Popullsia e parashikuar në Mitrovicë nuk ka marrë parasysh numrin e popullsisë së Mitrovicës së Veriut për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme. Për të marrë parasysh këtë popullsi, popullsia e parashikuar është rritur me 27.9% (duke pasur parasysh se popullsia e vlerësuar në Mitrovicën e Veriut në vitin 2011 ishte afër 20,000 banorë).



Masterplani bazohet në vlerësimin e detajuar të popullsisë në të ardhmen në zonën e pellgut, në infrastrukturën ekzistuese të ujërave të ndotura, aglomeracionet e përkufizuara, analizën e plotë të opsioneve dhe programin e investimeve për arritjen e përputhshmërisë së plotë.

Plani kryesor identifikon një numër të opsioneve për trajtimin e ujërave të ndotura. Kostoja për opsionin e “parazgjedhur” siç është prezantuar në planin e financimit (R8.3) është dhënë këtu.

Tabela 76 Programi i investimeve – Master Plani për Ujërat e ndotura për Ibrin

Gjithsej CAPEX (000' €)	Fazat e Implementimit				Gjithsej CAPEX
	1	2	2.5	3	
Programet investive					
Sistemi qendror	62,582	23,061	16,835	6,314	108,792
Drenas	0	11,375	6,026	8,223	25,625
Podujevë	0	17,788	400	11,304	29,492
Shtime	0	0	0	10,433	10,433
Mitrovica-Vushtrri	0	36,193	8,384	13,932	58,510
Investimet Totale	62,583	88,419	31,647.5	50,209	232,852

Plani afatgjatë i investimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizim për qytetin e Prishtinës

(Draft) plani afatgjatë i investimeve për qytetin e Prishtinës është përgatitur në vitin 2010 në financim të KfW. Kërkesat e përgjithshme për investime (Shtojca 4.3) për rrjetin e grumbullimit të ujërave të ndotura në qytet dhe zonat industriale janë paraqitur më poshtë.

Tabela 77 Qyteti i Prishtinës – Plani afatgjatë i investimeve – Furnizimi me ujë

	2010	2020	2030	2040	Gjithsej
Renovimi i kanalizimeve	23,669,800				23,669,800
Zgjerimi i kanalizimeve		57,920,100	18,846,000	4,406,100	81,172,200
Ujëra - Gjithsej	23,669,800	57,920,100	18,846,000	4,406,100	104,842,000

Vlerësimet e kërkesave për investime në rrjetin e kanalizimeve duken të larta në krahasim me vlerësimet tjera në dispozicion. Plani afatgjatë i investimeve i referohet gjithashtu:

- €105 milionë investime për trajtimin e ujërave të ndotura
- €45 milionë investime për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve për komnat dhe zonat rurale

Studimi i fizibilitetit për ujërat e ndotura të Prishtinës

Raporti i studimit të fizibilitetit i përgatitur nën kujdesin e Facilitetit për Përgatitje të Infrastrukturës (IPF) dhe të Facilitetit për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF). Vlerat e prezantuara në raport janë të riprodhuara këtu¹⁰⁵.

Popullsia e mbuluar nga projekti dhe parashikimet e popullsisë të përdorur për dizajnin e programit të investimeve janë dhënë këtu.

Tabela 78 popullsia e mbuluar nga studimi i fizibilitetit për ujërat e ndotura të Prishtinës (WBIF, IPF, WYG)

Komuna	2011	2020	2030	2040
Prishtinë	258,124	332,318	387,910	441,720
Fushë Kosovë	34,718	44,697	52,174	59,412

¹⁰⁵ <http://www.wbif-ipf.eu/?p=1111>



Obiliq	21,548	23,086	24,134	24,892
Gjithsej	314,390	400,101	464,218	526,024

Studimi i fizibilitetit përfshin një vlerësim të detajuar të zonës së zonës ujëmbledhëse, zhvillimet të popullsisë, infrastrukturës ekzistuese, nevojave për të ardhmen, dhe opsioneve për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura dhe, paraqet një plan të optimizuar për investime afatgjata si dhe disa opsione të ndara në faza për projektet e investimeve prioritare.

Në përgjithësi kërkesat për investime janë paraqitur këtu (në bazë të sllajdit 52 të prezantimit) dhe është nxjerrë një vlerësim indikativ i fazave.

Tabela 79 Vlerësimi i kostos së investimeve – Studimi i fizibilitetit për ujërat e ndotura të Prishtinës i vitit 2011

Komponenti	Kosto kapitale	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Prishtinë / Fushë Kosovë ITUZ	32,420,000	32,420,000	-	-
Prishtinë / Fushë Kosovë zgjerimi i ITUZ	12,723,000	-	12,723,000	-
Mbledhësi kryesor i kanalizimeve - Prishtinë deri te ITUZ	3,667,148	3,667,148	-	-
Kanalizimet ndërhyrëse në Prishtinë	2,956,518	2,956,518	-	-
Zgjerimi i rrjetit të Prishtinës	28,420,668	-	14,210,334	14,210,334
Rrjeti ekzistues i Prishtinës	41,431,133	-	20,715,567	20,715,567
Kolektori kryesor - Fushë Kosovë deri te ITUZ	958,347	958,347	-	-
Kolektorët primarë të kanalizim në Fushë Kosovë	3,856,784	3,856,784	-	-
Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Fushë Kosovë	4,747,473	-	4,747,473	-
Rrjeti ekzistues i Fushë Kosovës	11,383,722	-	5,691,861	5,691,861
ITUZ i Obiliqit	3,110,000	3,110,000	-	-
Zgjerimi i ITUZ të Obiliqit	2,248,000	-	2,248,000	-
Kolektori kryesor - Fushë Kosovë të ITUZ	425,584	425,584	-	-
Kolektori kryesor i kanalizimit: Prishtinë VP të ITUZ e Obiliqit	856,057	856,057	-	-
Zgjerimi rrjetit të kanalizimit të Obiliq	2,719,597	-	2,719,597	-
Zgjerimi i rrjetit të Obiliqit	4,231,203	-	2,115,602	2,115,602
Rrjeti i Kanalizimit i zgjeruar rishtas në PR VP	4,850,582	-	-	4,850,582
Kostot totale e investimeve afatgjata	161,005,817	48,250,438	65,171,433	47,583,945

Vlerësimi i prezantuar këtu është dukshëm më i lartë sesa ai në planin kryesor (zona qendrore) prej €109 milionë apo nga ai i vlerësuar në modelin e kostos së përputhshmërisë (€104 milionë). Është e qartë se ky dallim i dukshëm vjen nga:

- Vlerësimi shumë më i lartë i popullsisë për 3 komunitet e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Obiliqit:
 - 2040: Studimi i fizibilitetit: Vlerësimi i popullsisë prej 526,024
 - 2037: Plani kryesor: Vlerësimi i popullsisë prej 429,936
- Vlerësimi i kostos së renovimit dhe zgjerimit të rrjetit në studimin e fizibilitetit janë thelbësore:
 - Rrjeti ekzistues total: 57.0 milionë
 - Zgjerimi i rrjetit total: 40.7 milionë

Shkarkimi i ujërave të ndotura në Kosovën Jug-perëndimore

Këto seri të studimeve të arsyeshmërisë të përgatitura nën financimin e KfW dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nga kompanitë konsultante Fichtner dhe InfraTek adresojnë nevojat për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në tri qytete: të Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit.

Gjakovë

Popullsia e mbuluar me shërbime nën skenarin e studimit është:



- 57,950 në vitin 2021 (64,000 b.e.. me 10% komercial)
- 71,015 në vitin 2036 (80,000 b.e. me 10% komercial)

Studimi i fizibilitetit për Gjakovën (2011) paraqet një vlerësim të koston totale prej rreth €55 milionë siç është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 80 Vlerësimi i koston - Studimi i fizibilitetit për ujërat e ndotura të Gjakovës

Pozita	2016[€]	2021[€]	2021+[€]	2026[€]	2031[€]	2036[€]	Gjithsej[€]
<i>Të përgjithshme (5% tolerancë)</i>	106,929	373,378	601,178	42,678	30,823	363,569	1,518,555
<i>Rrjeti i kanalizimit</i>	2,138,589	-	4,757,481	853,560	616,460	7,271,379	15,637,469
<i>ITUZ – faza fillestare 2021</i>	-	7,467,550	-	-	-	-	7,467,550
<i>ITUZ - vazhdimi 2021+</i>	-	-	7,266,080	-	-	-	7,266,080
<i>Zëvendësimi i pajisjeve</i>	-	-	-	-	-	6,048,430	6,048,430
Punët ndërtimore	2,245,519	7,840,928	12,624,739	896,238	647,283	13,683,378	37,938,084
Materialet dhe Shërbimet	-	200,000	400,000	-	-	-	600,000
Shërbimet konsultuese	336,828	1,176,139	1,893,711	134,436	97,092	2,052,507	5,690,713
Shërbimet përcjellëse	-	924,000	-	-	-	-	924,000
Masat përcjellëse-	-	914,000	-	-	-	-	914,000
Toka	-	1,500,000	-	-	-	-	1,500,000
TOTALI I KOSTOS BAZË	2,582,347	12,555,067	14,918,450	1,030,674	744,375	15,735,885	47,566,797
Të paparashikueshme	387,352	1,883,260	2,237,768	154,601	111,656	2,360,383	7,135,020
KOSTO TOTALE E PROJEKTIT	2,969,698	14,438,327	17,156,218	1,185,275	856,032	18,096,267	54,701,817

Kostoja totale bruto për person është përafërsisht €760.

Kostoja totale bruto për b.e. është përafërsisht €684.

Pejë

Popullsia e mbuluar me shërbime nën skenarin e studimit është:

- 60,236 në 2021 (80,000 e.p. me 30% komercial)
- 73,817 në 2036 (100,000 e.p. me 30% komercial)

Ngjashëm, studimi i fizibilitetit për Pejën (2011) paraqet një vlerësim të koston totale prej rreth €64 milionë.



Tabela 81 Kosto e Investimeve – Studimi i arsyeshmërisë për ujërat e ndotura të Pejës

Zëri	2016	2021	2021+	2026	2031	2036	Gjithsej
<i>Të përgjithshme (5% tolerancë)</i>	44,833	594,227	663,871	82,985	80,614	372,827	1,839,356
<i>Rrjeti i kanalizimit</i>	896,650	2,989,855	4,834,515	1,659,700	1,612,280	7,456,530	19,449,530
<i>ITUZ – faza fillestare 2021</i>	-	8,894,680	-	-	-	-	8,894,680
<i>ITUZ - vazhdimi 2021+</i>	-	-	8,442,900	-	-	-	8,442,900
<i>Zëvendësimi i pajisjeve</i>	-	-	-	-	-	6,543,860	6,543,860
Punët ndërtimore	941,483	12,478,762	13,941,286	1,742,685	1,692,894	14,373,217	45,170,326
Materialet dhe shërbimet	-	200,000	400,000	-	-	-	600,000
Shërbimet konsultuese	141,222	1,871,814	2,091,193	261,403	253,934	2,155,983	6,775,549
Shërbimet përcjellëse	-	616,000	-	-	-	-	616,000
Masat përcjellëse-	-	914,000	-	-	-	-	914,000
Toka	-	1,600,000	-	-	-	-	1,600,000
TOTALI I KOSTOS BAZË	1,082,705	17,680,576	16,432,479	2,004,088	1,946,828	16,529,200	55,675,875
Të paparashikueshme	162,406	2,652,086	2,464,872	300,613	292,024	2,479,380	8,351,381
KOSTOJA TOTAL PROJEKTIT	1,245,111	20,332,663	18,897,351	2,304,701	2,238,852	19,008,579	64,027,256

Kostoja totale bruto për person është përafërsisht €870.

Kostoja totale bruto për b.e. është përafërsisht €640.

Dragash

Plani kryesor i sponzoruar nga ana e UNDP për sektorin e shërbimeve me ujë në Dragash gjithashtu përfshin vlerësimet e nevojave për investime në grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Tabela 82 Nevojat për investime për ujërat e ndotura – Komuna e Dragashit – Plani kryesor

	Faza 1a	Faza 1b	Faza 2	Faza 3	Të gjitha Fazat
	2013-2016	2017-2020	2020-2023	2023-2033	2013-2033
Ujërat e ndotura	2,771	4,373	6,067	4,272	17,484

Vlerësimi i kostos totale për investimet kapitale në ujërat e ndotura të Dragashit është përafërsisht €17.5 milionë. Kjo barazohet me koston për banor prej rreth €522.

Ferizaj

Të dhënat për nevojat afatgjata për investime në fushën e shërbimeve për ujërat e ndotura janë riprodhuar nga studimi i fizibilitetit për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura të Ferizajt (Vëllimi 1) i përgatitur nga WYG International nën ombrellën e Facilitetit të Projekteve të Infrastrukturës të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF-IPF).

Tabela në vijim tregon se kostoja investive për zhvillimin e sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura në Ferizaj është përafërsisht 8.2 milionë euro.

Tabela 83 Vlerësimi i kostos së zhvillimit afatgjatë të kanalizimit në Ferizaj

Zhvillimi i Kanalizimit	Përshkrimi	Kosto Investive (€)
Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit në zonat urbane - kanalizime të reja	765 m, 200 - 315 mm dia. HDPE	141,395



Zona jugore - kolektorët kryesorë nga sistemet rurale	1800 m, 400 - 630 mm dia HDPE	497,558
Zona jugore - sistemi i kolektorëve kryesorë për transferimin e prurjes drejt ITUZ-it jugor	6488 m, 1200 mm dia. gyp i PP	2,841,523
Sistemi i kolektorëve kryesorë për transferimin prurjen drejt ITUZ në veri	23435m, 200 - 800 mm dia. HDPE	4,738,385
Gjithsej për Zhvillimin e Kanalizimeve		8,218,861

Studimi i njëjtë i fizibilitetit gjithashtu siguron vlerësimet e kostos për implementimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUZ).

Tabela 84 Nevojat afatgjate për investime – trajtimi i ujërave të ndotura në Ferizaj

Zhvillimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura	Banorë ekuivalent	Kosto e investimeve (€)
ITUZ në jug (Kryesor) të Ferizajt në Gerlicë - Faza 1	82,500	12,170,000
ITUZ në jug (Kryesor) të Ferizajt në Gerlicë - Faza 2	88,900	2,143,000
ITUZ në veri në Trim-Bablak	22,450	3,620,000
ITUZ në lindje në Dardani	5,730	1,205,000
Gjithsej për zhvillimin e kanalizimeve		19,138,000

Tabela këtu tregon se kostoja e vlerësuar e investimeve për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Ferizaj është përafërsisht 19 milionë euro duke përjashtuar shpenzimet e papritura, përshkallëzimin e çmimeve dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Përveç kësaj është cekur në studimin e fizibilitetit se pas 15 vitesh do të nevojiten ri-investime në punimet e Fazës së parë si vijon:

- Zëvendësimi i Makinerisë dhe Pajisjeve pas 15 vitesh: €6.223 milionë

6.2.1.4 Përmbledhje e vlerësimeve në dispozicion – Poshtë-Lartë

Tabela e mëposhtme prezanton një përmbledhje të kostove të vlerësuara në secilin nga studimet individuale të shqyrtuara më lartë. Duhet cekur se studimet kanë përfunduar për Prizren, studimet për Mitrovicë do të fillojnë së shpejti.



Tabela 85 Përmbledhja e vlerësimit të studimit të fizibilitetit për ujërat e ndotura

Aglomerimet	Mbulueshmëria afatgjatë b.e.	Kosto e vlerësuar € milion	Kosto Specifike €/b.e.
Prizren	140,000	74	529
Prishtina me rrethinë	625,000	160	256
Glllogoc	70,000	26	371
Podujevë	94,000	30	319
Shtimë	27,000	11	407
Mitrovica-Vushtrri	185,000	59	319
Gjakovë	80,000	54	675
Pejë	100,000	64	640
Dragash	30,000	18	600
Gjilan	140,000	34	243
Ferizaj	89,000	27	303
Gjithsej	1,580,000	557	353

Tabela e mësipërme paraqet shkallën e mbulueshmërisë në aspektin e banorëve ekuivalent (b.e.), d.m.th. ngarkesën e kombinuar ekuivalente nga burimet e amvisërive, komerciale dhe industriale brenda aglomeracioneve.

Vlerësimet e kostove tregojnë një ndryshim të lartë befasues në kostot specifike për llogaritjet për Gjakovë dhe Pejë që janë dukshëm më të larta sesa për zonat tjera urbane. Vlerësimi për Dragash mendohet të jetë i lartë për shkak të natyrës së shpërndarë të demografisë së komunës.

6.2.1.5 Sinteza e të gjitha vlerësimeve për ujërat e ndotura

Në përmbledhje, vlerësimet e marra në konsideratë këtu për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura tregojnë sa vijon:

- AMVA të Bankës Botërore: €424 milionë (vlerësim gjenerik për zgjerim pa rinovim)
- Modeli i përputhshmërisë: €800 milionë (duke përfshirë: rinovimet, ujërat atmosferike, të gjitha aglomeracionet)
- Modeli i përputhshmërisë¹⁰⁶: €493 milionë (implementim minimal)
- Planet për investime: €675 milionë (vlerësim i përshtatur – përjashton ujërat atmosferike)
- Studimet e fizibilitetit: €557 milionë (përjashton “aglomeracionet më të vogla”)

Përderisa vlerësimet ndryshojnë nga njëra tjetra dukshëm, ato janë relativisht konsistente kur merren parasysh faktorët dallues në qasjet dhe komponentët e përfshira (përjashtuara).

Një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet çështjes së llumit nga impiantet trajtimit të ujërave të ndotura, trajtimit dhe deponimit të tij. Legjislati i BE-së dhe standardet shumë të ulëta të deponive të Kosovës që janë në gjendje aq të keqe sa që deponimi i llumit në deponi të mbetjeve të ngurta as që mund të konsiderohet si një nga opsionet e mundshme. Për qytetet e mëdha opsioni më i përshtatshëm duket të jetë digjestimi i plotë anaerob (pa ajër) i llumit për të gjeneruar gaz dhe me këtë energji. Për impiantet e vogla, ku shkalla e trajtimit anaerob të llumit nuk do të mbërrinte nivelin e mjaftueshëm për të qenë financiarisht e arsyeshme, një qasje alternative që përfshinë një trajtim të pjesshëm para përdorimit të tij në bujqësi, duket si opsioni më i mirë.

¹⁰⁶Për të vlerësuar gamën e mundshëm të kostove që lidhen me zbatimin - një skenar "Zbatimi minimale" është zhvilluar gjithashtu, me norma me të ulëta të rinovimit, kanalizime të kombinuara dhe zgjerimin e kufizuar të rrjeteve



6.2.2 Ndotja nga Shkarkimet Industriale

Nivelet e ndotjes pikore nga shkarkimet industriale janë trajtuar në detaje në raportin e Karakterizimit të Pellgjeve Lumore. Siç është thënë këtu dhe në Raportin e Gjendjes së Ujërave të vitit 2015, ndotja nga shkarkimet industriale është më e vogël se sa nga ujërat e ndotura urbane, por megjithatë duhet të adresohet.

Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes “duke pasur parasysh nevojën e harmonizimit të standardeve mjedisore në Kosovë për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes me ato të Bashkimit Evropian” është instrumenti kryesor i transpozimit për regjimin e Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes të BE-së. Zbatimi i këtij ligji do të adresojë shumicën e ndotësve kryesorë nga shkarkimet. Kështu që nevoja më e madhe është që departamenti përgjegjës për këtë detyrë brenda MMPH të koordinohet me Departamentin e Ujërave dhe të përgatis Planet Menaxhuese për Pellgjet Lumore.

6.2.3 Ndotja Difuzive

Siç u tha më lartë, nuk është e mundur që të bëhet një vlerësim i saktë i ndotjes difuzive duke u bazuar në të dhënat që janë në disponim nga monitorimi i mjedisit (gjendja). Prandaj duhet të merren parasysh nivelet krahasuese të aktivitetit (presionit) që do të mund të shkaktonte ndotjen difuzive.

6.2.3.1 Bujqësia

Siç u diskutua më lartë, intensiteti i bujqësisë është relativisht i ulët në krahasim me shumicën e vendeve anëtare të BE-së. Andaj është e arsyeshme të supozohet se, së paku në mesatare, niveli i ndotjes nga bujqësia është krahasimisht i ulët. Prandaj ndërmarrja e masave afatshkurta për ta trajtuar këtë çështje nuk duken të arsyeshme.

Sidoqoftë, është e arsyeshme të parashikohet se intensiteti i bujqësisë, veçanërisht përdorimi i preparateve agro-kimike do të shënojë rritje me rritjen ekonomike. Në mënyrë që të kufizohet ndotja difuzive në pajtim me kërkesat e legjislacionit relevant të BE-së (siç është Direktiva e Nitrates 91/676/EEC dhe Korniza e Direktivës së Ujërave 2000/60/EC) ky intensifikim duhet të shoqërohet më masa si rregullimi, shërbimet këshilluese, dhe udhëzues të praktikave të mira. Masa të tilla parashihen në afat të mesëm.

6.2.3.2 Kanalizimet atmosferike urbane

Siç u diskutua më lartë, shumë zona për momentin janë duke u shërbyer më sisteme të kombinuara të kanalizimit – kur të aplikohet trajtimi, sistemet e tilla do të trajtojnë efektivisht të gjithë ndotësit që vijnë nga kanalizimi atmosferik urban. Megjithatë, përdorimi i sistemeve të kombinuara paraqet në të njëjtën kohë disa vështirësi dhe në përgjithësi preferohet që sistemi i kanalizimit dhe ai i kanalizimit atmosferik urban të jenë të ndarë nga njëri tjetri.

Ripunimi i sistemeve të ndara do të jetë i shtrenjtë në shumë raste, prandaj nuk rekomandohet të bëhet. Megjithatë në zonat e zhvillimit të ri apo në zonat ku sistemi i kanalizimit ende mungon, rekomandohet të ndërtohen sisteme të ndara të kanalizimit. Kjo duhet të përcillet me zbatimin e parimit të drenazimit të qëndrueshëm të zonave urbane.

6.2.3.3 Toka e kontaminuar

Raporti i fundit për këtë temë është:

- Zonat e nxehta mjedisore ('hotspotet') në Kosovë, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës.

Raporti paraqet informatat e detajuara që kanë të bëjnë me zonat e ndotura në territorin e Kosovës.



Tabela 86 Toka e kontaminuar – Përmbledhje e hotspoteve të identifikuara në Kosovë

Aktiviteti	Sipërfaqja (km ²)	Përqindja e totalit të hotspoteve	Përqindja e totalit të Kosovës (km ²)
Sterilet	2.66	26.6	0.024
Deponitë e hirit	3.01	30.1	0.027
Deponitë industriale	2.7	27.08	0.024
Deponitë e mbeturinave	0.93	9.3	0.008
Materialet radioaktive	0.67	6.7	0.006
Gjithsej	9.97	100	0.091

Deponitë e mbeturinave të ngurta urbane janë brengë në vete.

Tabela 87 Deponitë sanitare si burim potencial i ndotjes në Kosovë

Nr	Vendndodhja – vendi i Deponisë Sanitare	Sipërfaqja	Burimet Potenciale të Ndotjes				
			Metalet e rënda	Substancat Kimike	Produktet e naftës	Materialet Organike	Të tjera
1	Podujevë	8.72 ha	x	x	x	x	x
2	Sferk e Thatë-Pejë	4.85 ha	x	x	x	x	x
3	Gjilan	20.50 ha	x	x	x	x	x
4	Prizren	20.94 ha	x	x	x	x	x
5	Obiliq	33.65 ha	x	x	x	x	x
6	Mitrovicë	3.60 ha	x	x	x	x	x

Për zbutjen e problemit të hotspoteve, raporti rekomandon që në të ardhmen të ndërmerren masat në vijim:

- Sektorët e industrisë dhe minierave
 - Sektorët e industrisë dhe minierave duhet të ndërmarrin masa për integrimin dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit të mjedisit, dhe teknologjive më të pastra (BAT) për të parandaluar ndotjen (zvogëlimin e substancave toksike, zvogëlimin e emisionit të mbeturinave, përdorimin efiçient të energjisë, minimizimin e shpenzimeve);
 - Të sigurohet menaxhim i duhur, dhe deponim adekuat i mbeturinave të rrezikshme (kimikatet dhe metalet e rënda);
 - Të themelohet eko-fondi, substituiimi apo granatet për menaxhim më të mirë mbeturinave të rrezikshme industriale;
 - Menaxhimi në sektorët e industrisë dhe minierave duhet të zbatohet sisteme për përmirësimin e kushteve mjedisore (të zbatohet riciklimi, ulja e ndotjes, të përcaktohen zonat e rrezikuara, etj.);
 - Të themelohet një qendër emergjente për aksidente, apo situata emergjente mjedisore që do të mund të vinin nga sektori i industrisë dhe minierave;
 - Informimi mjedisor brenda këtyre dy sektorëve duhet të menaxhohet më me efiçencë, dhe të jetë i hapur ndaj publikut;
 - Për të dy sektorët duhet të zhvillohen politika mirë të definuara për zhvillim të qëndrueshëm, në pajtim me ligjet mjedisore të vendit dhe Direktivat e BE-së.
- Sektori i mbeturinave
 - I terë sistemi menaxhues i mbeturinave duhet të përmirësohet;
 - Të promovohet zvogëlimi i emisionit të mbeturinave, ripërdorimi dhe riciklimi i tyre;



- Të përmirësohet mirëmbajtja teknike e deponive sanitare, në mënyrë që të parandalohet përzierja e ujërave sipërfaqësore me ato të deponive;
- Të zbatohet plani strategjik për menaxhimin e mbeturinave, dhe të zbatohen masat specifike të parapara për deponitë.
- **Sektori i bujqësisë**
 - Ruajtja e sigurt e mbeturinave bujqësore (pesticidet, plehurat artificiale, etj.) në lokacione të përshtatshme;
 - Të përmirësohet sistemi i menaxhimit të produkteve kimike që përdoren në bujqësi dhe të rritet efikasiteti i përdorimit të tyre;
 - Ngritja e vetëdijes së bujqve, kompanive, dhe konsumatorëve për përdorimin e substancave të rrezikshme në sektorin e bujqësisë.
- **Sektori i transportit**
 - Të promovohet përdorimi i veturave të reja dhe të ndalohet përdorimi i vjetrave;
 - Të përdoren lëndë djegëse me cilësi të lartë më ndikim më të vogël mjedisor. Të zbatohet implementimi i Rregullores për cilësi të lëndëve djegëse, (koncentrimi i sulfurit më pak se 0.001%);
 - Të zbatohet Rregullorja për vlerat kufizuese të emisionit për sektorin e transportit, dhe rregulloret tjera që kanë të bëjnë me cilësinë e lëndëve djegëse;
 - Të rritet efikasiteti i menaxhimit të mbeturinave të transportit (që të riciklohen apo ruhen në vende të përshtatshme).

Asnjëra nga këto masa dhe aksione nuk janë specifike për sektorin e ujërave, por do të kenë efekt pozitiv në cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor. Implementimi i vazhdueshëm i masave të identifikuara këtu do të ishin shumë të rëndësishme për sektorin e ujërave.

6.3 Nevojat për zhvillim – mbrojtja nga ujërat

6.3.1 Drenazimi i ujërave atmosferike urbane

Siç u theksua me lartë, vlerësimi kombëtar i nevojave zhvillimore, së paku për sa u përket kostove, për ndërrimin e gypave për drenazhimin e ujërave atmosferike është përfshirë në nivelin e lartë të vlerësimit të përputhshmërisë me Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane të cekur më lartë.

Disa nga planet për investime në ujëra dhe ujëra të ndotura janë hartuar në nivele komunale (2009, USAID et al.) duke përfshirë kërkesat për investime për ujërat atmosferike. Kostot e investimeve të përfshira në ato plane që adresojnë këtë çështje janë riprodhuar këtu.

Tabela 88 Kostoja e investimeve për kontrollin e ujërave atmosferike dhe mbrojtje nga vërshimet.

Komuna	Popullsia	Reshje/vërshime
Ferizaj	108,610	€3,649,348
Fushë Kosovë	34,827	€440,000
Drenas	58,531	€250,000
Malishevë	54,613	€923,000
Pejë	96,450	€10,363,960
Prishtinë	199,635	€900,000
Gjithsej	552,666	€16,526,308



Kjo tabelë prezanton vetëm një pjesë të vogël të nevojave të mundshme – vetëm në rastet e Pejës dhe Ferizajt duket së vlerësimet janë të sakta. Aplikimi i vlerës prej €100 për banor (si në Pejë) dhe aplikimi i kësaj të popullsisë e vlerësuar në aglomeracione (rreth 1.3 milion), do të gjeneronte një vlerë të përafërt prej €130 milionë, që është e krahasueshme me vlerësimin e bërë me modelin e përputhshmërisë.

Thënë shkurt, nevojat zhvillimore mbesin shumë të paqarta. Megjithatë, është e qartë së nevojiten punë urgjente në shumë fusha, siç është dëshmuar kohëve të fundit nga dështimet e sistemeve të drenazhimeve të zonave të ndryshme urbane për të përballuar reshjet e mëdha atmosferike që janë provuar në Gjakovë dhe zonat e tjera në vitet e fundit.

Gjithashtu, është me rëndësi të kuptohet së ka disa opsione zhvillimore që kanë të bëjnë me kanalizimet atmosferike urbane:

- Nëse duhet të imponohet kërkesa që të gjitha zonat e reja urbane të kenë sistem të veçantë të kanalizimit atmosferik (një për ujërat e ndotura dhe një për ujërat atmosferike);
- Deri në çfarë mase duhet të kërkohet ndarja e sistemeve ekzistuese me rastin e punëve për zëvendësim dhe renovim;
- Cili është niveli i trajtimit që duhet të aplikohet për ujërat atmosferike;
- Në çfarë mase duhet të aplikohen teknikat për një sistem të qëndrueshëm të drenazhimit urban (SQDU) në zonat e reja apo ato zgjeruara;
- Në çfarë mase duhet të aplikohen teknikat për modernizimin (aty ku është e mundshme) të SQDU në zonat urbane që veç janë zhvilluar.

Adresimi i këtyre pyetjeve në detaje të plota kërkon aplikimin e teknikës së modelimit hidraulik, disa nga të cilat ende nuk janë përfshirë në njësitë operationale. Megjithatë, duke u bazuar në përvojat Evropiane, mund të merren vendime të arsyeshme politike.

6.3.2 Mbrojtja nga vërshimet

Nevojat e vërteta zhvillimore për tërë vendin në fushën e mbrojtjes nga vërshimet është vështirë të specifikohen për momentin.

Megjithatë, një numër i vlerësimeve për aspekte të ndryshme të mbrojtjes nga vërshimet janë në dispozicion dhe ato identifikojnë nevojat specifike që duhet të adresohen në programin e parë zbatues në mënyrë që të ndihmojnë si menaxhimin e mbrojtjes nga vërshimet në afat të shkurt dhe përmirësimin e vazhdueshëm në menaxhimin e rrezikut nga vërshimet në afat të mesëm dhe të gjatë. Këto përfshijnë:

- Korniza e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet – TFU, 2011
- Raporti i vlerësimit të shpejtë: Identifikimi i komunave që kanë nevojë për mbështetje për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet dhe menaxhimin e rrezikut nga thatësia në Shqipëri dhe Kosovë, GIZ, gusht 2013
- Përgatitja e Hartave të Cenueshmërisë dhe Vlerësimit të Rrezikut (HCVR): Vlerësimi i Rrezikut nga Vërshimet në Kosovë, Nëntor 2012, OBSH

Për “investime strukturore”, duhet të pranohet së mund të ndërmerren investime në rastet “pa u pënduar” dhe “pa dyshim” në afat të shkurt, pa nevojën e pritjes së vlerësimeve shtesë. Kjo është e zbatueshme veçanërisht për:

- Mbrojtjet ekzistuese nga vërshimet që kërkojnë mirëmbajtje dhe riparime
- Masat e identifikuar nga studimet e kohëve të fundit në Viti – Gjilan



6.3.2.1 [Informimi mjedisor](#)

Menaxhimi i rrezikut nga vërshimet është, në të gjitha aspektet, shumë i varur nga informacioni që ka të bëjë me meteorologji dhe hidrologji. Siç u cek me lartë, ka pasur vështirësi në këtë aspekt dhe nevojiten përmirësime të dukshme, nëse Kosova don të jetë në gjendje të përmbushë obligimet që ka ndaj qytetarëve të vet për mbrojtjen nga vërshimet dhe të plotësojë kushtet për përputhshmëri me legjislacionin e BE-së. Disa hapa janë duke u ndërmarrë për të adresuar këtë problem, por nevojiten aksione tjera konkrete dhe të vazhdueshme.

6.3.2.2 [Planifikimi](#)

Direktiva për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet parasheh tri faza:

- Vlerësimi preliminar i rrezikut nga vërshimet
- Përgatitja e hartave të rrezikut nga vërshimet
- Përgatitja e hartave të kërcënimit nga vërshimet
- Planet për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet

Informacioni për kompletimin e nivelit të parë është prezent, siç konstatohet në raportin e TFU-së. Kjo çështje duhet të adresohet me urgjencë në mënyrë që të fokusohen përpjekjet afatshkurta në një vlerësim me të detajuar për rreziqet në ato zona që dihet se janë “në rrezik”.

Integrimi i procesit të planifikimit për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet me procesin e planifikimit për menaxhimin e pellgjeve lumore sipas DKU me një qasje eficiente dhe efektive.

Sipas të gjitha gjasëve, e asistenca teknike do të jetë e nevojshme për disa aspekte të procesit të planifikimit.

6.3.2.3 [Investimet](#)

Në mungesë të planeve të detajuara, vlerësimet për vëllimin e investimeve për mbrojtje nga vërshimet do të ishin spekulative dhe potencialisht çorientuese.

6.3.2.4 [Paralajmërimi dhe Emergjenca](#)

Për implementimin e një sistemi modern të paralajmërimit dhe për plotësimin e procedurave ekzistuese shtetërore të emergjencave kërkohen hapa shtesë dhe të konsoliduar mirë. Veprimet specifike janë identifikuar në Raportin TFU-së.

6.3.3 [Siguria e digave](#)

Kjo temë është adresuar në Nenet 42 - 44 të Ligjit për Ujëra, i cili kërkon që pronarët dhe operatorët e këtyre objekteve duhet të jenë të licencuar, që të gjitha digat të hulumtohen kohë pas kohe, dhe që përcakton se duhet të këtë procedura të emergjencës të cilat duhet të aplikohen sipas nevojës.

Raporti i Task Forcës së Ujërave për Sigurinë e Digave i tetorit 2012 rekomandon një numër te aksioneve me prioritet duke përfshirë:

- Krijimin e kornizës ligjore dhe përcaktimin e një entiteti brenda qeverisë që do të ishte përgjegjës për sigurinë e digave.
- Rifillimin e menjëhershëm të monitorimit të digave dhe raportimi për to.
- Hartimin e një studimi të detajuar për statikën dhe sigurinë e digave në rast tërmetesh.. Kjo përfshinë gjithashtu një vlerësim të ri të rrezikut seizmik.



- Rishikimin e menjëhershëm të PMF, së paku për ato diga me sipërfaqe të madhe të ujëmbledhësit (p.sh. Ujmani) dhe digat me ujëmbledhës më të vogël dhe të veçantë ku gjatë operimit janë vërejtur kapërderdhje.
- Instalimin e një sistemi të sigurisë me alarm përmes sirenave për popullsinë poshtë digave në rast të problemeve në diga. Kjo është praktikë e rregullt në shumë vende, por ka edhe vende si Gjermania që nuk përdorin sisteme të tilla.
- Sistemi i alarmit të sigurisë me sirena mund të anashkalohe nëse:
 - raporti i detajuar për sigurinë e digave tregon se ka një margjinë të mjaftueshme të sigurisë për të gjitha rastet e ngarkesave dhe nëse është vendosur monitorimi i vazhdueshëm i sigurisë së digave.
 - vendoset një sistem i alarmit nga pronarët e digave të policia dhe sistemi i mbrojtjes civile dhe testohet rregullisht, dhe ekziston planifikimi i nivelit të parë të sigurisë duke përfshirë vlerësimin e përafërt të zonës që potencialisht mund të vërshohet.

Tabela 6 Rekomandimet e TFU-së për Aksionet e Menjëhershme për Sigurinë e Digave: Të Përgjithshme

Masa e propozuar	Ekzekutimi nga	Vlerësimi i kostos €	Prioriteti	Koha e fillimit
Korniza legjislative Njësia për sigurinë e digave	Ndihmuar nga eksperti ndërkombëtar	30,000	1	menjëherë
Rifillimi i monitorimit Raporti vjetor	Vendorët; Trajnimi dhe mbështetja nga eksperti ndërkombëtar	30,000 €	1	Menjëherë
Vlerësimi i probabilitetit të rrezikut seizmik	Kompani ndërkombëtare	70,000 €	1	Menjëherë
		130,000		

Tabela 90 Rekomandimet e TFU-së për Aksionet e Menjëhershme për Sigurinë e Digave: Batllava

Masa e propozuar	Ekzekutimi nga	Vlerësimi i kostos €	Prioriteti	Koha e fillimit
------------------	----------------	----------------------	------------	-----------------



Një analizë e re e detajuar për sigurinë statike dhe dinamike	Kompani ndërkombëtare	70,000	1	1 Vit
---	-----------------------	--------	---	-------

Tabela 91 Rekomandimet e TFU-së për Aksionet e Menjëhershme për Sigurinë e Digave: Badovc

Masa e Propozuar	Ekzekutimi nga	Vlerësimi i kostos €	Prioriteti	Koha e fillimit
Një analizë e re e detajuar për sigurinë statike dhe dinamike	Kompani ndërkombëtare	70,000	1	1 Vit
Rishikimi i kapacitetit PMF të kanalit për shkarkimit	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Studimi për thyerjen e digës	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Instalimi i sistemit të alarmit	Kompani ndërkombëtare	I hapur	1	2 vite
Punët mirëmbajtëse	Kompani lokale	lokale	2	Menjëherë
Urë për të siguruar qasje në kreshtë të digës	Kompani lokale	70,000	1	1 Vit
		220,000+		

Tabela 92 Rekomandimet e TFU-së për Aksionet e Menjëhershme për Sigurinë e Digave: Radoniqi

Masa e Propozuar	Ekzekutimi nga	Vlerësimi i kostos €	Prioriteti	Koha e fillimit
Një analizë e re e detajuar për sigurinë statike dhe dinamike	Kompani ndërkombëtare	70,000	1	1 Vit
Rishikimi i PMF kapacitetit të kanalit për shkarkimi	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Instalimi i sistemit të alarmit	Kompani ndërkombëtare	I hapur	1	2 vite
Puna për mirëmbajtje	Kompani lokale	lokal	2	Menjëherë
		110,000+		

Tabela 93 Rekomandimet e TFU-së për Aksionet e Menjëhershme për Sigurinë e Digave: Ujmani

Masa e Propozuar	Ekzekutimi nga	Vlerësimi i kostos €	Prioriteti	Koha e fillimit
Një analizë e re e detajuar për sigurinë statike dhe dinamike	Kompani ndërkombëtare	70,000	1	1 Vit
Rishikimi i PMF kapacitetit të kanalit për shkarkimi	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Studimi për thyerjen e digës	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Instalimi i sistemit të alarmit	Kompani ndërkombëtare	I hapur	1	2 vite
Puna për mirëmbajtje	Kompani lokale	lokal	2	Menjëherë
		150,000+		

**Tabela 94 Rekomandimet e TFU-së për Aksionet e Menjëhershme për Sigurinë e Digave: Përlepnica**

Masa e Propozuar	Ekzekutimi nga	Vlerësimi i kostos €	Prioriteti	Koha e fillimit
Një analizë e re e detajuar për sigurinë statike dhe dinamike	Kompani ndërkombëtare	70,000	1	1 Vit
Rishikimi i PMF kapacitetit të kanalit për shkarkimi	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Studimi për thyerjen e digës	Kompani ndërkombëtare	40,000	1	1 Vit
Instalimi i sistemit të alarmit	Kompani ndërkombëtare	I hapur	1	2 vite
Vlerësimi i humbjeve të ujit	Ekspertët lokal	Lokal	1	Menjëherë
Puna e Mirëmbajtjes I	Kompanitë lokale	Lokal	3	2 vite
Puna e Mirëmbajtjes II	Kompanitë lokale	Lokal	3	2 vite
Ndërtimi i pjesës që mungon të kanalit për shkarkim	Kompanitë lokale	80,000	1	2 vite
		230,000+		

Tabela 95 Përmbledhje e Kostove që vijnë nga Rekomandimet e Masave për Sigurinë e Digave: Afat-shkurt

Kategoria	Kosto/ Euro	Shënim
Aksionet e përgjithshme	130,000	
Batlava	150,000	Plus puna e mirëmbajtjes dhe instalimi i alarmit
Badovci	220,000	Plus puna e mirëmbajtjes dhe instalimi i alarmit
Radoniqi	110,000	Plus puna e mirëmbajtjes dhe instalimi i alarmit
Ujmani	150,000	Plus puna e mirëmbajtjes dhe instalimi i alarmit
Përlepnica	230,000	Plus vlerësimi i humbjeve, puna e mirëmbajtjes dhe instalimi i alarmit dhe ndërtimi i kanalit për shkarkim
Gjithsej	990,000	

6.3.4 Erozioni

Teksti në vijim, i nxjerrë nga Plani Hapësinor paraqet një qasje praktike:

- Zonat ku intensiteti i erozionit është i lartë dhe shkakton pasoja të rrezikshme për rrjedhat e ujit, tokën, pyjet, objektet dhe gjërat tjera të paluajtshme, duhet të shpallen zona erozive. Kjo duhet të bëhet nga komunat, sipas Ligjit për Ujëra të Kosovës. Qeveria e Kosovës e shpall një zonë si erozive dhe përgatit masa mbrojtëse vetëm kur nga erozioni ndikohen interesa të mëdha shtetërore.

Parandalimi i erozionit është një objektiv dhe detyrë e të gjithë përdoruesve, përdoruesve të tokave bujqësore, tokave malore, pyjeve, ujërave dhe të mirave tjera materiale. Me qëllim të parandalimit të aktivitetit të erozionit, duhet të merren hapa konkret dhe të menjëhershëm:

- Parandalimi i prerjes dhe degradimit të pyjeve,
- Parandalimi i mbikullotjes (kullotja e tepërt),



- Parandalimi i përdorimit të mjeteve materiale që shkaktojnë erozion.

Veprimet kundër erozionit: për të ndaluar vazhdimin e këtij fenomeni negativ, duhet të merren masa hidro-teknike, bujqësore dhe biologjike.

- Masat hidro-teknike
 - Ndërtimi i tarracave, argjinaturave dhe digave në rrjedhat e ujërave si masa mbrojtëse hidro-teknike për të minimizuar efektet e erozionit,
 - Ndërtimi i argjinaturave përgjatë shtretërve të lumenjve ,
 - Mbjellja e drunjve përgjatë brigjeve të lumenjve,
 - Parandalimi i shfrytëzimit të inerteve nga shtretërit e lumenjve.
- Masat Bujqësore
 - Mirëmbajtja e tokave bujqësore,
 - Të përdoren praktika të pranueshme bujqësore
 - Shfrytëzimi i sistemeve të ujitjes dhe drenazhimit sipas këshillave të ekspertëve,
 - Shtimi i investimeve për mbrojtjen e tokave në brigjet e lumenjve.
- Masat biologjike
 - Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pakontrolluara dhe zjarret,
 - Parandalimi i kullotjes në zonat me vegetacion të rrallë dhe të varfra në florë,
 - Pyllëzimi i zonave të zhveshura dhe të degraduara,
 - Krijimi i zonave të gjelbëruara në rajonet ku incidentet e erozionit janë të shpeshta,
 - Mbjellja përgjatë brigjeve të lumenjve, rrjedhave ku ka erozion aktiv.

Zonat me prioritet ku duhet të merren masa kundër erozionit:

- Në pellgun e lumit Ibër, rreth 947 km² apo 23% e sipërfaqes së pellgut janë shkallën 1 dhe 2 të incidencës.
- Në pellgun e lumit të Moravës së Binçës, rreth 700 km² apo rreth 41% janë të rrezikuara nga rreziku i shkallës 1 dhe 2.
- Në pellgun e lumit Drini i Bardhë, rreth 800 km² apo 24% e sipërfaqes së pellgut janë në shkallën 1 dhe 2; dhe
- Në pellgun e lumit të Lepencit, rreth 230 km² apo 35% sipërfaqes së pellgut janë në shkallën 1 dhe 2.

Intervenimet hapësinore, nga të dhënat e prezantuara në harta, duhet të ndërmerren në 2,620 km² të rrezikuara nga erozione të mëdha.

Qeveritë komunale duhet të shpallin zonat me të rrezikuara dhe të marrin masa konkrete kundër erozionit, në bashkëpunim me MMPH, MBPZHR, Agjencinë e Pyjeve, MPS, MF, etj.

6.4 Nevojat zhvillimore - qeverisja

6.4.1 Legjislacioni

6.4.1.1 Transpozimi

Transpozimi i legjislacionit Evropian në kornizën ligjore të Kosovës po vazhdon dhe do të adresohet përmes miratimit të legjislacionit sekondarë të përgatitur sipas kërkesave të Ligjit për Ujëra të



Kosovës. Kur të aprovet ky legjislacion do të bëhet një rishikim i tij dhe një paketë e amendamenteve pasuese të propozuara për të siguruar koherencë, qëndrueshmëri dhe për të zgjeruar transpozimin.

6.4.1.2 [Legjislacioni dhe Sundimi i Ligjit](#)

Ngriten tri pika kryesore:

- Boshllëqet në legjislacion
- Kërkesa jo-reale
- Përputhshmëri dhe zbatim i dobët

Duke marrë parasysh perspektivën Evropiane, procesi i përafrimit me legjislacionin e BE-së është kyç. Ne e kemi të qartë që përafrimi përmban tri elemente:

- Transpozimi
 - Futjen e masave ligjore në Kosovë për të zbatuar kërkesat e legjislacionit të BE-së
- Implementimi
 - Vendosja e masave të nevojshme teknike, administrative dhe praktike për të plotësuar kërkesat “konkrete” të legjislacionit
- Hyrja në fuqi
 - Ndërmarrja dhe zbatimi i masave për të siguruar që kërkesat ligjore po zbatohen

[Boshllëqet në Legjislacioni](#)

Në krahasim me legjislacionin e BE-së mbesin boshllëqe të mëdha në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës. Shumë nga ato do të adresohen përmes legjislacionit sekondarë që është duke u përgatitur në bazë të kërkesave të Ligjit për Ujëra të Kosovës. Ky legjislacion sekondarë duhet të kompletohet gjatë vitit 2017. Ky do të jetë një avantazh i madh, por ne duhet të jemi realist dhe të pranojmë se asnjë kornizë ligjore nuk është e përsosur dhe së rishikimi i “paketës” së dispozitave ligjore për këtë sektor pas vitit 2017 do të jetë i dobishëm për të siguruar koherencë dhe tërësi.

[Kërkesat jo-reale](#)

Kosova, si vendet tjera që po lëvizin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, mund të tundohet të miratojë legjislacionin që pasqyron atë të BE-së (transponimi), pa i marrë parasysh vështirësitë për zbatim që mund të paraqiten për të arritur përputhshmërinë e legjislacionit.

Çështjet që duhet të kihet parasysh me këtë rast janë:

- Sa i dobishëm është një ligj që askush nuk mundët ta zbatojë në realitet?
- Nëse vendoset një kërkesë legale joreale, e sjellë “ligjin” në diskreditim
- Neni 7 kushtetutës:
 - Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimin e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe lirisë dhe **sundimin e ligjit**,

Kërkesa joreale mund të parashtrihen për një spektër të tërë të palëve të interesit duke përfshirë trupat qeveritare (qendrore dhe lokale), kompanitë e sektorit publik, kompanitë e sektorit privat, dhe madje edhe individët.

Prandaj gjatë transpozimit të kërkesave të legjislacionit të BE-së në ligjet e Kosovës do të zbatohen veglat në vijim në mënyrë që vlerësohen dhe sqarohen propozimet ligjore para së të propozohen për miratim:

- Vlerësimi i koston së zbatimit



- Një vlerësim i kostos së investimeve dhe të ardhurave që kanë të bëjnë me arritjen e përputhshmërisë
- Vlerësimi i shpërndarjes së këtyre kostove në palët e interesit dhe konsiderimi i kapacitetit të palëve të interesit për të menaxhuar ngarkesat e tilla
- Vlerësim i ndikimit rregullator
 - Identifikimi i ndikimeve të mundshme në administratën publike (qendrore dhe lokale)
 - Vlerësimi i kapaciteteve të administratës publike për të përballuar detyrat dhe përgjegjësitë që vijnë nga propozimet legjislative
- Dispozitat kalimtare reale
 - Përfshirja në dispozitat për implementim të afateve kohore reale dhe të përballueshme për arritjen e përputhshmërisë hap pas hapi

Zbatimi i dobët

Zbatueshmëria e dobët që vjen si rezultat i mangësive apo dobësive zbatuesetë ligjit e diskrediton atë.

- Sa ka vlerë një ligj nëse secili mund ta thyej atë pa u dënuar?

Kjo është pyetje që vlen shumë më gjerë sesa sektori i ujërave dhe është çështje që vazhdon të adresohet nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Përderisa kjo Strategji Shtetërore për Ujëra nuk mundet dhe nuk duhet të provojë ta adresojë këtë çështje në tërësi të plotë, së paku mund të jep një kontribut në përmirësimin gradual të respektimit të ligjit.

Shembujt në sektor përfshijnë:

- Nxjerrja e ujit pa leje adekuate
- Nxjerrja e ujit përtej normave të caktuara në lejen ujore
- Shkarkimi i ujërave të ndotura pa leje adekuate
- Shkarkimi i ujërave të ndotura përtej normave të caktuara në lejen ujore
- Kyçja pa kontratë (ilegalisht) në rrjetin e furnizimit me ujë
- Kyçja pa kontratë (ilegalisht) në rrjetin e ujërave të ndotura apo të drenazimit ujërave sipërfaqësore
- Mos-pagesa për furnizimin me ujë për pije dhe/apo mbledhjen e ujërave të ndotura
- Mos-pagesa për furnizimin me ujë me shumicë (për ujitje)

Adresimi i çështjeve të tilla kërkon përpjekje të përbashkëta administrative dhe politike. Megjithatë, është gjithashtu shumë e rëndësishme që palët relevante të interesit të jenë të vetëdijshme për jo-legjitimitetin e aksioneve të tilla dhe përkushtimin e autoriteteve qeveritare dhe agjentëve të tyre për të zvogëluar thyerjet e ligjit.

Nga një perspektivë më e gjerë një nga thyerjet e vazhdueshme të kërkesave ligjore që shkakton probleme për sektorin e ujërave janë ndërtimet pa leje. Zhvillimet e tilla mund të rezultojnë në çështje për:

- Përdorimin e tokës së pëlleshme bujqësore dhe interferencës me skemat e kullimit dhe të ujitjes
- Furnizimi me ujë të pijshëm – ofrimi i furnizimit për zonat pa planifikim zhvillimor
- Kullimi i ujërave të ndotura – ofrimi i shërbimeve për zonat pa planifikim zhvillimor
- Rreziku nga vërshimet – zhvillimet brenda zonave që janë në rrezik nga vërshimet



6.4.2 Korniza institucionale

Republika e Kosovës ka një kornizë institucionale të avancuar dhe të strukturuar mirë për sektorin e ujërave. Në aspektin konceptual korniza ofron një ndarje të qartë të përgjegjësive në atë mënyrë që ulë potencialin për konflikt të interesit dhe për pjesën me të mirë kërkon vetëm përsosje pa pasur nevojë për riorganizim substancial¹⁰⁷.

6.4.2.1 Shërbimet e ujit

Përgjegjësitë e përgjithshme në sektorin e shërbimeve të ujit janë kryesisht të definuara mirë:

- Ofrimi i shërbimeve me ujë është biznes teknik dhe e vë përgjegjësinë për operim të aktivitetit të biznesit në duart e ndërmarrjeve të pavarura në masë të mjaftueshme;
- Rregullatori ekonomik (biznesor) është i përcaktuar: ARRU
- Rregullatori i shëndetësisë është i përcaktuar: Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
- Rregullatori mjedisor është i përcaktuar: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Sponsori i sektorit, veçanërisht në aspektin zhvillimor – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Trupat e konsumatorëve: Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve

Megjithatë, janë ngritur shqetësime për sa i përket aranzhimeve institucionale në tri aspekte që kanë të bëjnë me:

- Rolin dhe performancën e Bordeve të KRU-ve
- Rolin e komunave
- Vazhdimin e ofrimit të shërbimeve nga entitetet që nuk janë pjesë e KRU-ve që nuk iu nënshtrohen kushteve të njëjta rregullatore sikurse KRU-të

Task Forca e Ujërave ka vlerësuar rolin e komunave në detaje në vitin 2011¹⁰⁸.

Këto çështje po adresohen përmes implementimit të Ligjit nr. 04/I-111 të prillit 2012 (amandamentimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike).

Rëndësia e komunave në sektorin e shërbimeve të ujit duhet të njihet plotësisht. Përpos marrjes në konsideratë të çështjes së bartjes së kompetencave dhe demokracisë lokale, është e rëndësishme të kihet parasysh se planifikimi dhe kontrolli zhvillimorë është nën përgjegjësinë e komunave, dhe që shërbimet e ujit janë një nga aspektet kyçe që e mbështet këtë zhvillim. Me pak fjalë, Komunitat kanë përgjegjësi shumë të qartë në identifikimin e nevojave për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve të ujit në zonat e tyre.

6.4.2.2 Pronësia e infrastrukturës

Infrastruktura që ka të bëjë me shërbimet ujore është në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Megjithatë, ka raste ku infrastruktura është ndërtuar nga komunitat që nuk transferohet tek KRU-të dhe përmes tyre te Qeveria e Kosovës. Kjo temë është hulumtuar në dy raportet e Task Forcës së Ujërave:

- Vlerësimi Institucional i Sektorit të Ujërave, maj 2010
- Roli i Komunave në Sektorin e Ujërave në Kosovës, qershor 2011

Rekomandimet që vijnë nga këto raporte sugjerojnë që komunitat të kenë rol më të madh në menaxhimin e KRU-ve por që ato duhet të heqin dorë nga pronësia e aseteve. Kjo qasje e balancuar e

107 Shikoni p.sh.: Vlerësimi Institucional i Sektorit të Ujit në Kosovë, Task Forca e Ujërave, maj 2010

108 Shikoni p.sh.: Roli i Komunave në Sektorin e Shërbimeve Ujore në Kosovë, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe Task Forca e Ujërave, qershor 2011



ruajtjes së strukturës rajonale por që inkurajon një pjesëmarrje më të madhe të komunave, është opsion i preferuar.

6.4.2.3 Siguria e Digave dhe Akumulacioneve

Vlerësimi i Task Forcës së Ujërave për Sigurinë e Digave në Tetor 2012¹⁰⁹, vjen në përfundim që:

- Nuk ekziston kornizë ligjore që definojnë përgjegjësitë, mbikëqyrjen, sanksionet në rast se neglizhohen masat e sigurisë, etj.

Kjo çështje duhet të adresohet në të dyja aspektet, ligjore dhe institucionale.

6.4.2.4 Ujitja

Ashtu si me rastin e shërbimeve të ujit, edhe në sektorin e ujitjes ka një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi:

- Furnizuesit kryesor për ujitje – tri kompani të mëdha për ujitje (Ndërmarrje Publike)
- Pronar i aseteve dhe sponsor i sektorit – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Politikat e sektorit – Ministri e Bujqësisë
- Asociacioni i shfrytëzuesve të ujit – përfaqësuesit e shfrytëzuesve

Megjithatë, në praktikë ka vështirësi në funksionimin praktik të këtij aranzhimi institucional:

- Asociacioni i shfrytëzuesve të ujit nuk kanë pasur sukses dhe shumica e tyre janë joaktive
- “Mendjet udhëheqëse” të kompanive kryesore të ujitjes (menaxherët e lartë të kompanive) nuk vijnë nga sektori i bujqësisë – edhe pse bujqësia është sektori kryesor që përfiton nga ujitja, ka rrezik substancial që objektivat politike të këtij sektori të mos kuptohen mirë gjatë përgatitjes së strategjive të kompanive.

Kjo çështje është trajtuar me thellësi në Strategjinë e re për Ujitje.

6.4.2.5 Hidroenergjinë

Aranzhimet institucionale për sektorin e energjisë së Kosovës janë jashtë fokusit kryesor të kësaj strategjie. Megjithatë, duhet cekur se aranzhimet që kanë të bëjnë me energjinë hidrike janë të qarta për çështjet vijuese:

- Kompanitë publike operojnë me asetet
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik - sponsor i sektorit dhe pronar i aseteve
- Rregullatori ekonomik – Zyra Rregullatore e Energjisë
- Rregullatori mjedisor – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Megjithatë, duhet cekur se:

- Pronësia e aseteve duhet të sqarohet – siguria e digave,
- Janë planifikuar koncesionet për skema të vogla hidroenergjetike.

6.4.2.6 Mbrojtja nga Vërshimet

Përgjegjësitë për mbrojtje nga vërshimet janë përcaktuar në Kapitullin VIII të Ligjit për Ujëra. Në esencë përgjegjësitë janë të ndara në mes të komunave, Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

¹⁰⁹ http://www.kryeministri-ks.net/tfu/repository/docs/Kosova_Dam_Safety_Review_Oct_2012.pdf



Masat e e ndëmarra për mbrojtje nga vërshimet duhet të jenë në pajtim me Planet për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore.

Megjithatë, dispozitat për përgatitjen e planeve për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet sipas kërkesës së Direktivës 2007/60/EC të Bashkimit Evropian ende nuk janë gati.

6.4.2.7 Rregullimi Mjedisore

Ligji për Ujëra e përcakton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si rregullator kryesor mjedisor në fushën e ujërave dhe i jep asaj dhe institucioneve në vartësi të saj (AKMM, IHMK, Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore) një gamë shumë të gjerë të kompetencave dhe përgjegjësive.

Megjithatë, duhet cekur se me përjashtim të pajisjeve dhe infrastrukturës për monitorimin e mjedisit, Ministria nuk është drejtpërdrejt e kyçur në operimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të sektorit të ujërave, dhe kështu shmangë konfliktin e interesit.

Është gjithashtu e rëndësishme të thuhet se Ministria, në kapacitetin e saj si trup i qeverisë qendrore me përgjegjësi për planifikimin hapësinor ka rol kyç për sigurimin e konsistencës së planifikimit hapësinor me planifikimin për menaxhimin e ujërave.

6.4.2.8 Raporti i Vlerësimit Institucional i Task Forcës së Ujërave

Raporti i vlerësimit institucional i sektorit të ujërave në Kosovë është përgatitur në emër të Task Forcës së Ujërave në maj 2010. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet e raportit janë dhënë këtu.

- Gjetjet e studimit të bazuara në vlerësimin e gjendjes, raporteve relevante, ligjeve të aplikueshme dhe intervistave të vlefshme me aktorët kryesorë të sektorit të ujërave në Kosovë janë si me poshtë:
 - Shpërndarja e gjerë e përgjegjësive delegimi jo i duhur i vendimmarrjes në ministrinë e ndryshme dhe trupat tjerë që merren me ujëra, kanë çuar në aksione të njëanshme, mungesë të komunikimit dhe informimit, përzierje të roleve dhe bashkëpunim të dobët.
 - Mungesa e Strategjisë Shtetërore për Ujëra është evidente dhe përgatitja e saj është e domosdoshme.
 - Mungon një trup qendror për të bërë vlerësimin e resurseve ujore dhe të vendos prioritetet për shfrytëzimin e tij.
 - Edhe pse Ligji për Ujëra sanksionon themelimin e Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore, ai nuk është ende funksional.
 - Nga përshkrimi i aktiviteteve të divizioneve ekzistuese brenda Departamentit të Ujërave, brenda MMPH, mund të shihet qartë së mungon lidhja në shfrytëzimin e ujërave, që e bën të pamundur administrimin e integruar të ujërave.
 - Niveli i ulët i pagesave është pengesë për përfshirjen e ekspertëve në sektorin shtetëror. Situata aktuale është demotivuese për stafin ekzistues.
 - Mungon një mekanizëm për koordinim në mes të niveleve qendrore dhe lokale.
 - Industria e ujërave, si aktivitet deficitar, është pak përfaqësuar në departamentet e ministrive përkatëse dhe është zhvilluar në një formë autarkike dhe pa një koordinim qendror nga kompanitë e ujit.

Rekomandimet në Raportin e Task Forcës së Ujërave përfshijnë:



- Ky studim rezultoi në një sërë rekomandimesh për ndryshimet e nevojshme të cilat do të përmirësojnë funksionimin e sektorit të ujërave në Kosovë. Ndryshimet e propozuara janë të natyrës ligjore, institucionale dhe operacionale.

LIGJORE

- Të përcaktohet me ligj statusi i ujërave duke e shpallur atë me interes të përgjithshëm¹¹⁰ dhe të përcaktohet pronari i ujërave (Republika e Kosovës).
- Të formohet një trup qendror për planifikim për të bërë vlerësimin e resurseve ujore, administrimin e rezervave ujore dhe caktimin e prioriteteve të përdorimit të tyre.
- Të themelohen dhe të funksionalizohen trupat e duhurnë përputhje me DKU.
- Të specifikohen përgjegjësit dhe llogaridhënia për sa i përket planifikimit, rregullimit dhe operacioneve.

INSTITUCIONAL

- Të formohet Divizioni për Shfrytëzimin e Ujërave brenda DU-së. Arsyeja e formimit të këtij divizioni është për të realizuar konceptin integruar të menaxhimit të ujërave, d.m.th shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat. Ky divizion do të shërbente si ndërlidhje në mes të MBPZHR, MEM, MFE dhe MSh.
- Të riemërohet Departamenti i Ujërave në Departamenti për Administrimin e Ujërave.
- Të kthehet inspektimi i ujërave nën kompetencat e DU-së në mënyrë që të kompletohet cikli i informacionit në administrimin e ujërave.
- Të funksionalizohet Këshilli Kombëtar i Ujërave¹¹¹ si organi më i lartë shtetëror për çështje strategjike të administrimit me ujëra.
- Të shtohet në emërtimin e MMPH edhe shprehja “Administrim i Ujërave” për të rritur rëndësinë e ujit si resurs kombëtar. Në të njëjtën kohë, të caktohet një Zëvendësministër për Administrimin e Ujërave.

OPERACIONAL

- Të forcohen mekanizmat koordinues në mes të niveleve qendrore dhe komunale dhe pellgjet lumore me themelimin e korporatës “Ujërat e Kosovës”.
- “Ujërat e Kosovës” do të ishte një person i pavarur juridik që do të ndërlidhte vertikalisht të gjitha Kompanitë e ujërave dhe do t’i administronte, në një mënyrë operacionale, së bashku pellgjet lumore dhe përdorimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe në veçanti ujitjen. Ky entitet do të formonte dhe qeveriste “Fondin e Ujërave”, që do të gjenerohej në bazë të parimeve “përdoruesi paguan” dhe “ndotësi paguan”. Kjo korporatë do të ishte pronar ligjor i aseteve të ekonomisë së ujërave dhe do të qeveriste, mirëmbante dhe zhvillonte atë.

6.4.3 Fuqizimi i Kërkesave Ligjore

6.4.3.1 Task Forca e Ujërave – Rekomandimet e Raportit

Këtu iu referohemi rekomandimeve të bëra në Raportin e Task Forcës së Ujërave:

- Rishikimi i legjislacionit që ka të bëjë me Raportin Final për Sektorin e Ujërave në Kosovë – korrik 2010 – Task Forca e Ujërave - Zyra e Kryeministrit

¹¹⁰ Ky rekomandim në ndërkohë është adresuar me Ligjin për Ujërat e Kosovës të vitit 2013

¹¹¹ Me Ligjin për Ujërat të vitit 2013 ky Këshill është rikonceptuar në Këshillin Ndërmintor për Ujëra dhe ky I fundit në ndërkohë është formuar dhe funksionizuar plotësisht.



Rekomandimet që kanë të bëjnë me shumë çështje janë dhënë këtu.

6.4.3.2 [Vizibiliteti i ndryshimit të Legjislacionit](#)

1) Krijimi i bazës publike të të dhënave/faqa e internetit për legjislacionin e ujërave

MMPH duhet të caktojë dikë në Departamentin e Ujërave apo AKMM ose KNMU për të krijuar dhe mirëmbajtur një faqe të bazës publike të të dhënave në internet për të gjithë legjislacionin primar dhe sekondar (apo referencat për të) duke përdorur listën nga Shtojca 3 si pikënisje. Kjo faqe e internetit duhet të ndërlidhet me një bazë të gjerë të të dhënave nga të gjitha institucionet kryesore, duke përfshirë KRU-të, ministritë, ARRU etj.

2) Përktimi i sektorëve relevant dhe i Shtojcave të Direktivës Kornizë të Ujërave dhe Ujërave të Ndotura të BE-së në shqip dhe serbisht dhe përfshirjen e mëvonshme në bazën e të dhënave në internet.

3) Të konsiderohet si obligim mirëmbajtja e bazës së të dhënave për legjislacion

Obligimet (i) për të ngarkuar dikë për legjislacion dhe (ii) mirëmbajtja e bazës së të dhënave do të mund të bëhej obligim specifik ligjor, p.sh. për MMPH.

4) Legjislacioni si udhërrëfyes për Ministritë tjera dhe palët tjera të interesit

Pasi që legjislacioni sekondar përgatitet për krijimin e (i) prezantimit të thjeshtuar të legjislacionit, (ii) Pyetjet e shpeshta, (iii) ndotja, ndërtimi, lejet/studimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis për objekte industriale.

Të punohet me personat e licencuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe me inspektorët për të bërë prezantim të përbashkët aty ku është e përshtatshme.

Të organizohen punëtori tematike nga mjedisi me komunat, MMPH, KRU-të, MBPZHR, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Financave (Njësinë e PPBs), Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Agjencinë e Pylltarisë, Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Të hartohen materiale me fokus në çështje specifike, p.sh. erozioni, nxjerrja, planifikimi, zonat, planifikimi për vërshimet/emergjencat kur janë relevante. Punëtoritë duhet të jenë me pjesëmarrje/ diskutime dhe jo të formës akademike.

Të krijohet informacioni për biznese p.sh. “A kam nevojë për leje ujore?” të promovohet përmes seminareve me asociacionet e biznesit (Oda Ekonomike e Kosovës, Asociacioni i Ndërtimtarëve, Asociacioni i Arkitektëve, AKB, Amcham), Agjencia për Promovimin e Investimeve, Agjencitë Regjionale për Zhvillim.

6.4.3.3 [Sigurimi i përputhshmërisë praktike](#)

Rekomandimet e prezantuara në lidhje me përputhshmërinë përfshijnë:

- 1) Përmes amendamenteve të duhura të Ligjit për Ujëra dhe sqarimeve të Ligjit për Mjedis, të sigurohet që të ardhurat nga veprimet e komunave të mbesin në komuna që të inkurajohen ato të veprojnë.
- 2) Të lejohen komunat/ministritë që të japin bonuse për inspektorët e tyre në bazë të “suksesit” të tyre.
- 3) Të konsiderohet mundësia që me ligjin e ri për ujëra apo me amendamentimin e ligjit për ARRU / Shërbimet ujore të sigurohet e drejta që inspektorët e KRU-ve të hyjnë në pronat e konsumatorëve në mënyrë që t'i zbulojnë rastet e vjedhjes së ujit dhe të lidhjeve të pa-autorizuara;.



- 4) Të trajnohen inspektorët për mënyrën e vlerësimeve të bazuara në rrezik dhe për vlerësime të rastit.
- 5) Të ofrohen më shumë udhëzime mbi gjobat përmes rasteve studimore/shembujve.
- 6) Të kërkohet mbështetje nga projekti mbështetës i SEAD edhe për zbatimin jo-monetar për inspektorët, jo vetëm vendimet e gjykatës civile. Të përfshihen çështjet në “projektin për komunat me të mira” të USAID-it
- 7) Të promovohet më shumë bashkëpunim në mes të inspektorëve – duke shkëmbyer shembujt në mes të komunave të ndryshme. Të publikohen dhe të përdoren rregulloret komunale sipas nevojës.
- 8) Të shqyrtohet mundësia që inspektorëve komunal, të MMPH (dhe të KRU-ve), të Ministrisë së Shëndetësisë, t’iu jepen më shumë kompetenca zbatuese të barabarta me fuqitë zbatuese të gjykatësve – të mblidhen të dhënat për veturat, asetet, dhe informatat për shkelësit. Në çdo rast më shumë trajnime janë të nevojshme për të drejtat sipas ligjit të vitit 2008. Ndoshta t’iu jepen atyre më shumë fuqi ngjashëm me ato të inspektorëve të taksave – pengu mbi pasuritë etj.
- 9) Të zbatohen menjëherë lejet ujore (mos t’u jepen 18 muaj tjerë për të qenë në pajtim me ligjin) – është i nevojshëm amendamenti i draft Ligjit për Ujëra.
- 10) Të konsiderohet mbledhja e të ardhurave nga MMPH/komuna dhe të tregohet përputhshmëri më e mirë në parandalimin e ndotjes si kusht i financimit për projektet e ujit nga donatorët. Aranzhimet me bashkëfinancim të barabartë??
- 11) Ministria e Drejtësisë apo organizatat tjera kompetente duhet të sqarojnë se lidhjet ilegale, sipas ligjit penal, janë vjedhje¹¹² (siç po veprohet me rastin e energjisë elektrike).

6.4.3.4 Arkëtimi i të hyrave

- 1) Të përmirësohen të dhënat në pretendimet – duke përfshirë letërnjoftimet personale, regjistrin e bizneseve, numrat fiskal të borxhlinjve, aty ku është e mundshme të mblidhen të dhëna më të besueshme që të ndihmohet zbatimi.
- 2) Të llobohet së bashku me ofruesit tjerë të shërbimeve për periudha më të gjata të parashkrimit të borxhit në ligjin e ri mbi marrëdhëniet detyimore p.sh. 3 vite dhe 5 vite.
- 3) Të vazhdohet me dorëzimin e kërkesave tek AKP ndaj ndërmarrjeve që janë në proces të likuidimit.
- 4) Të llobohet për të drejtat prioritare të gjobave për shërbimet publike dhe komunale në rastet e falimentimit – të drejtat e tilla duhet të jenë të barasvlershme apo pak më të ulëta nga ato të Administratës Tatimore të Kosovës (Rregullorja 2003/7 dhe Rregullorja 2006/46 për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore).
- 5) Të përfshihen normat e kamatave të tregut në kontratat me konsumatorë dhe të aplikohen kamata të njëjta për pagesat e papaguara për leje ujore dhe për gjobat (duke përfshirë kamatat sipas Udhëzimit Administrativ për Lejet Ujore). Të sigurohet



pëlqimi i rregullatorit për kamatë në tarifa për vonesat në pagesë. Të zgjedhen norma të thjeshta ditore. Të kërkohet aplikimi i kamatës, sado e ulët, në kërkesa/padi.

- 6) Të punohet me rregullatorin për përmirësimin e tarifave në mënyrë që të përmirësohen pagesat dhe të zvogëlohet burokracia në arkëtimin e të hyrave.
- 7) Të llobohet që t'u jepen kompanive, MMPH dhe komunave të drejta më të mëdha të zbatimit p.sh. të drejta automatike mbi sekuestrimin e aseteve, mundësia që vendimet gjyqësore dhe borxhet të regjistrohen në regjistrin e kredive.

6.4.3.5 Cështjet tjera

- 1) Të rishikohen taksat e lidhjes dhe aranzhimet e ligjit për ndërtime – ARRU mbështet idenë që secili konsumator potencial duhet të paguajë tarifën për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe për lidhjen në shërbimet publike të ujit. Sipas ARRU, tarifa e lidhjes duhet të transferohet nga kuvendet komunale tek KRU-të, duke pasur parasysh se praktikat në të kaluarën janë dëshmuar të jenë të pafavorshme për sigurimin e shërbimeve më të mira.
- 2) Legalizimi i pronave
KRU-të duhet të marrin pjesë në debat dhe të sigurohen që interesat e tyre merren parasysh në procesin e legalizimit në atë mënyrë që nuk u lëshohet leja e legalizimit të ndërtesave pa e bërë pagesën e borxheve të ujit (duke përfshirë lidhjet ilegale në të kaluarën). KRU-të duhet të llobojnë gjithashtu që të marrin një pjesë të pagesave për legalizim. ARRU favorizon pjesëmarrjen e KRU-ve në debate publike mbi legalizimin e lidhjeve ilegale në ato ndërtesa ku shërbimet e tilla janë ofruar. Kjo e drejtë duhet të mbështetet edhe nga legjislacioni tjetër.
- 3) Të sigurohet një bashkëpunim më i madh ndërinstitucional – KPMM, MZHE, MBPZHR.
- 4) Me Ligjin për Shërbimet e Ujit/amendamentimin e Ligjit të ARRU të rishikohen dhe amendamentohen dispozitat për pronësinë e aseteve, shpronësimin, lirin nga leja ndërtimore, bartjen tek KRU-të e aseteve të sistemeve rurale të ujësjellësit dhe kanalizimit, dhe për përgjegjësitë për matësit dhe gypat brenda duke ndjekur konkluzionet e shqyrtimit.
- 5) Duhet që së pari të llogariten kostot në nivel të KRU-ve e pastaj të diskutohen planet e veprimit për asetet e KRU-ve, financimi për shpronësimin dhe marrjen e aseteve të sistemeve rurale së bashku me MF.
- 6) Ujitja
Nevojitet një qartësi me e madhe për asetet dhe përgjegjësitë (për këtë nevojitet një projekt i veçantë). Ligji gjithashtu duhet të harmonizojë terminologjinë.
- 7) PPP-të dhe koncesionet – të përmirësohet aty ku mund të paraqitenë probleme.
- 8) Të hyrat e destinuara nga Eko Fondi / Fondit të Ujërave – të sqarohet por ndërlihdë me incentiva.

KRU-të duhet të përmirësojnë përputhshmërinë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, lidhur me raportimin, ruajtjen e dokumentacionit, etj.

6.4.4 **Monitorimi**

Si vend që aspiron anëtarësimin në BE, është me rëndësi Kosova të zhvillojë tutje programet për monitorimin e ujërave në pajtim me DKU – të kryhet monitorim dhe vlerësimi i statusit të trupave ujore.



Aktualisht IKSHPK nuk ka probleme me kryerjen e obligimeve monitoruese, përveç që stafi ka nevojë për më shumë trajnime për përdorimin e pajisjeve të reja analitike dhe mundësisht për analizimin e merkurit¹¹³. Prandaj, IKSHPK në parim është në gjendje të plotësojë kushtet për monitorim sipas kërkesave të Direktivës së BE-së 98/83/EC *për cilësinë e ujit të destinuar për konsum nga njerëzit* (kjo është direktiva kyçe e përmendur në DKU në lidhje me ujin e pijshëm).

Duke marrë parasysh gjendjen e tanishme të monitorimit nga IHMK (seksioni 12.4.1), janë identifikuar tre hapa për zhvillim të mëtutjeshëm:

- 1) Rehabilitimi dhe konsolidimi
- 2) Përgatitja për monitorim dhe vlerësim në përputhshmëri me DKU
- 3) Finalizimi i aranzhimeve për fillimin e monitorimit dhe vlerësimit në përputhshmëri me DKU

Rëndësia e monitorimit të sasisë së ujërave është një prioritet kyç.

Monitorimi i reshjeve, prurjes së lumenjve dhe sasive të ujërave nëntokësore

Informatat e përditësuara për reshjet, shfrytëzimin e resurseve ujore, prurjes së lumenjve dhe sasisë së ujërave nëntokësore është me rëndësi thelbësore për një numër aspektesh të veprimeve të rekomanduara duke përfshirë:

- Zhvillimin e resurseve ujore
- Mbrojtjen nga vërshimet
- Planifikimin për menaxhimin e pellgjeve lumore

Përgatitja e projekteve zbatuese për dy pikat e para varet veçanërisht nga sigurimi i të dhënave.

Përderisa të dhënat për periudhën para vitit 1990 janë në dispozicion, të dhënat pas kësaj periudhe mungojnë për shkak të dëmtimit të rrjeteve të monitorimit për këto variabla. Përkundër disa iniciativave nga ana e donatorëve që të rinovohen këto rrjete, ato ende nuk operojnë sipas standardeve të kërkuara. Gatishmëria e donatorëve për të kontribuar për projekte tjera në këtë fushë pritet të jetë e kufizuar përveç nëse Qeveria e Kosovës jep kontribut të madh për riparimin, operimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Kontributi i tillë është vital për implementimin e suksesshëm të investimeve të përshkruara më sipër.

Detajet e veprimeve për të ndikuar në këto zhvillime janë dhënë në planin e veprimit më poshtë.


113 Duhet të verifikohet nëse është e mundur matja e merkurit (Hg) me ICP-MS.

6.4.5 Menaxhimi i të dhënave

Të dhënat që kanë të bëjnë me prurjen e ujërave, kryesisht mbahen në mënyrë manuale dhe ka hapësirë për përmirësime.

Duke marrë si shembull cilësinë e ujërave, figura me poshtë ilustron si mund të zëvendësohet sistemi manual me atë automatik ku të dhënat do të mund të transferohen dhe publikohen në mënyrë elektronike

Figura 31 Tranzicioni nga sistemi i vjetër i të dhënave te sistemi i ri i menaxhimit të të dhënave



Sistemi në të ardhmen do të merr parasysh aspektet hapësinore, duke përfshirë të dhënat që kanë të bëjnë me ujë, duke ua mundësuar hartave digjitale që të ndërlidhen me bazën e të dhënave. Hartat do të shërbejnë si vegël orientimi për bazën e të dhënave (klikohet në hartë, p.sh. në stacionin e monitorimit, dhe shihet së çka është ruajtur në bazën e të dhënave nga objekti i klikuar) si dhe si mjet për të treguar të dhënat si harta tematike (siç është dendësia e popullsisë apo nevojat për investime si harta me ngjyra ose të mbuluara me shenja të ndryshme).

Për të plotësuar kërkesën për shpërndarje të informatave sipas Ligjit për Ujëra, si dhe për të përmirësuar shkëmbimin e të dhënave në mes të departamenteve dhe institucioneve të vendosura në objekte tjera, Sistemi i Informacionit Ujor duhet të jetë në Internet. Kjo është gjithashtu kërkesë e BE-së për raportim siç është raportimi për të dhënat mjedisore për AEM via EIONET.

Përfundimisht, një sistem informacioni për MMPH do të përfshijë linçet me modelet dhe GIS. Një shembull do të ishte ndërlidhja ndërmjet bazës së të dhënave dhe modelit SVPU që do të përdorej p.sh. nga stafi që lëshon lejet ujore i DU për të vlerësuar ngarkesën totale nga disa shkarkime të ujërave në lum. Hartat digjitale të treguara përmes sistemit të hartave në rrjet duhet të përditësohen me GIS dhe licencat e tanishme të ArcGIS dhe MapInfo duhet të përditësohen dhe numri i tyre të shtohet.

Sistemi i paraparë do të përmirësonte menaxhimin e të dhënave në MMPH si në vijim:



- Duke përdorur një shfletues interneti pasi që përdoruesi përdor hartat si një mjet të navigimit, sistemi jep qasje të lehtë për të gjitha të dhënat e ruajtura si numra, tekst, imazhe, raporte dhe harta, si dhe bashkimi i këtyre të dhënave në grafikone, diagrame dhe harta tematike .
- Sigurohet besueshmëri e të dhënave duke përdorur sistem profesional të menaxhimit të të dhënave dhe ruajtje ("backup") i rregulltë.
- Përmes ndërlidhjeve me modelet si SVPU dhe ndërlidhjeve me raportet, sistemi do të lehtësojë detyrat që lidhen me dhënien e lejeve.
- Mbishtresimi i shtresave të hartave, qasja në të dhënat për popullsinë dhe parashikimet për trendet e popullsisë mundësojnë që të shpërfaqen zonat e konfliktit dhe të mundësive. Këto funksione mund të përdoren gjithashtu për të mbështetur planifikimin, të prezantojnë varësinë hapësinore të investimeve të propozuara dhe të shërbejnë si vegël mbështetëse për vendim-marrje brenda sektorit.

Shumica prej këtyre iniciativave kërkojnë investime modeste kapitale dhe kosto modeste të operimit. Baza e të dhënave dhe serverët e rrjetit tanimë ekzistojnë në IPA me kapacitet më të madh se që nevojitet në një të ardhme të parashikuar. Për shembull, pagesat për licencën e serverit SQL janë tanimë të përfshira në buxhetin e Qeverisë dhe pagat për stafin që menaxhon atë janë tanimë të mbuluara.

Megjithatë, ajo që kërkohet janë disa investime për trajnimin e stafit të caktuar të MMPH për mirëmbajtjen e sistemit të informacionit. Në mënyrë ideale sistemi do të duhej të dizajnohej për mirëmbajtje të lehtë, pa ri-programim, kur paraqitet nevoja për ndryshime dhe zgjerim. Alternativë tjetër do të ishte që këto detyra t'u jepeshin ndërmarrjeve lokale të IT-së.

Kostot kapitale dhe operative varen plotësisht nga zgjedhja e sistemit dhe vlerësimet shkojnë nga zero në 100,000 EUR për investime në softuer dhe nga gati zero deri në 50,000 EUR/vit për pagesën e softuerit, mbështetje dhe trajnime.

6.4.6 Zhvillimet e tjera

Korniza e tashme institucionale është e përshtatshme. Dobësitë kryesore kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve të nevojshme teknike dhe numrin e stafit. Kosova ka popullsi dhe ekonomi relativisht të vogël. Si rrjedhojë, edhe institucionet për menaxhimin e ujërave janë gjithashtu relativisht të vogla. Megjithatë, secili institucion përballlet me sfida të ngjashme teknike me ato të vendeve të mëdha dhe atyre që janë anëtare të BE-së. Vështirësia vjen si rezultat i mosarritjes së "masës kritike" institucionale për të përballuar numër të duhur të pozitave specifike teknike.. Prandaj ka një logjikë të fortë për sa i përket thënies se një "qendër e ekspertizës teknike në sektorin e ujërave" që mbështet të gjitha institucionet e nën-sektorëve tjerë do të ishte një mënyrë e duhur për adresimin e këtyre sfidave.

Kjo qasje është zhvilluar konceptualisht për Institutin e Ujërave dhe vëmendje gjithashtu i është kushtuar nevojës për zhvillim akademik për të mbështetur argumentin e ekspertizës teknike në këtë sektor për vitet në vijim.

6.4.6.1 Aspektet akademike

Aspektet akademike në sektorin e ujërave janë hulumtuar në emër të Task Forcës së Ujërave në vitin 2010 dhe janë përfshirë në raportin: Zhvillimi i Programit Universitar për Sektorin e Ujërave në Kosovë – Arsimi i Lartë dhe Hulumtimi Shkencor.

- .



Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe prioritet e identifikuar në këtë raport janë dhënë këtu.

Përparësitë

- Disa laboratorë janë mobilizuar për të trajtuar çështjet në vendngjarje:
 - Laboratori mikrobiologjik (Universiteti i Prishtinës, UP) ka disa mjete për punë në trajtimin e ujërave të ndotura me llum të aktivizuar apo për të karakterizuar cilësinë biologjike të ujit në lumenj apo në liqene,
 - Laboratori kimik ka kryer një varg aktivitete të mostrimit dhe të testimit për të kualifikuar ndotjen e sedimenteve dhe ujërave përgjatë lumenjve (organike apo metalike).
 - Krerët e të dy laboratorëve kanë vullnetin të rrisin aktivitetet e tyre në atë drejtim
- UP dhe stafi mësimdhënës janë të rëndësishëm; ato janë mjaft të fuqishme për tu mobilizuar si sistem i lobimit për të ndihmuar arsimin e lartë për të pasur mjetet që korrespondojnë me ambicien e tyre.
- Disa profesorë janë të përfshirë në rrjetet më të mira shkencore duke përfshirë ekipet kërkimore “të ekselencës”. Ato duhet të mobilizohen për të treguar arsyeshmërinë e të qenit pjesë e këtyre sistemeve në kuptimin e mjeteve dhe rezultateve.
- Shume asistentë dhe profesorë të asociuara tregojnë potencial të të qenit pjesë e këtyre rrjeteve kur ata janë inkurajuar për të hyrë në këtë lloj mjaft sfidues të punës bashkëpunuese.
- Rrjetet e partnerëve të ndryshëm tashmë ekzistojnë në arsimin e lartë, institucionet kërkimore dhe ekonomike; ato duhet të përdoren nga i tërë komuniteti.
- Ekzistojnë vende në Kosovë ku praktiket më të mira në kuptimin e metodave të mësimdhënies janë të orientuara në drejtim të zhvillimit të kualiteteve personale sa i përket sjelljes apo qëndrimit: seminarët, rastet studimore, puna ekipore, mbrojtja me gojë apo me shkrim e temave etj. Ato duhet të zgjerohen me tutje.

Dobësitë

- Para se gjithash, mungesa e transparencës është një pengesë reale, në fakt shumë të dhëna bazike janë mjaft të vështira për t'u mbledhur dhe vetëm disa ueb faqe përditësohen rregullisht.
- Ekziston një nevojë e madhe për laboratorë kërkimorë për të siguruar disa nga mjetet më të mira apo të teknologjisë së fundit, në mënyrë që të shmanget mbështetja e plotë në laboratorët e huaj; mjetet moderne janë të shtrenjta prandaj ato duhet të përdoren bashkërisht nga i gjithë komuniteti shkencor.
- Nuk ekziston një strukturë e qartë për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore në nivel të universiteti. Prandaj duhet të zbatohen procedurat ligjore, financiare, administrative dhe teknike; ato janë të nevojshme për të menaxhuar secilin aktivitet kërkimor në nivel të njësisë kërkimore (5 deri 30 punëtorë shkencor me interes të përbashkët). Kjo është një domosdoshmëri e madhe për të filluar me ndonjë ekip kolektiv kërkimor apo aktivitet zhvillimor. Puna kërkimore në ditët e sotme kërkon qasje “kolektive” dhe njësi të fuqishme.
- Studentët, doktorantët si dhe mësimdhënësit, të gjithë e dinë se sa e vështirë është për të marrë vizat; rrjetet aktive nga partneritetet e ndryshme mund të shfrytëzohen për të tejkaluar këtë vështirësi.



- Distanca dhe kostot që ndërlidhen me bashkëpunimin me Institucionet e Europës Perëndimore apo asaj Veriore janë mjaft të larta; në disa raste bashkëpunimi regional mund të jetë i mjaftueshëm dhe më i lirë.
- Metodatat moderne aktive të mësimdhënies kanë nevojë për kushte; dhoma, kompjuter, qasje në internet dhe mbi të gjitha disponueshmëri dhe kontribut të vazhdueshëm të profesorëve.
- Rrjetet kombëtare që mundësojnë krijimin e mundësive për stazh, vendosje dhe kurrikula të përbashkëta janë konsideruar se janë shumë të rralla.

Mundësitë

- Kjo detyrë në vetvete mund të konsiderohet si një sinjal i nivelit të lartë që Shteti tregon se Institucionet e Arsimit të Lartë të përfshira si në trajnim ashtu edhe në studime kërkimore pritet që të japin përgjigje për nevojat të shprehura nga ky sektor i ekonomisë.
- Shumica e palëve të interesuara të intervistuar që merren me ujërat janë shprehur të vullnetshme për të bashkëpunuar me sistemin e Arsimit të Lartë forma të ndryshme si: Komitetet Drejtuese, vizitat, temat për projektet apo rastet studimore, stazhet. Ky propozim është formuluar qartë nga Drejtori i KRU Prishtina.
- Donatorët dhe zyrat e bashkëpunimit duket se janë të gatshme të fusin një kapitull të veçantë (bashkëpunimi me Arsimin e Lartë dhe Institutet Kërkimore) në të gjitha projektet e tyre por kjo ka nevojë për një kornizë para se të vihet në dispozicion ndonjë financim.
- Procedura e akreditimit të Komisionit të BE është një proces i vazhdueshëm dhe kërkues; kërkesat për anëtarësim mund të paraqesin një mjet për krijimin e kurrikulave të reja multi-diciplinare apo inter-diciplinare që do të mund të lidhen me kërkesat e sektorit.

Prioritetet

- Kurset e studimeve Master duhet të zgjedhen si një përgjigje e duhur për nevojën e kurseve interdisciplinare në fushën e burimeve natyrore, menaxhimit të mjedisit dhe ujërave; është parë si e pranueshme që studentët për studime Master të zgjedhen në mesin e atyre studentëve që vijnë nga kurrikulat mjaft të ndryshme ‘mono-diciplinare’ të studimeve baqellor. Këta student mandej do të kishin përfitim nga mundësia për të zhvilluar dy kompetenca kryesore që do të lehtësonte futjen e tyre në punë.
- Aktivitetet kërkimore duhet që të fokusohen në mënyrë strikte në lëndët që në mënyrë specifike janë të lidhura me situatën në Kosovë e që është kryesisht ndotja dhe metodologjitë për largimin e ndotjes si dhe mjete që shfrytëzohen për arritjen e objektivave të DKU. Këto programe kërkimore duhet të përfshijnë komponentin e fuqishëm të terrenit.

Rekomandimet nga raporti janë dhënë këtu gjithashtu: **- te behet nje SWOT qe eshte me i qarte**

Zhvillimi i kapaciteteve teknike kombëtare

Task Forca e Ujërave, Zhvillimi i Programit Universitar për Sektorin e Ujërave në Kosovë – Arsimi i Lartë dhe Hulumtimi Shkencor, 2010

Tabela 96 Rekomandimet për zhvillimin e programeve akademike

Ref	Aksioni	Përgjegjës	Kostoja
1.1	Për implementimin e programit të ri “Master i Menaxhimit të Mjedisit” MSc	Universiteti i Prishtinës	€340,000
1.2	Përmirësimin e drejtimit të Masterit për Hidro-teknikë	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në UP	€165,000



1.3	Përmirësimin e drejtimit të Masterit për Prodhimet Bimore	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në UP	€70,000
1.4	Përmirësimin e drejtimit të Masterit për Menaxhimin e Resurseve Natyrore	Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave Natyrore në UP	€50,000
1.5	Program i Integruar i Seminareve për Menaxhimin e Resurseve Ujore	MMPH	€142,000
1.6	Të fillojnë aktivitete hulumtuese për sektorin e ujërave: - A trajtimi i ujërave të ndotura; - B rehabilitimi i lumenjve; - C vlerësimi i resurseve ujore; - D sociologji dhe ekonomi që ka të bëjë me sektorin e ujërave.	MMPH dhe MEST	€500,000
1.7	Promovimi i shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës përmes rrjeteve ndërinstitucionale	MMPH	€50,000
	Gjithsej		€1,317,000



7 Analiza financiare dhe ekonomike

7.1 Hyrje

Bjë aspekt themelor i secilës strategji është përcaktimi i kostos për arritjen e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe me objektivat strategjike.

Procesi i përafrimit përbëhet nga transpozimi i kërkesave të BE në legjislacionin e Kosovës dhe më tutje nga **implementimi** dhe zbatimi i atij legjislacioni. Implementimi do të kërkojë zhvillimin e nën strategjisë dhe planeve që identifikojnë burimet që janë të nevojshme dhe si ato mund të mobilizohen për të kryer implementimin e *acquis*.

Në mënyrë që të plotësohen kërkesat e *acquis*, Kosova ballafaqohet me një sfidë të madhe në fushën e ekonomisë dhe financave. Shuma kostove të investimeve dhe të operimit dhe menaxhimit është e konsiderueshme dhe koha e nevojshme për të arritur këtë është e gjatë. Dinamika e zbatimit kufizohet nga disa pengesa në lëminë e përballueshmërisë për konsumatorët, kufizimeve kombëtare në kapacitetin investues në projektet mjedisore, fondet e donatorëve, kapacitetet e qëndrueshme financiare dhe kufizimet tjera të veçanta siç është kapaciteti ndërtues.

Planifikimi ekonomik dhe financiar në kuadër të Institucioneve Qeveritare të Kosovës është zhvilluar dhe kapacitete shtesë janë duke u arritur në mobilizimin e fondeve të BE, kontributeve të donatorëve të tjerë dhe mekanizmave financues nga Institucionet Financiare ndërkombëtare. Kapacitet i ngjashëm kërkohet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mënyrë që të adresohen komponentët financiarë të planifikimit të menaxhimit të integruar të pellgjeve lumore.

Procesi i implementimit të legjislacionit të ujit të BE imponon dhe do të vazhdojë të imponojë një varg kostosh shtesë dhe përfitimesh për ekonominë e Kosovës. Kostoja e përputhjes me legjislacionin është mjaft e gjerë dhe do të rezultojë kryesisht në:

1. Investime të mëdha në infrastrukturë të nevojshme për implementim dhe përputhje me *acquis*; (CAPEX)
2. Kosto të operimit dhe mirëmbajtjes që shoqërohen me operimin e këtyre investimeve; (OPEX)
3. Ngarkesë administrative të rritur për të mbështetur, transpozuar, zbatuar dhe monitoruar legjislacionin; (ADMIN)

Këto kosto do të barten nga:

- A. Qeveria qendrore;
- B. Qeveritë lokale;
- C. Industrinë, bizneset, sektori publik dhe ai privat;
- D. Ekonomitë familjare dhe fermerët përmes mekanizmave të ndryshme të mbulimit të koston duke përfshirë veçmas tarifatat për shërbimet publike.

Burimet financiare për secilin nga këta aktorë janë të kufizuara në çfarëdo kohe. Analiza financiare dhe ekonomike në vijim kërkon të shqyrtojë shtrirjen deri ku këto pengesa financiare janë në gjendje të sfidojnë barrën për implementim dhe kërkon të paraqes afatin real, të përballueshëm dhe ekonomikisht racional.

Analiza ekonomike e prezantuar këtu merr parasysh koston e implementimit duke marrë parasysh pengesat me të cilat ballafaqohet Kosova dhe nxjerrë vlerësimin e kapacitetit për investime ndër vite bazuar në vlerësimin e:

- Investimeve kapitale (CAPEX) që duhet të mbulohen nga burime të si fondet e donatoreve, kreditë dhe alokimet nga Buxheti i Kosovës;



- Kostove operative (OPEX), duke përfshirë koston financiare të jetëgjatësisë së projektit që duhet të mbulohet nga kompensimi i koston;
- Kostoja administrative (ADMIN) që duhet të mbulohet nga Buxheti i Kosovës

Nga këto analiza do të nxirret Strategjia Financiare.

7.2 Metodologjia

7.2.1 Fushëveprimi i analizës së koston

Ashtu siç u diskutua në këtë Strategji dhe gjetiu, koston e arritjes së pajtueshmërisë me Direktivën Kornizë të Ujërave në shumicën e Shteteve Anëtare dominohen nga koston e shoqëruara me ato që quhen “direktivatat e investimeve të mëdha”, duke përfshirë DTUNU, DUP dhe direktivën për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet. Ashtu si u tha me lartë, DTUNU dhe DUP imponojnë koston për popullsinë (përmes tarifave të kërkuara për mbulimin e e kostonve). Implementimi tyre është i kufizuar nga pragu i përballueshmërisë të ekonomive familjare dhe nga kufizimet e buxhetit institucional. Duhet të thuhet se infrastruktura për mbrojtje nga vërshimet, koston e së cilës janë të konsiderueshme, nuk financohet zakonisht përmes ngarkesës së shfrytëzuesit në të njëjtën mënyrë siç bëhet të shërbimet e ujit. Si të tilla, pengesat e përballueshmërisë financiare për këto investime janë më pak drejtpërdrejt të lidhura me përballueshmërinë financiare të ekonomive familjare.

Duke parë dominimin e tri Direktivave të referuara me lartë, kostoja e implementimit e analizuar këtu fokusohet në këto tri direktiva. Kostoja e vlerësuar mbulon:

1. Ujin e Pijshëm – bazuar në nevojat e zhvillimit të përmendur me lartë
2. Ujërat e ndotura urbane – bazuar në nevojat e zhvillimit të përmendur me lartë
3. Mbrojtjen nga vërshimet në tri faza:
 - 3.1 Modernizimi i infrastrukturës ekzistuese, në baza afatshkurtra,
 - 3.2 Faza e I-rë e përafrimit deri në 2022, me ndërtimin e infrastrukturës prioritare;
 - 3.3 Përputhja e plotë me këtë Raport deri me 2036.

Duhet të thuhet se ashtu siç u përshkrua më lartë, kostoja e detajuar e vlerësuar për infrastrukturën e mbrojtjes nga vërshimet tani për tani nuk është në dispozicion.

Duhet gjithashtu të thuhet se koston për adresimin e nevojave zhvillimore për sektorin e ujit nuk janë përfshirë. Ujitja është sektor i rëndësishëm ekonomik që ka ndikim të fuqishëm në shfrytëzimin e ujit në nivelin teknik, por nuk do të pengojë dinamikën kohore të nevojshme për të përmbushur kërkesat e DKU. Megjithatë është e rëndësishme të thuhet se uji për ujitje duhet të jetë me pagesë e cila do të mbulonte plotësisht koston për ofrimin e atij uji për ashtu siç është përcaktuar në Direktivën Kornizë të Ujërave (Neni 9).

Prezantimi i kostonve është bërë përmes “vlera aktuale Neto”. Kështuqë, duhet të kihet kujdes që, gjatë krahasimit të vlerave të kostonve, të sigurohet që metodologjitë të jenë të njëjta dhe që ato t’iu referohen zërave të njëjtë. Është e rëndësishme të saktësohet nëse vlerësimet e kostonve janë në terma



nominal apo në terma të vlerës aktuale neto (NPV¹¹⁴) dhe nëse ato përfshijnë kostot operative apo vetëm investimet.

7.2.2 Korniza metodologjike

Në vijim është dhënë në formë të përmbledhur qasja e aplikuar gjatë analizës. Një shpjegim i detajuar metodologjik është dhënë ndaraz.

Hapat e përcjellur janë:

- 1) Përcaktimi i pikënisjes/gjendjes aktuale
Ky “skenar bazë” i nxjerrë nga informacioni ekzistues dhe “planet e zotuar” përcakton situatën e tanishme si në kuptimin e “gjendjes së zbatimit” ashtu dhe nga “disponueshmëria e burimeve”.
- 2) Kostot e implementimit
Kjo është efektivisht një “gap analizë” që përcakton kostot e implementimit të kërkesave të legjislacioneve për skenarët bazë dhe përtej tyre. Ashtu siç u tha më lartë, vlerësimi i kostove fokusohet në tri Direktiva dominante. Duhet thënë gjithashtu që një provizion i rëndësishëm është ofruar për kostot e asociuara me “administrim” (ADMIN) duke përfshirë tërësinë e kostove administrative, rregullative dhe atyre “indirekte” të shoqëruara me implementimin jo vetëm të tri Direktivave por edhe të tërë barrës që imponohet nga *acquis për ujërat* – pra e atyre kostove që shkaktohen jashtë përgjegjësisë direkte praktike dhe teknike të ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë apo të menaxhimit të ujërave të ndotura.
- 3) Përcaktimi i afatit “të paracaktuar”
Kjo përfshinë definimin e afatit të supozuar për implementim. Ky afat fillestar “të paracaktuar” paraqet “vlerësimin e arsyeshëm” të kohës së kërkuar.
Nevojat investive të identifikuara janë përcaktuar për secilin vit brenda kësaj periudhe.
- 4) Analiza e rastit “standard”
Ky është përafrimi i parë në procesin analitik dhe imponon detyrimin e shqyrtimit të ndikimeve financiare dhe ekonomike në rastin e zgjedhur dhe krahason këto ndikime me projektimin e burimeve në dispozicion (përballimi financiar). Rezultati kryesor në këtë proces është identifikimi i “gapit financiar” që paraqet diferencën ndërmjet kostove të përgjithshme që paraqiten nga implementimi i rastit të zgjedhur dhe mjeteve të vlerësuara financiare në dispozicion.
- 5) Definimi i skenarit
Duke pasur për bazë analizimin e “rastit standard”, janë shqyrtuar një numër i opsioneve tjera që imponojnë dallimin në nivelin e ambicies, pra duke bërë ndryshimin e afateve të implementimit për nevojat zhvillimore.
Në këtë Strategji është bërë një analizë paraprake duke përcaktuar dy skenarë kryesorë, ‘rasti bazë’ i nxjerrë nga modeli i llogaritjes së kostove teknike që ilustron ndikimet e veta

¹¹⁴ Neto vlera e tanishme paraqet diferencën ndërmjet “vlerave të tanishme” (PVs) të të hyrave dhe shpenzimeve të ardhshme. Vlera e tanishme gjithashtu njihet si vlera e tanishme e zbritur dhe është shuma e parasë e cila është zbritur për të pasqyruar vlerën e saj të tanishme sikur ajo të ekzistonte sot. Vlera e tanishme është gjithmonë më e vogël apo e barabartë me vlerën e ardhshme sepse paraja e ka potencialin e fitimit në kamatë që është karakteristik e cila referohet si vlera kohore e parasë. Vlera kohore mund të përshkruhet me një frazë të thjeshtë, “Një dollar i sotëm është më i vlefshëm se një dollar i nesërm”. Shtrirja për të cilën “paraja e gatshme tani” vlerësohet përtej “parasë së gatshme me vonë” të “shkallës së zbritjes” për përqindjen vjetore për të cilën vlera e ardhshme është zbritur nga vlera e tanishme.



ekonomike, dhe 'skenari i arsyeshëm' që e përshtat procesin e investimeve me pengesat e përballueshmërisë financiare.

6) Optimizimi

Bazuar në analizën e skenarëve, definohet dhe zbatohet "qasja e preferuar"

7.2.3 Elementet kryesore të qasjes

Për të vlerësuar koston e përafrimit dhe në përgjithësi ndikimin rregullator janë përdorë dy metoda të gjëra:

- **Qasja nga poshtë-lartë.** Kjo konsiston në projektimin e koston bazuar në të dhënat e mbledhura përmes studimit dhe duke i'u referuar kostove specifike të sektorit. Baza e të dhënave (e pjesshme) e përcaktuar në këtë mënyrë pastaj projektohet për tërë sektorin e mjedisit/direktivës së përfshirë;
- **Qasja nga lartë-poshtë,** apo analiza makro-ekonometrike. Në këtë rast ndikimet vlerësohen mbi bazën e ndotësve që duhet të largohen apo të popullsisë që duhet të shërbehet me standarde të reja apo të përmirësuar. Vëllimet dhe kostot për njësi nxjerrjen nga referencat vendore dhe ato ndërkombëtare.

Qasja nga poshtë-lartë përdoret përgjithësisht kur të dhënat e shumta janë në dispozicion dhe direktiva e cila vlerësohet ka ndikim në sektorin specifik me një numër të kufizuar të palëve të përfshira. Fuqia e saj bazohet në atë se ky është vlerësim që ka burimin në industrinë me të dhëna të pjesshme të marra nga operatorët. Dobësia e saj është se kjo formë e ekstrapolimit mund të shkaktojë një magnitudë të madher të gabimeve nëse të dhënat kryesore nuk janë të mjaftueshme, nuk janë përfaqësuese ose që janë nxjerrë nga referenca bazë që dallojnë shumë nga kushtet karakteristike që dominojnë në regjionin/ vendin përfitues.

Nga lartë-poshtë, qasja makro-ekonometrike përdoret kur direktivat e vlerësuar janë komplekse dhe kanë një ndikim të gjerë në arritjet dhe veçmas që kanë ndikim të konsiderueshëm në popullsinë dhe që duhet të afatizohen ashtu që mos të tejkalojnë pragun e përballueshmërisë financiare.

Në fakt, për vlerësimin e kostove janë përdorur të dyja qasjet, ajo makro-ekonometrike për të vendosur kornizën e përgjithshme dhe për të vlerësuar rrjedhën ndër vite të kostove të ndara në CAPEX, OPEX dhe ADMIN, si dhe ajo nga poshtë-lartë apo mikro-ekonometrike për të vendosur në kuadër të asaj kornize dhe shpërndarjes shumëvjeçare, projektet specifike ose projektet e përbashkëta për një zonë/masë dhe për të bërë prioritizimin e tyre në kuadër të pengesave të definuara në atë kornizë.

Rezultatet e llogaritjeve janë paraqitur si kosto shumëvjeçare që mundëson krahasimin e kostove me burimet në dispozicion duke marrë parasysh kufizimet e imponuara nga pragu i përballueshmërisë financiare. Kjo në fund siguron që implementimi i Procesit të Përafrimit nuk lejon:

- Të vendosen afate kohore jo reale si rezultat i të cilave kostot operative do të ishin më të mëdha se sa maksimumi i përballueshmërisë financiare, që d.m.th. se maksimumi i kompensimit të koston është i pamjaftueshëm për të mbuluar kostot e operimit.
- Subvencionimin ndër-sektorial brenda sektorit të ujërave apo nga një sektor mjedisor në tjetrin, që do të komprometonte rëndë domosdoshmërinë e implementimit harmonik, duke pasur parasysh natyrën ndërvepruese të mjedisit.

Këta faktorë duhet të merren parasysh në mënyrë që të elaborohen politika kombëtare të arsyeshme dhe kredibile.



7.3 Baza

Konteksti i tashëm ekonomik dhe financiar i Kosovës është shqyrtuar më herët në këtë Strategji. Informacioni i prezantuar atje është përdorur në këtë kontekst, por nuk është përsëritur këtu.

7.3.1 Gjendja Aktuale e Implementimit

Hapi i parë në përcaktimin e kostove të implementimit është që të përcaktohet pika e fillimit. Kostot e Direktivës së Ujërave të Ndotura Urbane dhe Direktivës së Ujit të Pijshëm, që të dyja këto Direktiva që kërkojnë investime të larta, janë llogaritur duke bërë Vlerësimin e Kostove të Përputhshmërisë siç është referuar në Kapitullin për Nevojat Zhvillimore.

7.3.2 Datat e synuara për përputhshmëri

Qëllimi i kësaj analize ekonomike dhe financiare është që të kontribuojë në përcaktimin e afateve kohore realiste, të përballueshme dhe optimale për arritjen e përputhshmërisë me kërkesat direktivat. Kështuqë, duhet të kihet parasysh që synimet që gjenden në analizën në vazhdim janë indikativë dhe jo definitive. Afatet specifike janë prezantuar në kapitullin në vijim. Në këtë rast, synimet për përputhshmërisë janë prezantuar si % e popullsisë që duhet të shërbehet me sistem që është në përputhshmëri të plotë.

7.4 Uji i pijshëm

7.4.1 Caqet implicite në skenarin bazë – Uji i Pijshëm

Me poshtë janë dhënë caqet për secilën zonë të shërbimit të klasifikuara në bazë të madhësisë së zonës në Skenarin Bazë të Kalkuluar.

Tabela 987 Caqet për përputhshmëri me Skenarin Bazë

	Madhësi a	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2036
Përqindja e furnizimit me ujë të pijshëm si % e popullsisë urbane	I	84%	84%	88%	91%	95%	95%	95%	95%	95%	95%	95%
	II	58%	58%	62%	68%	79%	85%	90%	90%	90%	90%	90%
	III	89%	89%	89%	89%	89%	89%	91%	93%	94%	94%	94%
	IV	64%	64%	64%	64%	64%	64%	64%	64%	72%	85%	89%
	V	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	TOTAL	76%	76%	79%	83%	88%	90%	91%	91%	92%	93%	93%
Përqindja e pastrimit të ujit të pijshëm si % e popullsisë Urbane	I	78%	78%	83%	95%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	II	60%	60%	62%	74%	82%	98%	100%	100%	100%	100%	100%
	III	81%	81%	81%	81%	81%	87%	96%	100%	100%	100%	100%
	IV	66%	66%	66%	66%	66%	66%	66%	66%	81%	96%	100%
	V	93%	93%	93%	93%	93%	93%	93%	93%	93%	97%	100%
	TOTAL	74%	74%	77%	88%	93%	98%	99%	99%	99%	100%	100%

Caku i përcaktuar është viti 2036. Caku që duhet të arrihet është mbulueshmëria prej 93% të popullsisë me furnizim me ujë që i përmbush plotësisht standardet.

Konvergjenca e tipeve të ndryshme të komunave për këtë cak (për mbulueshmërinë dhe për standardet e cilësisë) çështje ilustruar në mënyrë grafike dhe paraqitur mëposhtë.



Figura 32 Progresi i mbulueshmërisë me lidhje në sistemin e ujit të pijshëm – rasti bazë






Figura 33 Progresi i mbulueshmërisë me trajtimin e ujërave – rasti bazë



7.4.2 Kostoja e përafrimit – Uji i Pijshëm

Në bazë të caqeve paraprakë për përputhshmëri, vëllimi i definuar në % të popullsisë që shërbehet plotësisht me sistem të përputhshmërisë dhe me kosto për njësi të definuar, kosto e përafrimit mund të vlerësohet në baza disavjeçare. Kjo është ilustruar me poshtë në terma nominal, i shpërndarë sic Capex, Opex dhe Kostot administrative.

Figura 34 Kostot e implementimit të rastit bazë – termat nominal, rrjedha shumëvjeçare e parasë



Sipas këtij skenari, plani i investimeve është shumë intensiv në afat të shkurt. Kjo është për arsye se cilësia e ujit është me prioritet të lartë për Kosovën.

- CAPEX arrin një vlerë prej pak me shume së €105 Milion për Vit në 2020.
- OPEX rritet dukshëm deri në €25 Milion për Vit në 2036.
- Kostot Administrative rriten me rritjen e OPEX, por në shkallë shumë më të ulët, dhe arrin shumën prej €4 milion për vit në 2036.

Me poshtë janë dhënë kostot e përafrimit të pa-skontuara (që nuk janë zbritur në vlerën e tyre të tanishme) që do të thotë në terma nominal, dhe e skontuar, në terma të Vlerës Neto Aktuale.



Figura 35 Kostoja e implementimit – në terma nominal (e pa-skontuar)





Figura 36 Kostoja e implementimit – NPV e skontuar për 5%





Kostoja totale prej €765 milion deri në 2036 është numër i përgjithshëm vlera e vërtetë e të cilit varet nga shpërndarja kronologjike e kostove. Një magnitudë e tillë, e pagueshme në vitin 2017 nuk është njëjtë si në momentin e arritjes për pagesë, për shembull në vitin 2036.

Kështuqë, për të definuar rezultate të krahasueshme dhe për të eliminuar deformimet kohore, rrjedhat e kostos janë zbritur përsëri në vlerën e tyre të vitit bazë. Ky është koncepti i Vlerës Neto Aktuale (NPV) dhe është një tregues që përdoret në ekonomi për të prezantuar koston e tashme të vendimeve politike.

Norma e zbritjes e përdorur është 5%, njëjtë me atë që rekomandohet për momentin për projektet e mëdha infrastrukturore.

Kjo magnitudë është treguar në anën e djathtë të grafikut.

Kostot e investimeve, CAPEX, janë vlerësuar të jenë €302 milion;

- OPEX, deri në 2036, është kosto e konsiderueshme (dhe e vazhdueshme) që deri në atë datë do të arrijë €191 milion në termat e sotëm.
- Kostot administrative janë vlerësuar në €29 milion, duke arritur, në termat NPV, përafërsisht €3 milion për vit.

Përgjithësisht, kostot e përafërimit për ujë të pijshëm, duke përfshirë ato kapitale, operacionale, dhe administrative janë vlerësuar të jetë €523 milionë.

7.4.3 Kufizimet e përbalueshmerisë – Uji i Pijshëm

Këto rrjedhje të kostos vjetore janë të lidhura me pragjet e vlerësuar të mundësive në mënyrë që të përcaktohet arsyeshmëria e këtij plani dhe, nëse është e përbalueshme, të vlerësohet një kornizë kohore që do të mund të konsiderohej që përkon me kufizimet e përbalueshmerisë.

Për të vlerësuar kufizimet e përbalueshmerisë të ardhurat mesatare për familje janë vlerësuar dhe projektuar.

Kjo është shpjeguar në detaje në kapitujt e mëparshëm.

Zyra e Statistikave të Kosovës ("Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në 2009" publikuar në 2011) ka raportuar të ardhurat mesatare për amvisëri në Kosovë prej €442; të ardhurat mesatare për amvisëri që jetojnë në varfëri prej €232; dhe të ardhurat mesatare për amvisëri që jetojnë në varfëri ekstreme prej €153. Të ardhurat mesatare për ekonomitë familjare në Kosovë prej €442, sipas raportit të Agjencionit Statistikor "Kosova në shifra në 2015", mbetet i ngjajshëm edhe në vitin 2015. Aktualisht, nuk ka të dhëna për mesataren për secilin regjion prandaj mesataret për tërë vendin janë marrë parasysht në analizën e mëposhtme.

Tabela 99 Të ardhurat mesatare të publikuara nga ASK

KRU-të të emëruara sipas regjioneve	Të ardhurat mesatare (€) dhe % e pop.	Të ardhurat mesatare për amvisër që jetojnë në varfëri (€) dhe % e pop.	Të ardhurat mesatare për amvisëri që jetojnë në varfëri (€) dhe % e pop.
Prishtina	442 (69.2%)	232 (21.8%)	153 (9%)
Prizren	442 (59.3%)	232 (33.9%)	153 (6.8%)
Peja	442 (49.7%)	232 (37.2%)	153 (13.1%)
Mitrovica	442 (45.0%)	232 (38%)	153 (17%)
Gjakova	442 (23.6%)	232 (54%)	153 (22.4%)
Gjilan	442 (78.4%)	232 (18%)	153 (3.6%)
Ferizaj	442 (28.5%)	232 (53.8%)	153 (17.7%)
Mesatarja	442	232	153



Kjo e dhënë prej €442 për muaj është përshtatur në rishpërndarje të BPV të kombinuar të indeksit të të ardhurave për vitet në vazhdim. Faktori i rishpërndarjes së të ardhurave është për shkak që në ekonominë në zhvillim, rritja e të ardhurave për amvisëri është tipike me e madhe së sa rritja e BPV. Në këtë Strategji është supozuar faktori prej 1.2. d.m.th. rritja e të ardhurave për amvisëri për rritje të BPV në terma real i shumëzuar me 1.2 për mesataren e të ardhurave të amvisëri, dhe 1.5 për grupin me të ardhura me të ulëta. Nëse rritja e BPV-së është, le të themi 5%, mesatarja e të ardhurave për amvisëri supozohet të rritet për 6% ($5\% * 1.2$).

Pjesa e të ardhurave mesatare të amvisërisë që mund të dedikohet për ujin e pijshëm është përcaktuar në pajtim me pragun ndërkombëtar. Ka disa pragje që përdoren nga disa institucione ndërkombëtare që do të mund të aplikoheshin në Kosovë. Në këtë raport janë përdorur si referencë pragjet standarde mesatare të përballeshmërisë në BE. Për ujin e pijshëm është marrë një vlerë maksimale prej 1.5% e të ardhurave mesatare të amvisërisë.

Është bërë vlerësimi i përballeshmërisë ekzistuese, e caktuar për momentin dhe që përdoret për mbajtjen e nivelit të tashëm të shërbimit. Ky vlerësim është dhënë në formë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 100 Vlerësimi i konsumit të ujit për amvisëri

Përshkrim	PR	PZ	PE	MT	GJA	FE	GJI
m ³ për amvisëri në muaj	16.66	17.13	20.80	16.58	18.08	12.50	11.86
litra për kokë banori për ditë	94.95	97.61	118.50	94.46	103.03	71.25	67.56

Nga ky informacion, mund të përcaktohet fatura mesatare që duhet të paguhet nga një amvisëri për muaj, pastaj të llogaritet për vit dhe të futet si e dhënë në veglën e modelit për kalkulim.

Vlera individuale është €0.31 x 17m³ x 12 muaj x numri i amvisërive që ishte 297,090 dhe e përshtatur për 0.5% të rritjes së vlerësuar vjetore.

Duke shfrytëzuar këto parametra de rritjen e BPV-së si dhe përshtatjet e bëra, janë kalkuluar të ardhurat mesatare për amvisëri që janë në dispozicion për mbulimin e kostove të procesit të përafrimit.

1. Duke përdorur këto parametra dhe rritjen e BPV-së dhe përshtatjet e bëra, kalkulohe të ardhurat bruto të amvisërisë në dispozicion për mbulimin e kostos së procesit të përafrimit.

Kjo shifër do të jetë thjeshtë të ardhurat maksimale për amvisëri në dispozicion, bazuar në pragun e përcaktuar, minus shuma që aktualisht paguajnë amvisëritë.

2. Mobilizimi i përballeshmërisë latente.

Shuma e përballeshmërisë që është në dispozicion për të bashkëfinancuar përpjekjet për përafrim nuk mund të mobilizohet menjëherë pasi që tarifat duhet të rriten suksesivisht (në vazhdimësi) dhe të ndërlidhen në një formë me përmirësimet e shërbimeve. Në model është supozuar një rritje të tarifës prej 7 % për vit në terma reale, që është maksimumi që do të mund të arrihej realisht madje edhe nëse marrim parasysh një skenar të rritjes së shpejtë të ekonomisë së Kosovës.

Kjo procedurë jep një shifër që mbetet për mbulueshmëri maksimale të kostove. Kjo shumë, në anën tjetër, do të përcaktojë kufijtë maksimal të OPEX-it që do të mund të përballoheshin na baza të qëndrueshme dhe, për me tepër, një plan investiv maksimalisht të qëndrueshëm që do të mund ta realizonte Kosova në këtë direktivë pa ndër-subvencionime nga ana e nën-sektorëve të tjerë mjedisorë.

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur në formë të përmbledhur më shumë detaje për rezultatet e këtij ushtrimi:



Tabela 101 Zhvillimi i përballueshmërisë

	EVOLUIMI I AEF(€/EF) NË TERMA VIETOR											
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	
MESATARJA E AEF €/EF	5,677	5,963	6,321	6,701	7,103	7,529	7,980	8,459	8,967	9,505	10,075	
INDEKSI I PËRBËRË MESATARISHT	107.0	112.4	119.2	126.3	133.9	141.9	150.5	159.5	169.1	179.2	190.0	
EK1 MË E ULËT 3 DHJETËSHORE	2,784	1,953	2,107	2,274	2,454	2,648	2,864	3,113	3,384	3,677	4,027	
INDEKSI I PËRBËRË DHJETËSHORIA MË E ULËT E TË ARDHURAVE	107.8	114.6	123.2	132.5	142.4	153.1	164.6	176.9	190.2	204.5	219.8	
BPV	2.60%	4.20%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	
INDEKSI I BPV	106.5	111.0	116.5	122.3	128.5	134.9	141.6	148.7	156.1	164.0	172.2	
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT MESATARISHT	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT DHJETËSHORIA MË E ULËT	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	
	EVOLUIMI I PËRBALLUESHMËRISË (EMILION/EF)											
PËRBALLUESHMËRIA IEF MË TË ULËT		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	
1,5% e IEF MESATARISHT		89	95	101	107	113	120	127	135	143	151	
IMADHËSIA E EF =297.090 në 2012 RRITUR PËR 0,5%		300,068	301,969	303,077	304,592	306,115	307,645	309,184	310,730	312,283	313,845	
PËRBALLUESHMËRIA VIETORE E AMVISËRISË, NË € MILION		26.8	28.6	30.5	32.5	34.6	36.8	39.2	41.8	44.5	47.4	
KOSTOJA E TANISHMË PËR UJIN E PIJSHËM PËR EF		21.3	22.7	24.2	25.8	27.5	29.3	31.2	33.2	35.4	37.7	
IEF BRUTO NË DISPOZICION PËR PËRPUTSHMËRI		5.5	5.9	6.2	6.7	7.1	7.6	8.0	8.6	9.1	9.7	
Norma e mobilizimit shprehur në terma real (rritjet e tarifave në terma real)		7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	
Indeksi i IEF shtesë		7%	14%	21%	28%	35%	42%	49%	56%	63%	70%	
NETO IEF NË DISPOZICION PËR ARRITJEN E CAQEVE		0.39	0.82	1.31	1.86	2.48	3.17	3.94	4.80	5.75	6.81	
KOSTOT SHITESË TË 'OPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVE		0.39	4.03	10.50	15.98	18.69	20.22	20.94	21.87	22.94	23.66	
KOSTOT SHITESË TË 'CAPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVE		80.95	92.95	105.94	131.96	151.11	171.16	191.16	211.16	231.16	251.16	
FINANCIMI NETO I NEVOJSHËM PËR ARRITJEN E CAQEVE		-80.95	-96.17	-114.73	-146.08	-171.32	-197.46	-224.15	-252.34	-281.09	-310.37	
KUMULATIVI I POZITËS FINANCIARE			-80.95	-96.17	-210.90	-256.98	-298.30	-320.76	-344.92	-371.85	-393.41	-410.48

7.4.4 Impakti ekonomik i Skenarit Bazë – Uji i Pijshëm

Kur të ndërlidhen rrjedhat e kostove shumëvjeçare të skenarit bazë me kufizimet e përballueshmërisë siç u shpjegua më sipër, mund të konstatohet sa vijon:


- **Kostot e OPEX-it nuk mbulojnë përmes aplikimit të parimit të mbulimit të kostove;**

Përballueshmëria neto është qartësisht e pamjaftueshme për të mbuluar kostot e reja të OPEX-it të nxjerra nga Plani i Investimeve sipas këtij skenari.

Kjo do të thotë që plani i investimeve thjeshtë nuk është i qëndrueshëm. Financimi nga donatorët do të mundësonte mbulimin e shumicës së kostove investive, por nëse operatorët e këtyre investimeve nuk do të mund të mbulojnë operimin e tyre nga të hyrat e veta, ata nuk konsiderohen të qëndrueshëm financiarisht.

Kjo është ilustruar në grafikun e mëposhtëm:


Figura 37 Mbulimi i kostove të operimit – Skenari Bazë



Nga pikëpamja e mbulimit të kostove totale, situata është, natyrisht, edhe më e rëndë, siç është ilustruar më poshtë:



Figura 38 Hendeku ('Gapi') financiar – Kostoja e pambuluar nga të hyrat e disponueshme



KËSHTU QË, NGA KJO VIJMË NË PËRFUNDIM SE KY SKENAR NUK ËSHTË I ZBATUESHËM.

7.4.5 Përcaktimi i një Strategjie të qëndrueshme ekonomike për ujin e pijshëm

Për të krijuar një skenar të zbatueshëm, është zgjatur plani investiv, ashtu që të sigurohet arritja e elementit kyç strategjik “që përballueshmëria neto të mbulojë OPEX-in”. Kjo rezulton në caqet vijuese:

Tabela 102 Strategjia e qëndrueshme e përputhshmërisë – Uji i Pijshëm

	Klasa	2017	2018	2019	2021	2023	2025	2027	2029	2031	2033	2035	2036
Furnizimi Publik me Ujë të Pijshëm si % e popullsisë urbane	TOTA L	76%	76%	76%	77%	79%	82%	85%	89%	91%	93%	93%	93%
Furnizimi Publik me Ujë të Pijshëm të trajtuar si % e popullsisë urbane	I	78%	78%	78%	79%	83%	85%	93%	99%	100%	%	100	100
	II	60%	60%	60%		61%	69%	74%	77%	82%	95%	%	100
	III	81%	81%	81%	81%	91%	92%	94%	97%	100%	%	100	100
	IV	66%	66%	66%		66%	67%	71%	77%	84%	85%	97%	%
	V	93%	93%	93%	93%	93%	93%	100	100	100	100	100	100
	TOTA L	74%	74%	74%	75%	80%	83%	89%	94%	98%	100	100	100
											%	%	%

Siç mund të shihet, plani i implementimit i është adaptuar kushteve të përballueshmërisë, që rezultojnë në zgjatjen e caktit të përputhshmërisë deri në vitin 2036.

Caqet e reja të definuara sipas tipeve të komunave janë ilustruar më poshtë si për mbulimin me furnizim me ujë ashtu edhe për trajtimin të ujit të pijshëm:



Figura 39 Mbulimi me sisteme publike të furnizimit me uji të pijshëm – Strategjia e qëndrueshme





Figura 40 Kalendar i përputhshmërisë së trajtimit të Ujit të Pijshëm – Strategjia e qëndrueshme



Skema e përgjithshme e përputhshmërisë është zgatur, siç është treguar me poshtë:



Figura 41 Skenari Bazë - i paqëndrueshëm






Figura 42 Strategjia e Qëndrueshme



Kostoja e përafritit të planeve për investimet e reja në grafikun në vijim:

Figura 43 Kostoja e Përafritit – Uji i Pijshëm – Strategjia e Qëndrueshme – Termat Nominal, rrjedhja shumë-vjeçare e parasë



Sipas këtij skenari, plani i investimeve është shpërndarë më njëtrajtshëm në afat të mesëm dhe të shkurtër. Në këtë skenar CAPEX arrin kulmin prej rreth €47 milion në vitin 2027, që është shumë më pak krahasuar me vlerën prej €105 milion në vit në vitin 2020 sipas skenarit bazë.

OPEX rritet gradualisht për të arritur €25 milion për vit në vitin 2036, njëjtë si në skenarin bazë.

Kostot administrative rriten njëjtë si OPEX, por në shkallë shumë më të ulët, dhe arrijnë gati €2 milion në vit në vitin 2036.

Më poshtë janë përfshirë kostot e përafritit të pa-skontuar, do të thotë, në termat nominal, dhe gjithashtu të skontuar, në termat e Vlerës Neto Aktuale.

Figura 44 Kosto Totale e Përafrimit – Uji i Pijshëm – Strategjia e Qëndrueshme – e pa-skontuar





Figura 45 Kosto Totale e Përafrimit – Uji i Pijshëm – Strategjia e Qëndrueshme – NPV në 5%





Kostoja totale prej €629 milionëve (€765 milionë në Rastin Bazë) deri në 2036 është numër i përgjithshëm vlera e vërtetë e të cilit varet nga shpërndarja kronologjike e kostove. Një magnitudë e tillë, e pagueshme në vitin 2017 nuk është njëjtë si për shembull në vitin 2036.

Dallimi në vlerë i të dy skenarëve për investimin e njëjtë nominal vjen si rezultat i zgjatjes së kohës së implementimit. Sa me tutje të shtyhen shpenzimet, aq me e ulët është vlera e tij në termat e tashëm. Megjithatë, duhet të ceket së sa me vonë që të arrihet objektivi, aq me e ulët është përfitimi futja e tij në përdorim.

Prandaj, për të përcaktua një shifër të krahasueshme dhe për të eliminuar ç'orientimet kohore, rrjedhat e kostos janë zbritur përsëri në vlerën e tyre të vitit bazë. Ky është koncepti i Vlerës Neto Aktuale (NPV) dhe është një tregues që përdoret në ekonomi për të vlerësuar koston e tashme të vendimeve që burojnë nga Politikat.

Norma e skontimit e përdorur është 5%, njëjtë me atë që rekomandohet aktualisht për projektet e mëdha infrastrukturore.

Kjo magnitudë është treguar në anën e djathtë të grafikut.

Kostot e investimeve, CAPEX, janë vlerësuar të jenë €235 milion (€302 milion për Rastin Bazë) që do të realizohen deri në 2036.

OPEX, deri në 2036, është kosto e konsiderueshme (dhe e vazhdueshme) që deri në atë datë do të arrijë € 118 Milion (€191 Milion për Rastin Bazë) në termat e sotëm.

Kostot administrative janë vlerësuar në €14 milion, duke arritur, në termat NPV, përafërsisht €3 milion për vit në vitin 2036.

Në përgjithësi, kosto e përafërimit për Ujë të Pijshëm është vlerësuar të jetë €368 milion (€ 523 milion në Rastin Bazë që kishte afat më të shkurtër).

7.4.6 Kufizimet e përballeshmerisë – Uji i Pijshëm


Tabela 103 Kufizimet e përballeshmerisë – Uji i Pijshëm – Strategjia e Qëndrueshme

EVOLUIMI I AEF(€/EF) NË TERMA VIETOR										
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
MESATARJA E AEF €/EF	5,677	5,963	6,321	6,701	7,103	7,529	7,980	8,459	8,967	9,505
INDEKSI I PËRBËRË MESATARISHT	107.0	112.4	119.2	126.3	133.9	141.9	150.5	159.5	169.1	179.2
EKI MË E ULËT 3 DHJETËSHORE	2,784	1,953	2,107	2,274	2,454	2,648	2,864	3,113	3,384	3,677
INDEKSI I PËRBËRË DHJETËSHORIA MË E ULËT E TË ARDHURAVE	107.8	114.6	123.2	132.5	142.4	153.1	164.6	176.9	190.2	204.5
BPV	2.60%	4.20%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%
INDEKSI I BPV	106.5	111.0	116.5	122.3	128.5	134.9	141.6	148.7	156.1	164.0
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT MESATARISHT	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT DHJETËSHORIA MË E ULËT	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
EVOLUIMI I PËRBALLESHERISË (€MILION/EF)										
PËRBALLESHERIA IEF MË TË ULËT		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
1,5% e IEF MESATARISHT		89	95	101	107	113	120	127	135	143
MADHESIA E EF =297,090 në 2012 RRITUR PËR 0,5%		300,068	301,569	303,077	304,592	306,115	307,645	309,184	310,730	312,283
PËRBALLESHERIA VIETORE E AMVISËRISË, NË € MILION		26.8	28.6	30.5	32.5	34.6	36.8	39.2	41.8	44.5
KOSTOJA E TANISHME PËR UJIN E PIJSHËM PËR EF		21.3	21.3	21.3	21.3	21.3	21.3	21.3	21.3	21.3
Best Estimate 2013=€0.31/M3*17M3*12 MONTHS										
Norma e mobilizimit shprehur në terma real (rritjet e tarifave në terma real)		7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%
Indeksi i IEF shtesë		7%	14%	21%	28%	35%	42%	49%	56%	63%
NETO IEF NË DISPOZICION PËR ARRITJEN E CAQEVE		0.39	1.02	1.92	3.11	4.63	6.51	8.77	11.46	14.61
KOSTOT SHITESË TË 'OPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVE		0.30	0.80	1.64	2.58	4.18	6.07	7.59	9.06	11.17
KOSTOT SHITESË TË 'CAPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVE										
KOSTOT SHITESË TË 'CAPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVE		4.48	10.01	17.58	30.05	31.45	28.60	21.84	34.85	41.70
FINANCIMI NETO I NEVOISHËM PËR ARRITJEN E CAQEVE		-4.39	-9.80	-17.31	-29.52	-31.00	-28.16	-20.66	-32.45	-38.26
KUMULATIVI I POZITËS FINANCIARE		-4.39	-14.19	-31.50	-61.02	-92.02	-120.18	-140.84	-173.29	-211.56

7.4.7 Impakti Ekonomik i Skenarit të Qëndrueshëm – Uji i Pijshëm

Relacioni në mes të OPEX-it dhe Përballeshmerisë Neto në skenarin e përballeshmerisë është prezantuar me poshtë:


Figura 46 Mbulimi i kostove operacionale nga përballueshmëria



Siç mund të vërehet, përballueshmëria neto mbulon OPEX-in në të gjitha fazat.

Mardhëniet në mes të përballueshmërisë dhe kostove totale janë ilustruar mëposhtë:

Figura 47 Hendeku ('Gapi') në financim – Uji i Pijshëm – Strategjia e qëndrueshme



Siç mund të vërehet, edhe ky version i zgjatur i cili është i qëndrueshëm, ngërthen në vete sfida të mëdha të financimit, me kërkesa të mëdha financiare për CAPEX (të shënuar me kolona të kuqe) dhe kapaciteti për shpëtim për financimin e kërkuar (i shënuar me kolonë të kaltër) është i mundur vetëm nga viti 2028 e tutje.

7.5 Ujërat e ndotura urbane

7.5.1 Synimet implicite të Skenarit Bazë - Ujërat e ndotura

Më poshtë janë paraqitur synimet e përcaktuara për secilin lloj të aglomeracioneve në skenarin e Rastit Bazë:



Tabela 104 Kalendar i Përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari Bazë

Statistikat		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2028	2033	2036
Përqindja e grumbullimit të ujërave të ndotura si % e aglomeracioneve të popullsisë	I	86%	86%	86%	86%	86%	87%	89%	97%	97%	97%
	II	54%	54%	54%	54%	54%	54%	54%	59%	91%	95%
	III	64%	64%	64%	64%	64%	64%	64%	64%	76%	94%
	IV	51%	51%	51%	51%	51%	51%	51%	51%	79%	86%
	V	32%	32%	32%	32%	32%	32%	32%	32%	32%	84%
TOTAL		67%	67%	67%	67%	67%	68%	69%	74%	87%	95%
Përqindja e trajtimit të ujërave të ndotura si % e aglomeracioneve të popullsisë	I	15%	15%	15%	15%	15%	17%	31%	100%	100%	100%
	II	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	2%	99%	100%
	III	8%	8%	8%	8%	8%	8%	8%	8%	47%	99%
	IV	13%	13%	13%	13%	13%	13%	13%	13%	61%	97%
	V	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	92%
TOTAL		8%	8%	8%	8%	8%	9%	15%	46%	85%	99%

Caku i përcaktuar është deri në 2036. Pikësnyimet që duhet të arrihen janë mbulueshmëria e popullsisë prej 95% dhe trajtimi i ujërave të ndotura në pajtim të plotë me standardet të këtij segmenti, që përfaqësojnë 99%, praktikisht 100% të të gjitha ujërave të ndotura.

Më poshtë janë ilustruar në mënyrë grafike të gjitha llojet e konvergencave, si për mbulimin me rrjet ashtu edhe për trajtim, si dhe me konvergencën e përgjithshme.

Figura 48 Konvergjenca e grumbullimit të ujërave të ndotura urbane – Skenari Bazë





Figura 49 Trajtimi i ujëravetë ndotura urbane – Skenari Bazë




Mbulimi i përgjithshëm evoluon ngadalë, duke marrë vull nga viti 2023 dhe vazhdon deri në 2036.

7.5.2 Kostoja e përafrimit - Ujërat e Ndotura

Duke u bazuar në synimet paraprake për përputhshmëri, përçindjen e popullsisë së tërësishme të shërbyer me sistem në pajtim me standardet dhe kostot e definuara për njësi, kostoja e përafrimit mund të vlerësohet në baza disa vjeçare. Kjo është ilustruar më poshtë në termat nominal, e shpërndarë si CAPEX, OPEX dhe kosto administrative.

Figura 50 Kostoja e përafrimit – Ujërat e ndotura – Skenari Bazë – termat nominal



Sipas këtij skenari, plani i investimeve fillon të adresojë aglomeracionet kryesore tek kah viti 2021, pastaj pëson rënie për të rifilluar rritjen në mënyrë me agresive nga viti 2028 e tutje. Ky është plan logjik pasi që shumica e përpjekjeve është shtyer për periudhën pas vitit 2029, pas anëtarësimit teorik dhe disponueshmërisë më të madhe të fondeve të donatorëve nga qasja e Kosovës në gamën e plotë të madh të Fondeve të kohezionit dhe jo vetëm fondeve të kufizuara nga programi IPA.

CAPEX arrin pak mbi €45 milionë për vit në vitet 2031/2032.

OPEX pëson një rritje të konsiderueshme në €58 milionë për vit në vitin 2037.



Kostot administrative akumulohen ngjashëm si OPEX, por në shkallë shumë më të ulët, dhe arrijnë €3 milionë për vit në vitin 2036.

Më poshtë janë përfshirë kostot e përafrimit të paskontuara (pa zbritje), do të thotë, në termat nominal, dhe kostot e përafrimit të skontuara, në Termat të Vlerës Neto Aktuale.

Figura 51 Kosto e arritjes së përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari Bazë – i pa-skontuar





Figura 52 Kosto e arritjes së përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari Bazë – NPV në 5%



Vlera totale pa zbritje prej € 989 milionëve, deri në 2036 është, megjithatë, numër i përgjithshëm, vlera e vërtetë e së cilës varet nga shpërndarja kronologjike e kostove. Një magnitudë e tillë, e pagueshme në vitin 2017 nuk është e njëjtë si kur arrin për pagesë, për shembull në 2036.

Prandaj, për të përcaktuar shifra të krahasueshme dhe për të eliminuar çorientimet kohore, rrjedhat e kostos janë zbritur përsëri në vlerën e tyre të vitit bazë. Ky është koncepti i Vlerës Neto Aktuale (NPV) dhe është një tregues që përdoret në ekonomi për të llogaritur koston e tashme të vendimeve politike.

Norma e zbritjes e përdorur është 5%, njëjtë me atë që rekomandohet aktualisht për projektet e mëdha infrastrukturore.

Kjo magnitudë është treguar në anën e djathtë të grafikut.

Kostot e investimeve, CAPEX, janë vlerësuar të jenë €263 milion që do të bëhen deri në 2036;

OPEX, deri në 2036, është kosto e konsiderueshme (dhe e vazhdueshme) që deri në atë datë do të arrijë €203 milion në termat e sotëm.

Kostot administrative janë vlerësuar në €23 Milion, duke arritur, në termat NPV, përafërsisht € 3 Milion për Vit në vitin 2036.

Përgjithësisht, kosto e përafërimit për Ujërat e Ndotura Urbane është vlerësuar të jetë €488 Milion.

7.5.3 Kriteri i përballueshmërisë - Ujërat e Ndotura

Procedura është e njëjtë si në rastin e ujit të pijshëm më lartë.

Ndryshimet që kanë të bëjnë me implementimin e direktivës së DTUZU janë dhënë më poshtë

1. **Të ardhurat mesatare për amvisëri që mund të ndahen për ujë të pijshëm përcaktohen në pajtim me pragun ndërkombëtar.**



Ka disa pragje të përdorura nga organizata të ndryshme ndërkombëtare që do të mund të aplikoheshin në Kosovë. Në këtë raport pragu standard i përballeshmerisë për BE është përdorur si referencë. Për Ujin e Pijshëm një maksimum prej 2.5% për një shtëpi mesatare (HH) është përdorur.

2. Përballeshmëria ekzistuese e caktuar për momentin është llogaritur dhe prandaj përdoret për të mbajtur nivelin e tanishëm të shërbimit.

Ky vlerësim është dhënë me lartë

Nga ky informacion, mund të përcaktohet fatura mesatare që paguhet për amvisëri në muaj, pastaj të llogaritet për vit dhe të futet si e dhënë në veglën e modelit.

Vlera fillestare është €0.07 x 17m3 x 12 muaj x numri i amvisërive që është dhënë në 297,090 dhe përshtatet për rritjen e vlerësuar vjetore prej 0.5%.

3. Mobilizimi i përballeshmerisë latente.

Sasia e përballeshmerisë në dispozicion për të bashkëfinancuar përpjekjet për përafrim nuk mund të mobilizohen menjëherë pasi që tarifat duhet të rriten suksesivisht dhe të ndërlidhet në një formë me përmirësimet në shërbime. Në model është supozuar një rritje e tarifës prej 7% në vit në terma reale, që është maksimumi që do të mund të arrihej realisht madje edhe nëse marrim parasysh një skenar të rritjes së shpejtë të ekonomisë së Kosovës.

Kjo procedurë jep një shifër përmaksimumin e rikuperimit të kostove. Kjo shumë, në anën tjetër, do të përcaktojë kufijtë maksimal të OPEX-it që do të mund të përballoheshin në mënyrë të qëndrueshme dhe, për me tepër, një plan plan të investimeve vjetore maksimalisht të qëndrueshëm që do të mund ta realizonte Kosova në këtë direktivë pa ndër-subvencionime nga ana e nën-sektorëve të tjerë mjedisor.

Në tabelën e mëposhtme, rezultatet e kësaj sipërmarrjeje janë paraqitur në detaje:

Tabela 105 Zhvillimi i përballeshmerisë – Ujërat e Ndotura – Skenari Bazë

	EVOLUIMI I AEF(€/EF) NË TERMA VJETOR											
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MESATARJA E AEF €/EF	5,677	5,963	6,321	6,701	7,103	7,529	7,980	8,459	8,967	9,505	10,075	10,680
INDEKSI I PËRBËRËS MËSARISHT	107.0	112.4	119.2	126.3	133.9	141.9	150.5	159.5	169.1	179.2	190.0	201.4
EK1 MË E ULËT 3 DHJETËSHORE	2,784	1,953	2,107	2,274	2,454	2,648	2,864	3,113	3,384	3,677	4,027	4,409
INDEKSI I PËRBËRËS DHJETËSHORJA MË E ULËT E TË ARDHURAVE	107.8	114.6	123.2	132.5	142.4	153.1	164.6	176.9	190.2	204.5	219.8	236.3
BPV	2.60%	4.20%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%
INDEKSI I BPV	106.5	111.0	116.5	122.3	128.5	134.9	141.6	148.7	156.1	164.0	172.2	180.8
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT MËSARISHT	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT DHJETËSHORJA MË E ULËT	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
EVOLUIMI I PËRBALLESHPËRITËS (€MILION/EF)												
PËRBALLESHPËRITË IEF MË TË ULËT		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
1,5% e IEF MËSARISHT		149	158	168	178	188	200	211	224	238	252	267
MADHËSIA E EF =297,090 në 2012 RITUR PËR 0,5%		300,068	301,269	303,077	304,592	306,115	307,645	309,184	310,730	312,283	313,845	315,414
PËRBALLESHPËRITË VJETORE E AMVISËRISË, NË € MILION		44.7	47.7	50.8	54.1	57.6	61.4	65.4	69.7	74.2	79.1	84.2
KOSTOJA E TANISHME PËR UJIN E PISHËM PËR EF		4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8
Best Estimate 2012=€0.31/M3*17M3*12 MONTHS												
IEF BRUTO NË DISPOZICION PËR PËRPUTSHMËRI		39.9	42.8	46.0	49.3	52.8	56.6	60.6	64.8	69.4	74.2	79.4
Norma e mobilizimit shprehur në terma real (rritjet e tarifave në terma real)		7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%
Indeksi i IEF shtesë		7%	14%	21%	28%	35%	42%	49%	56%	63%	70%	77%
NETO IEF NË DISPOZICION PËR ARRITJEN E CAQEVË		2.79	6.00	9.65	13.79	18.48	23.76	29.68	36.31	43.71	51.96	61.13
KOSTOT SHITESË TË 'CAPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVË		0.30	0.62	1.14	1.69	2.14	4.87	8.08	9.85	18.03	19.66	20.88
KOSTOT SHITESË TË 'CAPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVË												
KOSTOT SHITESË TË 'CAPEX' PËR ARRITJEN E CAQEVË		0.00	0.00	0.00	9.33	18.39	32.31	35.55	26.49	26.49	17.45	27.53
FINANCIMI NETO I NEVOJSHËM PËR ARRITJEN E CAQEVË		2.49	5.37	8.51	2.78	-2.05	-13.43	-13.95	-0.03	-0.81	14.85	12.72
KUMULATIVI I POZITËS FINANCIARE		2.49	5.37	13.89	16.66	14.62	1.19	-12.76	-12.79	-13.60	1.25	13.97

7.5.4 Impakti ekonomik i skenarit bazë - Ujërat e ndotura

Kur të ndërlidhet rrjedha e kostove shumëvjeçare të Skenarit Bazë me kufizimet e përballeshmerisë, siç është përshkruar në vazhdim, del në pah si në vijim:

- Kostot e OPEX-it mbulojnë mjaftueshëm nga përballeshmëria neto;
- Praktishtë nuk do të kishte nevojë për financimin e CAPEX-it;

Përballeshmëria neto është qartazi e mjaftueshme për të përmbushur shpenzimet e reja OPEX që rrjedhin nga Plani i Investimeve të përcaktuara në këtë skenar. Kjo është ilustruar në grafikun e mëposhtëm:

Nga pikëpamja e mbulimit të plotë të kostove, gjendja është shumë komode, siç është ilustruar me poshtë:

Tabela 106 Mbulimi i Kostos operative – Ujërat e ndotura – Skenari Bazë





Tabela 107 Hendeku ('Gapi') i financimit – Ujërat e ndotura – Skenari Bazë



PRANDAJ, DUHET TË KONKLUOHET SE KY SKENAR ËSHTË QARTAZI I REALIZUESHËM. MEGJITHATË, DUHET THËNË SE AI ËSHTË TEPËR KONSERVATIV PASI QË NUK SHFRYTËZON NË TËRËSI (NË NJË SHKALLË TË MATUR) PËRBALLUESHMËRINË NË DISPOZICION.

Vonesat e mëdha për arritjen e përputhshmërisë me DKU-në që ka të bëjë me UNU ka efekt negativ në shëndetin e popullsisë së Kosovës. Kostoja ekonomike e këtij ndikimi negativ në shëndet dhe mjedis është llogaritur nga disa studime në fushën e ekonomisë së mjedisit, që janë me të larta sesa kostoja e përputhshmërisë.

Prandaj, nuk është ekonomikisht eficient që të vonohet zbatimi i DKU-së përtej asaj që është e arsyeshme të arrihet brenda kufijve të përballueshmërisë.



Gjithashtu, një plan i tillë i implementimit nuk do të ishte i pranueshëm për partnerët e BE-së gjatë aplikimit për anëtarësim.

7.5.5 Strategjia e Realizueshme Ekonomike për Ujërat e Ndotura

Për të krijuar një skenar me optimal, plani i investimeve është shkurtuar, por prapë deri në një far mase në pajtim me elementet bazë, ku përbalueshmëria neto mund të mbulojë OPEX-in. Caqet e reja janë dhënë me poshtë:

Tabela 108 Orari Përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari i Qëndrueshëm

Statistikat		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2028	2032	2036	
Përqindja e mbledhjes së Ujërave të ndotura Si % e aglomeracioneve të popullsisë	I	86%	87%	89%	92%	93%	94%	96%	97%	97%	97%	
	II	54%	54%	54%	54%	54%	59%	65%	91%	95%	95%	
	III	64%	64%	64%	64%	64%	64%	64%	64%	79%	96%	96%
	IV	51%	51%	51%	51%	51%	51%	51%	51%	79%	81%	91%
	V	32%	32%	32%	32%	32%	32%	32%	32%	37%	69%	90%
	TOTAL		67%	68%	69%	70%	70%	73%	75%	88%	94%	96%
Përqindja e trajtimit të ujërave të ndotura Si % e aglomeracioneve të popullsisë	I	15%	17%	31%	46%	50%	90%	98%	100%	100%	100%	
	II	0%	0%	0%	0%	0%	2%	29%	99%	100%	100%	
	III	8%	8%	8%	8%	8%	8%	8%	72%	100%	100%	
	IV	13%	13%	13%	13%	13%	13%	13%	13%	44%	85%	100%
	V	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	11%	71%	97%
	TOTAL		8%	9%	15%	22%	24%	42%	54%	88%	98%	100%

Siç mund të shihet, plani implementimit është përshtatur për të optimizuar përbalueshmërinë në dispozicion, që rezulton në plan investiv më agresiv, që përfundon gjithashtu në 2036, por fillon në 2017 në qytetet kryesore në vend të 2019 si datë e fillimit që është konsideruar fillimisht.

Caqet e konvergimit për llojet e ndryshme të aglomeracioneve janë:

Figura 53 Mbulueshmëria me grumbullimin e ujërave të ndotura urbane në aglomeracione – Skenari i qëndrueshëm







Figura 54 Trajtimi i Ujërave e Ndotura Urbane në Aglomeracione – Skenari i Qëndrueshëm



Konvergenca nën skenarin e ri Konvergenca nën skenarin e Rastit Bazë

Figura 55 DTUNU – Përputhshmëria: Skenari Bazë






Figura 56 DTUNU Përputhshmëria: Skenari i Qëndrueshëm



Plani i investimeve që rezulton nga ky skenar është ilustruar me poshtë:

Figura 57 Kostoja për Arritjen e Përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari i Qëndrueshëm – Termat Nominal





Sipas këtij skenari, plani investimeve fillon në vitin 2017 përmes të cilit adresohen aglomeracionet kryesore, pastaj pëson rënie për të rimarrë rritjen në mënyrë më agresive që nga vitit 2021 e tutje. Skenari optimizon përballueshmërinë në dispozicion, por nënkupton një përpjekje më të madhe financiare që duhet të peshohet kundrejt angazhimeve të tjera mjedisore dhe përfitimeve nga përputhshmëria e hershme.

CAPEX arrin kulmin pak nën € 49 milionë në 2022 (€ 45 milionë për vit në 2031/2032 në Rastin Bazë).

OPEX rritet dukshëm në €58 milion për vit në 2037, njëjtë si në Rastin Bazë.

Kostot administrative rriten në proporcion të drejt me rritjen e OPEX-it, por në shkallë shumë më të ulët, duke arritur në €3 Milion për vit në vitin 2036, njëjtë si në Rastin Bazë.

Më poshtë janë përfshirë kostot e përafritimit pa zbritje, do të thotë, në terma nominal, dhe të skontuar, për termat NPV.

Figura 58 Kostoja e Përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari i Qëndrueshëm – e pa skontuar





Figura 59 Kostoja e Përputhshmërisë – Ujërat e Ndotura – Skenari i Qëndrueshëm – NPV 5%



Vlera totale pa zbritje prej €1,211 milionë (€989 milion në Rastin Bazë), deri në 2036 është, megjithatë, numër i përgjithshëm vlera e vërtetë e të cilit varet nga dislokimi kronologjik i kostove.

Dallimi në vlerat e të dy skenarëve për të njëjtat investime nominale paraqitet për shkak të efektit të intensifikimit të dinamikës së zbatimit. Ngjashëm si tek uji i pijes, sa më afër që bëhet shpenzimi, aq më e lartë është vlera në terma aktual. Mirëpo, duhet të ceket që sa më shpejtë që të arrihet objektivi, aq më të mëdha dobitë e futjes në shërbim.

Për të definuar një shifër të ngjashme dhe për të eliminuar çorientimet kohore, rrjedhat e kostos janë zbritur përsëri në vlerën e tyre të vitit bazë. Ky është koncepti i Vlerës Neto Aktuale (NPV) dhe është një tregues që përdoret në ekonomi për të vlerësuar koston e tashme të vendimeve politike.

Norma e aplikuar e zbritjes është 5%, njëjtë me atë që rekomandohet aktualisht për projektet e mëdha infrastrukturore.

Kjo magnitudë është treguar në anën e djathtë të grafikut.

Kostot e investimeve, CAPEX, janë vlerësuar të jenë €331Milion (€263 milion në Rastin Bazë), që do të bëhen deri në 2036;

OPEX, deri në 2037, është kosto e konsiderueshme (dhe e vazhdueshme) që deri në atë datë do të arrijë €338 milion (€203 milion në Rastin Bazë, që prolongon fillimin për 4 vite) në termat e sotëm.

Kostot administrative janë vlerësuar në €23 Milion, duke arritur, në termat NPV, përafërsisht €3 milion për vit në vitin 2037, njëjtë si në Rastin Bazë.

Përgjithësisht, kosto e përafërimit për Ujërat e Ndotura Urbane është vlerësuar të jetë €691 Milion (€488 milion në Rastin Bazë të prolonguar).



7.5.6 Kufizimet e Përballeshmerisë - Ujërat e Ndotura

Kufizimet e përballeshmerisë janë llogaritur në mënyrë të njëjtë për të dy skenarët në UNU.

Evoluimi është ilustruar me poshtë:


Tabela 109 Kufizimet e Përballeshmerisë – Ujërat e Ndotura – Skenari i Qëndrueshëm

EVOLUIMI I AEF(C/EF) NË TERMA VIETOR												
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MESATARJA I AEF C/EF	5,677	5,963	6,321	6,701	7,103	7,529	7,980	8,459	8,967	9,505	10,075	10,680
INDEKSI I PËRBËRË MESATARISHT	107.0	112.4	119.2	126.3	133.9	141.9	150.5	159.5	169.1	179.2	190.0	201.4
EK1 MË E ULËT 3 DHJETËSHORE	2,784	1,953	2,107	2,274	2,454	2,648	2,864	3,113	3,384	3,677	4,027	4,409
INDEKSI I PËRBËRË DHJETËSHORIA MË E ULËT E TË ARDHURAVE	107.8	114.6	123.2	132.5	142.4	153.1	164.6	176.9	190.2	204.5	219.8	236.3
BPV	2.60%	4.20%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%	5.00%
INDEKSI I BPV	106.5	111.0	116.5	122.3	128.5	134.9	141.6	148.7	156.1	164.0	172.2	180.8
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT MESATARISHT	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2
FAKTORI I RIDISTRIBUIMIT DHJETËSHORIA MË E ULËT	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
EVOLUIMI I PËRBALLESHPËRITËSË (€ MILION/EF)												
	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	
PËRBALLESHPËRITËSË IEF MË TË ULËT	149	158	168	178	188	200	211	224	238	252	267	
1,5% e IEF MESATARISHT	300,068	301,569	303,077	304,592	306,115	307,645	309,184	310,730	312,283	313,845	315,414	
MADHËSIA E EF =297,090 në 2012 RRITUR PËR 0,5%												
PËRBALLESHPËRITËSË VIETORE E AMVISIRISË, NË € MILION	44.7	47.7	50.8	54.1	57.6	61.4	65.4	69.7	74.2	79.1	84.2	
KOSTOJA E TANISHME PËR UJIN E PËRSHËM PËR EF	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	4.8	
Best Estimate 2012=E0,31/M3*17M3*12 MONTHS												
IEF BRUTO NË DISPOZICION PËR PËRPUTHSHMËRI	39.9	42.8	46.0	49.3	52.8	56.6	60.6	64.8	69.4	74.2	79.4	
Norma e mobilizimit shprehur në terma real (mijet e tarifave në terma real)	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	7%	
Indeksi i IEF shtesë	7%	14%	21%	28%	35%	42%	49%	56%	63%	70%	77%	
NETO IEF NË DISPOZICION PËR ARRITJEN E CAQEVE	2.79	6.00	9.65	13.79	18.48	23.76	29.68	36.31	43.71	51.96	61.13	
KOSTOT SHITESË TË "OPEX" PËR ARRITJEN E CAQEVE	0.66	3.44	6.85	8.46	16.15	21.77	25.44	29.59	33.94	38.21	43.25	
KOSTOT SHITESË TË "CAPEX" PËR ARRITJEN E CAQEVE												
KOSTOT SHITESË TË "CAPEX" PËR ARRITJEN E CAQEVE	18.39	32.31	22.98	43.94	48.16	48.86	33.61	36.67	44.80	32.67	32.82	
FINANCIIMI NETO I NEVOJSHËM PËR ARRITJEN E CAQEVE	-16.25	-29.75	-20.18	-38.60	-45.83	-46.87	-29.37	-29.95	-35.02	-18.92	-14.93	
KUMULATIVI I POZITËS FINANCIARE		-16.25	-29.75	-49.93	-88.54	-134.37	-181.24	-210.61	-240.56	-275.59	-294.51	-309.44

7.5.7 Ndikimi ekonomik i skenarit të rishikuar - Ujërat e Ndotura


OPEX mbulohet nga përballeshmëria neto, siç tregohet më poshtë:

Figura 60 Mbulimi i kostove operative – ujërat e ndotura – skenari i qëndrueshëm



Për të mbuluar kostot totale, kërkohen mjete financiare për një periudhë të gjatë, por rezultojnë shifra të menaxhueshme dhe rimbursimi neto mund të fillojë qysh nga viti 2029, një orar kohor profitabil ky nga pikëpamja e institucioneve ndërkombëtare financiare.

Figura 61 Hendeku i financimit – ujërat e ndotura – skenari i qëndrueshëm



Në përgjithësi ky skenar shfrytëzon në optimum përballueshmerinë në dispozicion, por politika që ai kërkon duhet të jetë e balancuar me atë të DUP dhe, në fakt, me atë të Sektorit të Ujit në përgjithësi dhe, për më tepër me atë të Mjedisit në përgjithësi.

7.6 Përmbledhje e konkluzave – Strategjia e investimeve

Kosova vazhdon angazhimin për zhvillim në shumë fusha dhe ka një numër të madh të nevojave konkurruese për zhvillim përdorues fondet investuese nga ana e investitorëve privat janë të limituara. Siç u tha më lartë:

- Shpenzimet vjetore të Qeverisë: rreth €1.5 miliard për vit, nga të cilat
 - Shpenzimet Kapitale në Sektorin Publik: rreth €0.5 miliard për vit
- Investimet në sektorin e shërbimeve të ujit në zonat urbane kanë arritur nivelin gati €25 milion për vit, duke përfshirë kontributin e donatorëve prej rreth 50%; investime shtesë janë bërë gjithashtu në sistemin e ujitjes dhe aspektet tjera të menaxhimit të ujërave, me investimet e planifikuara në sektorin e bujqësisë prej rreth €5 milion për vit.
- Shpenzimet qeveritare në infrastrukturën e ujërave përbëjnë 1.3% të shpenzimit total.
- Niveli i ngarkesës së investimeve në sektorin publik për të arritur të gjitha objektivat afatgjata për sektorin e ujërave është rreth €1.5 miliard siç është dhënë në tabelën e mëposhtme



Tabela 110 Përmbledhje e nevojave potenciale për investime që kërkojnë investime nga sektori publik

Çështja	Qëllimi afatgjatë	Investimi i Përafërt milion EUR
Akumulimi i ujit - rezervuarët	Akumulacione të reja	250
Shërbimet e furnizimit me ujë	Renovimi dhe zgjerimi	430
Rritja e mbulueshmërisë me ujitje	Rritja e mbulueshmërisë dhe efijencës	70
Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura	Renovimi dhe instalimi	680
Mbrojtja nga vërshimet	Renovimi dhe zgjerimi	100
TOTALI i nevojave potenciale	Të gjitha objektivat	1530

Në nivelin e tashëm të investimeve në sektorin e shërbimeve me ujë (€25 milion për vit), dhe me ngarkesën për atë pjesë të sektorit (mbi €1 miliard), programi i investimeve do të merrte 40 vite për t'u kryer.

Duke marrë parasysh periudhën e Strategjisë prej 20 vitesh, një vlerësim i thjeshtë do të sugjeronte që plotësimi i programit investiv gjatë periudhës 20 vjeçare sa zgjatë strategjia do të kërkonte një investim mesatarë prej €75 milionëve për vit, nga të cilat €50 milion do të duheshin për sektorin e shërbimit me ujë në zonat urbane.

Ky nivel i investimeve paraqet ngarkesë shumë të madhe për sektorin publik. Potenciali i arritjes së një niveli të tillë të investimeve është hulumtuar duke bërë projeksione të thjeshta financiare për periudhën e Strategjisë. Projeksionet janë bërë të bazuara në parashikime paksa optimiste:

- Bruto Produkti i Vendit i matur me parimin e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB) do të rritet 3.5% për vit në Terma Real (duke përjashtuar inflacionin) për periudhën 20 vjeçare të strategjisë
- Buxheti i Qeverisë do të rritet në dy aspekte:
 - Në linjë me rritjen e BPV
 - Rritja e pjesëmarrjes së shpenzimeve nga Sektori Qeveritarë në BPV¹¹⁵ nga niveli i tashëm prej 16% në 2016 deri në 20% në vitin 2036 - nivel që aplikohet në shumë vende anëtare të BE-së¹¹⁶
- Pjesëmarrja e donatorëve në programin e investimeve do të jetë 50:50 për gjysmën e parë të periudhës së strategjisë, dhe do të rritet në 65% për periudhën e mëvonshme të strategjisë krahas rritjes së perspektivës së anëtarësimit të Kosovës në BE, dhe qasja në opsionet e financimeve me kredi përmirësohet me rritjen e vlerësimit për kredimarrje nga ana e qeverisë qendrore, qeverive lokale dhe njërive operative
- Proporcioni i shpenzimeve qeveritare për sektorin e infrastrukturës së ujërave do të mbajë mesataren e tashme (1.3%) përgjatë periudhës së Strategjisë.

Aplikimi i këtyre parashikimeve dhe parashikimeve tjera siç është përdorimi i rritjes reale të bazuar në PFB merr parasysh rritjen e kostove për infrastrukturë¹¹⁷, skenarë si këto të paraqitur në tabelën e mëposhtme mund të parashikohen.

¹¹⁵ General government final consumption expenditure (% of GDP)

¹¹⁶ See for example: <http://data.worldbank.org/indicator/NE.CON.GOV.TZ>

¹¹⁷ This assumption must be considered as very optimistic



Tabela 111 Skenarët e moderuara optimiste për investime kapitale (për vitet e zgjedhura)

		Viti bazë	2017	2021	2025	2029	2033	2036
BPV (PFB në terma real)	milion €	5,500	5,555	5,881	6,719	7,970	9,459	10,599
Niveli i rritjes së BPV	% p.v. Real	1.0%	0.5%	2.8%	4.2%	4.5%	4.1%	3.5%
Shpenzimet qeveritare	% e BPV	16.0%	16.2%	17.0%	17.8%	18.6%	19.4%	20.0%
Buxheti qeveritar	milion €/v	1,500	1,534	1,704	2,039	2,527	3,128	3,613
Shpenzimet për ujë	% Buxhetit	1.33%	1.33%	1.33%	1.33%	1.33%	1.33%	1.33%
Kapitali Shtet. në ujëra	milion €/v	20.00	20.45	22.72	27.18	33.69	41.71	48.18
Pjesëmarrja e donatorëve	% e totalit	50%	50%	50%	50%	65%	65%	65%
Investimet totale	milion €/v	40.00	40.91	45.44	54.36	96.26	119.16	137.65
Investimet kumulative	milion €		41	214	417	744	1,185	1,580

Siç po shihet në tabelën e mësipërme aplikimi i skenarëve të moderuara optimiste na sjell tek projeksionet e shpenzimeve kapitale në infrastrukturën e sektorit të ujërave që janë konsistent me përmbushjen e investimeve të parapara deri në fund të Strategjisë, p.sh që investimet totale në këtë sektor deri në vitin 2036 do të jene rreth €1.5 miliard.

Duhet të merret parasysh që kompletimi i programit në këtë mënyrë varet shumë nga:

- Arritja e rritjes ekonomike
- Zotimi i Qeverisë për të bërë investimet në sektor
- Vazhdimi dhe zgjerimi i mbështetjes nga ana e donatorëve

7.7 Përmbledhje e nevojave

Strategjia identifikon një gamë të gjerë të nevojave në këtë sektor duke përfshirë nevojën për përmirësime në të gjitha pjesët e procesit të menaxhimit të ujërave siç është përmbledhur shkurtimisht më poshtë.

Qeverisja:

- Kompletimi i kornizës ligjore
- Përmirësimi i mbledhjes, shpërndarjes dhe menaxhimit të informatave duke përfshirë monitorimin afatgjatë si të presioneve (nxjerrjeve, shkarkimeve) gjithashtu edhe të gjendjes (rrjedhjeve, cilësisë së ujit)
- Planifikimi, veçanërisht në aspektin e shfrytëzimit të ujit, mbrojtjes nga vërshimet, dhe nevojave për investime kapitale duhet të përmirësohet
- Raportimi duhet të përmirësohet
- Zbatimi duhet të jetë më efektiv duke përfshirë sundimin e ligjit.

Kërkesat për implementim mund të përmblihen si:

- Furnizimi me ujë
 - Përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së furnizimit me ujë, ulja e humbjeve të ujit
 - Zgjerimi i furnizimit me ujë
- Akumulimet – ruajtja e ujit
 - Nevojiten rezervuarë të rinj
- Menaxhimi i ujërave të ndotura
 - Përmirësime në cilësinë e grumbullimit të ujërave të ndotura
 - Zgjerimi i mbulueshmërisë me rrjetin e kanalizimeve



- Trajtimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura
- Ujitja
 - Rritja e efikasitetit të sistemeve ekzistuese të ujitjes duke përfshirë furnizimin (humbjet gjatë furnizimit me shumicë) dhe përdorimit (mjetet, cilësia dhe koha e aplikimit)
 - Rritja e mbulueshmërisë me rrjetin e ujitjes
- Mbrojtja nga vërshimet
 - Riparimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës mbrojtëse ekzistuese
 - Masa të reja të mbrojtjes nga vërshimet duke përfshirë mjetet e forta (infrastrukturore) dhe të buta (institucionale/zbatuese)
- Erozioni
 - Menaxhimi i mbulesës tokësore
 - Mbrojtja e shtretërve të lumenjve
 - Menaxhimi i nxjerrjes së inerteve
- Hidro-energji
 - Rritje të implementimit

Kufizimet kyçe që duhet të përmenden për adresimin e këtyre çështjeve përfshijnë:

- Koston kapitale
- Koston operative duke përfshirë marrjen parasysh të:
 - Efikasitetin e operimit
 - Mirëmbajtjen e rregulltë
 - Mirëmbajtjen e kapitale
- Qëndrueshmërinë financiare

7.8 Menaxhimi i ciklit të projekteve

Nevojat për investime në sektorin e ujërave janë shumë të larta dhe do të marrin kohë të gjatë për t'u kompletuar. Përveç kësaj, do të nevojitet mbështetje e konsiderueshme nga donatorët për të kryer shumicën nga projektet e identifikuara për kohën sa zgjatë implementimi i kësaj strategjie.

Eksperienca e vendeve kandidate për anëtarësim në BE ka treguar¹¹⁸ së një nga vështirësitë më të mëdha për të bërë progres në një program aq të madh investiv është ajo që quhet “kapaciteti i pamjaftueshëm absorbues”. Ky term përdoret si referencë e gjerë për aftësinë e institucioneve përfituese për të përgatitur, proceduar dhe implementuar projektet me ritëm të mjaftueshëm për të mundur shkuarjen “sipas planit” të implementimit të investimeve.

- Kapaciteti absorbues është shkalla në të cilën vendi është në gjendje të shpenzojë resurset financiare të alokuara nga ... financuesit me efikasitet dhe efektivitet
- Shkalla e absorbimit ilustron kapacitetin absorbues dhe identifikon nivelin e shpenzimeve si përqindje e shumës së përgjithshme të... fondeve në dispozicion.

¹¹⁸ Një numër i hulumtimeve për arsyet e këtyre vështirësive janë bërë nga Institucionet Evropiane, nga organizmat e vendeve anëtare dhe hulumtuesit,

http://ec.europa.eu/regional_policy/information/evaluations/index_en.cfm

http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/KCSF_2008_ABSORPTION_OF_EU_PRE-ACCESSION_FUNDS.pdf



Rumania është shembulli më i publikuar dhe shembull dramatik i një vendi të ri anëtar që po përballet me vështirësi në absorbimin e mjeteve mbështetëse të fondeve të BE-së:

- *“ndër arsyt e kapacitetit të dobët absorbues kemi identifikuar mungesën e strategjisë së qeverisë, kapacitetin e dobët administrativ të institucioneve qendrore dhe lokale publike, dështimet e partneriteteve publiko – private, mungesa e burimeve njerëzore”*

Duhet theksuar dy procese kyçe:

- Planifikimin
- Menaxhimin e ciklit të projekteve¹¹⁹

Duhet të ceken gjithashtu tri nivele hierarkike:

- Strategjia
- Programi
- Projekti

Procesi i shkuarjes nga: “identifikimi i nevojave” e deri te “infrastruktura plotësisht funksionale në punë” është përmbledhur këtu:

- Faza e informimit
 - Vlerësimi i nevojave
 - Hulumtimi i opsioneve – niveli i lartë
 - Përafrimi i kostos
 - Definimi i përmbajtjes – ‘Fiche’ e parë
 - Donatorët – shprehja e interesit
- Studimi i Fizibilitetit ose Masterplani
 - Ri-ekzaminimi i definimit të projekteve
 - Ri-ekzaminimi i aspekteve ekonomike dhe financiare
 - Ekzaminimi më i detajuar i opsioneve – nivel kyç
 - Projekti konceptual
 - Përkushtimi i donatorëve
- Projekti ideor
 - Paramasa dhe parallogaria
 - Rishikimi i kostove
 - Marrëveshja për financim
- Projekti kryesor i detajuar
- Përgatitja e dokumentacionit të tenderit
- Implementimi
- Lëshimi në punë
- Periudha garantuese
- Operimi plotësisht i pavarur – “marrja në dorëzim”

Është arritur mjaft në vitet e fundit, ashtu siç pasqyrohet nga niveli i investimeve që tashmë i është dedikuar këtij sektori. Megjithatë, mbetet ende punë për t’u bërë, dhe është e rëndësishme për zbatimin efikas të veprimeve dhe investimeve të ardhshme që të aplikohet një qasje e strukturuar dhe efikase për zbatimin e projekteve.

¹¹⁹ Shikoni për shembull: http://ec.europa.eu/europeaid/multimedia/publications/publications/manuals-tools/t101_en.htm



8 Reagimi strategjik

8.1 Hyrje

Reagimi strategjik përfshin:

- Politikat për sektorin
- Masat dhe veprimet
- Planet për investime
- Sigurimi i resurseve

Reagimi strategjik përfshihet në:

- Këtë kapitull
- Katër kapitujt në vijim – një për secilin objektiv strategjik duke përfshirë masat dhe veprimet që janë aty
- Lista e prioriteteve e projekteve investive që gjenden në Bazën e të Dhënave për Projekte

Reagimi strategjik përfshinë politikat e nivelit të lartë që adresojnë:

- Kushtet ekonomike dhe mjedisore
- Përformancën aktuale në raport me objektivat strategjike
- Nevojat zhvillimore afatgjata për të gjithë sektorin duke përfshirë identifikimin e nevojave për investime që kërkohen gjatë fazës së implementimit
- Analizat financiare dhe ekonomike për opsionet e implementimit

8.2 Objektivat strategjike

Qeveria dhe Kuvendi miratojnë Objektivat dhe Parimet Strategjike kryesore:

1. Alokimi dhe mbikëqyrja e qëndrueshme e të drejtës për eksploatimin e burimeve ujore të Kosovës ndërmjet shfrytëzuesve të ujit ashtu që të garantohet qasja në ujë të sigurt për pije për të gjithë dhe të maksimizohen përfitimet ekonomike nga shfrytëzimet tjera të ujit, duke marrë parasysh ndryshimet e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesës së ujit dhe respektimin e parimeve për menaxhim të qëndrueshëm.
2. Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që shtojnë presionin në mjedisin ujor në një mënyrë proporcionale, efçente dhe efektive ashtu që të arrihen objektiva mjedisore ekonomisht të justifikueshme për ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore duke respektuar parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.
3. Arritja e niveleve të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujit duke përfshirë vërshimet dhe erozionin në mënyrë të balancuar dhe me kosto efektive.
4. Vendosja dhe mirëmbajtja e një sistemi të menaxhimit të ujërave që është i drejtë, transparent, efçent, i koordinuar me kapacitete të atilla teknike dhe profesionale që të jetë në gjendje të mbështesë arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe mbrojtjen nga uji duke përfshirë implementimin e një sistemi informativ ujor për monitorimin, vlerësimin, interpretimin dhe informimin e palëve të interesuara për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie.

Dhe objektivin horizontal si vijon:



- Arritja e pajtueshmërisë afatgjatë me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave fillimisht përmes adoptimit të sistemeve kompatible të legjislacionit dhe planifikimit dhe më pastaj përmes aplikimit hap pas hapi të masave praktike implementuese.

8.3 Qasja strategjike

Kapaciteti aktual për të përgatitur një plan për menaxhimin e pellgjeve lumore që është në përputhshmëri të plotë dhe që mbulon të gjitha aspektet e menaxhimit të ujërave duke përfshirë resurset ujore, cilësinë e ujit dhe menaxhimin e vërshimeve, është i kufizuar nga mungesa e të dhënave të besueshme. Prandaj për momentin nuk është i mundur kombinimi më kost-efektiv i masave që kërkohen sipas Direktivës Kornizë të Ujërave.

Mirëpo, ekzistojnë një numër i madh i masave “pa dyshim” (gjithashtu të njohura si “pa pendim”) që do të mund të ndërmerreshin në afat të shkurtër. Prandaj, Strategjia këtu është që të përvetësohet një “qasje në dy binarë”, që fokusohet në arritjen e përmirësimeve në procesin e planifikimit dhe, në të njëjtën kohë, të vazhdohet me investimet në infrastrukturë. Qasja përgjatë katër periudhave planifikuese mund të përmbledhet në sa vijon:

- Faza e parë (2017 – 2021): Konsolidimi
 - Investimet
 - Programi bazë i masave për implementimin e përmirësimeve thelbësore të infrastrukturës duke u bazuar në të dhënat në dispozicion
 - Implementimi i ‘masat pa dyshim’
 - Riparimet dhe renovimet urgjente (adresimi i mosmirëmbajtjes së mëhershme)
 - Kapaciteti Menaxhues
 - Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave (hidrometeorologji, resurset ujore, cilësia e ujit) – faza e parë: të gjitha parametrat bazë
 - Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe i implementimit të të masave të planifikuara
- Faza e dytë (2022 – 2026): Zgjerimi
 - Investimet
 - Një program më i gjerë i masave që adresojnë zgjerimin që është me prioritet dhe nevojat zhvillimore
 - Shtimi i resurseve ujore (akumulimet)
 - Rritja e fokusit për zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime
 - Rritja e fokusit për uljen e ndotjes (trajtimi i ujërave të ndotura)
 - Kapaciteti Menaxhues
 - Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave (hidrometeorologji, resurset ujore, cilësia e ujit) – faza e dytë: rritje e gamës së parametrave duke përfshirë ata hidro-ekologjik
 - Përmirësimi i mëtutjeshëm i procesit të planifikimit dhe masave implementuese – fokus më i madh në vlerësimin ekonomik



- Faza e tretë (2027 – 2031): Zgjerimi
 - Investimet
 - Një program më i gjerë i masave që adresojnë zgjerimin që është me prioritet dhe nevojat zhvillimore – vazhdimi nga faza 2
 - Shtimi i akumulimeve të ujit
 - Rritja e fokusit për zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime
 - Rritja e fokusit për uljen e ndotjes (trajtimi i ujërave të ndotura)
 - Kapaciteti Menaxhues
 - Rrjeti i monitorimit që tani është afër kërkesave të BE-së – përmirësime të vogla
 - Planifikimi dhe implementimi i masave përkatëse që i afrohen kërkesave të BE-së – përmirësime të vogla
- Faza e katërt (2032 – 2036):
 - Investimet
 - Një pako shumë e fokusuar të masave të cilat janë optimizuar në bazë të të analizimit të dhënave teknike dhe ekonomike të përmirësuara në masë të madh,
 - Investimet përfundimtare për zgjerimin e mbulueshmërisë e plotë me rrjet,
 - Investimet për uljen e ndotjes me fokus arritjen e objektivave mjedisore (Neni 4 DKU)
 - Kapaciteti Menaxhues
 - Rrjeti i monitorimit – stabil, i plotëson kërkesat e BE-së: optimizim dhe rafinim
 - Planifikimi dhe masa përkatëse të implementimit për të arritur kërkesat e BE-së – stabil: përmirësime të vogla dhe rafinim.

Përmes kësaj qasje në faza dhe në dy binarë, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës janë të vendosura që të arrijnë menaxhim të ujërave në mënyrë të besueshme, efektive, të qëndrueshme në aspektin mjedisor dhe financiar për tërë territorin e Kosovës.

8.4 Korniza ligjore

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të miratojë legjislacionin për të transpozuar kërkesat e gjithë legjislacionit relevant të Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave gjatë periudhës së parë implementuese të kësaj Strategjie bazuar në dispozitat e Ligjit të Kosovës për Ujëra.

Specifikimet e detajuara që përmbahen në legjislacionin sekondar, afatet për përputhje dhe aplikimi i kërkesave dhe masave do të bëhen të realizueshme dhe e arritshme përmes aplikimit të procedurave të **vlerësimit të kostos së përputhshmërisë (CCA)** dhe **vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA)**. Qeveria nuk do të mbështes miratimin e caqeve apo afateve të paarritshme por do të mbështes plotësisht masat ekonomisht racionale për arritjen hap pas hapi të përputhshmërisë me kërkesat e legjislacionit të BE duke përfshirë në veçanti kërkesat e Direktivës Kornizë të Ujërave dhe direktivave asociuese dhe atë gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj Strategjie¹²⁰.

¹²⁰ Ashtu sikur është specifikuar në Pjesë A të Aneksit VI të Direktivës



Qeveria i udhëzon të gjithë promovuesit e legjislacionit sekondar që të plotësojnë legjislacionin me masat për të rritur vetëdijesimin dhe për të ndihmuar palët në lidhje me implementimin duke përfshirë masat e publicitetit, udhëzimet e përgjithshme dhe dokumentacionin specifik për udhëzimet teknike. Në përputhje me kërkesat që kanë të bëjnë me menaxhimin e informacionit, gjithë legjislacioni, dokumentacioni udhëzues, materialet përgatitore (CCA, RIA) dhe përmbledhjet jo teknike do të vihen në dispozicion në formën digjitale dhe do të formojnë një bibliotekë elektronike të mirë-strukturuar dhe të përshtatshme për përdorim të legjislacionit të zbatueshëm në këtë sektor.

8.5 Efektiviteti rregullator

Qeveria është e vetëdijshme se menaxhimi i ujërave kërkon një sistem rregullativ i cili në vete ngërthen parimin kryesor që shfrytëzimi i ujërave të jetë i kontrolluar përmes sistemit të lejeve dhe që pa një sistem efektiv dhe të aplikuar të lejeve, alokimi i resurseve dhe kontrolli i ndikimit nuk mund të menaxhohet në praktikë. Prandaj, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, Qeveria do të rrisë mbështetjen për zbatimin e masave të kontrollit në kuadër të sektorit dhe, për këtë qëllim, do të vë në dispozicion burime shtesë tek autoritetet kompetente ashtu siç është paraparë me Ligj. Autoritetet kompetente udhëzohen t'i trajtojnë si prioritet çështjet në vazhdim:

- Shfrytëzimin pa leje apo në kundërshtim me kushtet e lejes;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura apo i substancave tjera ndotëse në ujëra i ndërmarrë pa leje apo në kundërshtim me kushtet e lejes ;
- Largimi i materialeve nga brigjet e lumenjve, shtretërit e lumenjve apo zonat bregore pa një leje të duhur*;
- Lidhja në sistemin publik të furnizimit me ujë në kundërshtim me dispozitat që i rregullojnë këto sisteme (lidhjet ilegale);
- Lidhja në sistemin publik të kanalizimit në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë sistemet e tilla (lidhjet ilegale).

Shkeljet e mësipërme konsiderohen vepra penale dhe Qeveria mbështet kompetencat zbatuese për inspektorët e MMPH lidhur me shfrytëzimin e ujërave nëntokësore dhe ato sipërfaqësore, dhe për KRU për lidhjet ilegale në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe për Policinë e Kosovës për të dyja këto aspekte përmes dispozitave të Kodit Penal të Kosovës dhe të legjislacionit sekondar të nxjerrë në pajtim me Ligjin për Ujërat.

Publiciteti, rritja e vetëdijesimit dhe aktivitetet edukative do të shfrytëzohen si pjesë e kampanjës për të çrrënjësuar shfrytëzimin e pa autorizuar të ujërave.

**Në afatin e shkurtër kohor nuk do të lëshohet asnjë leje për nxjerrje të inerteve nga shtretërit e lumit. Kjo politikë do të rishikohet mbi bazat e procesit planifikues të menaxhimit të pellgut lumor dhe Studimit të Fizibilitetit që është në fazën e përgatitjes nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.*

8.6 Qëndrueshmëria financiare

Qëndrueshmëria financiare është brenga kryesore. Pa të ardhurat nga tarifat dhe pagesat zhvillimi i sektorit do të vazhdojë të vonohet dhe siguria e furnizimit të vihet në dyshim. Një çmim fer do të duhej të paguhej nga të gjithë konsumatorët e të gjitha sektorëve. Aktualisht të gjitha KRU-të janë financiarisht të qëndrueshme dhe mund të mbulojnë kostot e shërbimeve publike të ujit dhe duke kryer disa investime të caktuara, që janë të imponuara nga gjendja e tanishme e sektorit të shërbimeve të ujit që rregullohet nga ARRU.

[Pagesa e tarifave dhe pagesave](#)



- Qeveria është e përkushtuar që të mbështes mekanizmat që do të përmirësojnë:
 - Arkëtimin e të ardhurave nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit
 - Arkëtimin e të ardhurave nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujitjes
 - Arkëtimi i pagesave për lejet ujore

Qeveria i fton komunat që të bashkohen në këtë angazhim.

[Ndihma ndaj konsumatorëve me të ardhura më të vogla](#)

Qeveria merr parasysh që disa familje përballen me vështirësi të konsiderueshme financiare në mbulimin e ngarkesave për shërbimet e ujit dhe merr përsipër që të sigurojë implementimin e dispozitave të veçanta që lehtësojnë ngarkesën e këtyre rasteve sociale.

8.7 Planifikimi

8.7.1 Shqetsimet urgjente dhe të rëndësishme

Qeveria shpreh brengë të madhe për problemet që dalin me resurset ujore në pellgun e Ibrit dhe për potencialin e këtyre problemeve për t'u perkeqësuar siç përshkruhet në raportin për Sigurinë e Ujit në Kosovën Qendror. Qeveria është e vendosur që të mbështes vazhdimin e implementimit të masave afatmesme për të ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për këtë problem urgjent dhe të rëndësishëm.

8.7.2 Procesi i Planifikimit

Qeveria e miraton plotësisht qasjen e menaxhimit të pellgjeve lumore të paraqitur në Direktivën Kornizë të Ujërave dhe siç është zhvilluar me tutje në Direktivën e Vërshimeve. Qeveria është gjithashtu enjoftuar me brengat në rritje që rrjedhin nga ndryshimet klimatike dhe për perspektiven e rritjes së mundësive për paraqitjen e thatësirave. Gjithashtu ajo e ka të qartë që përkundër dispozitave largpamëse të DKU, ajo nuk ofron vetvetiu planifikim të integruar për menaxhimin e pellgjeve lumore. Prandaj ne kemi vendosur që të integrojmë të gjitha objektivat strategjike në planifikimin e menaxhimit të pellgjeve lumore në Kosovë:

- Shfrytëzimi i ujërave, përfshirë menaxhimin e plotë të burimeve të ujit, duke përfshirë parandalimin dhe zbutjen e thatësirave
- Mbrojtjen e ujërave
- Mbrojtjen nga ujërat

Qeveria më tutje konfirmon se, në përputhje me Ligjin për Ujërat, organ kompetent për procesin e planifikimit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por duke qenë në dijeni për interesa të shumta dhe të ndryshme në këtë sektor atëherë e ngarkon Ministrinë që të themelojë Komitetin e Pellgut Lumor për secilin nga katër pellgjet lumore kryesore, duke përfshirë përfaqësuesit e të gjitha palëve kryesore në pellg, që do të takohen të paktën dy herë në vit në mënyrë që të shqyrtojnë progresin në përgatitjen e planeve të menaxhimit të integruar të pellgut lumor dhe të lehtësojnë koordinimin në nivel pune ndërmjet organizimeve kryesore në këtë fushë. Komitetet do të kryesohen me sistem rotacioni në baza tri vjeçare nga përfaqësuesit e komunave në kuadër të Pellgut. Ministria do të ketë përherë pozitën e zëvendës kryesuesit dhe do të raportojë në emër të Komiteteve tek Këshilli Ndërmnistror për Ujëra.

Ky dokument, Plani i bashkangjitur i Veprimit dhe Investimeve në Ujëra dhe versioni përsëritja e parë e Planit të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore do të udhëheqin zhvillimet në sektor gjatë viteve në vijim. Megjithatë duhet të pranohet se asnjë strategji, asnjë plan pavarësisht sa është mirë i përgatitur nuk është asnjëherë perfekt.



Prandaj në kemi përfshirë në këtë SSHUK dhe në dispozitat PVIU monitorimin, rishikimin, rivlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Në veçanti ne jemi në dijeni se planifikimi është i bazuar në informim të mirë, kapacitete të fuqishme analitike dhe bashkëpunim/koordinim ndërinstytucional. Ne do të kërkojmë përmirësimin e mjaftueshëm të elementeve në vazhdim si për të ndihmuar në periudhën e parë të implementimit por gjithashtu për të ndihmuar me përgatitjet për periudhën e dytë dhe të mëtejme implementuese:

- Bazën e informacionit për planifikimin e menaxhimit të ujërave për periudhën e parë implementuese përmes:
 - Kapacitetit të përmirësuar të IHMK
 - Shkëmbimit të përmirësuar të informacionit dhe masave të publikimit
 - Zbatimin e përmirësuar të kërkesave të raportimit
- Kapacitetet e institucioneve qendrore
 - Fuqizimin e Departamentit të Ujërave të MMPH
 - Trajnimin dhe mbështetjen teknike
- Kapacitetet e institucioneve lokale
 - Këshillime dhe trajnime për komunat

Në këtë drejtim qasja e integruar në Planifikimin për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore është theksuar përmes së cilës procesi i planifikimit adreson gamën më të gjerë të mundshme të çështjeve në mënyrë të koordinuar dhe koherente, duke përfshirë:

- Kërkesat e plota të DKU
- Menaxhimi i resurseve ujore – alokimin, parandalimi i thatësirave
- Menaxhimi i Rrezikut të Vërshimeve, Direktivat e Vërshimeve të BE-së
- Menaxhimi i rrezikut nga Thatësitrat

8.7.3 Rregullimi bazuar në Plan

Qeveria konfirmon se programi i masave të përfshira në Planin e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore, ndërmjet tjerash do të:

- Përcaktojë kriteret dhe kufizimet specifike të ujëmbledhësëve për nxjerrjen e ujit në përputhje me nevojën për të siguruar prurjet minimale, mbrojtjen e furnizimit publik si prioritet, lejimin për zhvillim racional ekonomik të resurseve.
- Përcaktojë kriteret dhe kufizimet specifike të ujëmbledhësëve për shkarkimin e ujërave të ndotura në përputhje me planin hap pas hapi të përputhjes siç është përcaktuar në Ligj dhe vënien e prioriteteve në aspektin e përfitimit për shëndetin publik dhe shfrytëzuesit.
- Imponojë masat për të mbrojtur resurseve kryesore të ujit.
- Bazohet në optimizimin financiar dhe ekonomik të masave, veçmas masat e investimit me treguesit ekonomik të “raportit kosto përfitim” dhe “efiçencës së koston” si kriteret kryesore për përcaktimin e kombinimit optimal të masave dhe prioritetizimit të tyre

8.7.4 Bashkëpunimi dhe koordinimi

Qeveria njihet rëndësinë e përfshirjes së komunave përgjithësisht në sektorin e ujërave dhe veçanërisht në shërbimet e ujit dhe mbrojtjen nga vërshimet. Prandaj Qeveria shpreh përcaktimin e vet për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe gjithashtu ndërmjet autoriteteve kompetente e Qeverisë qendrore.



8.8 Informimi

Qeveria e pranon se planet e optimizuara të menaxhimit të pellgjeve lumore nuk mund të përgatiten në mungesë të informacionit kryesor, ashtu si është paraqitur në Direktivën Kornizë të Ujërave dhe proceset planifikuese të Direktivës së Vërshimeve, dhe prandaj përcaktohet për mbështetjen e programit të vazhdueshëm të mbledhjes së informacionit dhe përmirësimet menaxhuese duke përfshirë në veçanti:

- Zgjerimin e rrjetit monitorues të prurjeve të ujit
- Përmirësimet në monitorimin meteorologjik
- Përmirësimet në monitorimin e cilësisë së ujit
- Zbatimin e dispozitave për lejet e ujit për shfrytëzuesit për të raportuar informacione të sakta

Përforsim i konsiderueshëm dhe i qëndrueshëm i IHMK do të bëhet në afat të shkurtër, ashtu që të sigurohet se ky institucion është i pajisur dhe ifinancuar për të kryer këto detyra vitale.

Qeveria zotohet që në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore në Kosovë të bëjë të gatshëm informacionin dhe ta vë në dispozicion pa pagesë, veçanërisht me mjetet elektronike si të përgjithshme dhe të detajuara, në mënyrë që të rritet vetëdija dhe që të sigurohet se të gjitha palët janë të informuara mirë dhe në gjendje për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procesin e vendim marrjes për sektorin e ujërave. Në këtë drejtim Qeveria riafirmon zotimin e vet për zhvillimin e Sistemit të Informacionit për Ujëra dhe zhvillimin e tij të vazhdueshëm.

8.9 Siguria Publike

8.9.1 Parandalimi i vërshimeve

Qeveria zotohet të ndërmarr një qasje tri drejtimshme për mbështetjen e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet:

- investimi afatshkurtër në masa "pa pendim", duke përfshirë në veçanti riparimin dhe renovimin e objekteve ekzistuese për mbrojtjen nga vërshimet dhe implementimin e projekteve të gatshme që dalin nga studimet e kompletuara dhe të studimeve afatshkurtra e të detajuara, sidomos për Gjilan - Viti.
- Identifikimi në bazë të vlerësimeve preliminare të rrezikut nga vërshimet i zonave që kanë studime të gatshme dhe të detajuara që çojnë në implementimin e projekteve të gatshme të cilat janë më urgjentet dhe më të rëndësishmet, dhe komisionimi i këtyre studimeve në afat të shkurtër me qëllim të implementimit të tyre në periudhën e parë implementuese të këtij plani.
- Vazhdimi i punimeve për të përgatitur planet komplete për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet për të gjithë vendin si pjesë e procesit të menaxhimit të pellgjeve lumore.

8.9.2 Rreziku nga vërshimet dhe procedurat e emergjencës

Qeveria e mbështetë kornizën e përgatitur nga Task Forca e Ujërave dhe përcaktohet për t'i zbatuar rekomandimet që përmbajnë ato përmes një kornize të përbashkët të menaxhimit të thatësirave dhe vërshimeve duke përfshirë rekomandimet e dhëna nga Raporti i Task Forcës së Ujërave për menaxhimin e thatësirave.



8.9.3 Siguria e digave

Qeveria mbështetë vlerësimin e bërë nga ana e Task Forcës së Ujërave dhe përcaktohet për të zbatuar programin e inspektimit të plotë të sigurisë së digave për të gjitha digat dhe të ndërmerr masa të menjëhershme pas inspektimeve me një program të masave për sanimin e problemeve eventuale për të siguruar operimin e sigurt të të gjitha strukturave të digave.

8.10 Ofruesit e shërbimeve të ujit

Qeveria do të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit që të jenë moderne, efçente, entitete që iu përgjigjen konsumatorëve, në gjendje për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë për të gjithë konsumatorët dhe i miraton masat që janë ndërmarrë bazuar në amandamentimin e fundit të Ligjit për Kompanitë Publike. Në këtë drejtim Qeveria përcakton se:

- Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit duhet të mbesin ndërmarrje me pronësi publike, të paktën për periudhën e parë programore të kësaj Strategjie.
- Infrastruktura e furnizimit me ujë dhe e ujërave të ndotura duhet që për të paktën në periudhën e programit të parë të kësaj Strategjie të jetë në emër të qytetarëve në pronësi të Qeverisë së Kosovës përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
- ARRU urgjentisht të ndërmerr një vlerësim kritik të procesit të përcaktimit të tarifave dhe procesit të planifikimit të punës në mënyrë që të përcaktojë arsyet e performancës së dobët të KRU-ve krahasuar me planin dhe të paraqesë rekomandime për KNMU për të amandamentuar procesin e planifikimit të biznesit në mënyrë që të lehtësojë në mënyrë të konsiderueshme shkallën e rritur të zhvillimit të infrastrukturës.
- Në mbështetje të këtij qëllimi Qeveria përcakton se investimet nga KRU-të do të përjashtohen nga Tatimi Mbi Vlerë të Shtuar (TVSH).
- Të gjitha KRU-të do të përgatisin planet afatgjata të investimeve që mbulojnë periudhën e kësaj Strategjie.
- Të gjitha aktivitetet e shërbimit të ujit në kuadër të zonës së caktuar (licencuar) të shërbimit të një KRU-je do të konsolidohen në kuadër të asaj KRU-je dhe ai proces i konsolidimit do të ndërmerret mbi bazat e marrëveshjes obliguese ndërmjet palëve kryesore dhe vëmendje e duhur do t'i kushtohet ndikimit financiar tek konsumatorët lokal duke ndërmarrë masa lehtësuese që do të zbatohen për të minimizuar barrën e ndryshimeve të tilla për amvisëritë me të hyra të ulëta.
- Tarifat e vendosura për shërbimet e ujit do të vazhdojnë të përcaktohen mbi kriteret ekonomike që konsiderohen caqe të realizueshme nga ARRU, të mbështetura me politikat tarifore të ARRU mbi bazën e planeve të biznesit të përgatitur nga KRU-të, dhe duhet të përputhen me rrethanat ekzistuese socio-ekonomike për:
 - Arritjen e mbulimit të plotë të kostove duke përfshirë amortizimin e aseteve;
 - Elementet fikse dhe vëllimetrike ashtu si është tani;
 - Tarifa për shërbimet e furnizimit me ujë nuk duhet të tejkalojë 2% të të hyrave mesatare të amvisërisë për zonën e shërbimit të KRU bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës
 - Tarifa për shërbimet e ujërave të ndotura nuk duhet të tejkalojë 2% të të hyrave mesatare të ekonomisë familjare për zonën e shërbimit të KRU bazuar në të dhënat e ashtu si është përcaktuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës



- Tarifa e kombinuar për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura së bashku nuk duhet të tejkalojnë 3.5 % të të hyrave mesatare të ekonomisë familjare për zonën e shërbimit të KRU ashtu si është përcaktuar nga Agjencia i Statistikave të Kosovës
- Përfshirja e elementit specifik (të ri) për zhvillimin e infrastrukturës të vlerësuar mbi bazat e nevojave investive të përcaktuara në planet investive afatgjatë - kjo nuk duhet të tejkalojë tarifën fikse për lidhje të reja..

8.11 Qasja e përgjithshme ndaj investimeve kapitale

Qeveria do të adoptojë një qasje të balancuar dhe integruese për plotësimin e nevojave zhvillimore për të gjitha komponentët e sektorit të ujërave. Do të mundohet të gjejë një balancë të optimizuar në mes të fushave kyçe të investimeve:

- Furnizimi me ujë për përdorim shtëpi dhe aktivitete komerciale;
- Furnizimi me ujë për përdorim industrial dhe për bujqësi;
- Grumbullimi i ujërave të ndotura urbane;
- Trajtimi i ujërave të ndotura urbane;
- Mbrojtja nga vërshimet.

Një balancim do të kërkohet gjithashtu në mes të:

- Rinovimit të infrastrukturës ekzistuese për të parandaluar dështimet katastrofale, duke reflektuar parimin e parandalimit.
- Investimeve në zgjerimin e shërbimeve dhe në ofrimin e shërbimeve të reja.

Prioritetizimi i masave investive do të bëhet duke u bazuar në kritere transparente dhe të zbatuara qartë të raportit të kost-benifitit dhe kost-efektivitetit, duke qenë të vetdijshëm që në raste të ndonjë nevojë të skajshme dhe urgjente që del nga ngjarje të paparashikuara, aplikimi i kriterëve të tilla nuk do të merret parasysh (*force majeure*).

8.12 Zotimi financiar

Duke marr parasysh rëndësinë e sektorit të ujërave dhe përkushtimin e Qeverisë së Kosovës që të mbajë premtimet e dhëna, Qeveria e Kosovës do të përpiqet që të sigurojë mjete financiare adekuate për këtë sektor. Në këtë aspekt Qeveria do të përpiqet të sigurojë që shpenzimet kapitale në sektorin e ujërave, duke përfshirë kontributet nga qeveria qendrore, nga komunitat, nga donatorët dhe nga kompanitë e sektorit të jenë në përputhje me arritjen e këtyre objektivave, dhe përcakton shifrën prej 1% të BPV-së si pikë referimi kundrejt të cilës ky angazhim duhet të gjykohe të periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Aksionet dhe investimet – shfrytëzimi i ujit

Siç është cekur me lartë Objektivi Strategjik është:

- Të shpërndajë dhe shfrytëzojë në mënyrë të qëndrueshme resurset ujore të Kosovës tek shfrytëzuesit e saj në mënyrë që të garantojë qasje në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin për të gjithë dhe të maksimizojë përfitimet ekonomike nga përdorimi i ujërave për qëllime tjera, duke marrë parasysh ndryshimet sezonale në prurjet e ujërave, të eliminojmungesën e ujit dhe të respektojë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.

Shpërndarja dhe alokimi i “shfrytëzimit të resurseve” kërkon:

- Monitorimin për mbledhjen e informatave për resurset ujore dhe shfrytëzimin e tyre;
- Planifikimin për përcaktimin e nivelit të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore;



- Rregullimin (licencat, inspektimi dhe zbatimi i ligjit) e shfrytëzuesve të ujit në mënyrë që të sigurohet se kufizimet e planifikuara respektohen.

Kapacitetet, proceset dhe procedurat e monitorimit, planifikimit dhe rregullimit janë gjithashtu të rëndësishme për Objektivat tjera Strategjike (Mbrojtja e Ujërave dhe Mbrojtja nga Ujërat) andaj janë adresuar më lart (në kuadër të Reagimit Strategjik) dhe Objektivit Strategjik “Qeverisja” më poshtë. Çështjet specifike të shfrytëzimit të ujërave janë trajtuar këtu, por duhet të trajtohen në kontekstin e përgjithshëm të Reagimit Strategjik dhe të premisave “horizontale” që kanë të bëjnë me Objektivin e Qeverisjes.

Duke pasur parasysh Objektivin Strategjik të Shfrytëzimit të Ujërave, është me rëndësi të dihet se sa i takon resurseve ujore:

- Kosova tashmë ka problem me mungesë të ujit;
- Potenciali për mungesë të tillë të ujit pritët të rritet pjesërisht si rezultat i:
 - Rritjes së kërkesës si rezultat i rritjes së popullsisë,
 - Rritjes së kërkesës nga sektori i bujqësisë,
 - Parashikimet e ndryshimeve klimatike tregojnë shenja të zvogëlimit të resurseve ujore gjatë periudhës së kërkesës së lartë (verë – vjeshtë)
- Kapaciteti specifik (për kokë banori) i akumulimit të ujërave është relativisht i ulët;
- Eficienca e shfrytëzimit të ujërave nuk është optimizuar (p.sh. uji i pa-faturuar);

Për sa i përket përfitimeve nga shfrytëzimi i uërave, nevojiten përmirësime:

- Ka ende zona urbane, nënurbane dhe zona rurale jo të largëta që nuk furnizohen nga sistemi publik i furnizimit me ujë;
- Disa nga sistemet publike të furnizimit me ujë nuk i plotësojnë standardet e kërkuara në veçanti për sa i përket:
 - Cilësisë së ujit të pijshëm,
 - Furnizimit të rregullt,
 - Humbjeve të ujit,
- Ka mundësi të mira që të zgjerohet mbulimi i tokave me sistemet e ujitjes në mënyrë që të promovohet rritja e sektorit të bujqësisë.

8.13 Masa 1.1: Rritja e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e resurseve ujore

Kjo masë ka të bëjë me akumulimin dhe ruajtjen e ujërave për shumicën e përdorimeve kryesore duke përfshirë shërbimet e furnizimit me ujë, ujitje dhe përdorime tjera (duke përfshirë industrinë).

Nevoja për rritjen e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e ujërave është vlerësuar për pellgun e Ibrit dhe janë identifikuar nevojat. Për pellgjet tjera është identifikuar nevoja për ruajtje shtesë të resurseve ujore bazuar në informacionet e disponueshme dhe në bilancin e thjeshtuar të ujërave, por të gjitha rastet kanë nevojë për hulumtime të mëtutjeshme në mënyrë që të identifikohen projekte “konkrete” investive. Megjithatë, duhet thënë se vlerësimi i nevojave të tashme dhe të ardhshme, siç janë bërë për pellgun e Ibrit duhet të bëhen edhe për pellgjet lumore tjerë. Kjo do të realizohet si pjesë e procesit të Planifikimit për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve dhe do të përfshijë vlerësimin e kërkesave të ardhshme dhe sa mund të përmbushen këto kërkesa nga resurset ekzistuese dhe akumulimet e disponueshme, duke shfrytëzuar, ndër tjera, modelin SVPU.



Megjithatë, përgatitja e Planeve Menaxhuese të Pellgjeve Lumore (PMBL-të) me të gjitha detajet do të merr kohë dhe në mënyrë specifike do të kërkojë që të sigurohen të dhënat për prurjen e ujërave – shumica prej të cilave duhet të mblidhen në mënyrë të rregullt.

Edhe pse veprimet e përshkruara këtu do të kërkonin kompletimin e PMBL-ve, kjo do të rezultonte në vonesa të konsiderueshme. Gjithashtu, Masterplani i kaluar tashmë ka identifikuar një numër të madh të vendeve për akumulimin e ujërave. Prandaj, aksionet që do të ndërmerren këtu do të bazohen në rivlerësimin e skemave të propozuara në Masterplanin e kaluar dhe gjithashtu do të kontribuojnë në PMBL-të. Vendimet për projektet investive që do të ndërmerren pas kompletimit të studimeve të arsyeshmërisë të përshkruara këtu do të duhet të merren në kuadër të procesit të Planeve Menaxhuese të Pellgjeve Lumore.



8.13.1 Veprimi 1.1.1: Studimi i fizibilitetit – të rritet kapaciteti i akumulimit të ujit: të gjitha pellgjet

Bazuar në termat e referencës të përcaktuara për Sigurinë e Ujit në Kosovën Qendrore siç është përshkruar në: “Masën/Projektin 4: Studimi i opsioneve për furnizim më të sigurt me ujë në raste emergjente” do të zbatohet në të gjitha pellgjet

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.1.1
Emri	Studimi i fizibilitetit – rritja e kapaciteteve akumuluese të ujit: Të gjitha pellgjet
Përshkrim i shkurtër	Bazuar në specifikimet e dhëna në Raportin e Sigurisë së Ujit në Kosovën Qendrore ky studim do të vlerësojë kërkesat afatgjata (20 vjet) për akumulimin e ujit në këtë pellg dhe do të përgatis një plan për rritjen e kapacitetit akumulues duke përfshirë edhe projektin konceptual.
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i Ujërave
Nën-sektori	Resurset Ujore
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha pellgjet
Natyra e kostove	Hulumtimet, Analizat, Planifikimi, Asistenca Teknike
Kosto e parashikuar:	€2,000,000
Pjesëmarrja e donatorëve	85%
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Palët tjera kyçe të interesit	Këshilli Ndërmintor i Ujërave Kompanitë Rajonale të Ujërave Kompanitë për Ujitje Komunat
Aktivitetet e koordinuara	Vlerësimi i resurseve ujore për Termocentralin Kosova e Re–Banka Botërore Kanali Ibër- Lepenc – Studimi i fizibilitetit për kanalin
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Të përcaktohet me vonë
Veprimet pasuese	Projektet investive për rritjen e sigurisë së furnizimit
Ref. e treguesve të verifikueshëm	Studimi i përfunduar Investimet e rekomanduara



Momentalisht janë disa projekte të gatshme për investim¹²¹ për rritjen e akumulimit të ujërave. Megjithatë, me kompletimin e studimit duhet të ndërmerren vendimet dhe aksionet investive.

Dokumentimi i projekteve, duke përfshirë dokumentet tenderuese duhet të përgatiten pas procesit të vendim-marrjes.

8.13.2 Veprimi 1.1.2: Mbështetja në zbatim-Rritja e kapacitetit të akumulimit të ujit: Të gjitha pellgjet

Pas veprimit të mëpamë ky veprim do të ndihmojë kapërcimin e 'gap-it' midis planifikimit dhe zbatimit.

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.1.2
Emri	Mbështetja në zbatim – rritja e kapacitetit të depozitimit të ujit: Të gjitha pellgjet
Përshkrim i shkurtër	Mbështetje në përgatitjen e projekteve prioritare të identifikuara më lartë në 1.1.1 duke përfshirë projektin dhe tenderimin
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujërave
Nën-sektori	Resurset ujore
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Natyra e kostove	Projekti, Dokumentet e tenderit, Mbështetje procesit të tenderimit
Kosto e parashikuar:	€2,000,000
Pjesëmarrja e donatorëve	85%
Fillimi	2019
Përfundimi	2021
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Palët tjera kyçe të interesit	Këshilli Ndërmintor i Ujërave Kompanitë Rajonale të Ujërave, Kompanitë për Ujitje, Komunat
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Mbetet të përcaktohet
Veprimet pasuese	Projekt(e) investive për rritjen e sigurisë së furnizimit

¹²¹ Ju lutem referojuni databazës së projektit investiv



Ref. e treguesve të verifikueshëm	Projekti është kryer Tenderët janë shpallur
--	--

8.13.3 Veprimi 1.1.3: Ndërtimi – rritja e kapacitetit për akumulimin e ujit: Të gjitha pellgjet

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.1.3
Emri	Ndërtimi – rritja e kapacitetit për akumulimin e ujit: Të gjitha pellgjet
Përshkrim i shkurtër	Ndërtimi i objekteve të reja për akumulimin e ujit
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujërave
Nën-sektori	Resurset ujore
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Natyra e kostove	Investimet kapitale
Kosto e parashikuar:	Shikoni më poshtë
Pjesëmarrja e donatorëve	75%
Fillimi	2020
Përfundimi	2026
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë Regjionale të Ujërave Kompanitë për Ujitje Komunat në pellg
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Mbetet të përcaktohet
Veprimet pasuese	Komisionimi
Ref. e treguesve të verifikueshëm	Ruajtja e ujit për banorët

Një rrjedhë indikative e investimeve për këtë iniciativë është dhënë më poshtë.

Tabela 112 Rrjedhja Indikative e Investimeve për Akumulimin e Ujërave: 2017 - 2024

Milion Euro	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	10-Vj.
Qeveria	2.50	2.50	10.00	10.00	8.95	7.48	7.81	8.19	8.60	9.06	75.10
Donatorë	2.50	2.50	10.00	10.00	8.95	7.48	7.81	8.19	8.60	11.08	77.11
Gjithsej	5.00	5.00	20.00	20.00	17.90	14.96	15.63	16.38	17.21	20.14	152.21



Shpenzimet relativisht të ulëta në dy vitet e para të kësaj periudhe reflektojnë nevojën për aktivitete përgatitore që duhet të ndërmerren në dy vitet e para së të kryhen investimet kryesore.

8.14 Masa 1.2: Rritja e efikasitetit në shfrytëzimin e ujit

Kjo masë ka të bëjë me dy aspekte të efikasitetit të shfrytëzimit të ujit:

- Efikasiteti me të cilin uji dërgohet nga burimi tek shfrytëzuesit final
- Efikasiteti e shfrytëzimit në pikën e konsumimit

Efikasiteti me të cilin uji dërgohet tek konsumatori i referohet tri fushave relevante:

- Humbjet nga furnizuesit me shumicë
- Humbjet nga sistemi i furnizuesit publik të ujit
- Humbjet nga sistemet e furnizimit të ujit për ujitje

Efikasiteti e shfrytëzimit të ujit nga konsumatorët ka të bëjë me të gjithë shfrytëzuesit e ujit duke përfshirë konsumatorët:

- Shtëpiak
- Për ujitje
- Për industri

Efikasiteti e shfrytëzimit do të përmirësohet dukshëm duke zbatuar parimin ndotësi paguan, p.sh. përmes iniciativave financiare që stimulojnë shfrytëzuesit që të kursejnë ujin.

Në të njëjtën mënyrë, efikasiteti e shfrytëzimit të ujit nga konsumatorët shtëpiak do të zgjidhet duke zbatuar plotësisht parimin shfrytëzuesi paguan të përshkruar mëposhtë. Kjo qasje është relevante edhe për shfrytëzuesit tjerë siç janë industria dhe bujqësia. Megjithatë, në rastin e këtyre shfrytëzuesve më shumë "teknik" ofrimi i udhëzimeve teknike dhe këshillimet për të zbatuar tërësisht masat për përdorim efikas të ujit konsiderohen të dobishme, përderisa një këshillim i tillë nuk është i nevojshëm për shfrytëzuesit shtëpiak të ujit pasi që në të kaluarën janë ndërmarrë shumë fushata për rritjen e vetëdijes qytetare .

8.14.1 Veprimi 1.2.1 Zvogëlimi i rrjedhjeve nga sistemet e furnizimit të ujit me shumicë

Ky veprim do të fokusohet në:

- Tri kompanitë e ujitjes që për momentin janë përgjegjëse për furnizimin me shumicë
- Zvogëlimi i rrjedhjeve teknike si rezultat i problemeve me infrastrukturë

Duhet thënë së vjedhjet nga sistemet e furnizimit me shumicë adresohen përmes masës 3 më poshtë.



Njësia	Vlera
Referenca unike	1.2.1
Emri	Zvogëlimi i rrjedhjeve nga sistemet e furnizimit me shumicë
Përshkrim i shkurtër	Monitorimi i performancës së sistemit të furnizimit Aksionet parandaluese për zvogëlimin e rrjedhjeve Vlerësimi i nivelit të humbjeve nga rrjedhjet e sistemeve të furnizimit të ujit me shumicë, përcaktimi i shkaqeve kryesore (teknike, të tjera), nxjerrja e planeve për adresimin e shkaqeve kryesore dhe zbatimin e tyre.
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Resurset ujore
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Natyra e kostove	Aktivitetet bazë Gjithashtu nevojiten investime për mirëmbajtje
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2017
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Kompanitë e Ujitjes (3)
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Aktivitetet e koordinuara	Përmirësime në inventarin e aseteve
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë e Ujitjes (3)
Veprimet pasuese	Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për rinovim
Ref. e treguesve të verifikueshëm	% e ujit të pa-faturuar

Ky veprim parasheh investime në infrastrukturë – Ju lutem referojuni bazës së të dhënave të projekteve investive.



8.14.2 Veprimi 1.2.2 Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e furnizimit me ujë

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.2.2
Emri	Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e furnizimit me ujë
Përshkrim i shkurtër	Monitorimi i performancës së sistemit të furnizimit Aksionet parandaluese për zvogëlimin e rrjedhjeve Vlerësimi i nivelit të humbjeve nga rrjedhjet e sistemeve të furnizimit me ujë, përcaktimi i shkaqeve kryesore (teknike, të tjera), nxjerrja e planeve për adresimin e shkaqeve kryesore dhe zbatimin e tyre.
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Furnizimi me ujë
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Natyra e kostove	Aktivitetet bazë Gjithashtu nevojiten investime për mirëmbajtje
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2017
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Kompanite Rajonale të Ujësjesit
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
Aktivitetet e koordinuara	Përmirësimi inventarit të aseteve
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë Rajionale të Ujësjesit
Veprimet pasuese	Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për rinovim
Ref/ e treguesve të verifikueshëm	% e ujit të pa-faturuar (shërbimet me ujë)

Aspekti kryesor i këtij veprimi është përgatitja e programit të identifikimit dhe zvogëlimit të rrjedhjeve. Duhet cekur se investimet për përmirësimin e kushteve të rrjeteve të furnizimit për të siguruar kushte me të mira të furnizimit (cilësia, presioni, besueshmëria) duhet gjithashtu t'i kontribuojnë qëllimit të këtij aksioni.



8.14.3 Veprimi 1.2.3 Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet shpërndarëse të ujitjes

Ky aksion është paralel me sistemin e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe do të fokusohet në:

- Sistemet për Ujitje
- Kompanitë për Ujitje
- Matësit për shfrytëzuesit dhe zonat

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.2.3
Emri	Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e ujitjes
Përshkrim i shkurtër	Monitorimi i performancës së sistemit të furnizimit Aksionet parandaluese për zvogëlimin e rrjedhjeve Vlerësimi i nivelit të humbjeve nga rrjedhjet e sistemeve të ujitjes, përcaktimi i shkaqeve kryesore (teknike, të tjera), nxjerrja e planeve për adresimin e shkaqeve kryesore dhe zbatimi i tyre.
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Ujitje
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Natyra e kostove	Aktivitetet bazë Gjithashtu nevojiten investime për mirëmbajtje
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2017
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Kompanitë e Ujitjes
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Aktivitetet e koordinuara	Rritja e efijencës së përdoruesve të ujit për ujitje
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë e Ujitjes (3)
Veprimet pasuese	Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për rinovim
Ref e treguesve të verifikueshëm	% e ujit të pa-faturuar (Ujitje)



8.14.4 Veprimi 1.2.4 Rritja e efijencës në shfrytëzimin e ujit për ujitje

Ky veprim ka të bëjë me nivelin e “vlerës së shtuar” që vjen si rezultat i ujitjes, p.sh. për sa rriten të ardhurat si rezultat i aplikimit të ujitjes (efijenca ekonomike).

Ky veprim do të fokusohet në:

- Bujqit
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Shërbimet e ofruara

Veprimi kryesisht do të merret me sigurimin e udhëzimeve dhe këshillave për bujqit përmes ofruesve të shërbimeve, por mund gjithashtu të ofrojë iniciativa ekonomike për ndryshimin e praktikave.

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.2.4
Emri	Rritja e efikasitetit të shfrytëzuesve të ujit për ujitje
Përshkrim i shkurtër	Monitorimi i shfrytëzimit të ujit për ujitje Analiza e llogarive ekonomike Ofrimi i shërbimeve këshilluese Administrimi i skemave ndihmëse
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Ujitje
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	Aktivitetet bazë Gjithashtu nevojiten investime për mirëmbajtje
Fillimi	2017
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Autoriteti bashkëpunues	Kompanitë e Ujitjes (3)
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Strategjia për Ujitje Programi për bujqësi dhe zhvillim rural
Pronari i infrastrukturës	
Operatori i infrastrukturës	Asociacioni i Shfrytëzuesve të Ujit
Veprimet pasuese	Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për rinovim
Ref. e treguesve të verifikueshëm	% e ujit të pa-faturuar



8.14.5 Veprimi 1.2.4 Rritja e efijencës së shfrytëzimit të ujit në industri

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të detyrohet të rregullojë (së paku pjesërisht) efijencën e shfrytëzimit të ujit përmes masave të “Teknologjisë më të Mirë në Dispozicion” të Direktivës së Emisioneve Industriale (2010/75/EU). Megjithatë, në (së paku) afat të shkurtër një veprim është përfshirë në PVIU për të adresuar këtë çështje pasi që adoptimi i DEI do të merr disa vite. Prandaj ky veprim do të koordinohet me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke përfshirë Dokumentin e Referencës për ofrimin e Teknologjisë më të Mirë në Dispozicion (DRMTMD-së) për industrinë e përfshira. Një shembull specifik që duhet të adresohet në kontekst të këtij veprimi është Studimi i Bankës Botërore për Kompleksin e Termocentraleve të Kosovës dhe mundësive për të përdorur teknologji që kanë nevojë për më pak ujë për sistemin e tyre të ftohjes.

Njësia	Vlera
Referenca unike	1.2.5
Emri	Rritja e efijencës së shfrytëzimit të ujit në industri
Përshkrim i shkurtër	Monitorimi i shfrytëzimit të ujit për industri Modelet specifike për industri Promovimi i shfrytëzimit të ujit në industri
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Industria
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar	Aktivitetet bazë
Fillimi	2017
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Entitetet industriale
Operatori i infrastrukturës	Entitetet industriale
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	Konsumimi i ujit për industri / njësi të BPV



8.15 Masa 1.3: Te sigurohet që të gjitha burimet ujore t'i nënshtrohen kontrollit

Siç e thamë në hyrjen e këtij Objektivi Strategjik, është esenciale që shfrytëzimi i resurseve ujore t'i nënshtrohet procesit të kontrollit. Kjo kërkohet në praktikë dhe në pajtim me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian (Direktiva Kornizë e Ujërave, Neni 11.3.e)

Kjo kërkon që të gjitha shfrytëzimet e ujit, siç janë përshkruar në Ligjin për Ujëra, të i nënshtrohen kontrollit siç kërkohet në Ligj. Përveç kërkesave që shfrytëzimi i ujit të bëhet në bazë të lejeve, respektimi i kushteve të lejes (p.sh. niveli i shfrytëzimit/nxjerrjes) duhet të monitorohet dhe nëse ka nevojë të merren masa zbatuese.

8.15.1 Veprimi 1.3.1 Fushata e zbatimit të lejeve për shfrytëzimin e ujërave

Ky veprim ka të bëjë me shfrytëzimin e ujërave nga mjedisi, p.sh. lumenjtë, liqenet natyrore dhe trupat ujore nëntokësore. Shfrytëzimi (marrja) i paligjshëm i ujërave nga objektet e ndërtuara nga njeriu është adresuar me veprimin e përshkruar më poshtë.

Ky veprim përbëhet nga një numër elementesh:

- Identifikimi i shfrytëzuesve ilegal të ujërave;
- Lëshimi i vërejtjeve për detyrimin e zbatimit të ligjit që kërkon marrjen e lejes për shfrytëzimin e ujërave ose ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit të shfrytëzimit të ujërave;
- Lëshimi i lejeve të reja;
- Veprimi i detyrimit të zbatimit të ligjit në rast të vazhdimit të thyerjes së ligjit që obligon marrjen e lejes ujore;
- Zbatimi i kushteve të specifikuara në lejen për shfrytëzimin e ujërave.

“Hapi” i parë i identifikimit të shfrytëzuesit të pa-autorizuar të ujërave duhet të ndërmerret nga MMPH dhe “Inspektorati” i saj, në bashkëpunim me palët relevante të interesit duke përfshirë Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, Kompanitë e Ujitjes, komunat dhe shfrytëzuesit tjerë të autorizuar¹²².

Elementi i parë do të përfshijë krahasimin e resurseve që janë në dispozicion në pellg me “sasinë e nevojshme” sipas kërkesës së aplikantit. Niveli i lejuar i shfrytëzimit do të përcaktohet në bazë të resurseve në dispozicion me, në rast mungese, preferencat që aplikohen në pajtim me ligjin (përparësi i jepet furnizimit të ujit për konsum nga njerëzit - Neni 28 i Ligjit të Ujërave).

Neni 75 i Ligjit për Ujëra përcakton obligimet e mbajtësit të drejtës ujore. Ky nen kërkon nga poseduesit e lejeve që të instalojnë dhe operojnë pajisjet matëse. Raportimi i këtyre matjeve duhet gjithashtu të kërkohet me kushtet e lejes.

Lëshimi i lejeve ujore duhet të bëhet në pajtim me Manualin për Lejt Ujore¹²³.

¹²² Funkzioni aktual i ueb faqes së Ministrisë “Raporto Aksionet Ilegale” do të mund të përfshinte edhe raportimin e shfrytëzimit ilegal të ujërave

¹²³ Udhëzues Referimi për Procedurat në Mbështetje të Administrimit të Lejeve Ujore 2007



Njësia	Vlera
Referenca unike	1.3.1
Emri	Fushata për zbatimin e lejeve ujore
Përshkrim i shkurtër	Identifikimi i shfrytëzimit të pa-autorizuar të ujërave Lëshimi i vendimit për ndalimin e shfrytëzimit të pa-autorizuar të ujit dhe kërkimi nga ta që të aplikojnë për marrjen e lejeve ujore ose të ndërpresin shfrytëzimin Lëshimi i lejes së re Veprim zbatues kundër moszbatimit në vazhdimësi të kushteve të lejes dhe kërkesa për marrjen e lejes Zbatimit i kushteve të përshkruara në leje
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Resurset ujore
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	Aktivitetet bazë
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Inspektorati mjedisor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Zhvillimit Ekonomik IHMK AKMM
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit Kompanitë e Ujitjes Komunat
Aktivitetet e koordinuara	Shih më poshtë – shfrytëzimet tjera të paligjshme
Pronari i infrastrukturës	Nuk aplikohet
Operatori i infrastrukturës	Nuk aplikohet
Veprimet pasuese	Lejet / aksionet detyruese
Ref e treguesve të verifikueshëm	Numri i lejeve për shfrytëzimin resurseve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore Sasia totale e lejuar e shfrytëzimit të ujit



8.15.2 Veprimi 1.3.2 Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të pijshëm

Ky veprim ka të bëjë me shfrytëzimin e paligjshëm të ujit nga rrjeti i ujësjellësit publik (urban edhe rural). Dy raste të ndryshme mund të konsiderohen:

- Lidhjet e paligjshme në rrjetin publik të furnizimit me ujë nga entitetet pa kontratën për shfrytëzimin e ujit;
- Manipulimi i paligjshëm i ujëmatësve nga ana e konsumatorëve që kanë kontratë me furnizuesin.

Në rastin e parë procesi kërkon:

- Identifikimin e lidhjeve të paligjshme;
- Kompletimin e kontratës në mes të shfrytëzuesit dhe kompanisë së furnizimit me ujë;
- Normalisht në këto raste shqiptohet, por kjo mund të mos aplikohet nëse kemi të bëjmë me familje të varfra;
- Verifikimin e kushteve teknike të lidhjen dhe instalimin e ujëmatësit sipas kushteve standarde.

Identifikimi i lidhjeve të paligjshme do të duhej të jetë i thjeshtë dhe fillimisht do të mund të bëhej duke krahasuar regjistrat e kompanisë së ujësjellësit me listat e pronave, e pastaj të kryhen vizita në objektet që nuk kanë kontrata shfrytëzimi. Kjo qasje mund të kombinohet me një proces të “rregullimit” në rastet e ndërtimeve pa leje. Një qasje e koordinuar nga komuna, MMPH dhe ofruesit tjerë të shërbimeve për një tranzicion në kushte plotësisht të legalizuara do të duhej të zbatohet kudo ku lejojnë kushtet.

Lidhur me manipulimin e ujëmatësve, konsiderohet me rëndësi ndërmarrja e veprimeve të mëposhtme:

- Analiza e shfrytëzimit të ujit nga konsumatorët individual në raport me konsumin total të rrjetit: këto analiza duhet të kombinohen me përmirësimin e matjeve të rrjetit dhe zbulimit të rrjedhjeve nga gypat si në veprimin e përshkruar më lartë dhe përmirësimin në menaxhimin e rrjetit në tërësi (inventari i infrastrukturës dhe sistemi i menaxhimit të informatave);
- Inspektimi i ujëmatësve;
- Imponimi i masave zbatuese – si edhe në rastin e mëparshëm kjo do të kërkonte vënien e gjobave, por mund të mos aplikohet në rastet sociale: çështja e pagesave për shërbimet është trajtuar gjithashtu me një masë të veçantë dhe me veprimet e lidhura me atë masë siç është përshkruar mëposhtë;
- Rivendosja e kushteve standarde teknike – largimi i gypave që e anashkalojnë ujëmatësin – ri-instalimin e ujëmatësit.



Njësia	Vlera
Referenca unike	1.3.2
Emri	Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të pijshëm
Përshkrim i shkurtër	Identifikimi i lidhjeve të paligjshme Kompletimi i kontratës në mes të shfrytëzuesit dhe kompanisë së furnizimit me ujë Vënia e gjobave të duhura Verifikimi i kushteve teknike të lidhjes dhe instalimit të valvulës dhe ujëmatësit të aplikueshme për një lidhje standarde
Objektiva strategjike	Shfrytëzimi i ujit
Nën-sektori	Furnizimi me ujë
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	Aktivitetet bazë
Fillimi	2017
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit Kompanitë tjera të furnizimit me ujë (komunale, lokal)
Autoriteti bashkëpunues	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Komunat
Aktivitetet e koordinuara	Legjislacioni për ndërtimet pa leje
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Komunat Komunitetet lokale
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë e Furnizimit me Ujë
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	Uji i pa-faturuar (furnizimi me ujë)



8.15.3 Veprimi 1.3.3 Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit për ujitje

Ky veprim është paralel me atë për furnizimin me ujë të pijshëm të përshkruar më sipër. Si në rastin e furnizimit me ujë ai përfshin dy aspekte:

- Shfrytëzimi i ujit pa kontratë
- Shfrytëzimi i ujit në sasi më të mëdha se sa që lejohen me kontratë

Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	



9.1.4 Veprimi 2.1.4 Programi i Vlerësimit të Licencave për Shkarkimin e Ujërave

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.1.4
Emri	Programi i Vlerësimit të Lejeve për Shkarkimin e Ujërave
Përshkrim i shkurtër	Verifikimi dhe validimi i modelit SVPU të shkarkimit të ujërave të ndotura për secilin pellg lumor duke përdorur të dhënat e përditësuara nga të dhënat e monitorimit Ri-vlerësimi i ndikimit të shkarkimeve individuale Prioritetizimi i shkarkimeve Negocimi me ndotësit për zvogëlimin e mundshëm të ndotjes në periudhat e ardhshme planifikuese Vendosja e kërkesave për përmirësime të arritshme Lëshimi i lejeve të rishikuara
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Kontrolli i Ndotjes
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Aktivitet bazë
Fillimi	2019
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit Kompanitë e Ujitjes
Aktivitetet e koordinuara	Kampanja për Zbatimin e Lejeve të Shkarkimeve
Pronari i infrastrukturës	N/A
Operatori i infrastrukturës	N/A
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	Ndotja e lejuar Cilësia e ujërave pranuese



9.2 Masa 2.2: Të zgjerohet mbulueshmëria me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura

Si në rastin e masave të lidhura me sistemin e furnizimit me ujë, kjo masë përfshin investime të mëdha në sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura. Këto investime do të sigurojnë pajtueshmëri me kërkesat e DTUNU për mbulimin me sistem të tillë hap pas hapi deri në vitin 2035.

Sikurse edhe investimet për zgjerimin e mbulueshmërisë së furnizimit me ujë, edhe këto investime janë përfshirë në bazën e të dhënave të projekteve investive. Kjo përbëhet nga 32 veprime që paraqesin 4 faza të investimeve në secilën nga 8 zonat rajonale.

Këto sisteme do të instalohen si sisteme të veçanta përveç nëse ka arsye të mëdha ekonomike dhe teknike për të përdorur sisteme të kombinuara.

Duhet të theksohet që masat që kanë të bëjnë me grumbullimin e ujërave sipërfaqësore për drenazhim në zonat që aktualisht nuk janë të pajisur me sistem të drenazhës adekuate janë përfshirë në Objektivat Strategjike “Mbrotjtja nga ujërat”.

Rrjedhja e investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura janë përmbledhur më poshtë.

9.3 Masa 2.3: Përmirësimi dhe ruajtja e funksionalitetit të sistemeve ekzistuese të grumbullimit të ujërave të ndotura

Si në rastin e masave të mësipërme që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë, kjo masë ka të bëjë me investime të mëdha në sistemin e mbledhjes së ujërave të ndotura. Këto investime do të sigurojnë pajtimin me kërkesat e DTUNU për mbulim me sistem të tillë. Megjithatë, në këtë instancë investimet kërkojnë vëmendje të mëtutjeshme – mbledhjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëse kanalizimet ekzistuese “të kombinuara” duhet të zëvendësohen me sisteme të ndara, kjo e fundit është e preferuar në shumë aspekte, por është më e kushtueshme për t’u implementuar.

Implementimi i sistemit të ndarë duhet të konsiderohet rast pas rasti, por argumenti i përgjithshëm është së përveç nëse vështirësitë tekniko-financiare të ndërlidhura me implementimin e sistemeve të ndara janë substanciale, kjo qasje do të ndërmerret.

Kjo masë dhe veprimet e asociuara me të kërkojnë gjithashtu eliminimin e lidhjeve ilegale dhe të pa-autorizuara, ngjashëm me aksionet e përshkruara në rastin e sistemeve të furnizimit me ujë të përshkruara më lartë.

Këto investime janë përfshirë në bazën e të dhënave për projektet investive. Ngjashëm kjo përbëhet nga 32 veprime që paraqesin 4 faza të investimeve në secilën nga 8 zonat regjionale.

Rrjedhja e investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura janë përmbledhur më poshtë.

9.4 Masa 2.4: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura

Kjo masë ka të bëjë me sigurimin e trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane siç kërkohet në Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (91/271/EEC). Objektivi i ndërlidhur me këtë masë është:

- Hyrja në operim në përputhshmëri të plotë me kërkesat bazë të DTUNU hap pas hapi deri në vitin 2036, ku prioritet do t’u jepet ndërtimit të impianteve që realizojnë përfitimet me të mëdha për shfrytëzuesit e ujit poshtë rrjedhës.

Rrjedhja e investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura janë përmbledhur më poshtë.

9.5 Programi i investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura

Programi i investimeve i bashkon tri veprimet e përshkruara më sipër.

Investimet e veçanta janë përshkruar në bazën e të dhënave të projektit.

Sipas definicionit, prioritetizim do të thotë se disa iniciativa shtyhen për më vonë në planin strategjik. Pavarësisht përpjekjeve të mëdha që janë bërë kohëve të fundit për përgatitjen e projekteve për trajtimin e ujërave të ndotura, ka argumente bindëse që na çojnë në përfundimin se zbatimi i këtyre planeve për aspektin e trajtimit të ujërave të ndotura do të përkeqësonte gjendjen edhe ashtu të dobët financiare të KRU-ve, deri sa nuk ofrojnë përfitime të qëndrueshme ekonomike për vendin.

Duhet të kemi parasysh se ka kufizime të mëdha jo vetëm të fondeve investuese por edhe në aftësinë për të mbuluar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së impianteve.

Në veçanti aspekti i shkallës së arkëtimit të të ardhurave, siç është referuar më lartë, duhet të konsiderohet me kujdes. Vështirësitë që kanë KRU-të në mbledhjen e të ardhurave për shërbimet ekzistuese sipas të gjitha gjasëve do të rriteshin kur të ngriten tarifat për shërbimet e kanalizimit, rritje kjo që do të nevojitej për mbulimin e kostove të operimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura. Prandaj është propozuar një qasje e kujdesshme për investimet në trajtimin e ujërave të ndotura, ku:

- Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit janë këshilluar që të përshtatin planet e tyre të biznesit që të fokusohen në investimet për mbledhjen e ujërave të ndotura në veçanti ato që do të ulin koston investive për njësi dhe/ose rrisin gjenerimin e të ardhurave
- Një impiant i madh i trajtimit të ujërave të ndotura është ndërtuar gjatë periudhës së parë të planit të veprimit, dhe se ky projekt t'i nënshtrohet monitorimit dhe vlerësimit nga afër në mënyrë që të shërbejë si projekt “pilot” dhe “demonstrim” për investimet e ardhshme të kësaj natyre

Një alokim indikativ i fondeve investuese për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura është dhënë në tabelën e më poshtme.

Tabela 10 Rrjedhja indikative e investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura urbane: 2017 - 2026

<i>Milion Euro</i>	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	<i>10-Vj.</i>
Qeveria	4.40	4.48	4.59	4.72	4.89	5.09	5.31	5.57	5.85	6.16	51.07
Donatorët	4.40	4.48	4.59	4.72	4.89	5.09	5.31	5.57	5.85	7.53	52.44
Gjithsej	8.80	8.96	9.18	9.45	9.78	10.17	10.63	11.14	11.70	13.69	103.50

Si projekt i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura që do të implementohej si prioritar, është konsideruar projekti për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura në Prizren i cili do të përdoret si projekt pilot demonstrues pasi që është përgatitur mirë.

9.6 Masa 2.6: Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura

Të sigurohet trajtim i duhur dhe ripërdorim i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me theks të veçantë në gjenerimin e energjisë për impiantet e mëdha dhe përgatitja për përdorim të dobishëm në bujqësi për impiantet e vogla.

9.6.1 Veprimi 2.6.1 Përgatitja e strategjisë shtetërore për menaxhimin dhe largimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura

Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura do të jetë një çështje me rëndësi kur të implementohet programi i investimeve për trajtimin e ujërave të ndotura. Prandaj është vendimtare që plani për menaxhimin e këtyre mbetjeve të përgatitet paraprakisht. Strategjia e menaxhimit të këtyre mbetjeve nevojitet të zhvillohet. Duhet cekur se:

- Trajtimi i llumit për gjenerimin e energjisë është i mundshëm vetëm nëse impiantet janë të mëdha;
- Përdorimi i këtij llumi në bujqësi është i rregulluar sipas Ligjit të BE (Direktiva 86/278/EEC);



- Shkarkimi i mbetjeve të tilla në deponi është në kundërshtim me Ligjin e BE (Direktiva për Deponitë e mbetjeve të ngurta);
- Kontaminimi i ujërave të ndotura me metale të rënda rezulton në koncentrim me të lartë të këtyre metaleve në mbetjet e ngurta dhe e bënë atë shumë më vështirë për ta deponuar – prandaj një detyrim duhet t’u vihet shkarkuesve komercial dhe industrial në kanalizim për të reflektuar në këtë çështje.

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.6.1
Emri	Përgatitja e Strategjisë Shtetërore për menaxhimin dhe shkarkimin e llumit nga trajtimi i ujërave
Përshkrim i shkurtër	Vlerësimi i parashikimit të llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura Identifikimi i opsioneve, përgatitja, optimizimi Përcaktimi i opsionit të preferuar Udhëzimi Administrativ - adoptimi
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Trajtimi i ujërave të ndotura
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Aktivitet bazë
Fillimi	2020
Përfundimi	2021
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë Rajonale të Ujësjetjes
Aktivitetet e koordinuara	Impiantet e mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të ndotura
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë Rajonale të Ujësjetjes
Veprimet pasuese	Investimet në Infrastrukturë
Ref e treguesve të verifikueshëm	



9.6.2 Veprimi 2.6.2 Investimet që kanë të bëjnë me strategjinë e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura

Investimet që kanë të bëjnë me strategjinë e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura duhet të integrohen në bazën e të dhënave për projektet investive.

Në shumicën e rasteve kjo parashihet të përfshijë amandamentimin apo zgjerimin e projekteve ekzistuese për ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, edhe pse në disa raste është vetëm një impiant i menaxhimit të llumit.

9.7 Masa 2.7: Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia

Është e njohur që aktivitetet bujqësore siç janë përdorimi i plehrave dhe agro-kimikateve tjera (p.sh. biocidet) mund të shkaktojnë ndotje difuzive të ujërave përmes kullimit dhe infiltrimit të ujit të kontaminuar. Kjo është reflektuar në Direktivën Kornizë Uërave (2000/60/EC) dhe në Direktivën e Nitrateve (91/676/EEC).

Edhe pse niveli i aktiviteteve bujqësore është ende relativisht i ulët, duhet të adoptohen rregullore që të arrihet një balancë në mes të përdorimit të agro-kimikateve dhe të parandalimit të ndotjes difuzive.

Kjo masë dhe veprimet e përfshira në të duhet të koordinohen me politikën agro-mjedisore

Neni 61 i ligjit për ujëra thotë:

- Ndalimi i plehërimit dhe përdorimi i preparateve kimike
 - Në zonat me vërshime ndalohet përdorimi i substancave organike dhe inorganike, për plehërimin e tokave, spërkatjen e pemëve dhe për mbrojtjen e bimëve, lumenjve, shtresimet mbrojtëse për lumenj dhe rezervuare, në distancë prej 30 metrash.



9.7.1 Veprimi 2.7.1 Udhëzues për prodhuesit bujqësorë – përdorimi i plehrave

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.7.1
Emri	Udhëzimet për Prodhuesit Bujqësorë – Përdorimi i Plehrave
Përshkrim i shkurtër	Përgatitja dhe Shpërndarja e Udhëzuesve Mbështetje me shërbime shtesë
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Ndotja difuzive
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Aktivitet bazë Masa investive për deponimin e plehrave organike
Fillimi	2020
Përfundimi	2021
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Plani për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale Strategjia e Ilumit nga Ujërat e Ndotura
Pronari i infrastrukturës	Prodhuesit Bujqësorë
Operatori i infrastrukturës	Prodhuesit Bujqësorë
Veprimet pasuese	Investime në infrastrukturën e nevojshme për deponimin e plehrave organike
Ref e treguesve të verifikueshëm	

Ju lutem referojuni Direktivës së Nitrates (91/676/EEC) dhe udhëzimeve përkatëse.



9.7.2 Veprimi 2.7.2 Udhëzimet për Prodhuesit Bujqësorë – Përdorimi i Biocideve

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.7.2
Emri	Udhëzimet për Prodhuesit Bujqësorë – Përdorimi i Biocideve
Përshkrim i shkurtër	Përgatitja dhe Shpërndarja e Udhëzuesve Mbështetje nga Shërbimet shtesë
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Ndotja Difuzive
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	Aktivitet bazë
Fillimi	2019
Përfundimi	2020
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Plani për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale
Pronari i infrastrukturës	Prodhuesit Bujqësorë
Operatori i infrastrukturës	Prodhuesit Bujqësorë
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	

9.8 Masa 2.8: Ulja e ndotjeve difuzive nga burimet jo-bujqësore

Ndotjet difuzive që vijnë si pasojë e burimeve jo-bujqësore duhet gjithashtu të konsiderohen duke përfshirë ndotjet difuzive që vijnë nga burimet tjera siç janë deponimi i mbeturinave të kontaminuara, minierat dhe aktivitetet e kaluara industriale.

Shumë nga aktivitetet që vijnë si pasojë e kontaminimit të tokave nga aktivitetet industriale do të kërkojnë përpjekje të konsiderueshme për rehabilitimin e tyre. Megjithatë, ekzistojnë masa që do të mund të merrshin për të zvogëluar kontaminimin e vazhdueshëm të ujërave: deponimi i mbeturinave të ngurta komunale është një brengë e madhe për këtë regjion. Prandaj qasja në dy faza është ndërmarrë ku kërkohen aksione të menjëhershme për zvogëlimin e problemeve që vijnë si pasojë e deponimit të mbeturinave të ngurta komunale, dhe qasja afatgjatë është adaptuar për çështjen e sipërfaqeve të mëdha të tokave të kontaminuara.



9.8.1 Veprimi 2.8.1 Regjistri i tokave të kontaminuara

Në mënyrë që të zhvillohet një qasje koherente dhe gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e problemit të tokave të kontaminuara, hapi i parë është krijimi i një regjistri.

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.8.1
Emri	Regjistri i Tokave të Kontaminuara
Përshkrim i shkurtër	Identifikimi i zonave me toka të kontaminuara Karakterizimi i shkurtër Përgatitja e hartave Publikimet
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Tokat e kontaminuara
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2018
Përfundimi	2021
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Komunat
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Aktivitetet e koordinuara	Plani dhe Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave
Pronari i infrastrukturës	
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	Strategjia dhe Plani I Veprimit
Ref e treguesve të verifikueshëm	Sipërfaqja e tokave të kontaminuara sipas klasifikimeve



9.8.2 Veprimi 2.8.2 Plani dhe Strategjia për Rehabilitimin e Tokave të Kontaminuara

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.8.2
Emri	Plani dhe Strategjia për Rehabilitimin e Tokave të Kontaminuara
Përshkrim i shkurtër	Përgatitja e regjistrit të tokave të kontaminuara Vlerësimi i rrezikut Përgatitja e opsioneve për rehabilitim Prioritetizimi Strategjia afatgjate Plani i Veprimit afatshkurtër
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Tokat e kontaminuara
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2020
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Komunat
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	

9.8.3 Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale – i menjëhershëm

Projekti i financuar nga IPA për menaxhimin e mbeturinave (CRIS vendimi numër 2013 / 024-216), si dhe projekte tjera të ngjajshme janë duke mbështetur zhvillimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale. Megjithatë përgatitja e planeve dhe implementimi i tyre do të merr disa vite. Në kohën e intervenimit është esenciale që të ndalohet hedhja e mbeturinave komunale si dhe atyre nga prishjet e ndërtimeve afër rrjedhave ujore.

Për të pasur efekt ky veprim, është e domosdoshme të sigurohet që:



- Secila komunë ka së paku një lokacion për hedhjen e mbeturinave të ngurta komunale dhe mbeturinat nga ndërtimtaria
- Të informohen të gjithë banorët për ofrimin e shërbimit të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave të ngurta
- Të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj atyre që nuk zbatojnë ligjin

Njësia	Vlera
Referenca unike	2.8.3
Emri	Përcaktimi i lokacioneve për deponimin e mbeturinave komunale
Përshkrim i shkurtër	Caktimi në të gjitha komunat i lokacioneve për deponimin e mbeturinave komunale për përdorim nga banorët dhe bizneset lokale
Objektiva strategjike	Mbrojtja e Ujërave
Nën-sektori	Mbeturinat e ngurta
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2020
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Komunat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	Programi për rehabilitimin e tokave të kontaminuara
Ref e treguesve të verifikueshëm	



10 Veprimet dhe investimet – mbrojtja nga ujërat

Objektivi Strategjik për Mbrojtjen nga Ujërat përcaktohet si:

- “Të arrihet niveli i pranueshëm i mbrojtjes së popullatës dhe pronave nga efektet negative të ujit duke përfshirë vërshimet, erozionin dhe vërshimet në mënyrë të balancuar ekonomike dhe kosto-efektive.”

Parakushtet kyçe për arritjen e këtij objektivi janë përcaktuar në Direktivën për Vërshimet të BE (2007/60/EC) duke përfshirë:

- Rrjetet e monitorimit
- Modelet hidraulike
- Hartat e dëmeve nga vërshimet
- Hartat e rrezikut nga vërshimet

Zhvillime të rëndësishme kërkohen për të gjitha aspektet e lartpërmendura në mënyrë që të ofrohet bazë e mirë për zhvillimin e masave për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet (investimet). Për shkak të kësaj mungese të informacionit dhe analizave është e vështirë në këtë kohë që të ceket një paketë komplete e investimeve në infrastrukturën që mbulon të gjitha fushat. Megjithatë, duhet cekur së në disa fusha ka analiza dhe informata të mjaftueshme¹³¹. Prandaj, parashihet një qasje “dy drejtimshë” cila parasheh:

- Faza e parë - investimet
 - Investimet pa-pendim në mirëmbajtjen dhe restaurimin e infrastrukturës ekzistuese
 - Investimet në infrastrukturën e re aty ku ka analiza dhe informata të mjaftueshme
- Faza e dytë – përgatitja për fazat vijuese
 - Përmirësim në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave
 - Përgatitja e planeve për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet duke përfshirë paketën investive

Planet për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet të hartuara gjatë fazës së parë do të:

- Specifikojnë në detaje investimet me urgjente për fazën e dytë;
- Specifikojnë masat e mëtutjeshme për fazat në vazhdim;
- Të rishikohen dhe përditësohen për çdo 5 - 6 vjet.

Duhet cekur së të dhënat e projektit menaxhues të GIZ për përgatitjen e Sistemeve Rajonale të Paralajmërimit të Hershëm të Vërshimeve kanë rëndësi të madhe për këtë Objektiv Strategjik si dhe për masat dhe aksionet e përshkruara me poshtë.

10.1 Masa 3.1: Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet

Kërkohet kompletimi i legjislacionit sekondar të paraparë në kapitullin VIII të Ligjit për Ujëra.

10.1.1 Veprimi 3.1.1 Krijimi i një sistemi të mbledhjes, verifikimit dhe publikimit të të dhënave

Ky veprim është parakusht për përgatitjen e hartave të përditësuara për rrezikun nga vërshimet dhe analizave të rrezikut. Gjithashtu, ky veprim është esencial për zbatimin e masave shumë të nevojshme për paralajmërimin e vërshimeve. Ky veprim mbështetet nga projekti i GIZ.

¹³¹ EU Funded investigation of flood protection requirements in the Morava I Bince basin (Viti and Gjilan)



Njësia	Vlera
Referenca unike	3.1.1
Emri	Menaxhimi i të dhënave për rrezikun nga vërshimet
Përshkrim i shkurtër	Themelimi dhe mirëmbajtja e një rrjeti të stacioneve meteorologjike dhe stacioneve matëse për lumenj të pajisur me sistemet për telemetri, verifikimin dhe publikimin e të dhënave
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Shih forcimi Institucional i IHMK
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Komunat
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Forcimi i institucioneve – Objektivi Strategjik i Qeverisjes me poshtë
Pronari i infrastrukturës	MMPH
Operatori i infrastrukturës	IHMK
Veprimet pasuese	Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit
Ref. e treguesve të verifikueshëm	Intensiteti i raportimit

Ky Veprim do të përfshijë:

- Kompletimin e të dhënave historike për vërshimet duke përfshirë vjetarët statistikorë të IHMK, shënimet komunale, evidencë nga banorëve lokal;
- Instalimin e pajisjeve automatike për matjen e reshjeve me telemetri në lokacionet ekzistuese dhe në të gjitha kompanitë e ujit;
- Instalimin e stacioneve për matjen e rrjedhave dhe përgatitjen e kurbave krahasuese për të gjitha stacionet;
- Sistemet monitoruese për akumulacionet (nivelet);
- Sistemin e menaxhimit të të dhënave për reshjet, të dhënat për prurjen dhe nivelet e ujërave duke përfshirë ruajtjen e këtyre të dhënave, ruajtjen dhe publikimin e tyre.

Përveç kësaj nën këtë veprim duhet t'i jepet rëndësi:

- Rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore;
- Monitorimin e borës – instrumentet për matjen e nivelit të dëborës në lartësi të mëdha.



10.1.2 Veprimi 3.1.2 Përgatitja e Planeve të para të Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.1.2
Emri	Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet
Përshkrim i shkurtër	<p>Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet në pajtim me kërkesat e Direktivës për Vërshimet duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Përgatitjen e udhëzimeve standarde për Planet Shtetërore të Rrezikut nga Vërshimet• Përgatitjen e udhëzimeve standarde për hulumtimin e rrafshëve të përmbytura;• Hulumtimin topografik të kanaleve të lumenjve;• Përgatitjen e modeleve hidraulike të lumenjve me ISIS¹³² apo HEC - RAS,¹³³• Hartat e rrezikut nga vërshimet;• Hartat e kërcënimit nga vërshimet;• Vlerësimin e dëmeve të rrezikut nga vërshimet;• Identifikimin dhe vlerësimin e opsioneve;• Planet Menaxhuese dhe Prioritetet Investive për Rrezikun nga Vërshimet.
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Natyrë e kostove	Projekt i Asistencës Teknike
Kosto e parashikuar:	€2,000,000
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Komunat, KNMU
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Planifikimi Hapësinor, Planet e përgjithshme zhvillimore urbane
Pronari i infrastrukturës	Komunat, MMPH, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

¹³² <http://www.halcrow.com/isis/>

¹³³ <http://www.hec.usace.army.mil/software/hec-ras/>



Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	Rishikimi dhe rafinimi i planeve për çdo 5 – 6 vjet
Ref. e treguesve të verifikueshëm	Plani i hartuar Identifikimi i investimeve me prioritet dhe veprimet

10.1.3 Veprimi 3.1.3 Mbështetja për Zbatimin e Planeve të para për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet

Njësia	Vlera
Referenca Unike	3.1.3
Emri	Zbatimi i Planeve për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet
Përshkrim i Shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> • Dizajnimi i masave për mbrojtje nga vërshimet • Përgatitja e dokumenteve të tenderit • Asistenca në tenderim
Objektiva Strategjike	Mbrojtja nga uji
Nën-sektori	Rreziku nga Vërshimet
Pellgu/gjet Lumore	Të gjitha
Natyra e Kostove	Projekt i Asistencës Teknike
Kosto e parashikuar:	€2,000,000
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me Përgjegjësi të Drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti Bashkëpunues	Komunat
Palët Tjera Kyçe të Interesit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, KNMU
Aktivitetet e Koordinuara	Planifikimi Hapësinor Planifikimi për zhvillimin e planeve urbane
Pronari i Infrastrukturës	Komunat, MMPH, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i Infrastrukturës	
Veprimet Pasuese	Rafinimi dhe rishikimi i planit për ç'do 5 – 6 vjet
Ref. e Treguesve të Verifikueshëm	



10.1.4 Veprimi 3.1.4 Sistemi menaxhues dhe mirëmbajtja e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve

Ngjashëm si në rastin e sistemit të inventarit të aseteve për infrastrukturën e shërbimeve me ujë, një sistem i menaxhimit të infrastrukturës (inspektimet, mirëmbajtja, riparimet) nevojitet për infrastrukturën për parandalimin/mbrojtjen nga vërshimet. Në pajtim me Ligjin për Ujëra ky sistem do të jetë përgjegjësi e përbashkët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunave.

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.1.4
Emri	Sistemi menaxhues dhe mirëmbajtja e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve ¹³⁴
Përshkrim i shkurtër	Regjistri i infrastrukturës Procedurat e mirëmbajtjes së regjistrave Programi i inspektimit të infrastrukturës Programi i mirëmbajtjes së infrastrukturës
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2018
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Komunat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave)
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Planifikimi Hapësinor Përgatitja e planeve të përgjithshme zhvillimore urbane
Pronari i infrastrukturës	Komunat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	Alokimi i buxhetit për mirëmbajtje
Ref. e treguesve të verifikueshëm	

¹³⁴ Digat dhe akumulimet përcjellëse paraqesin “rast specifik” dhe prandaj janë trajtuar në mënyrë specifike më poshtë



Do të integrohet me implementimin e masave të specifikuara në Kornizën e Menaxhimit të Vërshimeve dhe gjithashtu me Kornizën e Menaxhimit të Thatësirave (më sipër):

10.2 Masa 3.2 Paralajmërimi i vërshimeve dhe menaxhimi i emergjencave

Ngjashëm si me masat tjera të këtij Objektiv Strategjik, potenciali për dëme nga vërshimet mbetet si mundësi. Kërkohej një sistem i parandalimit të vërshimeve dhe reagimit në rast të emergjencave. Kjo e fundit veç ekziston, por avancime të mëtutjeshme janë të nevojshme për paralajmërimin e vërshimeve.



10.2.1 Sistemi i monitorimit dhe paralajmërimit të rrezikut nga vërshimet

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.2.1
Emri	Sistemi i monitorimit dhe paralajmërimit të rrezikut nga vërshimet
Përshkrim i shkurtër	Përgatitja e sistemit shtetëror për paralajmërimin e vërshimeve të bazuar në ISR ¹³⁵ Monitorimi i sistemit rajonal të paralajmërimit për vërshime bazuar në MeteoAlarm ¹³⁶ Monitorimi i statusit të vërshimeve dhe lëshimi i paralajmërimeve sipas nevojës Regjistrimi në forumin EFAS dhe monitorimi në baza të rregullta
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2018
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave)
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Projekti i GIZ për Drinin e Bardhë Menaxhimi i të Dhënave Mjedisore
Pronari i infrastrukturës	Komunat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	Alokimi i buxhetit për mirëmbajtje
Ref e treguesve të verifikueshëm	

¹³⁵ Indeksi i Standardizuar i Reshjeve

¹³⁶ <http://meteoalarm.eu>



10.2.2 Menaxhimi i emergjencave të vërsimeve

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.2.2
Emri	Menaxhimi i emergjencave të vërsimeve
Përshkrim i shkurtër	Procedurat në rast emergjence Prokurimi i pajisjeve Trajnimi
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2018
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave) Komunat
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Palët tjera kyçe të interesit	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
Aktivitetet e koordinuara	Projekti i GIZ për ndryshimet klimatike
Pronari i infrastrukturës	
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	



10.3 Masa 3.3: Infrastruktura për parandalimin dhe mbrojtjen nga vërshimet

Qëllimi i kësaj mase është që të sigurohet implementimi i investimeve për parandalimin e rrezikut nga vërshimet duke përfshirë rehabilitimin e strukturave ekzistuese për mbrojtjen nga vërshimet.

10.3.1 Veprimi 3.3.1 Investimet në Infrastrukturën për Mbrojtje nga Vërshimet– Faza 1

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.3.3
Emri	Investimet në Infrastrukturën për Mbrojtje nga Vërshimet – Faza 1
Përshkrim i shkurtër	Rehabilitimi i strukturave ekzistuese për mbrojtje nga vërshimet. Implementimi i projekteve të gatshme për investime për infrastrukturën e re për parandalimin e vërshimeve
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/et lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2018
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Komunat
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave)
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Komunat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	
Ref. e treguesve të verifikueshëm	

10.3.2 Veprimi 3.3.2 Sistemi i Drenazimit Urban

Siç u diskutua më sipër, shumica e sistemeve të sistemeve të kanalizimit momentalisht janë “të kombinuara”, d.m.th. ato mbledhin edhe ujërat e ndotura edhe ato atmosferike. Politika e përvetësuar në këtë strategji është që ngadalë të lëvizet drejt ndarjes së tyre në sisteme të veçanta kudo që është praktike dhe e përballueshme. Qasja e ndërmarrë është:



- Implementimi i sistemeve të ndara për të gjitha zonat e reja (dhe zonat në të cilat nuk ka një sistem të tillë);
- Transformimi gradual gjatë procesit të renovimit dhe zëvendësimit të sistemeve ekzistuese nga ato të kombinuara në të ndara, përveç në rastet ku transformimi i tillë është shumë i shtrenjtë ose teknikisht jopraktik;
- Aplikimi i sistemeve të qëndrueshme urbane të drenazhimit (SQUD) kudo që është e përshtatshme dhe e aplikueshme, në veçanti në zonat e reja zhvillimore dhe gjatë renovimit të sistemeve ekzistuese¹³⁷

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.3.2
Emri	Sistemet e Qëndrueshme Urbane të Drenazhimit
Përshkrim i shkurtër	Udhëzimet për komunat Planet rregullative urbane për komunat Planet komunale për drenazhet urbane
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Aktivitet bazë
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Komunat
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit
Aktivitetet e koordinuara	Infrastruktura e mbledhjes së ujërave të ndotura Planet e zhvillimit dhe rregullimit urban
Pronari i infrastrukturës	Komunat Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Operatori i infrastrukturës	Komunat Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	

¹³⁷ Shiko për shembull: <http://www.susdrain.org>



10.3.3 Veprimi 3.3.3 Investimet në infrastrukturën për mbrojtje nga vërshimet – Faza 2

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.3.3
Emri	Investimet në infrastrukturën për parandalimin e rrezikut nga vërshimet – Faza 2
Përshkrim i shkurtër	Implementimi i masave të investimeve të reja prioritare siç janë përcaktuar në Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	
Fillimi	2019
Përfundimi	2026
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Komunat
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave), KNMU
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Komunat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	
Ref. e treguesve të verifikueshëm	

Ky aksion përfshin ndërtimin dhe komisionimin e projekteve prioritare për mbrojtje nga vërshimet dhe do të kërkojë investime të mëdha kapitale. Do të jetë subjekt i mbështetjes në implementim përmes veprimeve të përshkruara më sipër.

Duhet të përcaktohet me saktësi pronësia e aseteve për mbrojtjen dhe menaxhimin e mbrojtjes nga vërshimet. Pronare zakonisht do të jetë komuna, dhe komuna duhet të marrë përgjegjësinë për mirëmbajtjen e strukturave për mbrojtje nga vërshimet. Duhet të ndahet buxheti nga ana e të gjitha komunave relevante në mënyrë që të përmbushet kjo përgjegjësi.

Projektet për investime kapitale me prioritet nuk mund të specifikohen me saktësi në këtë kohë, por do të bëhen të ditura përmes veprimit të parë të përshkruar më sipër. Për qëllimet e planifikimit



makro-financiar duhet të parashihet një vëllim i investimeve përafërsisht €50 milion i shpërndarë përgjatë 10 viteve (plani i parë dhe i dytë i veprimit).

Një strategji financiare e detajuar për këtë iniciativë do të përgatitet si pjesë e veprimeve përgatitore të përshkruara më lartë.

Kjo duhet të pasohet me alokime buxhetore adekuate dhe duhet të kërkohet ndihma e donatorëve për këtë iniciativë.

Një rrjedhë indikative e investimeve për këtë iniciativë është dhënë më poshtë.

Tabela 116 Investimet Indikative për masat e mbrojtjes nga vërshimet: 2017 - 2026

<i>Million Euro</i>	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	<i>10-Vj.</i>
Qeveria	1.00	1.00	3.00	3.03	2.16	2.24	2.34	2.46	2.58	2.72	22.53
Donatorë	1.00	1.00	3.00	3.03	2.16	2.24	2.34	2.46	2.58	3.32	23.13
Gjithsej	2.00	2.00	6.00	6.05	4.32	4.49	4.69	4.91	5.16	6.04	45.66

Shpenzimet relativisht të ulëta në dy vitet e para të kësaj periudhe reflektojnë nevojën për veprime përgatitore të përshkruara më lartë që duhet të ndërmerren para se të fillojnë investimet kryesore.

10.4 Masa 3.4: Sigurimi që të gjitha strukturat ekzistuese akumuluese janë të sigurta

Kjo masë është e ndërlidhur me masën që ka të bëjë me inspektimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve. Megjithatë, pasi që digat dhe akumulimet kanë disa funksione, jo vetëm parandalimin e vërshimeve, dhe janë struktura të mëdha, një masë specifike është përfshirë këtu.

10.4.1 Veprimi 3.4.1 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së digave

Qëllimi i këtij veprimi është që të vendoset një vlerësim i vazhdueshëm i sigurisë dhe integritetit fizik të strukturave të akumulimeve ujore dhe një sistem “reagues” që përfshin masat e nevojshme për të mbajtur sigurinë dhe integritetin e strukturave të tilla. Këtu i referohemi raportit të Task Forcës për Sigurinë e Digave.



Njësia	Vlera
Referenca unike	3.4.1
Emri	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Digave
Përshkrim i shkurtër	Sqarimi ligjor i përgjegjësisë për sigurinë e digave (neni 42 i Ligjit për Ujëra dhe aktet nënligjore) Hulumtimi i Digave (neni 43) Dhënia e alarmit në rast rreziku (neni 44) Caktimi i një inspektorati të plotfuqishëm
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/et lumore	Të gjithë
Kosto e parashikuar:	€990,000
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Palët tjera kyçe të interesit	Kompanitë e Ujitjes Kompanitë Regjionale të Ujit Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave) KNMU
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Pronarët privat
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë e Ujitjes Pronarët privat
Veprimet pasuese	Implementimi i vazhdueshëm i inspektimeve dhe detyrimeve
Ref. e treguesve të verifikueshëm	



10.4.2 Aksioni 3.4.2 Renovimi i digave ekzistuese dhe akumulimeve

Njësia	Vlera
Referenca unike	3.4.2
Emri	Renovimi i Digave Ekzistuese dhe Akumulimeve (neni 43.4)
Përshkrim i shkurtër	Vlerësim i detajuar (prioritetizuar nga raporti për TFU) Përgatitja e opsioneve për masat rinovuese Tenderimi dhe kontraktimi i masave infrastrukturore
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Rreziku nga vërshimet
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Mbetet të përcaktohet: ~€1,500,000
Fillimi	2017
Përfundimi	2019
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Autoriteti bashkëpunues	Kompanitë e Ujitjes, Kompanitë Regjionale të Ujit, KNMU
Palët tjera kyçe të interesit	Pronarët privat në strukturat e akumulimeve ujore
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Pronarët privat
Operatori i infrastrukturës	Kompanitë për Ujitje Pronarët privat
Veprimet pasuese	Mirëmbajtja siç është specifikuar me lartë
Ref. e treguesve të verifikueshëm	

10.5 Masa 3.4: Menaxhimi i erozionit dhe rrëkeve

Kjo masë ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe implementimin e aksionit për parandalimin dhe kontrollin e erozionit.

10.5.1 Veprimi 3.4.1 Përgatitja e Planeve për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit

Draftimi i raportit për vlerësimin e rrezikut nga erozioni në nivel komunal duke përfshirë përgatitjen e hartave dhe masave që duhet të ndërmerren për parandalimin e erozionit.



Njësia	Vlera
Referenca unike	3.5.1
Emri	Plani Menaxhues për Rrëke dhe Erozion (nenet 51 - 54)
Përshkrim i shkurtër	Identifikimi i zonave të erozionit (neni 51.1) Caktimi i zonave të erozionit (nenet 51.2, 54.1) Përcaktimi i masave dhe detyrave (nenet 51.3, 54.2) Lajmërimi i banorëve dhe entiteteve ekonomike në zonat e përcaktuara erozive
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Erozioni
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Aktivitet bazë
Fillimi	2019
Përfundimi	2021
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Komunat
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	
Pronari i infrastrukturës	
Operatori i infrastrukturës	
Veprimet pasuese	
Ref e treguesve të verifikueshëm	

10.5.2 Aksioni 3.5.2 Implementimi i Planeve për Menaxhimin e Rrëkeve dhe Erozionit

Siç është përcaktuar në Ligjin për Ujëra, Plani për Menaxhimin e Erozionit duhet të përfshijë një numër masash duke përfshirë:

- Ndalimin e nxjerrjes së dheut, rërës, zhavorit dhe gurëve;
- Ndalimin i shartimit, prerjeve dhe nxjerrjes së drunjve dhe vegetacionit;
- Ndalimi i kullotjes nga kafshët;
- Pyllëzimi, mbjellja e barit; dhe
- Ndryshimet hidro-morfologjike (p.sh. argjinaturat, kanalizimet);
- Prerja e drunjve mund të bëhet në kushte të caktuara, mënyra dhe procedura e të cilave siguron mbrojtjen nga erozioni dhe është në pajtim me Ligjin për Pyjet.



Njësia	Vlera
Referenca unike	3.5.2
Emri	Implementimi i Planeve të Menaxhimit të Rrëkeve dhe Erozionit.
Përshkrim i shkurtër	Udhëzimet për banorët dhe entitetet ekonomike që gjenden në zonën erozive Procedurat e inspektimit dhe implementimit Implementimi i masave
Objektiva strategjike	Mbrojtja nga Ujërat
Nën-sektori	Erozioni
Pellgu/gjet lumore	Të gjitha
Kosto e parashikuar:	Të përcaktohet në planin për menaxhimin e erozionit
Fillimi	2018
Përfundimi	2022
Autoriteti me përgjegjësi të drejtpërdrejt	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Komunat
Autoriteti bashkëpunues	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Palët tjera kyçe të interesit	
Aktivitetet e koordinuara	Strategjia për Pylltari Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Plani Hapësinor deri me 2020+
Pronari i infrastrukturës	
